



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance

KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE

2015-2017

Prill, 2014

Lista e shkurtesave

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AKK	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronave
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AMKMK	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
ARKEP	Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BDMS	Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
BPV	Bruto Produkti Vendor
BSL	Ndërtimi i Burgut të Sigurisë së Lartë
CEER	Këshilli i Rregullatorit të Energjisë Evropiane
DD	Departamenti i Drejtësisë
DBK	Departamenti i Buxhetit Komunal
EPK	Ekipet Përgatitore Komunale
ERRE	Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë
EU	Unioni Evropian
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GJKK	Gjykata Kushtetuese e Kosovës
HVK	Të Hyrat Vetanake të Komunave
ICO	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Koordinimi i Programit të Asistencës
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KG	Komisioni i Granteve
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKK	Komisioni Kosovar i Konkurrencës
KKTK	Këshilli Kosovar për Trashëgimi Kulturor
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KPMM	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
PZPA	Paneli për Parashpresa dhe Ankesa
LFPL	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
LVQL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Ministria e Financave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
KG	Komisioni i Granteve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
NSH	Ndërmarrjet Shoqërore
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PIP	Programi për Investime Publike
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
RGJM	Rishikimi gjashtëmujor
SEQ	Statistikat Financiare të Qeverisë
SKG	Sekretaria e Komisionit të Granteve
THVK	Të Hyrat Vetanake Komunale
TI	Teknologjia Informative
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UP	Universiteti i Prishtinës
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZK	Zyra e Kryetarit
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZKTMK	Zyra e Koordinatorit të TMK-së
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit të Evropës
ZP	Zyra e Presidentit
ZRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRRUM	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina

Përmbajtja:

DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME TË QEVERISË 2015 – 2017	7
KORNIZA E PËRGJITHSHME	7
1. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik.....	8
2. Qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit.....	11
3. Zhvillimi i resurseve njerëzore	12
4. Rritja e standardit jetësor dhe mirëqenies sociale	13
2. KORNIZA MAKRO-FISKALE 2015-2017	15
2.2. SEKTORI REAL.....	16
2.2.1. LËVIZJA E ÇMIMEVE DHE PARASHIKIMI PËR PERIUDHËN 2013-2015	17
2.3. SEKTORI I JASHTËM	18
2.4. SEKTORI FINANCIAR.....	21
2.5. SEKTORI FISKAL 2015-2017.....	22
2.5.1. TË HYRAT BUXHETORE 2015-2017	22
2.5.1.1. TË HYRAT SIPAS BURIMIT TË ARKËTIMIT	23
2.5.2. SHPENZIMET SIPAS KATEGORIVE BUXHETORE 2015-2017	25
2.5.3. RREZIQET FISKALE PËR PERIUDHËN 2015-2017	31
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	36
ZYRA E PRESIDENTIT	39
ZYRA E KRYEMINISTRIT	41
MINISTRIA E FINANCAVE.....	44
MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE	52
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	55
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË.....	61
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS	65
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	69
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	74
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË.....	78
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE	84
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	90
MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	95
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL.....	98
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	100
MINISTRIA E DREJTËSISË	112

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME.....	118
MINISTRIA PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS	122
MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN	129
MINISTRIA E DIASPORËS	133
KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK	136
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE ARTEVE TË KOSOVËS	140
AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE.	143
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	145
ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI	147
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT	149
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT.....	152
AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS	154
UNIVERSITETI I PRISHTINËS.....	156
GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS.....	161
KOMISIONI KOSOVAR I KONKURRENCËS.....	163
AGJENCIA E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË.....	165
KËSHILLI I KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE.....	167
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARSHTRESA	169
KËSHILLI I PAVARUR MBIKQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS.....	171
PROKURORI I SHTETIT	173
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJTHSHËM	176
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA.....	178
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	180
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL.....	182
KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE	185
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE.....	187
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE.....	189
INSTITUCIONI I AVOKATIT TE POPULLIT	191
INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS.....	193
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS	197
AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS	201
AGJENCIA SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	205
RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS.....	207
AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS	209

KASH KOMUNAL 2015-2017	211
FINANCIMI KOMUNAL NGA GRANTET QEVERITARE DHE TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE PËR VITIN 2015 SI DHE VLERËSIMET PËR VITIN 2016-2017, SI PJESË INTEGRALE E KASH-IT 2015-2017	211
1 BURIMET E FINANCIMIT KOMUNAL PËR VITIN 2015-2017	212
1.1 GRANTI I PËRGJITHSHËM.....	215
1.2 Granti specifik për Arsim	219
1.3 Granti specifik për Shëndetësi primare	221
1.4 Shëndetësia sekondare: spitalet në komunat me kompetenca të zgjeruara:	223
1.5 Financimi i Shërbimeve rezidenciale në komunat Skenderaj dhe Graçanicë	224
1.6 Të hyrat Vetanake Komonale	224
2 TRANSFERI I KOMPETENCAVE TË BARTURA DHE TË DELEGUARA	226
3 KOMUNAT E REJA - DECENTRALIZIMI.....	226

DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME TË QEVERISË 2015 – 2017

KORNIZA E PËRGJITHSHME

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve paraqet koherencën, koordinimin dhe ndërlidhjen funksionale ndërmjet prioriteteve të përcaktuara me dokumente strategjike të qeverisë në një tërësi si dhe përfshirjen e tyre konkrete në projeksionet buxhetore për periudhën afatmesme. Për qëllime të orientimit sa më të mirë të ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor është hartuar Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2015-2017 përmes së cilës konfirmohet përkushtimi i qeverisë për t'i dhënë efekt prioriteteve kryesore strategjike duke synuar rritje të qëndrueshme ekonomike, vendosjen e standardeve të larta të qeverisjes së mirë dhe sundimit të rendit dhe ligjit, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe përmirësimin e standardit jetësor dhe mirëqenies sociale të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve mundëson zhvillimin e një buxheti të qëndrueshëm për periudhën 2015-2017, që përfshin financimin e prioriteteve kyçe me resurset e disponueshme, të përcaktuara në Deklaratën e Prioriteteve të Politikave Afatmesme të Qeverisë (DPPA).

Prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017, janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe institucional të vendit. Prioritetet afatmesme 2015-2017, bazohen në Programin e Qeverisë, Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016, dhe Planin e Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim. Në harmoni me prioritetet e përcaktuara përmes DPPA-së, KASH-i 2015-2017 merr parasysh edhe zotimet e Qeverisë së Kosovës në raport me institucionet ndërkombëtare. Në këtë kontekst KASH-i është hartuar në pajtim me politikat fiskale – buxhetore për të cilat Qeveria ka diskutuar dhe ka rënë në ujdi me Fondin Monetar Ndërkombëtarë (FMN). Duke u bazuar në këtë, procesi i zhvillimit buxhetor duhet të ketë parasysh respektimin e rregullës fiskale ku deficiti i përgjithshëm buxhetor nuk duhet të kalojë 2% të Bruto Prodhimit Vendor (BPV).

Qëndrueshmëria buxhetore dhe projeksionet makro-fiskale për periudhën afatmesme kanë rëndësi të veçantë në procesin e realizimit të prioriteteve të Qeverisë. Në këtë kontekst do të vazhdohet me ritmin e rritjes ekonomike, ruajtjen e deficitit të ultë buxhetor, nivelin e qëndrueshëm të borxhit publik të vendit, ngarkesës të ultë të biznesit me tatime si dhe rritjen e nivelit të grumbullimit të të hyrave brenda vendit në raport me ato që arkëtohen në kufi.

Krahas prioriteteve të përcaktuara me dokumentet kryesore strategjike, periudha afatmesme 2015-2017 përfshinë edhe disa vendime të rëndësishme të ndërmarra nga ana e Qeverisë. Këto politika përfshijnë rritjen e pagave për të gjithë shërbyesit publik, rritjen e pensioneve të të gjitha kategorive, pastaj ndarjen e mjeteve për skemat sociale dhe pensionale, duke përfshirë skemat e reja për ish të përndjekurit dhe burgosurit politik dhe veteranët e luftës. Për më tepër, për të realizuar këto prioritete Qeveria do të vazhdojë të financoj brenda kornizës buxhetore 2015-2017 sektorin e bujqësisë, reformat në shërbimin civil, investimet në infrastrukturën rrugore, duke përfshirë ndërtimin e Rrugës 6 dhe forcimin e rendit dhe sigurisë, të gjitha këto

të integruara në një kornizë të qëndrueshme afatmesme buxhetore. Për të zbatuar këto politika, Qeveria gjatë periudhës së ardhshme afatmesme do të zvogëlojë ndarjet buxhetore për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve krahasuar me ndarjet për vitin 2014. Për më tepër, përmbushja e prioriteteve të Qeverisë përfshinë reformat e nevojshme në sektor të caktuar, përmes të cilave do të bëhet plotësimi i parakushteve ekonomike, sociale dhe institucionale në procesin e integrimi Euro-Atlantike dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, duke u bazuar në Programin e Qeverisë, prioritetet e Qeverisë janë përmbledhur në katër shtyllat e mëposhtme:

- Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
- Qeverisja e mirë dhe politikat e sigurisë dhe mbrojtjes;
- Zhvillimi i kapitalit njerëzor;
- Rritja e standardit jetësor dhe mirëqenies sociale

Të gjitha prioritetet e lartpërmendura do të financohen duke ruajtur qëndrueshmërinë makro-fiskale. Qeveria do të vazhdojë të zhvillojë sistem tatimor të thjeshtë dhe modern që do të fokusohet në zgjerimin e bazës tatimore. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi Qeveria e Kosovës, mbetet e përkushtuar në avancimin e mëtutjeshëm të luftës ndaj ekonomisë joformale dhe pastrimit të parasë, përmes implementimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018. Parandalimi dhe luftimi i suksesshëm i ekonomisë jo-formale në të njëjtën kohë do të sigurojë ruajtjen e ekuilibrit fiskal në mes të nevojave për financim të sektorit publik dhe nevojës të zhvillimit të sektorit privat, duke krijuar kushte të barabarta për zhvillim të sektorit privat.

Duke synuar rritjen e vazhdueshme të efektivitetit dhe efikasitetit si dhe përgjegjshmërinë dhe llogaridhënie në menaxhimin e financave publike, Qeveria ka përcaktuar prioritetet për financim. Këto prioritate më tutje do të zhvillohen në objektivat specifike dhe të matshme brenda sektorëve përmes procesit të KASH-it. Objektivat e përcaktuara në KASH do të zhvillohen në aktivitete dhe projekte konkrete përmes procesit të rregullt buxhetor.

1. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik

Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të fokusohet në prioritate specifike sektoriale për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Zbatimi i këtyre prioriteteve si edhe më herët përbëjnë pjesën më të madhe të investimeve kapitale që Qeveria ka ndërmarr vitet e fundit, dhe do të vazhdojë me një orientim të ngjashëm edhe përgjatë viteve në vijim. Këto prioritate sektoriale do të realizohen përmes financimit brenda kornizës buxhetore si dhe potencialisht nga burimet e tjera shtesë të financimit (partneritete publiko-private, granteve, etj.). Prioritetet të cilat Qeveria synon ti zbatoj në kuadër të kësaj shtylle gjatë periudhës së ardhshme afatmesme përfshijnë: fuqizimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare me vendet tjera; politikat tregtare, promovimin e investimeve dhe zhvillimin e industrisë; modernizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës; energjinë, minierat, telekomunikimin dhe ndërmarrjet publike.

Fuqizimi i marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare me vendet tjera do të jetë prioritet kyç i Qeverisë gjatë periudhës afatmesme. Në këtë kuadër krahas objektivit të vazhdueshëm për anëtarësimin e Kosovës në organizma ndërkombëtarë, Qeveria gjithashtu synon të fuqizoj bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar me vendet nga rajoni dhe më gjerë, duke u bazuar në

shembullin e bashkëpunimit me Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, bashkëpunimi me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, por edhe me vetë këtë organizëm do të marr një fokus të veçantë, dhe atë duke marr parasysh obligimet që Kosova do të ketë nga nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asociim. Me qëllim të tërheqjes dhe promovimit të investimeve do të vazhdohet me lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale për promovim dhe mbrojtje të investimeve, eliminimin e tatimit të dyfishtë, si dhe memorandumet me institucionet homologe për këmbim të përvojave në kontekst të promovimit të investimeve dhe të eksportit.

Qeveria do të vazhdoj përkushtimin e saj në *promovimin e investimeve* duke krijuar një ambient të favorshëm për qëllim të rritjes së investimeve të brendshme dhe të jashtme dhe për të promovuar revitalizimin ekonomik dhe industrial të vendit. Ky prioritet do të realizohet përmes kompletimit të infrastrukturës ligjore dhe zbatimit të saj, rritjen e koordinimit dhe bashkëveprimit ndërinstytucional, dhe fokusim në projekte të rëndësisë së veçantë për promovimin e investimeve. Ndër projektet më madhore që do të ketë ndikim në zhvillim ekonomik dhe rritje të punësimit në vend është edhe fillimi i zbatimit të projektit të ndërtimit të kompleksit turistik në Brezovicë përmes Partneritetit Publik Privat.

Puna e madhe e treguar në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes do të vazhdoj edhe më tutje, duke synuar rumbullakimin e progresit të Kosovës në top 40 reformatorin në vitin 2015 sipas vlerësimeve të Bankës Botërore të të bërit biznes. *Përkrahja për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM)* do të fokusohet përmes inicimit të skemës për garantimin e kredive për bizneset fillestare dhe bizneset të cilat kanë potencial për eksportim, politikë që gjithashtu pritet të përkrahet nga partnerët zhvillimor.

Modernizimi dhe zhvillimi i infrastrukturës përbënë një element të rëndësishëm të investimeve të Qeverisë, të cilat investime kanë për qëllim përmirësimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e transportit duke synuar integrimin e Kosovës në korridoret pan-evropiane në përputhje me standardet evropiane. Pas përfundimit të autostradës R7 (Morinë – Merdar) Qeveria është në përfundim të procedurave për të filluar ndërtimin e Autostradës R6 (Prishtinë – Hani i Elezit), projekt ky që pritet të zbatohet gjatë kësaj periudhe afatmesme. Vazhdimi i punëve për zgjerimin e rrugëve nacionale M2 dhe M9 sipas fazave të përcaktuara do të përbëjë një aspekt tjetër të financimit gjatë kësaj periudhe. Duhet të theksohet se zgjerimi i rrugës M2 pritet të financohet përmes metodave të tjera të financimit. Gjithashtu, Qeveria gjatë kësaj periudhe do t'i qaset me prioritet modernizimit të vijës hekurudhore 10 Hani i Elezit – Leshak.

Në përputhje me prioritetet qeveritare, parashihet zhvillimi i infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror me përqendrim në projektet e hapjes së hapësirës së lartë ajrore dhe normalizimit të plotë të hapësirës së ulët ajrore në bashkëpunim me NATO-në. Këto projekte do të realizohen nga Agjencia për Shërbime të Navigacionit Ajror pas themelimit të saj. Zhvillimi i infrastrukturës publike pritet të ndikojë fuqishëm në zhvillimin ekonomik në përgjithësi, duke përfshirë krijimin e vendeve të reja të punës, fuqizimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, zhvillimin integral rural etj.

Përmeshja e nevojave për energji elektrike me rritjen e prodhimit dhe furnizimit me energji në pajtim me standardet ndërkombëtare do të bëhet përmes fillimit të zbatimit të projektit të TC Kosova e Re. Gjithashtu, pas nënshkrimit të kontratës për ndërtimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë – Shqipëri me një gjatësi totale prej 241.5 km, parashihet një rritje e dukshme e kapacitetit transmetues për shkëmbim të energjisë. Qeveria do të vazhdoj zbatimin e

politikave për promovimin e kapaciteteve për energjinë efiçiente dhe prodhim të energjisë nga burime të ripërtërishe, në pajtueshmëri me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, përkatësisht arritjen e caqeve ambicioze të vendosura nga Bashkimi Evropian deri në vitin 2020. Në këtë kuadër përfshihet edhe finalizimi i projektit të sistemit të kogjenerimit, përkatësisht lidhjen e ngrohtores së qytetit të Prishtinës me TC Kosova B. Këto projekte dhe të tjera do të kenë ndikim të madh në përmbushjen e nevojave të qytetarëve për energji dhe ngrohje, zhvillim ekonomik, dhe përmirësimin e ambientit për investime.

Gjithashtu, Qeveria e Kosovës përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Ndërmarrje Publike, synon të përkrahë tutje zhvillimin e resurseve minerare dhe zgjerimin e industrisë së përpunimit minerar. Në këtë mënyrë, rregullimi dhe qartësimi i statusit pronësor-juridik do të lehtësojë edhe tërheqjen e investitorëve dhe kredi-dhënësve në dobi të “Trepça sh.a.” si dhe do të krijojë parakushtet e nevojshme për përfshirjen e kapitalit privat në Trepçë, qoftë përmes partneritetit publiko-privat ose përmes një privatizimi të pjesshëm, varësisht prej interesit publik dhe nevojave zhvillimore të Trepçës. Kjo do të mundësoj krijimin e kushteve ligjore dhe institucionale për rritjen e shpejtë të investimeve në sektorin minerar, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, hapje të vendeve të reja të punës dhe rritje të mirëqenies së qytetarëve.

Vazhdimi i përkrahjes për *zhvillimin rural dhe bujqësi* do të bëhet përmes rritjes së buxhetit për këtë sektor në masën prej 100%, duke synuar avancimin e infrastrukturës për zhvillimin rural dhe të bujqësisë, rritjen e prodhimtarisë, uljen e importit të produkteve bujqësore dhe zëvendësimin e tyre me produkte vendore, ofrimin e shërbimeve këshillimore për fermerët dhe njëherit gjenerimin e vendeve të reja të punës. Qeveria gjithashtu synon që përmes zbatimit të masave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural të përkrahë revitalizimin e pemëtarisë, perimtarisë dhe stallave, si dhe mundësi të reja në zhvillimin e sektorëve të hortikulturës dhe blegtorisë në ekonominë familjare për periudhën 2015-2017.

Investimet lidhur me menaxhimin e mjedisit dhe sigurimin e ujit të pijes, në bashkëpunim edhe me donatorët të cilët janë duke e mbështetur këtë sektor do të vazhdojnë në ngritjen e kapaciteteve për rehabilitim dhe zgjerim të kapaciteteve të ujit të pijes, grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza, përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave etj. Gjithashtu, në funksion të zbatimit të legjislacionit për ujëra Qeveria do të shqyrtojë mundësitë për ngritjen e sistemit për monitorimin e ujërave nëntokësor si shtesë ndaj sistemit ekzistues për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësor.

Qeveria e Kosovës edhe gjatë periudhës së ardhshme do ta ketë *rritjen e shkallës së punësimit* si synim strategjik që tenton ta arrij jo vetëm përmes këtij prioriteti por edhe përmes zhvillimit të tërësishëm të burimeve njerëzore. Në mbështetje të politikave të punësimit do të vazhdohet në reformimin dhe modernizimin e shërbimeve publike të punësimit duke u përqendruar në ngritjen e kapaciteteve fizike dhe metodologjike të mekanizmave shtetërorë, rritjen e masave aktive të tregut të punës, nxitjen e punësimit të të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, femrave, të papunëve afatgjatë dhe komuniteteve. Si një sektor që përfshinë akterë të ndryshëm Qeveria gjithashtu do të mbështet funksionimin e shërbimeve publike të punësimit, ngritjen e kapaciteteve të aftësimit dhe arsimit profesional, fuqizimin e partneritetit publiko-privat dhe fusha të tjera.

2. Qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit

Duke synuar vendosjen e standardeve më të larta të qeverisjes së mirë dhe fuqizimit të rendit dhe ligjit, Qeveria gjatë periudhës afatmesme 2015-2017 do të fokusohet në këta sektorë: sistemin gjyqësor dhe prokurorial, fuqizimin e zbatimit të ligjit, politikat e sigurisë, reformën e administratës publike dhe qeverisjen lokale. Prioritetet të cilat Qeveria synon t'i mbështes në këtë shtyllë kërkojnë vendosmëri dhe përkushtim të madh të të gjitha institucioneve duke marr parasysh gërshetimin e madh të tyre në kuadër të aspiratave të Kosovës për anëtarësim në institucionet Euro-Atlantike. Zbatimi i reformave në këta sektor paraqet një rëndësi të veçantë për të ardhmen e integritit të Kosovës në strukturat Euro-Atlantike.

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të përkrah reformimin dhe ngritjen e kapaciteteve në **sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës**, në mënyrë që të sigurojë pavarësi të plotë dhe të rrisë efikasitetin operacional të bazuar në rezultate. Qeveria do të vazhdojë të përkrahë përmbylljen e ristrukturimit dhe reformimit të këtij sistemi në mënyrë që të ngritet efikasiteti nëpër gjykata dhe të ulet numri i rasteve të grumbulluara.

Fuqizimi i sistemit për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe dukurive tjera negative duke përfshirë një koordinim më të mirë ndërmjet të institucioneve relevante mbetet prioritet i lartë i Qeverisë së Kosovës. Qeveria do të punojë për të përshtatur legjislacionin penal me praktikën më të mira ndërkombëtare në shërbim të luftimit të korrupsionit dhe dukurive tjera negative. Do të vazhdohet angazhimi në drejtim të parandalimit dhe luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Sa i **përket mbrojtjes dhe sigurisë**, Qeveria gjatë vitit të fundit ka punuar në rishikimin e këtij sektori dhe si rrjedhim ka miratuar Analizën e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS) dhe rekomandimet përkatëse, si dhe për periudhën afatmesme do të përqendrohet në zbatimin e vendimeve dhe legjislacionit për shndërrimin e MFSK-së dhe FSK-së, përkatësisht krijimin e Ministrisë të Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Kosovës. Zbatimi i rekomandimeve të RSSS-së përveç kësaj përfshinë angazhime shtesë në rishikimin e kornizës ligjore dhe institucionale, hartimin e dokumenteve strategjike si dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore duke reflektuar në rekomandimet e RSSS-së.

Qeveria do të vazhdojë përkrahjen në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të rendit dhe sigurisë, duke përfshirë avancimin e kushteve të Policisë së Kosovës, pajisjen me mjete të nevojshme teknike, pajisje teknologjike për shkëmbim të informatave, etj. Gjithashtu do të vazhdohet edhe me mbështetjen e reformave tashmë të iniciuara në sektor si dhe forcimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të Policisë, në veçanti në fushat që kanë të bëjnë me hetimin, luftimin dhe zbulimin e krimit të organizuar dhe luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Ngritja e bashkëpunimit ndërinstitucional të të gjitha agjencive qeveritare për sundimin e ligjit dhe shtrirja e mëtutjeshme e konceptit të policisë të bazuar në inteligjencë dhe policisë në komunitet do të përkrahët nga ana e Qeverisë. Gjithashtu do të punohet në drejtim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit bilateral dhe integrimi në organizata relevante rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e çështjeve kufitare dhe Menaxhimit të Integruar të Kufirit, fushën e migracionit, mbrojtjes së të dhënave personale, luftimit të krimit të organizuar etj.

Duke synuar krijimin e një **administratë publike dhe profesionale**, Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë me procesin e **reformimit të administratës publike** përmes zbatimit të strategjisë dhe planit të Veprimit të Reformës së Administratës Publike. Zbatimi i

legjislacionit përkatës për reformën e administratës publike përbënë elementet kryesore të angazhimit të Qeverisë në këtë drejtim. Në periudhën afatmesme nuk pritet që të ketë punësime të reja, përveç kur kërkohet me legjislacionin e ri i cili është në harmoni me kornizën aktuale buxhetore 2013-2016. Do të vazhdohet me punë në rritjen e nivelit të organizimit dhe të kapaciteteve të përgjithshme në aspektin e sigurimit të koherencës adekuatë dhe të koordinimit ndërinstytucional në hartimin dhe implementimin e politikave sektoriale në vend. Gjithashtu, përmes përkrahjes së asistencës së BE-së do të punohet në përmirësimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimit të financave publike, përkatësisht vendosjen e sistemit për planifikim të integruar duke punuar në zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim.

Me qëllim të avancimit të vazhdueshëm të qeverisjes lokale si dhe ofrimit të shërbimeve kualitative, Qeveria do të vazhdoj në zbatimin e kornizës legjislative dhe strategjike në fushën e qeverisjes lokale. Periudha afatmesme do të përfshijë një angazhim të shtuar të Qeverisë lidhur me unifikimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në vend, përkatësisht krijimin e kushteve politike, administrative dhe institucionale për integrimin e komunave të veriut të vendit në sistemin e vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës.

3. Zhvillimi i resurseve njerëzore

Politikat e planifikuara në kuadër të këtij prioriteti strategjik synojnë **zhvillimin e mëtutjeshëm të kapitalit njerëzor, me qëllim të përshtatjes më të mirë me kërkesat e tregut të punës**. Ky sektor ka qenë dhe vazhdon të trajtohet në nivelin e njëjtë të prioriteteve dhe do të trajtohet ngjashëm në aspektin buxhetor. Megjithatë përqendrimi në fazën e ardhshme afatmesme do të orientohet tek politikat që do ndikojnë në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së arsimit, ku ndër të tjera orientimi dhe planifikimi në drejtim të plotësimit të nevojave të tregut të punës në vend do të jetë synim parësor. Në të njëjtën kohë angazhimi në përmirësimin e kushteve të zhvillimit të arsimit sidomos në nivelin universitar do të jetë permanent. Synohet po ashtu zhvillimi i kulturës së ndërmarrësisë, zgjerimit të plan programit të ndërmarrësisë në shkolla fillore, shkolla të mesme dhe në institucione të arsimit të lartë si dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe bizneseve.

Me qëllim të zhvillimit të **aftësisimit profesional** të orientuar kah nevojat e tregut të punës synohet rritja e numrit të shkollave profesionale, rritja e nivelit dhe diversifikimit të trajnimeve dhe në të njëjtën kohë sigurimi i kriterëve dhe parimeve të institucioneve ofruese të arsimit dhe aftësisimit profesional për akreditim dhe validim të kualifikimeve. Gjithashtu synohet të vazhdohet me rritjen e kapaciteteve të trajnimeve profesionale për punëkërkuarit dhe sigurimi i cilësisë së trajnimeve në Qendrat e Aftësisimit Profesional. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës aktualisht është duke punuar në hartimin e **Vizionit dhe Udhërrëfyesit për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore në Kosovë 2014-2020**, të financuara nga Bashkimi Evropian me ndihmën e Kornizës Evropiane të Trajnimeve (ETF), ku synim kryesor ka përshtatjen e sistemit të arsimit dhe trajnimit në një perspektivë të të mësuarit gjatë gjithë jetës duke mbuluar: inicimin dhe vazhdimin e arsimit dhe aftësisimit profesional (AAP) dhe të arsimit të lartë, por edhe me theks të veçantë në të mësuarit për të rriturit, trajnimin në kompani dhe trajnimin e të papunëve.

Gjithashtu, do të vazhdohet që të përkrahet edhe **zhvillimi i resurseve njerëzore në fushën e kulturës dhe sportit**, pastaj stimulimi i zhvillimit të krijimtarisë kulturore, rritjes së performancës dhe kualitetit të sportit si dhe zhvillimi dhe ndërkombëtarizimi i mëtejshëm i sportit dhe kulturës kosovare në vend dhe arenën ndërkombëtare. Qeveria do të shtojë

përkrahjen në aspektin e promovimit dhe ndërkombëtarizimit të sportit, përkatësisht gjatë periudhës afatmesme Qeveria synon të investoj në përmirësimin e infrastrukturës me theks të veçantë në ndërtimin e Stadiumit të Kombëtares së Kosovës në pajtim me standardet e FIFA-së dhe UEFA-së.

Në kuadër të kësaj shtylle, duke synuar ruajtjen e identitetit kombëtar dhe kulturor Qeveria do të shqyrtoj thellimin e institucionalizimit të organizimit të mësimit plotësues në diasporë, përfshirjen e një numri shumë më të madh të fëmijëve që marrin pjesë në proces, si dhe modernizimin e procesit edukativo-arsimor, sipas standardeve bashkëkohore. Kjo politikë synohet të arrihet nëpërmjet ***unifikimit të plan programeve mësimore dhe përgjithësisht të sistemit të mësimit plotësues me Republikën e Shqipërisë.***

4. Rritja e standardit jetësor dhe mirëqenies sociale

Fushat prioritare përmes të cilave Qeveria e Republikës së Kosovës synon të forcojë ***kohezionin social dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në mënyrë të barabartë në jetën publike*** të vendit janë: politikat sociale (skemat sociale, pensione, përkrahje për invalid, familje të dëshmorëve dhe kategori tjera të luftës) dhe shërbimet shëndetësore. Me qëllim të ofrimit të një përkrahje financiare në përputhje me nevojat e përfituesve, Qeveria e Kosovës synon që çdo vit të bëjë indeksimin e skemave sociale dhe pensioneve me inflacionin. Në këtë funksion, edhe rishikimi i infrastrukturës ligjore do të mundësojë një përkrahje më të madhe për këto kategori, dhe përmirësim të targetimit të përfituesve të skemave sociale. Përkrahja për kategoritë e ndryshme të pensionistëve mbetet prioritet i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Qeveria do të vazhdojë përkushtimin në fuqizimin e sistemit pensional tre shtyllës, si një sistem i drejtë, funksional dhe me burime të qëndrueshme financiare i cili plotëson kërkesat nga e drejta e sigurimeve sociale për të gjitha kategoritë e pensioneve.

Invalidët, familjet e dëshmorëve, veteranët dhe kategoritë tjera të luftës: Përkrahja financiare për kategoritë e dala nga lufta është rritur në veçanti gjatë viteve të fundit. Qeveria ka ndërmarrë hapa legjislativë për të rregulluar statusin, të drejtat dhe përfitimet e kategorive të dala nga lufta. Qeveria mbetet e përkushtuar që të realizojë në vazhdimësi përkrahjen për kategorinë e invalidëve, familjet e dëshmorëve dhe veteranët çështje kjo e rregulluar me ligjin për këto kategori. Qeveria mbetet e angazhuar që kategorisë së invalidëve të luftës, familjeve të dëshmorëve dhe veteranëve tu krijojë kushte për tu inkuadruar në jetën publike të vendit.

Me qëllim të ***fuqizimit të partneritetit dhe dialogut social***, Qeveria e Kosovës ka nënshkruar Kontratën Kolektive me të gjithë Partnerët Social. Kjo marrëveshje rregullon themelimin e marrëdhënies së punës, orarit, pushimet, pagat, kompensimet, ndërprerja e kontratës, të drejtat, detyrimet e palëve dhe mënyra e zgjidhjes së kontesteve.

Sistemi shëndetësor kosovar, ende ballafaqohet me probleme të konsiderueshme të cilat paraqesin sfidë serioze në ofrimin e shërbimeve të nevojshme shëndetësore për të gjithë qytetarët. Përmirësimi i cilësisë dhe efektshmërisë së shërbimeve shëndetësore është njëri nga prioritet kryesorë strategjike të Qeverisë. Përmes përmirësimit të treguesve shëndetësor synohet që të zvogëlohet vdekshmëria e foshnjave dhe nënave në pajtim me projeksionet e mijëvjeçarit të aprovuara nga OKB-ja dhe të përmirësohet statusi shëndetësor i të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore nënkupton edhe ndërmarrjen e reformave të konsiderueshme në sistemin e financimit dhe menaxhimit të shërbimeve shëndetësore. Qeveria gjatë periudhës afatmesme do të mundësoj përfshirje në sistemin e sigurimeve shëndetësore, i cili do të rezultojë në qasje kualitative dhe të barabartë në shërbimet shëndetësore për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës. Me këtë synim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar ***Ligjin për Sigurime Shëndetësore***, i cili parasheh financimin e sektorit të shëndetësisë nga buxheti dhe nga fondi publik i sigurimit të detyrueshëm shëndetësor. Në këtë drejtim, financimi i sektorit të shëndetësisë do të realizohet nëpërmjet themelimit të modelit të përzier të financimit nga buxheti dhe nga Fondi publik i sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, në pajtim me Ligjin për Sigurime Shëndetësore. Ndërsa, deri në fillimin e funksionimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore funksionet e tij do t'i zbatoj, në pajtim me Ligjin e Shëndetësisë, Agjencia e Financimit Shëndetësor, si agjenci ekzekutive e Ministrisë së Shëndetësisë.

2. KORNIZA MAKRO-FISKALE 2015-2017

2.1. HYRJE

Analiza makroekonomike e cila mbështet planin fiskal tre vjeçar të elaboruar në këtë dokument parasheh rritje të të ardhurave vjetore për kokë banori nga 2,960 Euro më 2014, në 3,276 Euro më 2017. Me një mesatare afat-mesme inflacioni prej 1.1%, dhe rritje reale të BPV-së prej 4.4%, performanca makroekonomike në vitet vijuese pritet të jetë reflektim i ngritjes së përgjithshme të potencialit gjenerues të ekonomisë, dhe jo vetëm i lëvizjeve ciklike përbrenda kapaciteteve ekzistuese. Udhëheqës të rritjes ekonomike pritet të jenë konsumi dhe investimet private, të përcjellura me mbështetje të eksportit dhe investimeve publike. Këto parashikime janë në përputhje edhe me zhvillimet e pritura në sektorin e jashtëm, gjegjësisht pritet për përshpejtim të rritjes në ekonomitë e shteteve me të cilat Kosova ka marrëdhënie tregëtare, apo ka të përqëndruar në to diasporën e saj. Pritjet për zhvillim të mëtutjeshëm ekonomik bazohen po ashtu edhe në parashikimin për thellim të mëtutjeshëm financiar të ekonomisë së Kosovës, të përcjellur me kushte më të favorshme kreditore, dhe zgjerim të përgjithshëm të portfolit të depozitave dhe kredive.

Mbi këtë performancë makroekonomike është zhvilluar edhe parashikimi i të hyrave buxhetore për periudhën 2015-2017. Të hyrat pritet të arrijnë në 1,598 milionë Euro më 2017, nga 1,458 milionë Euro sa janë buxhetuar më 2014. Nën parashikimet për shkallë të ulët inflacioni (dhe çmime rënëse të importit), kjo rritje që dominohet nga rritja e të hyrave tatimore pritet të vijë nga volumi i shtuar i aktivitetit ekonomik. Për më shumë, rritja rezulton edhe pas përfshirjes së ndikimit të dy marrëveshjeve për tregëti të lirë si dhe në përgjithësi politikave fiskale që mbështesin stimulimin e biznesit privat. Parashikimi po ashtu ndërthet edhe efektet e aktiviteteve të Qeverisë së Kosovës për përmirësimin e ambientit biznesor përmes luftimit të ekonomisë jo-formale. Në pajtim edhe me procesin e vazhdueshëm të zëvendësimit të importit, rritja e të hyrave në periudhën afatmesme pritet të udhëhiqet nga rritja e të hyrave vendore si rrjedhojë e shtimit të aktivitetit prodhues vendor.

Të hyrat e parashikuara në pajtim me kufizimin e deficitit me anë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (rregulla fiskale) kanë përcaktuar hapësirë më të gjërë për shpenzime publike se sa në vitet paraprake, duke mundësuar kështu vazhdimin e përkrahjes së zhvillimit ekonomik nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Shpenzimet buxhetore të elaboruara më poshtë reflektojnë një sërë aktiviteteve dhe iniciativash të reja në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit sipas Deklaratës së Prioriteteve të hartuar për KASH 2015-2017. Deri më 2017 shpenzimet e përgjithshme pritet të arrijnë në 1,708 milionë Euro, nga 1,589 sa janë buxhetuar më 2014. Një rritje e tillë shpenzimesh është e një vlere të veçantë sepse mund të sigurohet pa e rritur barrën tatimore për qytetarët dhe bizneset. Për më shumë, një rritje e tillë sigurohet bashkarisht me politika stimuluese fiskale për sektorin privat dhe me aplikim të marrëveshjeve tregëtare integruese.

2.2. SEKTORI REAL

Stabiliteti makroekonomik është jetik për rritjen afatgjate të ekonomisë sepse krijon hapësirë për transformimin strukturor që kushtëzon rritjen e produktivitetit. Andaj, shpenzimet buxhetore dhe mënyra e financimit të tyre kërkojnë përputhje me objektivat makroekonomike të cilat, duke synuar ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, rezultojnë në mjedis më të favorshëm për sektorin privat, duke gjeneruar punësim dhe rritje të të ardhurave për kokë banori.

Analiza e sektorit real të ekonomisë, apo më saktësisht ajo e identifikimit të kontributdhënësve kryesor në rritjen ekonomike, zbulon se akumulimi i deritanishëm i stokut të kapitalit publik dhe politika fiskale e formuluar në pajtim me zhvillimet makroekonomike nuk ka shkaktuar predominim të sektorit publik ndaj atij privat, por ka rezultuar në nxitje të sektorit privat. Për këtë arsye, në periudhën afatmesme janë konsumi privat, investimet private, dhe eksporti që pritet të udhëheqin rritjen ekonomike. Nga ana e ofertës, struktura e ekonomisë pritet të dominohet nga rritja e produktivitetit në bujqësi, e shoqëruar me investime më të mëdha në industri të lehtë dhe prodhim.


Ekonomia e Kosovës ka treguar rezistencë të dukshme përballë trazirave të ekonomisë së Euro zonës. Kjo për faktin se Qeveria e Kosovës ka ndërmarë hapa të suksesshëm drejt përmirësimit të konkurrueshmërisë së ekonomisë kundrejt vendeve të rajonit, përfshirë këtu përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe investime të mëdha publike në infrastrukturë, gjithnjë duke ruajtur qëndrueshmërinë fiskale. Si rezultat, edhe pse rritja ekonomike e Kosovës është ngadalësuar gjatë këtyre viteve, ajo ka mbetur pozitive në kohën kur shumica e vendeve të rajonit kanë rënë në recesion (shih grafikun 1).

Megjithatë, edhe pse që nga fillimi i krizës ekonomike financiare në vitin 2007 ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej mesatarisht 4.7%, rritja e çmimeve përgjatë kësaj periudhe prej (mesatarisht) 3.8% ka ndikuar që përfitimi nga një rritje e tillë e ekonomisë të mos transmetohet plotësisht në të ardhurat reale të popullsisë.


Pas rritjes së vlerësuar prej 3.2% në vitin 2013, në përputhje me zhvillimet e pritshme në ekonominë e eurozonës, rritja ekonomike në vitin 2014 pritet të jetë më e lartë për të arritur në 4.1%, përderisa gjatë periudhës 2014-2017 kjo rritje parashihet të jetë 4.5% në mesatare (shih grafikun 2).

Në vitin 2012 dhe 2013 rritja e ekonomisë së Kosovës vlerësohet të ketë qenë nën atë potenciale, çka edhe është reflektuar me presione të ulëta inflacionare në çmimet e mallrave dhe shërbimeve të pa-tregëtueshme. Me një potencial rritjeje prej 4%, vlerësuar nga historiku 2004-2012, boshkllëku i prodhimit parashihet të ngushtohet në periudhën afatmesme kur edhe ekonomia pritet të rritet në pajtim me nivelin potencial të rritjes, që reflekton zëvendësim të importit dhe rritje të eksportit të mallrave.

Grafiku 1: Rritja e BPV-se në vendet e rajonit, ne %



Grafiku 2: Rritja e BPV-së reale dhe kontributi i componentëve të tij




Burimi: ASK dhe kalkulimet e DPEP

rritjes së konsumit në rritjen reale të BPV-së do jetë i qëndrueshëm përgjatë periudhës së projektuar, i financuar kryesisht nga dërgesat nga diaspora si dhe nga rritja e pagave të punonjësve në sektorin publik. Anëtarësimi në institucionet ndërkombëtare financiare i shoqëruar me parashikimet për një rritje më të përshpejtuar të kreditimit nga sektori financiar që pritet të vije si përgjigje ndaj zvogëlimit të pasigurisë në ekonominë e euro-zonës, pritet të ndikojnë në rritjen e investimeve private në përgjithësi si dhe në kontributin pozitiv të tij në rritjen reale. Kontributi në rritje i eksportit të mallrave në rritjen reale të BPV-së dhe rënia relative e importeve shërben për të theksuar pritjet për zëvendësim më të madh të importit. Si përfundim, faktorët kryesorë që parashihet të ndikojnë në përshpejtimin e rritjes ekonomike në periudhën afat-mesme janë: a) konsumi më i lartë i mbështetur nga rritja e remitancave dhe rritja e pagave në sektorin publik, b) rritja e investimeve si rrjedhojë e rritjes së kreditimit dhe uljes së kostos së ndërtimit rezultuar nga rënia e çmimeve të përgjithshme të materialit ndërtimor, c) rritja e eksportit të mallrave, kryesisht të eksportit të mallrave përjashtuar metalet si dhe, d) ngadalësimi i rritjes së importit të mallrave.

2.2.1. Lëvizja e çmimeve dhe parashikimi për periudhën 2013-2015

E matur me ndryshimet vjetore në indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK), norma e inflacionit ka shënuar një rritje të ngadalësuar që nga fillimi i vitit të kaluar duke u kthyer në negative nga mesi i vitit. Moderimi i presioneve inflacioniste reflekton një numër faktorësh, duke përfshirë efektin e bazës së lartë nga vitet e kaluara si dhe çmimet në rënie të ushqimit dhe naftës. Rënia e çmimeve në një masë u kompensua nga rritja e çmimeve në sektorin e shërbimeve dhe atyre të duhanit dhe alkoholit. Norma e rënies së çmimeve të produkteve ushqimore dhe naftës pritet të përshpejtohet në muajt e ardhshëm duke ndikuar që

Grafiku 3: Niveli i inflacionit dhe parashikimi për periudhën 2014-2017



Burimi: FMN, ASK dhe njesia e makroekonomisë, MF

niveli i rritjes së çmimeve të stabilizohet në 0.8% në mesatare gjatë vitit 2014 dhe në mesatare prej 1% përgjatë periudhës afat-mesme. Thënë ndryshe, në këtë fazë duket të jetë në perspektivë një periudhë e qëndrueshme e rënies së çmimeve. Megjithatë, presionet për rritje çmimesh në periudhën afatmesme pritet të vijnë nga sektori i shërbimeve dhe çmimet e alkoholit dhe duhanit.

Rritja e pagave të punonjësve në sektorin publik pritet të ketë ndikim të limituar në nivelin e pagave në sektorin privat për faktin që tregtarët dhe prodhuesit vendor pritet t'i rikthejnë margjinat e tyre të cilat i kishin ngushtuar gjatë viteve të fundit si reagim ndaj ngadalësimit të rritjes së kërkesës të shoqëruar me presionet inflacioniste që erdhën kryesisht nga çmimet e importit. Në të kundërtën, çdo rritje e pagave në sektorin privat do të shkaktonte rritje të kostos gjë që do të reflektehej në rritje të çmimeve apo mos-reagim ndaj rënies së paraparë të çmimeve ndërkombëtare.

Deflatori i BPV-së parashihet të jetë më i lartë se IÇK-ja gjatë vitit 2014 dhe 2015 gjë që kryesisht reflekton ndryshimin e strukturës së shpenzimeve publike si dhe çmime më të larta të eksportit të shërbimeve.

2.3. SEKTORI I JASHTËM

Në vitin 2013, llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave regjistroi një deficit prej 6.6% të BPV-së nga 7.7% sa ishte në vitin 2012. Duke pasur parasyshë që pozicioni i llogarisë rrjedhëse pasqyron varshmërinë e ekonomisë nga financimi i jashtëm, reduktimi i saj do të tregonte një zhvillim pozitiv. Sidoqoftë, faktorët kryesor që kanë ndikuar në reduktimin e llogarisë rrjedhëse kanë qenë rënia e importit të mallrave, rritja e eksportit të mallrave dhe rritja e llogarisë së transfereve, përfshirë dërgesat nga diaspora.

Llogaria kapitale dhe financiare është rritur në 3.2% të BPV-së nga 2.9% në vitin 2012. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e zvogëlimit të investimeve në letra me vlerë jashtë vendit të cilat supozohet të jenë ri-orientuar drejt letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Veç kësaj, investimet e huaja direkte kanë shënuar rritje në raport me BPV-në nga 4.3% në 4.7%. Për sa i përket llogarive të sektorit të jashtëm, vlenë të theksohet që niveli i gabimeve dhe lëshimeve është zvogëluar për 1.5 pika të përqindjes në raport me BPV duke treguar për ngritje të kualitetit të të dhënave.

Për periudhën afatmesme, parashihet që vlera e importit të mallrave të rritet me një normë më të ngadaltë duke reflektuar deri në një masë rënien e çmimeve të produkteve të cilat kanë peshën më të madhe në total importin e poashtu edhe rënien e kërkesës për import si rezultat i zëvendësimit me produkte vendore. Si rrjedhojë, importi i mallrave pritet të rritet me 3.3% në mesatare përgjatë periudhës në vrojtim. Importi i shërbimeve, i dominuar nga shërbimet e udhëtimit dhe transportit pritet të vazhdoj të rritet në pajtim me trendet historike.

Duke pasur parasyshë që struktura e eksportit të mallrave ka ndryshuar dukshëm nga vitet paraprake, rritja e eksportit në vitet në vijim parashihet të vije kryesisht nga produktet përjashtuar metalet. Për më tepër, eksporti i mallrave pritet të rritet me një normë reale prej 8% në mesatare për katër vite. Rritjes së eksportit të mallrave pritet t'i kontribuoj edhe marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim me BE-në e cila pritet të filloj të implementohet nga vitit 2016 si dhe marrëveshja për tregti të lirë me Turqinë. I dominuar nga shërbimet e udhëtimit që ndërliken me vizitat e diasporës në vend, ekporti i shërbimeve pritet të rritet me një normë reale prej rreth 4% në mesatare për katër vitet e ardhshme. Përveq rritjes së shërbimeve të udhëtimit, ekporti të shërbimeve pritet t'i kontribuojnë edhe shërbimet e transportit dhe të ndërtimit.

Në përputhje me trendet historike si dhe me zhvillimet e pritshme në vendet ku diaspora është e përqëndruar, remitancat parashihet të rriten me një normë mesatare prej rreth 4%. Për më shumë, përveç konsumit ku deri më tash këto të hyra janë destinuar, një pjesë e të hyrave nga remitancat pritet të kanalizohen edhe në investime, kryesisht në patundshmëri.


Si rezultat i këtyre supozimeve, bilanci rrjedhës i bilancit të pagesave parashihet të përmirësohet në krahasim me vitin 2012 duke u ngritur nga -6.6% në -5.1% e BPV-së në fund të periudhës së parashikimit.

Si pjesë e llogarisë financiare, investimet e huaja direkte pritet të shënojnë 6.2% të BPV-së në fund të periudhës duke reflektuar kështu uljen e paqartësive me ekonominë e eurozonës dhe rrjedhimisht rritjen e konfidencës së investitorëve. Në anën tjetër, investimet në letrat me vlerë jashtë vendit pritet të vazhdojnë me trendin rënës si rezultat i orientimit të investimeve nga ana e institucioneve financiare drejt letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Kutia 1: Mjedisi i jashtëm ekonomik

Pas një ngadalësimi në zhvillimin ekonomik global përgjatë viteve të fundit, ekonomia globale në pjesën e dytë të vitit 2013 tregoj shenja të rimëkëmbjes ekonomike dhe se keto zhvillime ishin më pozitive se sa ishte pritur dhe parashikuar. Këto zhvillime pozitive ishin më të theksuara në shtetet në zhvillim dhe gjithashtu ishin inkurajuese zhvillimet në shtetet e zhvilluara, pas vështirësive të shumta që i karakterizuan këto vende gjatë viteve paraprake. Për më shumë, aktiviteti ekonomik global pritet të përmirësohet edhe më tutje gjatë viteve vijuese. Këtyre zhvillimeve pozitive në rritje ekonomike në nivel global i kontribuoj kryesisht ngritja e kërkesës vendore në vendet e zhvilluara gjë që rezultoj me përmirësimin e eksporteve në vendet në zhvillim dhe rrjedhimisht u transmetua në ngritje ekonomike. Gjithashtu, rol substancial në përmirësimin e aktivitetit ekonomik në vendet e zhvilluara ka edhe përmirësimi i ambientit financiar pas një tronditje që u manifestua në këtë sektorë në vitet paraprake. Ky përmirësim i sektorit financiar u përcoll me lehtësime në kredi dhënie dhe rrjedhimisht ngritje të investimeve. Megjithatë, në ekonomitë në zhvillim kushtet financiare vazhduan të mbeten të shtrënguara dhe sektori financiar vazhdoi të jetë i karakterizuar me nivel të ulët të besueshmërisë gjë që po ngadalëson zhvillimin me të hovshëm ekonomik.

Për sa i përket parashikimeve, zgjerimi i aktivitetit ekonomik global përgjate vitit 2014 pritet të rritet me rreth 3.7% nga 3% rritje sa ishte shënuar përgjatë vitit 2013. Për më shumë, gjate vitit 2015 rritja ekonomike pritet të jetë më e theksuar, rreth 3.9%, si dhe parashikimet fillestare janë se ekonomia botërore pritet të rritet me rreth 4.1% gjatë vitit 2016. Sikurse edhe viteve paraprake, ekonomitë në zhvillim ishin shtytës të rritjes së aktivitetit global. Gjithashtu, në vitet vijuese ngritja ekonomike në vendet e zhvilluara pritet të jep




të rritet me rreth 3.7% nga 3% rritje sa ishte shënuar përgjatë vitit 2013. Për më shumë, gjate vitit 2015 rritja ekonomike pritet të jetë më e theksuar, rreth 3.9%, si dhe parashikimet fillestare janë se ekonomia botërore pritet të rritet me rreth 4.1% gjatë vitit 2016. Sikurse edhe viteve paraprake, ekonomitë në zhvillim ishin shtytës të rritjes së aktivitetit global. Gjithashtu, në vitet vijuese ngritja ekonomike në vendet e zhvilluara pritet të jep

mbështetje për zgjerimin e aktivitetit ekonomik në vendet në zhvillim, kjo pasi që destinacion kryesor i eksporteve nga ekonomitë në zhvillim janë të drejtuara drejt shteteve të zhvilluara.

Burimi: Fondi Monetar Nderkombetar, WEO Prill 2014

Bazuar në raportimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), rreziqet ndaj mos kapitalizimit të këtyre parashikimeve janë evidente. Në ekonomitë e zhvilluara dhe në veçanti ato të

Grafiku : Rritja ekonomike, ne %




Eurozonës, rreziqet nga shkalla e ulët e inflacionit dhe mundësitë për deflacion rrezikojnë qëndrueshmërinë e borxhit publik edhe ashtu në nivele të larta të cilat ato gjinden. Rrjedhimisht, kjo do të vinte presion mbi ngritjen e normave reale të interesit si rezultat i kufizimeve në politikat monetare. Gjithashtu, rrezik që vazhdon të përcjell këto parashikime është edhe stabiliteti i sektorit financiarë.

Burimi: Fondi Monetar Nderkombetar, WEO Prill 2014

Për sa u përket zhvillimeve në Eurozonë, ato përcillen në trajtë të ngjashme me zhvillimet globale. Për dallim nga ngritja e aktivitetit ekonomik global e cila filloj në pjesën e fundit të vitit 2013 pas tronditjeve gjatë viteve 2008-2012, rritja e aktivitetit ekonomik në Eurozonë ishte negative përgjatë vitit 2013. Gjithashtu, të dhënat e deritanishme si dhe parashikimet për vitin 2014 flasin për një rritje ekonomike modeste gjatë këtij viti, për të filluar një ngritje më të theksuar nga viti 2015 (1.4%). Përmirësimi gradual i kërkesës vendore së bashku me ngritjen e kërkesës nga jashtë si rezultat i përmirësimit të aktivitetit ekonomik global është parashikuar të jenë shtytësit kryesorë të kësaj ngritje ekonomike. Gjithashtu, kërkesa e brendshme pritet të perfitoj edhe nga relaksimi i politikave fiskale (pas shkurtimeve në shpenzime si rezultat i borxheve të larta publike) si dhe përmirësimit të kredithënies nga sektori bankar.

Përgjatë dy viteve paraprake, 2012 dhe 2013, ekonomitë në zonën euro u ballafaquan me tkurrje të aktiviteteve ekonomike dhe me nivel relativisht stabil të inflacionit. Siç mund të shihet nga grafiku, nga një rritje mesatare vjetore prej rreth 1.5% në vitin 2011, rënia ekonomike vazhdoi përgjatë vitit 2012 për të arritur pikën më të ulët në nivel prej rreth -0.6%. Që nga gjysmë viti i 2012-ës, gjendja në sektorin financiar u stabilizua, megjithatë, ky stabilizim nuk u transmetua mjaftueshëm në sektorin real dhe rrjedhimisht rritja ekonomike në pjesën e dytë të vitit ishte mjaft e ulët. Gjatë vitit 2013, ngritja e aktivitetit ekonomik vazhdoi të jetë negative prej rreth -0.4%. Bazuar në parashikimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Eurozona pritet që gjatë vitit 2014 dhe 2015, si tërësi, të ketë një rritje prej 1% dhe 1.4% respektivisht dhe me rreth 1.5% gjatë vitit 2016 dhe 2017.

Këto zhvillime në Eurozonë u reflektuan në një maseëte konsiderueshme edhe në vendet regionale. Në vendet para antarësimit në zonën euro rritja ekonomike ishte më e lartë se sa ishte pritur me përjashtim të Shqipërisë. Sipas të dhënave të publikuara nga institucionet perkatëse, rritja ekonomike u përshpejtua në mënyrë të theksuar në kuartalin e katërt në Maqedoni, Mal të Zi dhe Turqi, ndërsa rritja e BPV-së u ngadalësua në Serbi dhe Islandë. Shqipëria ishte vendi i vetëm që shenoi rënie në rritjen ekonomike gjatë vitit 2013. Prospektet e zhvillimit në vendet para antarësimit në BE janë mjaft pozitive, ku rritja më e përshpejtuar në vitin 2015 pritet të shënohet në Kosove dhe Turqi pasuar nga Serbia (4%) dhe Shqipëria (3.3%).




2.4. SEKTORI FINANCIAR

Përbërja e sektorit financiar në Kosovë vazhdon të dominohet nga bankat komerciale, pasuar nga kompanitë e sigurimeve dhe institucionet mikro-financiare. Sektori financiar në Kosovë vazhdon të jetë stabil dhe profitabil përkundër paqëndrueshmërive që përshkruan tregjet financiare ndërkombëtare gjatë viteve të fundit, ku ndër faktorët kyç në këtë situatë stabile bankare ishin investimet e limituara nëpër tregjet financiare ndërkombëtare.

Struktura e përbërjes bankare ka vazhduar të mbetet e njëjtë sa i përket ndarjes së tregut, ku bankat me kapital ndërkombëtare vazhdojnë të dominojnë tregun kosovar. Gjatë dy viteve të fundit është vërejtur një shtim në aktivitetet konkurruese ndër-bankare sa i përket ofrimit të produkteve atraktive dhe shërbimeve me qëllim të avancimit të shërbimeve për mbajtjen dhe shtimin e klientëve. Gjatë vitit 2013, kreditimi i ekonomisë kosovare ka vazhduar të ketë ngritje të lehtë ku kreditë arritën vlerën prej 1,806mln euro me një ngritje prej 2% në krahasim me vitin 2012 dhe depozitat 2,449mlrd euro me një ngritje prej 7%.

Përgjatë periudhës 2010-2013 kreditë shënuan rritje mesatare prej 9% përderisa depozitat shënuan rritje mesatare 8.9%, rritje të cilat parkojnë edhe trendin e rritjes së BPV-së nominale. Grafiku 4 ilustron trendët e normave të rritjes së BPV-së nominale, kredive dhe depozitave. Vlerësimi i parametrave të ilustruar në grafik është bërë në bazë të dhënave historike të datuara nga viti 2008. Nga grafiku shihet se të tre indikatorët kanë korrelacion pozitiv dhe parashikimet tregojnë për një lëvizje pozitive ndërmjet tyre edhe përgjatë viteve 2014-2017, ku kreditë dhe depozitat parashihet të rriten me një norme mesatare prej 7.6%, respektivisht 7.2% e që është konsistente me parashikimet për rritjen ekonomike në terme mesatare nominale prej 6.2% përgjatë periudhës 2014-2017.


Grafiku 4. Rritja e kredive, depozitave dhe BPV-së nominale, në përqindje



Burimi: Banka qendrore e Kosovës dhe kalkulimet e Dep. për politika ekon-publike

Norma e interesit në kredi gjatë vitit 2013 ishte 11%, duke shënuar një rënie prej 1.7% nga viti 2012. Në anën tjetër norma e interesit në depozita regjistroi 2.4% duke shënuar rënie prej 1.3% në krahasim me vitin 2012. Siç është paraqitur në grafik, norma e interesit në depozita dhe kredi gjatë vitit 2014 pritet të shënojë një rënie të lehtë përderisa në vitet në vijim ato pritet të jenë në mesatare prej 10% (2014-2016). Iniciativat e fundit të ndërmarra nga institucionet financiare

Grafiku 5. Normat e interesit në depozita dhe kreditë, në përqindje



ndërkombëtare për ofrimin e fondeve me kosto të ulët huazimi për ndërmarrjet bujqësore në Kosovë pritet të ketë ndikim në uljen graduale të normave të interesit në kredi, megjithatë edhe në ngritjen e likuiditetit bankar, gjë që mund të ndikojë në uljen e normave për depozita.

2.5. SEKTORI FISKAL 2015-2017

2.5.1. Të hyrat buxhetore 2015-2017

Parashikimi i të hyrave buxhetore për periudhën 2015-2017 karakterizohet me dy supozime kryesore: arkëtim shtesë i të hyrave si rrjedhojë e rritjes së vëllimit të aktivitetit real të ekonomisë, si dhe shtim të të hyrave përmes luftimit të ekonomisë jo-formale.

Për dallim nga parashikimet periudhave paraprake, supozimi i parë bazohet në parashikimin e rritjes së ulët të çmimeve brenda periudhës së ardhshme trevjeçare. Më saktësisht, korniza makroekonomike mbi të cilën bazohet planifikimi i të hyrave parasheh që rritja mesatare e çmimeve të konsumit të jetë 0.9%, ndërsa çmimet e importit pritet të biejnë me një mesatare prej 0.7% (për periudhën 2015-2017). Një mjedis i tillë me presione të ulëta inflacionare do të ndikojë në rritjen e të hyrave përmes shtimit të aktivitetit ekonomik si rezultat i uljes reale të kostove të konsumit dhe investimit. Për më shumë, ndryshimet në strukturën e shpenzimeve publike të karakterizuara me rritje pagash dhe transferesh pritet të jenë një stimul shtesë për konsumin, dhe rrjedhimisht edhe për arkëtimin e të hyrave buxhetore.

Supozimi i dytë bazohet në planifikimin e gjenerimit të të hyrave shtesë nga aktivitetet e parapara me “Strategjinë për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit, dhe Krimeve Financiare” 2014-2018. Zbatimi i suksesshëm i planit të veprimit të kësaj strategjie do të mundëson uljen e hendekut tatimor përmes formalizimit të vazhdueshëm të aktiviteteve ekonomike, të cilat do të sigurojnë të hyra të qëndrueshme buxhetore për vitet në vijim.

Tabela 1: Të hyrat buxhetore si dhe pjesëmarrja e tyre në BP-V


Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014 Buxheti	2015 Proj.	2016 Proj.	2017 Proj.
në miliona Euro								
Te hyrat e përgjithshme:	1,166.0	1,309.2	1,321.7	1,316.2	1,458.0	1,571.8	1,572.5	1,598.2
si % e BPV-së	29%	31%	28%	26%	27%	27%	26%	25%
Të hyrat tatimore	893.6	1,058.0	1,094.3	1,104.8	1,264.1	1,346.4	1,342.1	1,365.6
si % e BPV-së	21%	22%	22%	22%	23%	23%	22%	21%
Të hyrat jo-tatimore dhe vetanake	147.9	162.6	145.4	168.4	192.5	195.0	200.4	202.6
si % e BPV-së	3%	3%	3%	3%	4%	3%	3%	3%

Në total, për periudhën 2015-2017, parashihet që arkëtimi kumulativ i të hyrave buxhetore të arrijë vlerën prej 4.74 miliardë euro, me 1.58 miliardë euro si mesatare vjetore. Pjesëmarrja e të hyrave në BPV përgjatë periudhës afat-mesme pritet të jetë mesatarisht 27%, me një pjesëmarrje mesatare të të hyrave tatimore në 23%. Pjesëmarrja e të hyrave tatimore në BPV parashihet të ulet gradualisht në 21% deri më 2017, pasi që në periudhën afatmesme politika fiskale pritet të akomodojë dy marrëveshje për tregëti të lirë (me Turqinë dhe Bashkimin Evropian), si dhe të ofrojë lehtësira fiskale për stimulimin e sektorit privat përfshirë këtu lirimet e aprovuara doganore për inputet në prodhim, stimuj tatimor për zonat e lira ekonomike, si dhe stimuj për thithjen e investimeve të huaja direkte. Si rezultat, parashihet që si përqindje ndaj aktivitetit të përgjithshëm ekonomik (BPV-së) barra tatimore të jetë më e ulët.

2.5.1.1. Të Hyrat Sipas Burimit të Arkëtimit

Të hyrat buxhetore pritet të kenë strukturë të ngjashme përgjatë periudhës së parashikuar afatmesme, me një rritje graduale të pjesëmarrjes së të hyrave vendore. Për shkak të arkëtimit të përbashkët të Tatimit në Vlerën e Shtuar nga Dogana dhe Administrata Tatimore në Kosovë, struktura e të hyrave edhe më tej parashihet të dominohet nga të hyrat doganore, me një pjesëmarrje mesatare prej 59%. Përderisa në vitin 2010 pjesëmarrja e të hyrave vendore në të hyrat e përgjithshme ishte 18.5%, falë rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave nga Administrata Tatimore e Kosovës, përgjatë periudhës afatmesme kjo pjesëmarrje pritet të arrijë në 27%, që dëshmon për një përkushtim të vazhdueshëm në implementim të reformave për të siguruar zhvendosje të mbledhjes së tatimeve nga kufiri brenda vendit, për të siguruar një financim të qëndrueshëm gjatë periudhës afatmesme.

- **Të hyrat vendore** pritet të rriten nga 367 milionë euro, sa janë parashikuar me Buxhetin e vitit 2014, në 430 milionë euro më 2015. Kjo rritje prej 17% mbështetet në rritjen e të hyrave nga TVSH-ja dhe nga të hyrat e gjeneruara përmes tatimit të të ardhurave si rezultat i rritjes së përshpejtuar ekonomike më 2014 (në veçanti rritjes së konsumit si rezultat i stimujve fiskal dhe zgjerimit kreditor, si dhe zëvendësimit të importit), dhe si rezultat i aktiviteteve për luftimin e ekonomisë jo-formale në vend. Për shkak të efektit të

Grafiku 5: Struktura e të hyrave sipas kategorive, në % të të hyrave të përgjithshme

zgjërimit të bazës tatimore më 2015, në vitet në vijim (2016-2017) pritet rritje më modeste e të hyrave vendore, në linjë me performacën makroekonomike dhe me parashikimet për ofrimin e lehtësirave fiskale për sektorin privat.

- **Të hyrat doganore** pritet të rriten më 2015 me rreth 3% në krahasim me parashikimin e buxhetuar më 2014. Përkundër rënies së parashikuar të çmimeve të importit me 0.6% më 2015, rritja e të hyrave pritet të vijë nga kërkesa e shtuar për importe si rezultat i rrijtes së konsumit dhe investimeve, ndonëse me trend më të ngadalësuar se ai historik për shkak të zëvendësimit evident të importit. Më 2016 të hyrat doganore pritet të jenë për 15 milionë euro më të larta se në vitin 2014, mirëpo për 9 milionë euro më të ulëta se në vitin 2015. Kjo për arsye se implementimi i marrëveshjes për tregti të lirë me BE-në dhe me Turqi pritet të ketë një efekt të njëhershëm, i cili më pastaj do kompensohet me rritje të volumit të importit më 2017, duke rezultuar në të hyra të parashikuara prej 969 milionë Euro, apo rreth 4% më të shumë se sa parashikimi i buxhetuar për vitin 2014. Megjithatë duhet cekur që efekti në rënien e të hyrave doganore nga fillimi i implementimit të marrëveshjeve për tregti të lirë (BE dhe Turqi), në vitin e parë të implementimit të tyre (2016) nuk pritet të jetë në vlerën prej 10% të vlerës nominale të importit prej këtyre vendeve, për shkak të liberalizimit gradual që do të ndodhë si pjesë e marrëveshjeve përkatëse të negociuara.

Tabela 2: Struktura e të hyrave buxhetore, parashikimi 2015-2017

Përshkrimi	2011	2012	2013	2014 Buxheti	2015 Proj.	2016 Proj.	2017 Proj.
në miliona Euro							
Të hyrat nga tatimet	1,058	1,094	1,105	1,264	1,346	1,342	1,366
Të hyrat tatimore vendore	261	284	305	367	430	436	443
Të hyrat tatimore doganore	828	845	837	934	958	949	969
<i>Kthimet</i>	-31	-35	-38	-37	-41	-42	-46
Të hyrat jo-tatimore dhe vetanake	163	145	168	193	195	200	203
Dividenda	60	45	43	0	30	30	30
Grantet e projekteve	0.1	-	-	1	0.3	-	0.0
Fondi i mirëbesimit	9	-	-	-	-	-	-
Të hyrat totale	1,309	1,322	1,316	1,458	1,572	1,572	1,598

- **Të hyrat jo-tatimore, ato vetanake, dhe të hyrat tjera** ndonëse me potencial të gjerë për rritje, sidomos në nivelin komunal, janë parashikuar në mënyrë konzervative, duke ruajtur pjesëmarrjen e tyre konstante në mesatarisht 3% të BPV-së (me një mesatare vjetore prej 199 milionë euro). Duhet theksuar se në parashikimin e kësaj kategorie të hyrash nuk është marrë për bazë stoku potencial i të hyrave që mund të gjenerohen nga legalizimi i objekteve në nivel komunal brenda periudhës afat-mesme, apo edhe ngritja e kapaciteteve për grumbullim të tatimit në pronë nga ana e komunave. Rënia në nivelin e të hyrave vetanake në nivelin qëndror reflekton vendimin për lirimin e nivelit të pagesave për studentë si dhe trendin e të hyrave nga lëshimi i dokumenteve. Në anën tjetër rritja nga të hyrat nga tantimat nuk reflekton ndryshim të pagesës, por rritje të hyrash si rezultat i prodhimit më të lartë të energjisë, në pajtim me trendin e përmirësimit të bilancit energjetik në Kosovë. Po ashtu, si e hyrë shtesë është paraparë edhe dividenda nga ndërmarrjet publike në vlerë prej 30 milionë Euro.

Tabela 3: Struktura e të hyrave buxhetore dhe parashikimi 2015-2017

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014 Buxheti	2015 Proj.	2016 Proj.	2017 Proj.	
në miliona Euro									
Të hyrat jo-tatimore dhe vetanake	131	148	163	145	168	193	195	200	203
Te hyrat jo-tatimore	53	47	46	41	47	48	49	50	50
Te hyrat vetanake	78	101	115	104	95	117	114	117	119
<i>Niveli komunal</i>	48	52	56	59	56	67	74	76	77
<i>Niveli qëndror</i>	30	49	59	45	39	50	40	41	42
Tantiemat	-	-	-	-	25	22	22	22	22
Taksa koncesionare	-	-	2	-	2	6	10	12	12
Dividenda	200	85	60	45	43	0	30	30	30
Grantet e projekteve	-	-	0.1	-	-	1	0.3	-	-

2.5.2. Shpenzimet sipas kategorive buxhetore 2015-2017

Buxheti i vitit 2014 dhe korniza afatmesme fiskale është përgatitur duke respektuar parametrat e lejuar sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë për deficitin e përgjithshëm. Andaj, bazuar në parashikimin për trendin e të hyrave të përgjithshme buxhetore, shpenzimet e përgjithshme janë planifikuar të rriten me një normë mesatare prej 2% përgjatë periudhës afatmesme. Pavarësisht kësaj, niveli si dhe struktura e shpenzimeve mund të ndryshoj varësisht nga aprovimi dhe implementimi i iniciativave të reja ligjore si dhe realizimit të të hyrave.

Përgjatë periudhës së vrojtuar, shpenzimet rrjedhëse parashihet të përbëjnë rreth 71% të shpenzimeve totale përderisa shpenzimet kapitale prezantojnë 27% të tyre. Pjesën tjetër të shpenzimeve e përbëjnë shpenzimet për servisim të borxhit si dhe shpenzimet tjera.

Tabela 4: Struktura e shpenzimeve si % e BPV-së

Pershkrimi	2013	2014	2015	2016	2017	2014-2017
si % e BPV-së						
Shpenzimet e përgjithshme	28.7%	29.2%	29.0%	27.4%	26.3%	28.0%
Rrjedhese	18.5%	19.3%	20.7%	19.7%	18.8%	19.6%
Pagat dhe mëditjet	8.1%	8.9%	9.5%	9.0%	8.5%	9.0%
Mallrat dhe shërbimet	4.2%	4.6%	3.7%	3.5%	3.3%	3.8%
Subvencionet dhe transferet	6.1%	5.8%	7.5%	7.2%	6.9%	6.8%
Shpenzimet kapitale	10.3%	9.7%	8.0%	7.4%	7.3%	8.1%
Deficiti primar	-3.0%	-2.4%	-1.8%	-1.7%	-1.7%	-1.9%
Deficiti i përgjithshëm (sipas rregullës fiskale)	-3.3%	-2.0%	-2.0%	-2.0%	-2.0%	-2.0%

Pagat dhe mëditjet – Pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet rrjedhëse e përbën kategoria e Pagave dhe Mëditjeve. Përgjatë kësaj periudhe, kjo kategori do të përfaqësoj rreth 45.7% të shpenzimeve rrjedhëse apo rreth 9% të BPV-së. Duke filluar nga muaji Prill i vitit 2014, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për rritjen e pagave të shërbyesve civil për 25%, financimi i së cilës do të bëhet nga kontigjenca për paga që është planifikuar në buxhetin 2014 si dhe racionalizimi i shpenzimeve në kategori të ndryshme. Krahas kësaj, në periudhën afatmesme, kjo rritje planifikohet të inkuadrohet në kuadër të buxhetit të planifikuar për këtë

kategori për vitet e ardhshme. Megjithatë, rritjes së nivelit të shpenzimeve për këtë kategori në një masë të caktuar i kanë kontribuar shpenzimet e implementimit të ligjit për sigurime shëndetësore i cili planifikohet të kapë vlerën prej 18.5 milionë euro si dhe shpenzimet për punësimet e reja të planifikuara me buxhet të vitit 2014. Si rezultat, niveli i shpenzimeve për paga dhe mëditje gjatë vitit 2015 do të arrijnë në 550 milionë euro duke përfaqësuar një rritje prej 14% krahasuar me vlerën e buxhetuar për vitin 2014.

Mallra dhe shërbime – me qëllim të ruajtjes së deficitit të përgjithshëm buxhetor, dhe rrjedhimisht përfshirjes së iniciativave të reja të cilat në vete bartin kosto shtesë për buxhetin, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për reduktimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për 15% përgjatë periudhës së planifikimit. Si rrjedhojë, shpenzimet për këtë kategori pritet të shënojnë rënie në pjesëmarrje në shpenzimet rrjedhëse nga 24% në 17.7% duke qëndruar në vlerën prej 215 milionë euro përgjatë periudhës 2015-2017.

Subvencionet dhe transferet– Krahas vendimit për rritje të pagave, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim edhe për rritje të pensioneve dhe mbështetjes së kategorive tjera sociale për 25% si dhe pensioneve të të pensionuarve nga Trepça për 50%. Veç kësaj, kjo kategori e shpenzimeve reflekton edhe rritjen natyrale të përfituesve e po ashtu, filluar nga viti 2014, në këtë kategori është përfshirë edhe implementimi i Ligjit mbi Veteranët e Luftës si dhe Ligjit mbi Ish të Përndjekurit Politik. Kjo ka rezultuar në rritjen e pjesëmarrjes së kategorisë së subvencioneve dhe transfereve nga 29.9% sa ishte planifikuar në vitin 2014 në 36.7% në fund të periudhës së planifikimit. Në këtë kategori janë përfshirë edhe subvencionet për sektorin e bujqësisë të cilat planifikohen të rriten për rreth 38 milionë euro në vitin 2015 duke u rritur shumëfish krahasuar me buxhetin e vitit 2014. Kjo rritje pritet të vazhdojë edhe përgjatë periudhës së planifikimit, që dëshmon përkushtimin për trajtimin e sektorit të bujqësisë si një prej sektorëve prioritar dhe me potencial për zhvillim, krijim të vendeve të punës dhe zëvendësim të importit. Rrjedhimisht, kategoria e subvencioneve dhe transfereve është vlerësuar në 434 milionë euro në vitin 2015 dhe parashihet të rritet në 440.6 milionë euro si rezultat i përfshirjes së rritjes natyrale të përfituesve përgjatë viteve.

Shpenzimet Kapitale – kjo kategori e shpenzimeve edhe përgjatë periudhës së projektuar do të vazhdojë të përfaqësojë një pjesë të rëndësishme të shpenzimeve të përgjithshme. Nën supozimin e ekzekutimit të plotë të këtyre shpenzimeve kjo kategori pritet të përbëjë rreth 27% të shpenzimeve totale apo rreth 8.1% të BPV-së në mesatare për periudhën 2015-2017.

Në kuadër të shpenzimeve kapitale dhe kornizës së prezantuar fiskale është integruar edhe projekti i ndërtimit të Rrugës 6 Prishtinë –Shkup. Ajo që vlen të ceket është që pjesa më e madhe e investimeve kapitale edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme do të financohen nga burimet e të hyrave të rregullta, edhe pse një numër i madh i projekteve të sektorëve të ndryshëm planifikohet të financohet nga huazimi i jashtëm.

Tabela 5. Struktura e shpenzimeve 2014-2017, në miliona euro

Pershkrimi	2014 Buxheti	2015 Proj.	2016 Proj.	2017 Proj.
<i>Ne miliona euro</i>				
Shpenzimet totale	1,589	1,678	1,679	1,706
nga te cilat AKP	7	7	5	4
Rrjedhese	1,050	1,196	1,207	1,215
Pagat dhe meditet	483	550	552	554
Mallrat dhe sherbimet	252	211	215	215
Subvencionet dhe transferet	314	435	441	447
<i>Transferet sociale</i>	293	414	420	436
<i>Subvencionet per NP</i>	21	21	21	21
Shpenzimet kapitale	530	461	450	470
Rezerva	2	5	5	5
Rezerva e pashpërndarë		16	16	16
Bilanci primar	-131	-106	-106	-108
Pagesa e interesit	-17	-17	-22	-23
Bilanci i pergjithshem (sipas rregulles fiskale)	-111	-117	-122	-127
Bilanci i pergjithshem	-148	-123	-128	-131

Burimi: MF, Thesari dhe parashikimet e Departamentit të makroekonomisë

Financimi – Pas anëtarësimit në BERZH, EIB si dhe institucionet tjera financiare, një pjesë e shpenzimeve planifikohet të financohet nga huamarrja e jashtme.

Ashtu siç është sqaruar edhe më lartë, supozimet për fillim të implementimit të rregullës fiskale nga viti 2014 e tutje ka kushtëzuar planifikimin e matur të shpenzimeve publike duke e kufizuar rritjen e deficitit buxhetor në 2% të BPV-së. Nën supozimin e ekzekutimit të plotë të shpenzimeve dhe arkëtimit të të hyrave deficiti buxhetor pritet në mesatare të arrijë në 2.0 % të BPV-së.

Tabela 6. Financimi 2014-2017, në miliona euro

Pershkrimi	2014 Buxheti	2015 Proj.	2016 Proj.	2017 Proj.
<i>Ne miliona euro</i>				
Financimi	-148	-123	-128	-131
Financimi i jashtem	34	55	-6	-23
Terheqjet	56	82	55	33
Pagesa e kryegjese se borxhit	-22	-27	-61	-55
Financimi i brendshem	114	68	134	154
Huazimi i brendshem	120	121	169	160
Financimi i njehereshem	20	0	0	0
Ndyshimi ne mjetet tjera financiare	-19	-38	-19	-10
Ndyshimi ne stokun e THV	4	12	12	7
Ndyshimi ne bilancin bankar	-10	-26	-29	-3
Bilanci i BKK	170	196	225	228
<i>Nga te cilat: ELA</i>	46	46	46	46

Burimi: MF, Thesari dhe parashikimet e Njesisë së makroekonomisë

Deficiti i parashikuar buxhetor pritet të financohet nga disa burime përfshirë këtu huamarrjen e jashtme, huamarrjen e brendshme si dhe të hyrat e njehershme nga fondet e likuidimit. Me adoptimin e rregullës fiskale, Qeveria synon të ruaj nivel të moderuar të borxhit publik duke e mbajtur rritjen e tij në normë që qon drejt nivelit të stabilizuar të borxhit e që është nën nivelin e lejuar me ligj. Në këtë kontekst, vlera e përgjithshme e huazimeve të jashtme (përfshirë edhe kreditë me nën-huazim) gjatë viteve 2015-2017 planifikohet të mos e tejkaloj vlerën prej rreth 169.6 milionë euro. Vec kësaj, duke qenë si pikë e balancimit, me qëllim të ruajtjes së një niveli adekuat të bilancit bankar, huazimi i brendshëm parashihet të arrijë vlerën prej 450 milionë eurosh përgjatë periudhës 2015-2017. Me këtë strategji të huazimit, borxhi publik pritet të arrijë në 15.7% të BPV-së deri në fund të periudhës së planifikimit nga 11.2% sa parashihet në vitin 2014.

Rol të rëndësishëm në financim të deficitit gjatë vitit 2014 pritet të ketë edhe financimi i njehershëm nga të ardhurat nga likuidimi i ndërmarrjeve publike, që pritet të disbursohen përmes AKP-së. Andaj, gjatë vitit 2014 nga ky burim pritet të realizohen të hyra në vlerë prej 20 milionë euro. Si rezultat, në fund të periudhës së planifikimit, bilanci bankar përfundimtar pritet të arrijë në 228.5 milionë euro e që përbënë 3.5% të BPV-së. Në kuadër të këtij bilanci ngjajshëm me vitet e kaluara është e përfshirë edhe Asistenca për Likuiditet Emergjent në vlerë prej 46 milionë euro. Ndërkaq, vlera e tërësishme e bilancit të parashikuar bankar përgjatë kësaj periudhe është në nivelin adekuat që siguron qëndrueshmëri të financave publike në rast të tronditjeve emergjente.

Kutia 2: Analizë e shkurtër e qëndrueshmërisë së borxhit

Rreziku për mundësinë e arritjes së borxhit publik në gjendje të paqëndrueshme në Kosovë është ende i vogël. Kjo për faktin që Kosova ka ende një nivel të ulët të borxhit në raport me BPV-në dhe Qeveria e Kosovës tanime ka adoptuar rregullën fiskale që kufizon deficitin e përgjithshëm buxhetor në 2% të BPV-së. Qëllimi i kësaj rregulle fiskale është ta stabilizoj nivelin e borxhit shtetëror në nivelin nën atë të lejuar me ligj. Andaj, analiza e qëndrueshmërisë së borxhit publik (AQB) bën vlerësimin e borxhit mbi bazën e qëndrueshmërisë së rregullës fiskale duke bërë krahasimin e indikatorëve të borxhit dhe kufinjëve të barrës së borxhit në skenarin bazë me skenarë të ndryshëm për periudhën 2012-2050.

Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit të Kosovës përdorë modelin e Ministrisë së Financave për AQB dhe indikatorët e rrezikut të përpiluar nga ana e Bankës Botërore- FMN për vendet me të ardhura të ulëta. Vlera aktuale (VA) e borxhit publik të Kosovës në vitin 2013 është 12% e BPV-së. Maturiteti i **borxhit të trashëguar** është 23 vite përderisa borxhi i mbetur maturon në vitin 2031. Borxhi tjetër ekzistues ka kryesisht maturitet afat-gjatë i cili varion në mes 10 dhe 30 vite.

Duke filluar nga viti 2014, deficiti i përgjithshëm buxhetor pritet të jetë 2% e BPV-së. Projekti për rrugën 7 është përfunduar në vitin 2013 ndërsa korniza fiskale është mjaft e kufizuar për të mbuluar presionet fiskale që pritet të vijnë nga politikat e reja sociale të cilat ndërlihen me aprovimin e ligjeve që krijojnë benefite të reja, si dhe nga projekte të reja


kapitale të cilat janë të domosdoshme për ngritjen e infrastrukturës në përgjithësi.
Indikatorët e borxhit dhe kufijtë e barrës së borxhit të caktuara nga BB-FMN janë:

- Vlera aktuale e borxhit në raport me BPV-në - 40%;
- Vlera aktuale e borxhit në raport me eksportin e mallrave dhe shërbimeve - 150%;
- Vlera aktuale e borxhit në raport me të hyrat buxhetore - 250%;
- Servisimi i borxhit në raport me eksportin e mallrave dhe shërbimeve – 20%;
- Servisimi i borxhit në raport me të hyrat buxhetore – 30%.

Skenari bazë: Supozimet kryesore që janë marrë për të ndërtuar skenarin bazë janë:

- Rritja nominale e BPV-së - 6.0%;
- Norma e inflacionit – 2%;
- Pjesëmarrja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në BPV– nga 18.8% e BPV-së në 2012 në 37.3% e BPV-së në 2050 (nën supozimin që pjesëmarrja e eksportit do të rritet me 0.5 pika të përqindjes për çdo vit);
- Të hyrat buxhetore 25.5% e BPV-së;
- Bilanci i përgjithshëm buxhetor - 2%;
- Bilanci bankar i Qeverisë së përgjithshme - 4.5% e BPV-së;
- Nga viti 2016, pjesëmarrja e borxhit koncesional supozohet të jetë 30% përderisa pjesa tjetër është borxh komercial.

Nën skenarin bazë sikurse indikatorët e solvencës ashtu edhe indikatorët e likuiditetit mbeten nën kufijtë e barrës së borxhit (shih grafikët më poshtë). Pra, siç u cek edhe më lartë, mbajtja e deficitit në nivel të përcaktuar me rregull fiskale e shpie borxhin drejt një trajektoreje që mundëson mbajtjen e nivelit të tij nën atë të lejuar me ligj.



Në **skenarët alternativ** është bërë analiza e ndryshimit të ndryshimit të supozimeve për rritjen ekonomike dhe rregullën fiskale.

Skenari alternativ a.: Në këtë skenar është ndryshuar supozimi i rritjes nominale të BPV-së nga 6.0% në 4%. Me këtë ndryshim, si rrjedhojë, kemi nivel më të ulët të të hyrave dhe nivel më të ulët të eksportit. Andaj, rritja më e ulët e BPV-së nominale ndikon në arritjen më të shpejtë të nivelit maksimal të stokut të borxhit përderisa indikatorët e borxhit në raport më të hyrat i ofrohen kufirit.

Skenari alternativ b.: Ky skenar supozon që presionet e mëdha fiskale shtyjnë në thyerjen e rregullës fiskale duke rritur deficitin e përgjithshëm nga 2% të BPV-së në 3% të BPV-së. Edhe në këtë skenarë, indikatorët e solvencës dhe likuiditetit në raport me BPV-në dhe eksportin e tejkalojnë kufirin e barrës së borxhit ndërsa indikatorët e borxhit në raport me të hyrat arrijnë kufirin.

Nga të gjithë këta skenarë, përfshirë këtu edhe skenarin bazë, shihet që baza e ulët e eksportit i lejon Qeverisë mundësi të limituara për të hyrë në borxh. Andaj, kjo analizë sugjeron që politikat e Qeverisë duhet të orientohen drejt reformave strukturore që do të ndikojnë në ngritjen e sektorit privat dhe rritjes së bazës së eksportit.

2.5.3. Rreziqet fiskale për periudhën 2015-2017

Periudha e planifikimit që mbulon KASH 2015-2017 përcjelllet me rrezik më të ulët makroekonomik se sa periudhat paraprake. Kjo për arsye se tronditjet që mund të viejnë nga sektori i jashtëm – kryesisht në formë të uljes së dërgesave nga emigrantët apo rënies së rrjedhës të kapitalit të huaj – kanë probabilitet më të ulët të paraqitjes. Në vitin 2014, parashikimet e institucioneve ndërkombëtare (IMF, DG ECFIN) janë rishikuar për të reflektuar një shkallë më të përsjpejtuar të rimëkëmbjes ekonomike pas daljes nga kriza, sidomos në ekonomitë e avancuara ku është e bazuar mërgata kosovare.

Kjo siguri më e lartë në sektorin e jashtëm pritet të ndikojë edhe në rritjen e besimit të sektorit bankar, i cili në Kosovë dominohet nga bankat me pronësi të huaj. Andaj, edhe rreziku nga kufizimi i ofertës së kredive është më i ulët për periudhën e projektuar afatmesme. Si rezultat i pasigurisë më të ulët makroekonomike, edhe rrjedha e të hyrave buxhetore që kanë raport të drejtpërdrejtë me performacën ekonomike pritet të jetë stabile dhe në pajtim me parashikimet.

Mjedisi i parashikuar makroekonomik me inflacion të ulët dhe çmime rënëse të importit, në një ekonomi me deficit të lartë strukturor të llogarisë korente siç është Kosova, pritet të jetë faktor kontributdhënës në rritjen ekonomike. Megjithatë, një mjedis i tillë ndërthet edhe rrezik fiskal sistematik. Më saktësisht, në rast të shtrëngimit të kreditimit për shkak të faktorëve të brendshëm (p.sh. rritjes së kredive jo-performuese si rezultat i mospërshtatjes së ofertës dhe kërkesës në sektorë specifik me investime intenzive) çmimet më të ulëta të importit mund të çojnë drejt një rrjedhe më të ulët të të hyrave të arkëtuara në kufi.

Rreziqet specifike fiskale në përgjithësi varen nga integrimi adekuat i iniciativave fiskale (në anën e shpenzimeve) brenda parametrave të lejueshëm të deficitit buxhetor. Duke qenë se rreziku makroekonomik që përcjell arkëtimin e të hyrave vlerësohet të jetë i ulët, dhe duke marrë parasysh se Republika e Kosovës ka të përfshirë një rregull fiskale (që kufizon nivelin e deficitit) si pjesë të legjislacionit të saj për menaxhimin e financave publike, atëherë rreziku specifik fiskal për KASH 2015-2017 vlerësohet të jetë i ulët.

Shtojcat:

Tabela 1. Agregatet Kryesor Makroekonomik

Pershkrimi	2012	2013 Vler.	2014 Proj.	2015 Proj.	2016 Proj.	2017 Proj.
Normat reale te rritjes (ne perqind)						
BPV	2.5%	3.2%	4.1%	4.3%	4.4%	4.5%
BPV per koke banori	0.9%	1.6%	2.5%	2.7%	2.8%	2.9%
Konsumi	1.9%	1.0%	3.9%	4.5%	2.7%	3.6%
Investimet	-10.9%	5.0%	2.1%	1.8%	6.4%	5.6%
Eksporti	-0.9%	-1.1%	5.8%	4.8%	6.1%	4.9%
Importi	-7.2%	-1.7%	3.2%	3.6%	2.3%	3.3%
Ndyshimet e cmimeve (ne perqind)						
ICK	2.4%	1.8%	0.8%	1.0%	1.0%	1.2%
Deflatori	0.5%	1.1%	2.1%	1.8%	1.4%	1.4%
Cmimet e Importit	4.5%	0.4%	-0.8%	-0.6%	-0.7%	-0.3%
Buxheti Qeveritar (ne perqindje te BPV-se)						
Te hyrat	26.9%	25.7%	26.8%	27.2%	25.7%	24.7%
Shpenzimet primare	29.3%	28.7%	29.2%	29.0%	27.5%	26.3%
<i>Nga te cilat: shpenzimet kapitale</i>	11.2%	10.3%	9.7%	7.4%	6.9%	6.9%
Bilanci rrjedhes	9.0%	7.2%	7.5%	6.4%	5.9%	5.8%
Bilanci primar	-2.4%	-3.0%	-2.4%	-1.8%	-1.8%	-1.7%
Pagesa e Interesit	0.2%	0.2%	0.3%	0.3%	0.4%	0.4%
Bilanci i pergjithshem (sipas rregulles fiskale)	-2.6%	-3.2%	-2.0%	-2.0%	-2.0%	-2.0%
Bilanci i kursimeve/investimeve (ne % te BPV-se)						
Kursimet vendore	-8.0%	-5.5%	-4.1%	-3.8%	-1.7%	-0.3%
Dergesat nga diaspora	10.6%	10.8%	10.5%	10.2%	10.1%	9.9%
Te hyrat nga jashtë, neto	3.1%	2.4%	4.2%	1.7%	2.6%	2.2%
Kursimet kombetare	5.7%	7.6%	10.5%	8.1%	11.0%	11.8%
Investimet	28.2%	27.8%	26.9%	25.9%	26.1%	26.1%
Llogaria rrjedhese	-7.7%	-6.8%	-4.8%	-6.8%	-4.3%	-4.1%
Agregatët kryesor (ne miliona euro)						
BPV	4,916	5,125	5,446	5,778	6,117	6,481
BPV per koke banori (ne euro)	2,686	2,757	2,884	3,013	3,141	3,276
BAKD per koke banori (ne euro)	2,969	3,053	3,186	3,320	3,459	3,601
Dergesat nga diaspora, neto	519	552	570	590	620	642
Popullsia (ne mijera)	1,831	1,859	1,888	1,918	1,948	1,978

Tabela 2. BPV nominale dhe komponentët e tij

Pershkrimi	2012	2013 Vler.	2014 Proj.	2015 Proj.	2016 Proj.	2017 Proj.
<i>Ne miliona euro</i>						
Konsumi	5,256	5,390	5,675	5,999	6,217	6,506
Konsumi privat	4,448	4,522	4,759	5,020	5,247	5,524
Konsumi publik	788	843	891	954	945	956
Qeveria e pergjithshme	571	632	687	756	753	766
Sektori i donatoreve	217	211	204	198	192	190
IJPSHESH	20	25	25	25	25	26
Investimet	1,387	1,427	1,467	1,499	1,595	1,691
Investimet private	837	898	973	1,110	1,177	1,245
Investimet publike	550	529	494	390	418	446
Neto eksportet e mallrave dhe sherbimeve	-1,727	-1,692	-1,696	-1,721	-1,695	-1,717
Eksportet	922	927	997	1,064	1,143	1,213
Eksportet e mallrave	287	305	329	361	396	422
Eksportet e sherbimeve	635	622	668	703	746	791
Importet	2,649	2,619	2,693	2,784	2,838	2,930
Importet e mallrave	2,360	2,306	2,361	2,435	2,481	2,562
Importet e sherbimeve	289	314	332	350	356	368
BPV	4,916	5,125	5,446	5,778	6,117	6,481
Dergesat nga diaspora, neto	519	552	570	590	620	642
Te hyrat nga jashtë, neto	154	122	227	99	158	144
BAKD	5,590	5,798	6,243	6,467	6,895	7,266
<i>Indikatorë tjerë:</i>						
Te ardhurat e disponueshme te sektorit privat (ne i	4,999	5,232	5,753	5,798	6,243	6,582
Konsumi privat per koke banori (ne euro)	2,430	2,432	2,521	2,618	2,694	2,793
Konsumi privat ne raport me BPV-ne	90%	88%	87%	87%	86%	85%
Investimet private ne raport me BPV-ne	17%	18%	18%	19%	19%	19%
Eksportet ne raport me BPV-ne	19%	18%	18%	18%	19%	19%
Importet ne raport me BPV-ne	54%	51%	49%	48%	46%	45%

Tabela 3¹. Te hyrat dhe Shpenzimet e Qeverise se Pergjithshme

Pershkrimi	2013	2014 Buxheti	2015 Proj.	2016 Proj.	2017 Proj.
<i>Ne miliona euro</i>					
1. Te hyrat totale	1,316	1,458	1,572	1,572	1,598
Te hyrat nga tatimet	1,105	1,264	1,346	1,342	1,366
Te hyrat vendore	305.4	367.3	429.6	435.6	443.0
Te hyrat doganore	837.3	934.1	958.2	948.7	968.6
Kthimet	-37.9	-37.3	-41.3	-42.3	-46.0
Te hyrat jo-tatimore, THV	168.4	192.5	195.0	200.4	202.6
Te hyrat jo-tatimore	46.7	47.8	48.8	49.8	49.8
Te hyrat vetanake	95.0	117.2	114.2	116.6	118.8
Niveli komunal	55.9	67.2	74.2	75.6	76.8
Niveli qendror	39.1	50.0	40.0	41.0	42.0
Taksa koncesionare	2.0	5.5	10.0	12.0	12.0
Tantiemat	24.7	22.0	22.0	22.0	22.0
Dividenda	43.0	0.0	30.0	30.0	30.0
Mbeshtetja buxhetore nga donatoret	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Komisioni Evropian	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Banka Botërore	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Grantet e projekteve	0.0	1.3	0.3	0.0	0.0
Fondi i mirebesimit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
2. Shpenzimet totale	1,469	1,589	1,678	1,679	1,706
<i>Nga te cilat: shpenzime nga të hyrat e dedikuara AKP</i>	5.8	7.0	6.6	5.4	4.4
Rrjedhese	945.5	1,050	1,196	1,207	1,215
Pagat dhe medijtjet	417.1	483.4	550.2	551.9	553.9
Mallrat dhe sherbimet	215.5	252.0	211.4	214.8	214.8
Subvencionet dhe transferet	312.9	314.1	434.6	440.6	446.6
Transferet sociale	288.3	292.7	413.6	419.6	436.4
Subvencionet per NP	24.6	21.4	21.0	21.0	21.0
Rezerva	0.0	2.2	5.0	5.0	5.0
Kredidhenia	-6.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Nga te cilat: kredite per NP	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Nga te cilat: kthimet nga NP	-6.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzimet kapitale	529.2	530.5	460.7	450.4	470.3
Rezerva të pashpërndara			15.8	15.8	15.8
3. Bilanci primar	-152.5	-131.2	-106.0	-106.0	-108.2
Pagesa e interesit	-11.5	-16.5	-17.4	-21.6	-23.1
4. Bilanci i pergjithshem (sipas rregulles fiskale)	-163.9	-110.7	-116.8	-122.2	-126.9
5. Bilanci i pergjithshem		-147.7	-123.4	-127.6	-131.3
6. Financimi	-163.9	-147.7	-123.4	-127.6	-131.3
Financimi i jashtem	-9.4	33.6	55.2	-5.9	-22.7
Terheqjet	4.6	55.7	82.4	54.7	32.5
<i>nga te cilat: FMN</i>	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Pagesa e principalit te borxhit	-14.0	-22.1	-27.2	-60.6	-55.3
Financimi i brendshem	173.3	114.1	68.2	133.5	154.0
Huazimi i brendshem	78.0	120.0	120.6	169.2	160.0
Financimi i njehereshem	26.3	20.0	0.0	0.0	0.0
Ndyshimi ne mjetet tjera financiare	-1.9	-19.5	-38.1	-19.1	-10.0
Ndyshimi ne stokun e THV	14.5	4.0	12.0	12.0	7.4
Ndyshimi ne bilancin bankar	56.4	-10.4	-26.3	-28.6	-3.4
7. Bilanci i BKK	159.7	170.2	196.5	225.0	228.5
<i>Nga te cilat: ELA</i>	46.0	46.0	46.0	46.0	46.0
BPV	5,125	5,446	5,778	6,117	6,481
Deficiti i pergjithshem si % e BPV	-3.2%	-2.0%	-2.0%	-2.0%	-2.0%
Stoku i borxhit si % e BPV-së	9.3%	11.2%	13.0%	14.6%	15.7%
<i>Nga te cilat: garancionet</i>	-	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%

¹ Per vitin 2014, vlerat e te hyrave dhe shpenzimeve jane vlerat e aprovuara me ligjin e buxhetit 2014, perderisa pjesa e financimit ka ndryshuar konform te dhenave aktuale per bilancin perfundimtar bankar te vitit 2013 si dhe te disbursimit te huamarrjes nga jasht.

Tabela 3a. Financimi

Pershkrimi	2014	2015	2016	2017
Hyrjet	362.4	385.1	432.3	425.0
Bilanci bankar nga viti paraprak (t-1)	159.7	170.2	196.5	225.0
Huazimi i jashtëm	36.2	44.3	35.6	22.5
BB Projekti per modernizimin e sektorit publik	1.2	1.0	0.0	0.0
Nga te cilat perfitues: MF	0.2	0.3	0.0	0.0
KRPP	0.0	0.6	0.0	0.0
MAP	1.0	0.2	0.0	0.0
BB Projekti per regjistrimin e patundshmerise dhe kadastrit	1.5	1.1	0.0	0.0
Nga te cilat perfitues: MMPH	1.5	1.1	0.0	0.0
BB Projekti i zhvillimit rural dhe bujqësisë	4.5	1.2	1.0	1.0
Nga te cilat perfitues: MBPZHR	4.5	1.2	1.0	1.0
BB Projekti për pastrimin dhe rikuperimin e tokës sektori i energjisë	1.4	0.4	0.0	0.0
Nga te cilat perfitues: MMPH	1.4	0.4	0.0	0.0
BB Zbatimimi i masave te efencies se energjise ne ndertesat publike	1.0	2.2	3.9	3.9
Nga te cilat perfitues: MZHE	1.0	2.2	3.9	5.0
Projektet Rrugore (MI)	11.6	20.1	14.7	0.0
ISDB rruga Millosheve-Mitrovice	3.1	9.3	3.1	0.0
OFID rruga Millosheve-Mitrovice	5.4	5.4	4.6	0.0
SFD rruga Millosheve-Mitrovice	3.1	5.4	7.0	0.0
EBRD Hekurudha FK-HE Rehabilitim	10.0	10.0	10.0	10.0
Nga te cilat perfitues: MI	10.0	10.0	10.0	10.0
BB Reforma e sistemit shendetesor	1.0	1.4	4.5	5.4
MSH- Rishikimi I sektorit Shendetesor dhe Dataqendra e Sigurimeve Shen	1.0	1.4	4.5	5.4
Rep. Austrise Projekti i kardiokirurgjise	2.0	2.6	0.0	0.0
MSH- Kardikirurgjia	2.0	2.6	0.0	0.0
Rep. Austrise e-edukimi	2.0	2.9	0.0	0.0
Nga te cilat perfitues: MASHT	2.0	2.9	0	0
BB Reforma ne arsim	0.0	1.5	1.5	2.2
Nga te cilat perfitues: MASHT	0.0	1.5	1.5	2.2
Kredite me nën-huazim	19.5	38.1	19.1	10.0
KFW Permiresimi i rrjetit-KOSTT	0.0	11.6	0.9	0.0
KFW Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujërave të zeza Faza II - Prishtinë	3.0	2.1	0.0	0.0
KFW Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujërave të zeza Faza III - Prishtinë	3.7	6.1	2.5	0.0
IDA-BB Forcimi i sektorit financiar dhe infrastruktura e tregut II	0.8	0.1	0.0	0.0
KFW Përmirsimi i Sistemit të ngrohjes qëndrore	3.9	0.0	0.0	0.0
KFW 400kV Kosove-Shqiperi-KOSTT	8.1	8.2	0.7	0.0
EIB Hekurudha FK-HE Rehabilitim	0.0	10.0	10.0	10.0
Austria Hekurudha FK-HE Rehabilitim	0.0	0.0	5.0	0.0
Huazimi i brendshëm	120.0	120.6	169.2	160.0
Letrat me vlerë	120.0	120.6	169.2	160.0
Financimi i njëhereshem	20.0	0.0	0.0	0.0
Të hyrat nga privatizimi	0.0	0.0	0.0	0.0
Të hyrat nga likuidimi	20.0	0.0	0.0	0.0
Të hyrat nga likuidimi (të dedikuara)	0.0	0.0	0.0	0.0
Ndryshimi në stokun e te hyrave vetanake	7.0	12.0	12.0	7.4
AKP	7.0	7.0	7.0	4.4
Komunat	0.0	5.0	5.0	3.0
Daljet	192.2	188.7	207.3	196.5
Amortizimi	22.1	27.2	60.6	55.3
për Huazimin e brendshëm	0.0	0.0	0.0	0.0
Letrat me vlerë (neto pagesa e kryegjësë)	0.0	0.0	0.0	0.0
për Huazimin e jashtëm	22.1	27.2	60.6	55.3
Ndryshimi në mjetet tjera financiare	19.5	38.1	19.1	10.0
Kreditë me nën-huazim	19.5	38.1	19.1	10.0
Ndryshimi në stokun e te hyrave vetanake	3.0	0.0	0.0	0.0
AKP	0.0	0.0	0.0	0.0
Komunat	3.0	0.0	0.0	0.0
Nevoja për financim të deficitit buxhetor	147.7	123.4	127.6	131.3
Bilanci Perfundimtar Vjetor	170.2	196.5	225.0	228.5

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Misioni

Kuvendi i Republikës së Kosovës si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës në Kosovë ka fushëveprim të gjerë konform Kushtetutës dhe Rregullores së punës. Kuvendi i Kosovës miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme, ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare, zgjedh dhe mbikëqyr punën e Qeverisë dhe institucioneve tjera publike që i përgjigjen Kuvendit, mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë dhe kryen punë të tjera nga fushë veprimtaria e tij.

Situata aktuale

Kuvendi i Republikës së Kosovës si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës ka miratuar një numër të konsideruar të ligjeve dhe akte tjera nga fushëveprimi i vet. Gjatë vitit janë zhvilluar aktivitete të ndryshme të bashkëpunimit ndërparlamentar.

Krahas punëve procedurale të ligjvënësve, Kuvendi gjithashtu ka kontribuar në çështje tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me integrimin e vendit në institucione të ndryshme ndërkombëtare.

Të arriturat e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë si në vijim:

- Kuvendi ka shqyrtuar dhe amendamentuar 61 projektligje, prej tyre 6 marrëveshje ndërkombëtare, ka propozuar 1129 amendamente, ka mbikëqyrur zbatimin e 13 ligjeve në fuqi, ka shqyrtuar 30 raporte të agjencive të pavaruara. Gjatë vitit Kuvendi ka shqyrtuar 23 vendime dhe propozime të Qeverisë. Kuvendi ka mbajtur 405 mbledhje të rregullta dhe aq procesverbale të hartuara, ka mbajtur 251 mbledhje të grupeve të punës dhe aq shënime zyrtare, ka mbajtur 58 dëgjime publike, ka shqyrtuar 42 raporte të audituara, ka shqyrtuar 20 peticione.
- Kuvendi në tërësi ka përfunduar renovimin e pjesës së aneksit të ndërtesës i cili tani është funksional dhe janë në vazhdim disa projekte të tjera afatgjate siç është projekti i rifreskimit dhe pavarësimit të TIK-ut.

Nga viti 2013, 26 projektligje janë shqyrtuar vetëm në lexim të parë dhe si të tilla janë bartur në vitin 2014 të cilat do të shqyrtohen, 95 projektligjet nga Programi Legjislativ i Qeverisë dhe i komisioneve parlamentare për vitin 2014, do të bëhet mbikqyrja e zbatimit të Ligjit me 17 aktivitete, do të shqyrtohen 30 raporte të agjencive të pavarura, si dhe do të realizohen edhe punët tjera teknike, administrative dhe procedurale në mbështetje të Kuvendit dhe Organeve të tij.

Objektivat

Për të përmbushur misionin e vet Kuvendi i Republikës së Kosovës planikon të arrij pesë objektiva strategjike:

1. Zhvillimi i një procesi ligjvënës efikas dhe gjithëpërfshirës;
2. Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj institucioneve që i përgjigjen Kuvendit;
3. Krijimi i kushteve për mbajtjen e takimeve të rregullta të Kuvendit me zgjedhësit e tij;
4. Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të administratës së Kuvendit;
5. Krijimi i hapësirave dhe kushteve të nevojshme për punën e deputetëve dhe organeve të Kuvendit.

Objektivi i parë synon zhvillimin e një procesi ligjvënës efikas dhe gjithëpërfshirës. Aktivitetet për realizimin e këtij objekti janë:

- Hartimi i planeve vjetore të punës së komisioneve parlamentare;
- Planifikimi i dinamikës së shqyrtimit të projektligjeve;
- Hartimi dhe miratimi i (ndryshim/plotësimi) i Rregullores së Re të Kuvendit.

Objektivi i dytë synon fuqizimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj institucioneve që i përgjigjen Kuvendit. Aktivitetet për realizimin e këtij objekti janë:

- Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit;
- Mbikëqyrja e shpenzimeve buxhetore të Qeverisë dhe agjencive tjera buxhetore;
- Mbikëqyrja e Institucioneve të Pavarura.

Objektivi i tretë synon krijimin e kushteve për mbajtjen e takimeve të rregullta të Kuvendit me zgjedhësit e tij. Aktivitetet për realizimin e këtij objekti janë:

- Ndërtimi i komunikimit në relacion deputet-qytetar;
- Të rritet shkalla e transparencës në punimet e Kuvendit;
- Instucionalizimi i bashkëpunimit në mes të Kuvendit dhe shoqërisë civile;
- Dëgjimet publike.

Objektivi i katërt synon zhvillimin e kapaciteteve profesionale të administratës së Kuvendit. Aktivitetet për realizimin e këtij objekti janë:

- Bashkëpunimi me parlamentet e vendeve të tjera;
- Trajnimet që organizohen nga institucionet tjera brenda dhe jashtë vendit.

Objektivi i pestë synon krijimin e hapësirave dhe kushteve të nevojshme për punën e deputetëve dhe organeve të Kuvendit. Aktivitetet për realizimin e këtij objekti janë:

- Renovimi i brendshëm i ndërtesës;
- Modernizimi i pajisjeve të sallës plenare dhe sallave konferenciale;
- Krijimi i qendrës së të dhënave në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Mirëmbajtja e objektit dhe pajisjeve.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Kuvendi	7,564,021	7,540,342	9,388,157	8,922,383	7,802,383	7,802,383
Totali i Programeve	3,891,390	3,793,701	4,925,536	4,849,786	3,849,786	3,849,786
Antaret e Kuvendit	3,891,390	3,793,701	4,925,536	4,849,786	3,849,786	3,849,786
Administratat e Kuvendit	3,247,280	3,319,887	4,011,796	3,628,796	3,508,796	3,508,796
Stafi mbeshtetes politik	425,351	426,754	450,825	443,801	443,801	443,801
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	7,564,021	7,540,342	9,388,157	8,922,383	7,802,383	7,802,383
Nr. i punetoreve	318	322	338	338	338	338
Paga dhe meditje	5,300,710	5,096,023	6,556,332	6,556,332	5,556,332	5,556,332
Mallra dhe sherbime	1,379,748	1,562,755	1,550,825	1,318,201	1,318,201	1,318,201
Shpenzime komunale	176,393	183,972	221,000	187,850	187,850	187,850
Subvencione dhe transfere	15,000	59,900	30,000	30,000	30,000	30,000
Shpenzime kapitale	692,170	637,692	1,030,000	830,000	710,000	710,000
Burimet e Financimit	7,564,021	7,540,342	9,388,157	8,922,383	7,802,383	7,802,383
Grantet qeveritare	7,564,021	7,540,342	9,388,157	8,922,383	7,802,383	7,802,383
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

ZYRA E PRESIDENTIT

Misioni

Përfaqësimi i unitetit të popullit të Republikës së Kosovës. Garantimi i funksionimit kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Misioni i Zyrës së Presidentit është të ofroj informata të sakta dhe këshilla të paanshme e profesionale për Presidentin e Republikës në mënyrë që të sigurohet përmbushja e misionit të Presidentit të Republikës ashtu siç është paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Situata aktuale

Gjatë vitit 2013 në vazhden e agjendës së Presidentes së Republikës së Kosovës, ka pasur një numër të konsiderueshëm të pritjeve dhe vizitave të përfaqësuesve më të lartë botëror. Gjatë vitit presidentja e Republikës mori pjesë në aktivitete të rëndësishme botërore.

Gjatë vitit presidentja dekretoi ligje të aprovuara nga Kuvendi .

Presidentja e Republikës së Kosovës, në pesë vjetorin e pavarësisë së Republikës së Kosovës, nxori një dekret për faljen e dënimit të mbetur 4 personave, që janë duke vuajtur dënimet nëpër qendrat korrektuese në Republikën e Kosovës.

Me rastin e festave të 7 e 8 Marsit, Presidentja dekoroi femra të shquara për punën e tyre në fushën e arsimit.

Është nënshkruan marrëveshja për programin Korpusi i Paqes në Kosovë me ambasadën Amerikane, po ashtu është nënshkruar Marrëveshja Bilaterale për Përmbushjen e Synimeve Zhvillimore me Ambasadorin e SHBA-ve në Kosovë dhe përfaqësuesen e misionit të USAID-it në Kosovë.

Për vitin 2013 Presidentja e Republikës së Kosovës pranoi Raportin e Progresit nga përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian për Kosovë.

Objektivat

Zyra e Presidentit për periudhën afatmesme 2015-2017 planifikon të realizojë këto objektiva:

1. Zbatimi i Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës, si dhe funksionalizimi i Zyrës së Presidentit të Republikës në përputhje me dispozitat e këtij Ligji si Institucion i veçantë në kuadër të shërbimit civil;
2. Zbatimi i politikës jo diskriminuese ndaj personelit të zyrës, duke përfshirë përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet, dhe sigurimin që struktura e personelit të pasqyrojë karakterin shumë etnik të Republikës së Kosovës;
3. Zbatimi i Ligjit për të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës – funksionalizimi i plotë i Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Zyra e Presidentit	1,422,994	1,474,314	1,900,000	1,744,676	1,744,676	1,744,676
Totali i Programeve	1,354,185	1,393,803	1,812,615	1,744,676	1,744,676	1,744,676
Zyra e Presidentit	1,354,185	1,393,803	1,812,615	1,666,291	1,666,291	1,666,291
Keshilli Konsultativ per Komunitete	68,809	80,511	87,385	78,385	78,385	78,385
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	1,422,994	1,474,314	1,900,000	1,744,676	1,744,676	1,744,676
Nr. i punetoreve	58	54	70	70	70	70
Paga dhe meditje	511,192	547,820	694,504	694,504	694,504	694,504
Mallra dhe sherbime	860,743	885,013	1,013,496	861,472	861,472	861,472
Shpenzime komunale	11,061	12,206	22,000	18,700	18,700	18,700
Subvencione dhe transfere	39,998	29,276	70,000	70,000	70,000	70,000
Shpenzime kapitale	-	-	100,000	100,000	100,000	100,000
Burimet e Financimit	1,422,994	1,474,314	1,900,000	1,744,676	1,744,676	1,744,676
Grantet qeveritare	1,422,994	1,474,314	1,900,000	1,744,676	1,744,676	1,744,676
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

ZYRA E KRYEMINISTRIT

Misioni

Misioni i Zyrës së Kryeministrit është ushtrimi i pushtetit ekzekutiv në përmbushjen e detyrave programore të Qeverisë së Kosovës, sipas funksionit dhe detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Zyra e Kryeministrit kryen udhëheqjen, koordinimin dhe monitorimin e Institucioneve të Republikës së Kosovës në përmbushjen e kriterëve që dalin nga proceset që po kalon Kosova, si dhe zbatimin e Ligjeve që janë në fuqi.

Situata aktuale

Zyra e Kryeministrit të Kosovës (ZKM), funksionon në bazë të skemës organizative që është e ndarë në agjenci dhe zyra. Agjencitë dhe zyrat e ZKM-së kanë të përcaktuar mandatin e tyre, standardet e punës dhe fushën e veprimit konkret. Agjencitë ekzekutive kanë mandate të veçantë si dhe përgjegjësi e funksione të veçanta të përcaktuara në legjislacionin e hartuar. Mandati dhe funksionet e ZKM-së janë të përcaktuar me Rregulloren nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Objektivat

Zyra e Kryeministrit e Republikës së Kosovës për periudhën afatmesme 2015-2017 planifikon të realizojë këto objektiva:

1. Përmirësimi i procesit për zhvillimin dhe koordinimin e politikave, planifikimit strategjik dhe koordinimit mbarë qeveritar, ngritja e kapaciteteve në Qeverinë e Kosovës për planifikim, hartim dhe mbikëqyrje të legjislacionit;
2. Rritja e integritetit të ekzekutivit në luftimin e korrupsionit, krijimi i një administrate publike, etike, transparente të përgjegjshme dhe jo-diskriminuese, siguri më të mirë/ lartë si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore, promovimi, respektimi dhe monitorimi i të drejtave të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare;
3. Krijimi i infrastrukturës ligjore në fushën e ruajtjes së shëndetit të kafshëve, mirëqenies së tyre, shëndetit publik dhe sigurisë së ushqimit, mbrojtjen e shëndetit të kafshëve nga sëmundjet infektive të cilat e rrezikojnë shëndetin e kafshëve, shëndetin publik dhe ekonominë e vendit;
4. Avancimi dhe strukturimi i Arkivave të Kosovës, mbrojtja, evidencimi, klasifikimi, përpunimi, shfrytëzimi, ruajtja e dokumentacionit arkivor me vlerë historike dhe shkencore si dhe organizimi dhe funksionimi i shërbimit Arkivor në Republikën e Kosovës;

5. Përmirësimi i kualitetit të informacioneve statistikore për nevojat e shfrytëzuesve dhe integrimi i sistemit statistikor në sistemin e BE-së, ngritja e kapaciteteve të teknologjisë informative dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.

Objektivi i parë synon përmirësimin e procesit për zhvillimin dhe koordinimin e politikave, planifikimin strategjik dhe kordinimet mbarë qeveritare, ngritjen e kapaciteteve në Qeverinë e Kosovës për planifikim, hartim dhe mbikëqyrje të legjislacioneve.

Objektivi i dytë synon rritjen e integritetit të ekzekutivit në luftimin e korrupsionit, krijimin e një administrate publike, etike, transparente të përgjegjshme dhe jo-diskriminuese, siguri më të mire / lartë si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore, promovimi, respektimi dhe monitorimi i të drejtave të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare. Programet të cilat janë në funksion të realizimit të këtij objekti janë: Kabineti, Zyra e Kryeministrit, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Agjencia për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, Agjencia për Barazi Gjinore, etj. Aktivitetet e këtyre programeve për realizimin e këtij objekti janë:

- Monitorimi dhe zbatimi i ligjit për barazi gjinore;
- Zbatimi i programit të Kosovës kundër dhunës në familje dhe planit të veprimit;
- Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e rezolutës 1325;
- Ngritja e vazhdueshme e marrëdhënieve me institucionet e sigurisë, monitorimin dhe informimin e shpejtë dhe të saktë mbi situatën e sigurisë në vend;
- Mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore-plotësimi i kornizës ligjore dhe harmonizimi me direktivat dhe dokumentet ndërkombëtare (EURAtom dhe dokumentet e IAEA-së).

Objektivi i tretë synon krijimin e infrastrukturës ligjore në fushën e ruajtjes së shëndetit të kafshëve, mirëqenies së tyre, shëndetit publik dhe sigurisë së ushqimit, mbrojtjen e shëndetit të kafshëve nga sëmundjet infektive të cilat e rrezikojnë shëndetin e kafshëve, shëndetin publik dhe ekonominë e vendit. Programi i cili është në funksion të realizimit të këtij objekti është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Aktivitetet e këtij programi për realizimin e këtij objekti janë:

- Krijimi i infrastrukturës ligjore në fushën e ruajtjes së shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, shëndetit publik dhe sigurisë së ushqimit;
- Mbrojtja e shëndetit të kafshëve nga sëmundjet infektive të cilat e rrezikojnë shëndetin e kafshëve, shëndetin publik dhe ekonominë e vendit;
- Mbrojtja e shëndetit publik dhe të bimëve;
- Kryerja e analizave laboratorike;
- Vazhdimi i ndërtimit të fabrikës së riciklimit.

Objektivi i katërt synon avancimin dhe strukturimin e Arkivave të Kosovës, nëpërmjet mbrojtjes, evidentimit, klasifikimit, përpunimit, shfrytëzimit, ruajtjes së dokumentacionit arkivor me vlerë historike dhe shkencore si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit arkivor në Republikën e Kosovës. Programi i cili është në funksion të realizimit të këtij objekti është Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. Aktivitetet e këtij programi për realizimin e këtij objekti janë:

- Ngritja e kapaciteteve profesionale për përpunimin e lëndës arkivore;

- Evidentimi dhe mbledhja e fondeve dhe koleksioneve arkivore nga fond-krijuesit dhe sjellja e tyre në agjenci;
- Digjitalizimi i lëndës arkivore dhe krijimi i arkivave elektronike(e-arkivave);
- Ngritja në shkallë më të lartë e shfrytëzimit të materialit arkivor.

Objektivi i pestë synon përmirësimin e kualitetit të informacioneve statistikore për nevojat e shfrytëzuesve dhe integrimin e sistemit statistikor në sistemin e BE-së, ngritja e kapaciteteve të teknologjisë informative dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar. Programi i cili është në funksion të realizimit të këtij objekti është Agjencia e Statistikave të Kosovës. Aktivitetet e këtij programi për realizimin e këtij objekti janë:

- Mbledhja e të dhënave nëpërmjet koordinimit, harmonizimit dhe sigurimit të cilësisë së të dhënave statistikore të prodhuara nga burimet administrative në Qeverinë e Kosovës,
- Harmonizimi me metodologjitë, nomenklaturat dhe klasifikimet e njohura ndërkombëtarisht.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Zyra e Kryeministrit	8,860,111	9,051,501	12,401,512	12,010,190	11,310,190	10,810,190
Totali i Programeve	8,860,111	9,051,501	12,401,512	12,010,190	11,310,190	10,810,190
Zyra per Komunitetet	999,745	1,037,211	1,284,237	1,277,186	1,277,186	1,277,186
Agjencia Shtetore e Arkivave e Kosoves	579,749	576,983	612,861	583,924	583,924	583,924
Zyra e Kryeministrit	1,628,015	1,422,688	1,553,949	1,434,026	1,434,026	1,434,026
Kabineti I Kryeministrit	1,366,726	1,769,446	1,916,399	1,719,151	1,719,151	1,719,151
Agjencia per barazi gjinore	170,636	176,962	185,770	176,320	176,320	176,320
Keshilli i Siguris se Kosoves	234,987	215,201	334,595	306,031	306,031	306,031
Agjensioni Veterinar dhe Ushqimit te Kosoves	2,873,610	2,795,735	5,240,079	5,319,655	4,619,655	4,119,655
Zyra Statestikore e Kosoves	875,992	875,706	1,023,299	961,124	961,124	961,124
Zyrat e Komisionerit per Gjuhen	125,332	83,841	182,523	169,473	169,473	169,473
Agjencia e Kosoves per mbrojtjen nga rezatimi	5,320	97,727	67,800	63,300	63,300	63,300
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	8,860,111	9,051,501	12,401,512	12,010,190	11,310,190	10,810,190
Nr. i punetoreve	542	565	642	642	642	642
Paga dhe medetje	3,006,973	3,192,556	3,600,744	3,600,743	3,600,743	3,600,743
Mallra dhe sherbime	2,912,787	3,136,133	3,428,970	2,914,624	2,914,625	2,914,625
Shpenzime komunale	128,649	119,896	239,798	203,828	203,828	203,828
Subvencione dhe transfere	1,132,285	1,173,990	1,480,000	1,480,000	1,480,000	1,480,000
Shpenzime kapitale	1,679,417	1,428,927	3,652,000	3,810,994	3,110,994	2,610,994
Burimet e Financimit	8,860,111	9,051,501	12,401,512	12,010,190	11,310,190	10,810,190
Grantet qeveritare	8,831,844	8,785,285	12,019,339	11,661,859	10,961,860	10,461,860
Te hyrat vetanake	28,267	266,216	382,173	348,330	348,330	348,330
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	258,253	223,891	512,992	-	-	-

MINISTRIA E FINANCAVE

Misioni

Misioni i Ministrisë së Financave (MF) është sigurimi i menaxhimit të përgjegjshëm, të drejtë dhe transparent të fondeve publike si dhe të këshillojë Qeverinë e Republikës së Kosovës për politikën e saj ekonomike, fiskale të përgjegjshme. Përmirësimi i standardit të jetesës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës synohet të arrihet përmes përkrahjes së një mjedisi të sigurtë dhe të shëndoshë për investime si dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Për më tepër, zhvillimi dhe zbatimi i politikave të shëndosha makro-ekonomike do të vazhdoj në bashkëveprim me Kuvendin e Kosovës, Ministrinë e Linjës, Institucionet Ndërkombëtare Financiare dhe Donatorët.

Situata aktuale

Ministria e Financave është duke analizuar dhe siguruar parashikimet e zhvillimeve makroekonomike, përgatitjen e dokumenteve kryesore buxhetore, strategjinë ekonomike dhe të gjitha politikën ekonomike dhe fiskale të Qeverisë së Kosovës.

MF-ja shqyrton dhe ofron komente mbi të gjitha marrëveshjet ekonomiko financiare ndërkombëtare dhe aktivitetet tjera në fushën financiare të Qeverisë së Kosovës.

Ministria - Qeveria ka përmbyllur me sukses Programin 20 mujor Stand By me FMN-në. Negociatat e katërmbëdhjeta bilaterale me Qeverinë Gjermane kanë rezultuar me zotime mbi 27 milionë euro për projekte zhvillimore.

Ministri i Financave në emër të Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen kornizë të bashkëpunimit me Bankën Investive Evropiane, njëkohësisht është realizuar edhe projekti i parë nga EIB në mbështetje të sektorit privat financiar.

Republika e Kosovës është anëtarësuar në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës, ndërsa me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim është nënshkruar linja kreditore stand-by për të mbështetur FSDK-në (Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës), po ashtu është nënshkruar marrëveshja e partneritetit me Bankën Islamike për Zhvillim.

Ministria e Financave ka vazhduar edhe bashkëpunimin me Bankën Botërore në implementimin e projekteve aktuale brenda portfolios.

Ka filluar edhe implementimi i Marrëveshjes Kornizë të Programit të Huave të Buta me Austrinë, dhe është finalizuar marrëveshja e parë për e-edukimin në MASHT.

Ka vazhduar me sukses projekti i emetimit të Letrave me Vlerë i cili është karakterizuar në secilin anka me kërkesë më të lartë se sa oferta, si dhe me norma të ulëta të interesit.

Me qëllim të ruajtjes së stabilitetit makro-fiskal, Ministria e Financave ka rolin kryesor në mbledhjen e qëndrueshme të të hyrave buxhetore, gjithashtu MF-ja ka përkrahur të gjitha politikën që janë në favor të zhvillimit ekonomik.

Politikat fiskale janë zhvilluar në drejtim të mbështetjes së bizneseve dhe prodhimit në vend dhe në këtë drejtim duhet përmendur sidomos hyrjen në fuqi të ligjit për lirimet doganore si dhe hartimin e UA për heqjen e TVSH-së në qumësht dhe produktet tjera bujqësore.

Ministria e Financave ka qenë pjesë e ekipit negociues për Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me Turqinë si dhe përgatitjet për MSA me Bashkimin Evropian.

Marrëveshjet e eliminimit të tatimit të dyfishtë janë negociuar dhe finalizuar në aspektin teknik me Britaninë e Madhe, kurse janë finalizuar dhe nënshkruar ato me Slloveninë, Hungarinë, Çekinë dhe Shqipërinë. Poashtu janë në proces të vazhdimit të negociimit edhe me një numër të shteteve tjera si ajo me Kroacinë, Emiratet e Bashkuara Arabe, Austrinë, etj.

Gjatë këtij viti do të zhvillohet sistemi i integruar i Teknologjisë Informative që përmirëson dhe lehtëson analizimin e politikave të ndryshme për një kohë më të shkurtër për menaxhmentin. Në këtë kuadër bashkë me Komisionin Evropian do të modernizojnë sistemin e TI-së të ATK-së, po ashtu do të punohet në integrimin e të dhënave të Aid Management Platform me sistemet e Ministrisë së Financave si dhe ngritjen e mëtejme të infrastrukturës së transparencës.

Qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë për luftimin e ekonomisë jo-formale, parandalimin e financimit të terrorizmit, shpëlarjes së parasë dhe krimeve të tjera financiare. Lufta kundër ekonomisë joformale është një nga prioritetet e larta të Ministrisë këtë vit dhe në vitet e ardhshme. Gjithashtu është miratuar Strategjia trevjeçare e Partneritetit Publiko Privat e cila paraqet orientimet kryesore të zhvillimeve ekonomike dhe ngritjes së infrastrukturës pa i mbingarkuar financat publike duke bashkëpunuar ngushtë me sektorin privat në financimin e projekteve kapitale në sektor të ndryshëm.

Në planin legjislativ Ministria ka përgatitur 15 ligje të cilat rregullojnë fusha të rëndësishme në kuadër të mandatit të Ministrisë, ka hartuar 5 Udhëzime Administrative si dhe 2 Rregullore në sferën e menaxhimit të financave publike.

Objektivat

Ministria e Financave planifikon të realizojë misionin e saj për periudhën afatmesme 2015-2017 përmes objektivave të dhëna si më poshtë:

1. Ruajtja e Qëndrueshmërisë Makro-fiskale përmes hartimit të Politikave të qëndrueshme Fiskale;
2. Plotësimi i standardeve nga procesi i Integritetit Evropian në fushën e MF-së si dhe zhvillimin e mëtejme të marrëdhënieve me Institucionet Financiare Ndërkombëtare;
3. Zvogëlimi i Ekonomisë Joformale përmes zbatimit të Programit Qeveritar dhe Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë;
4. Zhvillimi dhe përsosja e sistemit të vjeljes dhe administrimit të të hyrave tatimore dhe doganore;
5. Ngritja e cilësisë së menaxhimit të shpenzimeve publike përmes menaxhimit efikas dhe transparent të Financave Publike.

Objektivi i parë synon ruajtjen e qëndrueshmërisë makro-fiskale përmes hartimit të politikave të qëndrueshme fiskale. Programet të cilat janë në funksion të realizimit të këtij objektivi janë: Departamenti i Politikave Ekoomike, Fiskale dhe Publike, Departamenti i Buxhetit, Departamenti i Buxhetit Komunal, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e

Kosovës, Departamenti i Auditimit, Njësia Qendrore Harmonizuese dhe Thesari. Aktivitetet e këtyre programeve për realizimin e këtij objektivi janë:

- Përgatitja e kornizës së matur makro-fiskale si element bazë për hartim të buxhetit të Qeverisë (MF);
- Ndërlidhja e politikave prioritare, reformave strukturore dhe ligjeve të propozuara me planifikim të matur të shpenzimeve publike dhe avancimi i politikave fiskale në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe qëndrueshmërisë buxhetore;
- Implementimi i kriterëve të përcaktuara me marrëveshjen e FMN-së;
- Menaxhimi i borxhit publik;
- Projekti i vlerësimit të sistemit fiskal lokal dhe aplikimi i burimeve të reja për të ngritur qëndrueshmërinë financiare të komunave.

Objektivi i dytë synon plotësimin e standardeve nga procesi i Integritimit Evropian në fushën e MF-së duke përfshirë zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me Institucionet Financiare Ndërkombëtare. Programet të cilat janë në funksion të realizimit të këtij objektivi janë Departamenti për Integrim dhe Koordinim Evropian, Departamenti i Politikave Ekonomike, Fiskale dhe Publike, Njësia e Inteligjencës Financiare, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Aktivitetet e këtyre programeve për realizimin e këtij objektivi janë:

- Përbushja e obligimeve të dala nga marrëveshja me FMN-në dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare;
- Adresimi i sfidave nga Studimi i Fizibilitetit, Procesi i Liberalizimit të Vizave dhe takimet sektoriale të Dialogut për Procesin e Stabilizim Asocimit (DPSA);
- Zbatimi i Planit të Veprimit për Negocimin e MSA-së, obligimeve që dalin nga MSA dhe standardeve në procesin e Liberalizimit të Vizave;
- Fillimi i draftimit të Programit Ekonomiko Fiskal (EFP) si parapërgatitje për Programin Ekonomik për Para-anëtarësim (PEP).

Objektivi i tretë synon zvogëlimin e ekonomisë joformale përmes zbatimit të Programit Qeveritar dhe Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë.

Programet të cilat janë në funksion të realizimit të këtij objektivi janë: Departamenti i Politikave Ekonomike, Fiskale dhe Publike, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, Departamenti i TI-së, Departamenti i Administratës, Bordi i Pavarur për Rishikimin e Ankesave, Departamenti i Buxhetit dhe Thesari. Aktivitetet e këtyre programeve për realizimin e këtij objektivi janë:

- Arritja e projeksionit për të hyrat e planifikuara;
- Zvogëlimi i ekonomisë joformale me anë të ngritjes së strukturave organizative, rishikimit të legjislacionit, koordinimit të aktiviteteve, rritjes së bashkëpunimit në mes të autoriteteve përgjegjëse, ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, zhvillimit të sektorit të ndërmarrjeve, vetëdijesimit kundër ekonomisë joformale, ngritjes së sistemeve të TI-së dhe rritjes së efikasitetit të grumbullimit të tatimeve;
- Ndërtimi dhe zhvillimi i sistemeve me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efijencës në grumbullimin e të hyrave nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës;
- Përfundimi i shqyrtimit të të gjitha ankesave të grumbulluara deri në transformim të Bordit të Pavarur për Rishikimin e Ankesave.

Objektivi i katërt synon zhvillimin dhe përsosjen e sistemit të vjeljes dhe administrimit të të hyrave tatimore dhe doganore. Programet të cilat janë në funksion të realizimit të këtij objektivi janë: Departamenti i Politikave Ekonomike, Fiskale dhe Publike, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, Departamenti i Buxhetit dhe Thesari.

Aktivitetet e këtyre programeve për realizimin e këtij objektivi janë:

- Arritja e projeksionit për të hyrat e planifikuara nga MF-ja, duke synuar që në vitin 2015 të Hyrat të jenë në nivelin e shpenzimeve dhe rishikimi i fushave për ngritjen e të hyrave, sistemeve të reja dhe procedurave;
- Furnizimi me pajisje të TI-së;
- Licencimi dhe menaxhimi i klientëve;
- Qendra e thirrjeve (zhvillimin dhe komunikimin me tatim pagues) lidhur me përmbushjen e obligimeve tatimore;
- Zhvillimi dhe aplikimi i fajllingut (deklarimi i obligimeve tatimore për mes rrjetit elektronik).

Objektivi i pestë synon ngritjen e cilësisë së menaxhimit të shpenzimeve publike përmes menaxhimit efikas dhe transparent të financave publike. Programet të cilat janë në funksion të realizimit të këtij objektivi janë: Departamenti i Politikave Ekonomike, Fiskale dhe Publike, Departamenti i Buxhetit, Departamenti i Buxhetit Komunal, Thesari, BKS RF, Departamenti i Auditimit të Brendshëm.

Aktivitetet e këtyre programeve për realizimin e këtij objektivi janë:

- Përgatitja e propozim buxhetit vjetor në pajtim me legjislacionin në fuqi, dhe praktikant më të mira ndërkombëtare;
- Ekzekutimi i buxhetit në pajtim me rregullat financiare të Thesarit dhe legjislacionin në fuqi;
- Monitorimi dhe raportimi i funksionimit të sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik;
- Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së auditimit të brendshëm në Sektorin Publik dhe Programi për Certifikim Ndërkombëtar;
- Të punohet drejt implementimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinnor (BPGj) sipas praktikave ndërkombëtare duke bërë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë e grave dhe burrave në mënyrë që të kontribuohet në efektivitetin dhe transparencën e menaxhimit të financave publike. Sa i përket përgatitjeve për buxhetin e vitit 2015 puna e filluar në pilot-projekte do të zhvillohet më tutje në vitet në vijim;
- Harmonizimi dhe azhurnimi i Udhëzimeve Administrative (U.A) bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) në përputhje me Direktivat e BE-së.

Tabela1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë dhe politikave të reja 2015 – 2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Ministria e Financave (pa politika të reja)	27,383,747	29,819,740	51,276,386	61,087,608	61,600,108	61,246,554
Totali i Programeve	27,383,747	29,819,740	51,276,386	61,087,608	61,600,108	61,246,554
Departamenti i Buxhetit	188,744	201,798	202,041	194,541	194,541	194,541
Departamenti i Buxhetit komunal	93,147	102,880	94,392	94,392	94,392	94,392
Departamenti për Integrim Evropian	30,316	30,762	30,443	30,443	30,443	30,443
Departamenti i Politikës Ekonomike	151,805	158,385	103,789	99,289	99,289	99,289
Departamenti i Auditimit të Brendshëm	83,336	83,597	89,641	89,641	89,641	89,641
Njësia Qendrore Harmonizuese	82,692	89,414	94,504	91,995	91,995	91,995
Thesari	3,413,620	4,367,136	3,117,833	2,935,403	2,955,403	2,945,403
Shërbimet e Administrates	1,631,412	4,450,979	2,155,961	2,454,661	2,279,161	2,114,161
Administrata Tatimore	7,426,108	7,616,788	9,138,417	8,824,869	9,484,869	8,749,328
Zyrat për mbledhjen e tatimit/Doganat	8,130,890	8,143,509	9,781,070	8,891,243	8,899,243	9,456,230
Këshilli I Kosovës për Raportim	46,118	44,025	52,052	52,052	52,052	52,052
Bordi i Pavarur për Rishqyrtimin e Tatimit	78,288	156,519	155,266	155,266	155,266	155,266
Zyra ligjore	31,265	35,820	37,521	37,521	37,521	37,521
Zyra për Komunikim Publik	22,073	21,965	25,683	25,683	25,683	25,683
Zyra për të Drejtat e Njeriut	21,593	24,594	27,919	27,919	27,919	27,919
Departamenti i Tatimit në pronë	83,559	97,108	98,779	98,779	98,779	98,779
Departamenti i Partneritetit Publiko Privat	143,917	146,731	70,226	64,075	64,075	64,075
Shërbimet e Konsulencës	732,100	179,510	300,000	255,000	255,000	255,000
Fondi për kuadro	-	-	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000
Bashkëfinancimi me IPA	1,239,557	1,697,448	2,000,000	-	-	-
Ligji i depozitave	3,300,000	1,442,489	-	-	-	-
Qendra Informativ Financiare	330,476	334,360	351,250	330,687	330,687	330,687
Agjencia Qendrore e Prokurimit	122,731	221,529	281,617	152,077	152,077	152,077
Kontigjenca për energji	-	-	6,880,000	-	-	-
Departamenti i Teknologjise Informativ	-	102,942	112,312	108,997	108,997	108,997
Zyra e buxhetit dhe Financave	-	51,209	54,812	52,217	52,217	52,217
Zyra e Prokurimit	-	18,244	20,858	20,858	20,858	20,858

Kontigjenca per Financimin e ish të Burgosurve Politik dhe veteranëve të Luftes	-		15,000,000	35,000,000	35,000,000	35,000,000
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	27,383,747	29,819,740	51,276,386	61,087,608	61,600,108	61,246,554
Nr. i punetoreve	1,597	1,602	1,704	1,704	1,704	1,704
Paga dhe meditje	11,581,057	11,922,569	13,061,529	13,061,529	13,061,529	13,061,529
Mallra dhe sherbime	7,629,946	7,930,388	8,285,269	7,245,819	6,970,319	6,970,319
Shpenzime komunale	415,743	446,723	609,920	488,592	488,592	488,592
Subvencione dhe transfere	4,745,754	6,804,736	23,474,800	36,594,800	36,594,800	36,594,800
Shpenzime kapitale	3,011,247	2,715,324	5,844,868	3,696,868	4,484,868	4,131,314
Burimet e Financimit	27,383,747	29,819,740	51,276,386	61,087,608	61,600,108	61,246,554
Grantet qeveritare	27,383,747	29,716,926	51,156,386	60,812,108	61,600,108	61,246,554
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	102,814	120,000	275,500	-	-
Grantet donatoret	201,427	2,545,503	199,349	199,349	199,349	199,349
Totali i Politikave të reja	-	-	45,000,000	68,624,014	68,816,597	68,816,597
Nr. i punetoreve			-	-	-	-
Paga dhe meditje			45,000,000	68,624,014	68,816,597	68,816,597
Mallra dhe sherbime			-	-	-	-
Shpenzime komunale			-	-	-	-
Subvencione dhe transfere			-	-	-	-
Shpenzime kapitale			-	-	-	-
Burimet e Financimit:	-	-	45,000,000	68,624,014	68,816,597	68,816,597
Grantet qeveritare	-	-	45,000,000	68,624,014	68,816,597	68,816,597
Te hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet						
Grantet donatoret						
Kontigjenca për paga (nga viti 2015-kontigjenca eshte e planifikuar per nivelin qendror	-	-	45,000,000	50,424,014	50,441,597	50,441,597
Nr. i punetoreve						
Paga dhe meditje			45,000,000	50,424,014	50,441,597	50,441,597
Mallra dhe sherbime						
Shpenzime komunale						
Subvencione dhe transfere						
Shpenzime kapitale						
Burimet e Financimit:	-	-	45,000,000	50,424,014	50,441,597	50,441,597
Grantet qeveritare	-	-	45,000,000	50,424,014	50,441,597	50,441,597
Te hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet						
Grantet donatoret						
Politika e re: Kontigjenca për	-	-	-	18,200,000	18,375,000	18,375,000

Fondin e Sigurimit Shëndetësor						
Nr. i punetoreve						
Paga dhe medijtje				18,200,000	18,375,000	18,375,000
Mallra dhe sherbime						
Shpenzime komunale						
Subvencione dhe transfere						
Shpenzime kapitale						
Burimet e Financimit:	-	-	-	18,200,000	18,375,000	18,375,000
Grantet qeveritare	-	-	-	18,200,000	18,375,000	18,375,000
Te hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet						
Grantet donatoret						
Te hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet						
Grantet donatoret						
Totali i skenarit bazë dhe politikave të reja	27,383,747	29,819,740	96,276,386	129,711,622	130,416,705	130,063,151
Numri i punëtorëve	1,597	1,602	1,704	1,704	1,704	1,704
Paga dhe medijtje	11,581,057	11,922,569	58,061,529	81,685,543	81,878,126	81,878,126
Mallra dhe sherbime	7,629,946	7,930,388	8,285,269	7,245,819	6,970,319	6,970,319
Shpenzime komunale	415,743	446,723	609,920	488,592	488,592	488,592
Subvencione dhe transfere	4,745,754	6,804,736	23,474,800	36,594,800	36,594,800	36,594,800
Shpenzime kapitale	3,011,247	2,715,324	5,844,868	3,696,868	4,484,868	4,131,314
Burimet e Financimit	27,383,747	29,819,740	96,276,386	129,711,622	130,416,705	130,063,151
Grantet qeveritare	27,383,747	29,716,926	96,156,386	129,436,122	130,416,705	130,063,151
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	102,814	120,000	275,500	-	-
Grantet donatoret	201,427	2,545,503	199,349	199,349	199,349	199,349

Shënim: Kontigjenca për Paga që ka të bëjë me rritjen e pagave sipas vendimit të Qeverisë është e planifikuar në Ministrinë e Financave për vitet 2015-2017. Këto mjete gjatë planifikimit të buxhetit do të shpërndahen nëpër Organizata Buxhetore vetëm për nivelin Qendror. Për nivelin komunal fondet shtesë për rritje të pagave janë paraparë te ndarjet për Komuna.

Kontigjenca për Fondin e Sigurimit Shëndetësor është e planifikuar në Ministrinë e Financave për vitet 2015-2017. Këto fonde në procesin buxhetor do të ndahen nëpër Organizata buxhetore për të paguar obligimet që kanë ndaj këtij Fondi si punëmarrës të punëtorëve të sektorit publik.

Tabela 2. Indikatorët Kyç të Performances

Programi (grupimi funksional i programeve)	Produkti	
<p>Planifikimi, Monitorimi, Ekzekutimi dhe Raportimi</p>	<p>Përgatitja e Ligjit për Buxhetin e Kosovës.</p> <p>Përgatitja e 4 raporteve financiare.</p> <p>16 Auditime të brendshme brenda viti.</p> <p>20 Trajnime të organizuara për auditorë të brendshëm.</p> <p>Trajnimi i anëtarëve të Komitetit të auditimit.</p> <p>Parashikimet e sakta Makrofiskale dhe me kohe.</p> <p>52 organizata buxhetore të trajnuara për sistemin e kompjuterizuar të thesarit.</p>	<p>Aprovimi në kohën e paraparë të buxhetit sipas LMFPP.</p> <p>Raportimi i Ministrisë të Financave mbi të hyrat dhe shpenzimet e parasë publike para Qeverisë dhe Kuvendit.</p> <p>Përmirësimi i Menaxhimit të Financave Publike.</p> <p>Ekzekutimi i buxhetit.</p>
<p>Grumbullimi i të hyrave</p>	<p>2,000 inspektime të subjekteve afariste.</p> <p>270,000 zhdoganime (DUD).</p>	<p>Inkasimi i të Hyrave Tatimore sipas Legjislacionit në fuqi, shqyrtimi i ankesave në fushën e tatimeve.</p> <p>Numri dhe koha e zhdoganimeve sa më e shkurtër.</p>

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Misioni

Reforma e Administratës Publike është dhe mbetet komponentë kyçe e misionit të Ministrisë së Administratës Publike. Funkcionalizimi i mirëfilltë i administratës publike, si aparat i rëndësishëm shtetëror, përqendrohet dhe përmbledhet në tri zotime vizionare: ofrimin e shërbimeve administrative efektive, realizimin e shpenzimeve në mënyrë sa më ekonomike dhe organizimin e administratës dhe punës së saj sipas standardeve evropiane.

Situata aktuale

Ministria e Administratës Publike (MAP) ka ndikuar në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të institucioneve qeveritare, duke vazhduar punën për të siguruar një ngritje të performancës së administratës në shërbim të interesave të qytetarëve, si një synim i vazhdueshëm, me qëllim të plotësimit të kriterëve për integrim evropian. Për të siguruar zbatimin sa më efikas të reformave, me synimin afatmesëm për ngritjen e sistemit të fondeve të BE-së, ka ndërmarrë një varg veprimesh në zbatim të reformës dhe ka miratuar të gjitha aktet nënligjore që derivojnë nga ligji i Shërbimit Civil për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Administratës Shtetërore, menaxhimit të financave publike, luftimit të korrupsionit, sigurimit të transparencës dhe ofrimit të shërbimeve efikase për qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë sigurimi i infrastrukturës së nevojshme fizike dhe elektronike për funksionimin efikas të administratës, duke krijuar Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit në mënyrë që të krijohen parakushte sa më të mira për një administratë sa më efikase dhe transparente, përmes e-Qeverisjes.

Në vazhdimi është duke u bërë akomodimi i të gjitha institucioneve të administratës qeveritare në objektet perkatëse.

Aktivitetet që janë në realizim e sipër përfshijnë hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore të parapara me Strategjinë Legjislative, ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civil në bazë të planit të trajnimeve për 2014, zbatimin i udhërrëfyesit për reformën e administratës publike si fazë kalimtare si dhe përgatitja e strategjisë për Reformën e Administratës Publike, ndërtimin dhe rinovimin e objekteve të institucioneve, si dhe avancimi i rrjetit shtetëror.

Objektivat

Për të realizuar misionin e saj, Ministria e Administratës Publike në periudhën afatmesme planifikon të realizoj këto objektiva:

1. Reforma në administratën publike dhe krijimi i një shërbimi civil jo-politik, profesional i bazuar në merita dhe i menaxhuar mirë;
2. Krijimi dhe menaxhimi i infrastrukturës për akomodimin e Institucioneve të Republikës së Kosovës (IRK);
3. Hartimi, plotësimi dhe ndryshimi i legjislacionit në fushën e administratës publike;

4. Ngritja e cilësisë së shërbimeve duke shfrytëzuar kapacitetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
5. Ngritja e kapaciteteve në Shërbimin Civil për t'i përmbushur në mënyre sa më efektive detyrat dhe përgjegjësit.

Objektivi i parë synon realizimin e reformës në administratën publike dhe krijimin e një shërbimi civil jo-politik dhe profesional. Për realizimin e këtij objekti përfshihen këto aktivitete:

- Ri-organizimi i ministrive dhe organeve vartëse të tyre;
- Finalizimi i procesit të klasifikimit të vendeve të punës;
- Zbatimi i sistemit të ri të pagave dhe gradimeve;
- Implementimi i Planit të Veprimit për Reformë të Administratës Publike në Kosovë.

Objektivi i dytë synon krijimin dhe menaxhimin e infrastrukturës për akomodimin e Institucioneve të Republikës së Kosovës. Aktivitetet për realizimin e këtij objekti janë:

- Rinovimi i objekteve qeveritare;
- Ndërtimi i objekteve të IRK;
- Mirëmbajtja higjienike dhe teknike e IRK.

Objektivi i tretë ka të bëjë me hartimin, plotësimin dhe ndryshimin e legjislacionit në fushën e Administratës Publike. MAP planifikon të realizoj këto aktivitete:

- Ri-procedimi i projektligjeve të cilat mbesin pa u miratuar nga viti pasues;
- Plotësim ndryshimi i 3 Ligjeve në fushën e Shërbimit Civil të Kosovës dhe Administratës Shtetërore;
- Hartimi i ligjeve të reja (në fushën e administratës publike);
- Hartimi i akteve nënligjore.

Objektivi i katërt synon ngritjen e cilësisë së shërbimeve duke shfrytëzuar kapacitetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). MAP planifikon të realizoj këto aktivitete:

- Rishikimet, plotësimet e ndryshimet në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për e-Qeverisje 2009-2017;
- Projekti E-Qeverisja;
- Sistemi telefonik qeveritar (VOIP);
- Ngritja e resurseve për TI dhe avancimi i shërbimeve;
- Mirëmbajtja e TIK -ut për IRK (licencat e Microsoft-it; anti-virusit; VPN, kabllit optik,etj).

Objektivi i pestë ka për qëllim trajnimin dhe aftësimin e nëpunësve civil për të përmbushur në mënyrë efektive detyrat e tyre. MAP-i planifikon të realizoj këto aktivitete:

- Koordinimi i trajnimeve me partner, projekte dhe institucione;
- Punimi i moduleve për trajnimet obligative.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Ministria e Administratës Publike	16,806,664	18,386,831	24,324,569	21,655,577	22,735,577	23,913,981
Totali i Programeve	16,806,664	18,386,831	24,324,569	21,655,577	22,735,577	23,913,981
Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil	176,814	349,106	1,071,884	352,081	172,081	172,081
Departamenti i Standareve dhe politikave të IMNQ-së	10,982,678	11,919,150	15,942,577	14,186,734	15,446,734	16,675,138
Shërbimet e Administratës	927,874	840,717	940,133	873,539	873,539	823,539
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	4,371,373	4,927,828	5,536,255	5,412,352	5,412,352	5,412,352
Departamenti i Regjistrimit të OJQ-ve	108,053	84,047	107,286	106,628	106,628	106,628
Departamenti për menaxhimin e reformës së Administrimit Publike	52,205	64,876	555,189	552,999	552,999	552,999
Instituti i Kosovës për Administrim Publik	187,667	201,107	171,245	171,244	171,244	171,244
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	16,806,664	18,386,831	24,324,569	21,655,577	22,735,577	23,913,981
Nr. i punëtorëve	260	254	266	266	266	266
Paga dhe mëditje	1,670,642	1,685,434	1,782,249	1,782,249	1,782,249	1,782,249
Mallra dhe shërbime	3,782,904	5,274,499	5,755,449	4,892,132	4,892,132	4,892,132
Shpenzime komunale	1,275,174	1,391,029	1,340,706	1,139,600	1,139,600	1,139,600
Subvencione dhe transfere	50,000	29,500	50,000	50,000	50,000	50,000
Shpenzime kapitale	10,027,944	10,006,369	15,396,165	13,791,596	14,871,596	16,050,000
Burimet e Financimit	16,806,664	18,386,831	24,324,569	21,655,577	22,735,577	23,913,981
Grantet qeveritare	16,806,664	17,962,163	23,431,569	21,475,577	22,735,577	23,913,981
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	424,668	893,000	180,000	-	-
Grantet donatorët	43,776	153,526	-	-	-	-

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Misioni

Misioni i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është krijimi dhe zbatimi, në mënyrë aktive, i politikave dhe programeve të cilat kanë një ndikim të shpejtë në zhvillimin e balancuar ekonomik, mjedis shoqëror dhe kulturor dhe ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e zonave rurale të Kosovës, njëherazi me këtë kontribuohet edhe në përshejtimin e integritit të vendit në BE.

Situata aktuale

Nga sipërfaqja totale e Kosovës prej 1.1 milion ha, 53% janë tokë bujqësore, ndërsa 41% janë tokë pyjore. Bujqësia është sektor i rëndësishëm ekonomik i cili siguron pjesën më të madhe të punësimit në Kosovën e pasluftës. Bujqësia e Kosovës karakterizohet me ferma të vogla, prodhimi të ulët dhe nivel i pamjaftueshëm i shërbimeve këshillimore, por edhe përkundër kësaj ajo kontribuon me 13% në BPV (bruto prodhimi vendor) të Kosovës, punëson mbi 25% të punësimit të përgjithshëm, kryesisht në sektorin joformal dhe përbën rreth 16% të vlerës së eksportit total. Rreth 62% e popullsisë së Kosovës jeton në zonat rurale. Sektori i bujqësisë, si i tillë, do të luaj një rol të rëndësishëm për ofrimin e mundësive për punësim dhe për krijimin e të ardhurave për njerëzit që jetojnë në zonat rurale.

Duke parë rëndësinë e zhvillimit të sektorit të bujqësisë, Qeveria e Kosovës i dha prioritet rritjes së financimit të këtij sektori përmes subvencionimit të fermerëve. Ky subvencionim u implementua dhe po implementohet nga MBPZHR-ja.

Nga viti 2009 deri në 2013 këto subvencione mbuluan sektorët në vijim: subvencionimi për krerë për lopë qumështore dhe mëshqerra, subvencionimi për krerë për dele dhe dhi, pagesat për sipërfaqe për grurë, subvencionimi i karburantit për korrjen e drithërave. pagesat për sipërfaqe për misër, pagesat për sipërfaqe për farë gruri, pagesat për sipërfaqe për luledielli, dhe subvencionimi për koshere (zgjua) bletësh. Përveç këtyre subvencioneve, MBPZHR-ja ka vazhduar përkrahjen edhe në projektet e hortikulturës, sera, në kompanitë e përpunimit të mishit dhe përpunimit të qumështit. Zhvillimit të këtij sektori i kanë ndihmuar edhe investimet në sistemin e ujitjes dhe ndërtimi i depove për grumbullimin, klasifikimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore.

Të gjitha këto investime kanë ndikuar që të rritet interesimi i qytetarëve, e sidomos në viset rurale që të orientohen në zhvillimin e bujqësisë përmes kultivimit të prodhimeve bujqësore, me të cilat jo vetëm që ndikuan në zbutje të varfërisë, por ndikuan edhe në rritjen e të ardhurave familjare.

Prioritetet në të cilat është përqendruar puna e Ministrisë janë në harmoni të plotë edhe me planifikimin strategjik të Qeverisë së Kosovës dhe janë të fokusuar në: (i) rritja e aftësisë konkurruese – përmes ristrukturimit të potencialit fizik në fermë; (ii) avancimit të analizave të detajuara ekonomike dhe përforcimit të Shërbimeve Këshillimore (iii) rehabilitimit të

sistemeve ekzistuese të ujitjes dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja në funksion të shtimit të rendimentit dhe cilësisë të të gjitha kulturave bujqësore të cilat kultivohen në vendin tonë; (iv) shfrytëzimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe tokës bujqësore, (v) mbështetja për zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit, dhe të tjera. (vi) krijimin e fondit për fatkeqësi natyrore, (vii) krijimin e fondit për sigurime bujqësore.

Objektivat

Për të realizuar misionin e saj, MBPZHR-ja në periudhën afatmesme planifikon të realizojë këto objektiva:

1. Rritja e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë dhe sigurimi i nivelit të duhur i të ardhurave të prodhuesve bujqësor si dhe prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit cilësor dhe mbrojtja e mjedisit,
2. Rritja e aftësisë konkurruese në bujqësi, sektorin e ushqimit dhe pylltarisë, promovimi i zhvillimit dhe mundësive të punësimit si dhe përmirësimi i kualitetit të jetesës në zonat rurale,
3. Përmirësimi i zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe të gjitha funksioneve të tyre ekologjike, ekonomike dhe sociale duke përfshirë ruajtjen e biodiversitetit.
4. Menaxhimi dhe zhvillimi cilësor i sektorit të bujqësisë përfshirë zhvillimin e politikave, vendosjen e kornizës legislative dhe normative.

Objektivi i parë synon zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, rritjen e nivelit të të ardhurave të prodhuesve bujqësor, prodhimin e qëndrueshëm, sigurinë e ushqimit, ruajtjen e shëndetit të njeriut dhe kafshëve, si dhe ruajtja e mjedisit jetësor.

Programi 'Politikat Bujqësore' përbëhet nga masat të cilat kanë për qëllim rritjen e aftësisë konkurruese, rritjen e madhësisë së fermave, rritjen e prodhimit të ushqimit të shëndetshëm, përmirësimi i kushteve socio-ekonomike, përmirësimi i infrastrukturës rurale, ruajtja e burimeve natyrore dhe biodiversitetit.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural do të vazhdoj të mbështes përmes pagesave direkte sektorët: e grurit, grurit për farë, misrit, lulediellit, kolzes, vreshtave ekzistues, pemëtarisë, perimeve në fushë të hapur, fidanëve të pemëve, lopëve qumështore, deleve, dhive, bletëve, dosa për riprodhim, pulave Vjose.

Gjithashtu do të vazhdohet me zgjerimin e sipërfaqeve të ujitura përmes rehabilitimit të sistemeve primare dhe sekondare. Pastaj do të vazhdohet me konsolidimin e tokave bujqësore te dy këto veprimtari do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e produktivitetit dhe aftësisë konkurruese në këtë sektor.

MBPZHR-ja edhe në periudhën planifikuese do të vazhdoj me mbështetjen financiare për sektorin e vreshtarisë përmes investimeve dhe pagesave të drejtpërdrejta. Aktivitet primar përveç rritjes dhe zgjerimit të sipërfaqeve me vreshta do të jetë menaxhimi i sistemit të kadastrit të vreshtave dhe Industrisë së verës në Kosovë, tregtinë e brendshme të rrushit, verës dhe produkteve tjera nga rrushi dhe vera, eksportin dhe importin e rrushit, verës dhe produkteve tjera nga rrushi dhe vera si dhe kontrollin e kualitetit të verës në dy aspekte: Analitikë dhe Organoleptikë.

Objektivi i dytë synon rritjen e aftësisë konkurruese, krijimin e vendeve të reja të punës, përmirësimi i kushteve të jetesës në viset rurale, përmirësimi i standardeve dhe përafrimi me ato të BE-së.

Programi i Zhvillimit Rural synon përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale, krijimin e një niveli më të lartë të mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së biodiversitetit dhe mirëqenien e përgjithshme .

Objektivi i tretë synon përmirësimin e zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe të gjitha funksioneve të tyre ekologjike, ekonomike dhe sociale duke përfshirë ruajtjen e biodiversitetit. Programi ‘Pylltaria’ konsiston në aktivitetet që ofrojnë kushtet për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të pyjeve në pajtim me parimet e mbrojtjes së ambientit dhe funksionimin e ekosistemeve pyjore. Të gjitha masat do të drejtohen në kultivimin, mbrojtjen, shfrytëzimin e qëndrueshëm, ruajtjen e burimeve gjenetike të pyjeve, mirëmbajtjen e infrastrukturës së pyjeve si dhe zbatimin e mbrojtjes preventive nga zjarri, sëmundjet dhe dëmtuesit në pyje.

Objektivi i katërt synon të siguroj ofrimin e menaxhimit dhe zhvillimit kualitativ në sektorin e bujqësisë përfshirë edhe zhvillimin e politikave, vendosjen e kornizës legislative dhe normative, monitorimin dhe evaluimin e zbatimit të programeve të ndryshme aftësuese.

Fondet e programit ‘Administrata dhe Menaxhimi’ synojnë kryerjen e detyrave profesionale, mbikëqyrëse, hulumtuese dhe administrative në MBPZHR dhe institucionet vartëse të saj. Gjithashtu ofrohet menaxhimi dhe operimi i regjistrave ligjor dhe bazave të të dhënave, inspektimi i aplikimeve si dhe realizimi i analizave ekonomike dhe legjislativitetit në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe pylltarisë. Mjetet e këtij programi gjithashtu kanë për qëllim mbështetjen e komunikimit, informimit të publikut, aftësimin si dhe trajnimin e fermerëve. Një fushë tjetër e rëndësishme e aktiviteteve është edhe bashkëpunimi ndërkombëtar dhe zbatimi i masave për adaptimin e Acquis.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	22,423,823	22,471,367	27,170,487	60,000,000	60,000,000	60,000,000
Totali i Programeve	22,423,823	22,471,367	27,170,487	60,000,000	60,000,000	60,000,000
Departamenti i Administratës Qendrore	383,807	617,760	671,346	618,529	618,529	618,529
Departamenti i Administratës Qendrore-BB	1,604,658	5,028,234	4,549,622	1,221,100	1,025,100	1,025,100
Zyra e Ministrit	159,306	158,488	184,301	184,301	184,301	184,301
Zyra per të Drejtat e Njeriut	20,210	25,050	26,521	24,937	24,937	24,937
Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve	7,743,506	7,158,241	16,346,501	32,591,212	32,787,212	32,787,212
Departamenti i Blegtorise	1,625,349	-	-	-	-	-
Agjencioni Pyjor i Kosovës	1,845,546	1,897,002	2,341,683	2,248,597	2,248,597	2,248,597
Departamenti i Shërbimeve Këshillimore-Teknike	8,231,230	554,167	780,967	590,175	590,175	590,175

Instituti Bujqësor i Kosovës	280,204	513,978	933,065	917,202	917,202	917,202
Departamenti i Pylltarisë	166,828	92,217	115,793	115,793	115,793	115,793
Departamenti i Politikave dhe Zhvillimit Rural	262,178	88,942	109,050	20,918,693	20,918,693	20,918,693
Enti i Verërave të Kosovës	101,002	65,143	84,953	79,563	79,563	79,563
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore	-	575,832	606,227	99,012	99,012	99,012
Agjencia për Zhvillim Bujqësor	-	5,659,704	371,871	345,240	345,240	345,240
Departamenti Ligjor	-	36,609	48,587	45,647	45,647	45,647
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	22,423,823	22,471,367	27,170,487	60,000,000	60,000,000	60,000,000
Nr. i punësuarave	315	323	323	323	323	323
Paga dhe mëditje	1,607,325	1,599,359	1,939,278	1,939,278	1,939,278	1,939,279
Mallra dhe shërbime	2,248,485	2,678,125	3,303,554	2,808,033	2,808,033	2,808,022
Shpenzime komunale	97,892	94,344	127,962	108,768	108,768	108,778
Subvencione dhe transfere	17,014,991	16,427,920	11,810,487	53,573,922	53,573,922	53,573,922
Shpenzime kapitale	1,455,130	1,671,618	9,989,206	1,570,000	1,570,000	1,570,000
Burimet e Financimit:	22,423,823	22,471,367	27,188,487	60,000,000	60,000,000	60,000,000
Garantët qeveritare	20,649,472	17,240,129	22,379,765	58,519,800	58,715,800	58,715,800
Të hyrat vetanake	169,693	203,004	259,100	259,100	259,100	259,100
Financimet nga huamarrjet	1,604,658	5,028,234	4,549,622	1,221,100	1,025,100	1,025,100
Garantët donatorët	-	-	-	-	-	-

Tabela 2. Përmbledhja e Indikatorëve Kyç të Performancës

	Aktual 2012	Aktual 2013	Buxheti 2014	Plani 2015	Plani 2016	Plani 2017
Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve						
Pagesat direkte, për grurë, grurë për fare, misër, lule diell (ne ha)		60079	63083	66237	69,549	73026
Rritja e pagesave direkte për lopë, dele, dhi, shpeztari, bletari, fidane, peme		1,267,305	1,330,670	1,397,203	1,467,063	1,540,416
Rritje e numrit të Licencave		497	500	504	529	555
Rritja e sipërfaqeve të konsoliduara (ne ha)		2697	2831	2973	3122	3278
Departamenti i Zhvillimit Rural						
Rritja e vendeve të punës		0	302	604	900	1200
Rritja e prodhimit		0	0	0	0	0
Rritja e numrit të fermerëve, përfitues të granteve		580	580	610	671	738

	Aktual 2012	Aktual 2013	Buxheti 2014	Plani 2015	Plani 2016	Plani 2017
Rritja e të hyrave për ekonomi familjare, përmirësimi i mirëqenies.		18944	18944	19891	21880	24068
Rritja e numrit të projekteve në industrinë ushqimore		29	30	31	35	38
Departamenti i Pylltarisë						
Rritja e hartimit të bazës ligjore dhe udhëzimeve administrative (harmonizimi me acquis)				20%	25%	25%
Monitorimi permanent i sipërfaqeve				10%	10%	10%
Agjencioni Pyjor i Kosovës						
Shtimi i kontroleve me qëllim të parandalimit të prerjeve ilegale dhe aktiviteteve të tjera jo ligjore në Sektorin e pylltarisë për 5 %	1064	1260	1323	1390	1460	1531
Rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara të pyjeve të degraduara, (pyllëzimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve pyjore)	683	761	710	710	710	710
Rritja vjetore e pyllit-rritja e masës drurore kualitative (në m ³ /ha)	3.3 3	3.3 3	3.3	3.3	3.3	3.3
Rritja e prerjes sanitare	34109	43,702	22,621	23,752	24,940	26,187
Ndikimi i edukimit në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe prerjet ilegale.						
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë						
Numrit i Aplikacioneve për Pagesa Direkte-Subvencionimi (pritet rritja e kërkesave për 5 %)	19200	26000	27300	28665	30100	31600
Numri i Aplikacioneve për Projekte të Zhvillimit Rural-Grante	1450	3900	4100	4300	4515	4740
Numri i kontrollit në teren, për Pagesa Direkte dhe Projekte të Zhvillimit Rural	12970	13765	14490	15252	16055	16900
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore						
Rritja e mbledhjes së analizave të të dhënave, të cilat shërbejnë si bazë për vendime/ dizajnime të politikave bujqësore	-	-	5%	5%	5%	5%
Rritja e numrit të hulumtimeve	-	-	5%	10%	10%	10%
Rritja e numrit të bazave të të dhënave dhe regjistrave		400	520	676	878	1142

	Aktual 2012	Aktual 2013	Buxheti 2014	Plani 2015	Plani 2016	Plani 2017
Regjistrat Operacional - me shumë se 95 % e sigurisë së regjistrave						
Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike						
Ngritja e kapaciteteve të këshilltarëve		500	600	700	700	700
Trajnimi dhe këshillimi i fermerëve - edukimi		9500	12000	20000	25000	25000
Përgatitja e materialit për ekstension		50000	50000	60000	60000	60000
Numri i këshillimeve në qendrat këshilluese është rritur		3500	3500	4000	5000	5000
Instituti Bujqësor i Kosovës						
Rritja e nivelit të shërbimeve laboratorike			-	-		-
Rritja e cilësisë së ushqimit			-			
Rritja e hulumtimeve në Institut						
Enti i verërave të Kosovës						
Rritja e kontrollit të kualitetit të verës		-	10%	10%	10%	10%
Rritja e eksportit të verës (baza për vitin 2014 është 8,000,000 Euro)				20%	20%	20%
Administrata Qendrore						
Rritja e bazës ligjore me qëllim të harmonizimit me Acquis		-	10%	15%	20%	25%
Rritja e numrit të kontratave, marrëveshjeve, projekteve me qëllim të integritit në BE						
Rritja e efikasitetit të menaxhmentit dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë, përfshirë zhvillimin e politikave dhe kornizave normative						
Rritja e mirëmbajtjes së regjistrave si baza e të dhënave për implementimin e politikave bujqësore dhe politikave të zhvillimit rural						
Realizimi në kohë i programeve normative të Qeverisë						
Përmirësimi profesional dhe ligjor i procedurave implementuese për menaxhimin e resurseve humane						

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

Misioni

Misioni i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) është krijimi i kushteve sistemore për zhvillimin e politikave të mirëfillta për Tregti dhe Industri. Në veçanti, Ministria zhvillon politikën, harton legjislacionin dhe programet, në mbështetje të: promovimit të investimeve dhe potencialit eksportues; promovimit të turizmit; avancimit të infrastrukturës së cilësisë; mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit si dhe zhvillimit të mëtejshëm të politikave tregtare.

Situata Aktuale

MTI-ja ka shënuar progres në të gjitha fushat e përgjegjësisë, si në implementimin e programeve ekzistuese, ashtu edhe në hartimin e programeve të reja. Progres është shënuar, duke filluar nga përmirësimi i ambientit të të bërit biznes duke u renditur në top 10 vendet më reformatore në botë, mandej është punuar në promovimin e investimeve dhe eksporteve; mbështetjen e zhvillimit të NVM-ve; avancimin e politikave tregtare dhe mekanizmave koordinues; përmirësimin e infrastrukturës së cilësisë; mbrojtjen e pronësisë industriale dhe konsumatorit; si dhe avancimin në mbikëqyrjen e tregut.

Duke e konsideruar rëndësinë e procesit të përgatitjes së negociimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit si njërin ndër proceset më të rëndësishme nëpër të cilin është duke kaluar Kosova, MTI-ja ka qenë e gatshme t'i paraprijë kësaj agjende. Gjatë vitit 2013, u krijuan strukturat negociuese të MSA-së dhe u formuan tre grupe punuese, ku MTI-ja është përgjegjëse për grupin e parë, atë për negociimin e çështjeve tregtare. Negocimi i çështjeve tregtare tanimë ka përfunduar, në këtë drejtim kemi negociuar çështjet si: liberalizimin e produkteve industriale dhe bujqësore, indikatorët gjeografik, të drejtën e themelimit të bizneseve, tregtinë e shërbimeve, lëvizjen e kapitalit, dhe trafikun tranzit.

Gjatë vitit 2013, MTI-ja ka vazhduar me pjesëmarrjen e rregullt në takimet e CEFTA-së. Është dërguar kërkesë lidhur me rastet e ndryshme të shkeljes së kësaj marrëveshje tek Sekretariati i CEFTA-së, si rasti i kuotave për miellin kosovar në Maqedoni dhe si rrjedhojë, janë larguar kuotat nga ana e Maqedonisë.

Objektivat

Për të realizuar misionin e saj Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në periudhën afatmesme planifikon të realizoj këto objektiva:

1. Krijimi i një klime të favorshme për investimet private, si vendore ashtu edhe të huaja për të promovuar rivitalizimin ekonomik dhe industrial të vendit;
2. Promovimi i Investimeve dhe Eksporteve;

3. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së cilësisë, duke i avancuar Laboratorët e Metrologjisë, përmirësuar akreditimin dhe duke shtuar numrin e standardeve të adaptuara (transpozuar) dhe po ashtu implementimin e tyre;
4. Siguria e produkteve industriale jo ushqimore, duke e ngritur vetëdijen e konsumatorit dhe përmirësuar mbikëqyrjen e tregut;
5. Zhvillimi i Politikave Tregtare në drejtim të përmirësimit të bilancit tregtar të vendit.

Objektivi i parë "Krijimi i një klime të favorshme për investimet private, si vendore ashtu edhe të huaja për të promovuar rivitalizmin ekonomik dhe industrial" synon që të krijohen kushte më të volitshme për afarizëm të bizneseve si atyre vendore ashtu edhe të huaja. Aktivitetet të cilat do të ndërmeren për realizimin e këtij objektivi janë :

- Ngritja e kapaciteteve industriale dhe turistike,
- Mbështetja e bizneseve përmes ofrimit të infrastrukturës fizike (parqet e biznesit, inkubatorët, qendrat inovative, zonat ekonomike),
- Trajnime dhe këshillime për bizneset, panaire brenda dhe jashtë vendit, etj,
- Zhvillimi i sistemit të ri për lehtësimin e ofrimit të shërbimeve biznese,
- Krijimi i infrastrukturës bashkëkohore për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale dhe promovimin e pronësisë industriale.

Objektivi i dytë "Promovimi i Investimeve dhe Eksporteve", synon promovimin e potencialit eksportues të Kosovës që do të ndikonte në përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës, duke i organizuar bizneset me potencialë eksportuese si dhe pjesëmarrja në panaire të ndryshme. Aktivitetet të cilat do të ndërmeren për realizimin e këtij objektivi janë:

- Promovimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar me qëllim të tërheqjes së kapitalit të huaj (panaire, konferenca, punëtori, etj),
- Aktivitete në promovim të investimeve dhe eksporteve.

Objektivi i tretë "Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së cilësisë, duke i avancuar Laboratorët e Metrologjisë, përmirësuar akreditimin dhe duke shtuar numrin e standardeve të adaptuara (transponuar) dhe po ashtu implementimin e tyre ", synon ngritjen e nivelit të cilësisë së produkteve vendore duke zbatuar standardet ndërkombëtare. Aktivitetet të cilat do të ndërmerren për realizimin e këtij objektivi janë:

- Adaptimi i Standardeve (Transpozimi) dhe mbikëqyrja e implementimit të legjislacionit në fushën e industrisë (infrastruktura e cilësisë, rregullat teknike, etj),
- Procedurat e akreditimit, vlerësimit dhe mbikëqyrjes së trupave vlerësues të konformitetit,
- Blerja e standardeve dhe ngritja e vetëdijes në implementimin e standardeve,
- Marrja e mostrave të naftës dhe derivateve të naftës me qëllim të verifikimit të konformitetit,
- Zhvillimi i mëtejshëm i metrologjisë, kompletimi i laboratorëve ekzistues, krijimi i laboratorëve të rinj për kryerjen e shërbimeve metrologjike.

Objektivi i katërt "Siguria e produkteve industriale jo ushqimore, duke e ngritur vetëdijen e konsumatorit dhe përmirësuar mbikëqyrjen e tregut", synon që të ngritet vetëdija e konsumatorëve përmes informimit publik, kontakteve të drejtpërdrejta, organizimin e konferencave etj. Aktivitetet të cilat do të ndërmerren për realizimin e këtij objektivi janë:

- Shtimi i aktiviteteve në lëmin e sigurisë së produkteve dhe cilësisë së tyre në treg dhe mostrimi i produkteve,
- Furnizimi me produkte të Rezervave Shtetërore,
- Kontrolli i mallrave strategjike në treg, gjatë importit, eksportit, trans ngarkesës dhe shërbimet e ndërlidhura.

Objektivi i pestë ”Zhvillimi i Politikave Tregtare në drejtim të përmirësimit të bilancit tregtar të vendit” sunon të arrihet përmes këtyre aktiviteteve:

- Pjesëmarrja dhe zbatimi i politikave dhe i rekomandimeve të dala nga CEFTA,
- Aktivitete lidhur me përafrimin e politikave me ato të Organizatës Botërore të Tregtisë,
- Aktivitete rreth zvogëlimit të barrierave tregtare, si dhe mbrojtjes së industrive me potencial eksportues.

Tabela 1: Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	4,188,779	5,332,854	5,990,989	4,233,632	4,233,632	4,233,632
Totali i Programeve						
Programi Zhvillimi Ekonomik	3,237,594	3,986,152	4,700,398	3,139,441	3,139,441	3,139,441
Rexhistrimi i Bizneseve	111,900	170,383	156,188	106,188	106,188	106,188
Departamenti për Integritet	-	24,441	37,196	37,196	37,196	37,196
Programi i Administratës Qendrore	839,285	1,151,878	1,097,207	950,807	950,807	950,807
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	4,188,779	5,332,854	5,990,989	4,233,632	4,233,632	4,233,632
Nr. i punëtorëve	195	202	207	207	207	207
Paga dhe mëditje	1,010,312	1,107,422	1,108,608	1,108,608	1,108,608	1,108,608
Mallra dhe shërbime	2,499,333	2,930,994	2,293,101	1,935,744	1,935,744	1,935,744
Shpenzime komunale	38,685	93,668	89,280	89,280	89,280	89,280
Subvencione dhe transfere	49,950	-	1,000,000	-	-	-
Shpenzime kapitale	590,499	1,200,770	1,500,000	1,100,000	1,100,000	1,100,000
Burimet e Financimit	4,188,779	5,332,854	5,990,989	4,233,632	4,233,632	4,233,632
Grantet qeveritare	4,188,779	5,332,854	5,990,989	4,233,632	4,233,632	4,233,632
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

Tabela 2. Përmbledhje e indikatorëve kyç të performancës

Indikatorët Kyç te Performancës	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 plani	2016 plani	2017 plani
Hapësira Pune Ha	0.6 Ha	1 Ha	10 Ha	15 Ha	15 Ha	18 Ha
Inspektimet	1400	1500	1600	1600	1600	1600
Licencat për rregullimin e tregut	290	290	290	290	290	290
Konferenca panairë, punëtori	133	150	180	180	190	190
Numri i produkteve të testuara	650	650	700	700	750	700

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS

Misioni

Misioni i Ministrisë së Infrastrukturës (MI) është krijimi i ambientit për zhvillim të sigurt, kualitativ dhe funksional të sistemeve të transportit dhe kapacitete njerëzore për të mundësuar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme, mjedis ekologjik, rritje ekonomike dhe integrim ndërkombëtar.

Situata aktuale

Gjatë vitit të kaluar janë lëshuar në qarkullim 78 km të projektit Autostrada Morinë - Merdare - segmentit deri në Besi. Gjithashtu, gjatë vitit të kaluar janë asfaltuar 34 km të rrugëve Nacionale dhe Regjonale dhe 125 km të rrugëve lokale.

Shtimi i sigurisë në komunikacionin rrugor është njëra nga objektivat prioritare strategjike, Ministria e Infrastrukturës ka ndërmarrë një varg veprimesh dhe masash për të realizuar këtë objektive. Si rezultat i zbatimit të Ligjit mbi Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, ndërtimit të shumë nënkalimeve dhe trotuareve, përmirësimit të sinjalizimit horizontal dhe vertikal, zbatimit të akteve ligjore dhe nën ligjore, numri i aksidenteve me fatalitet ka pësuar rënie në raport me vitin e kaluar.

Rrjeti i hekurudhave përbëhet nga rreth 334 km infrastrukturë hekurudhore. Pjesa më e madhe e rrjetit hekurudhor është në gjendje të mirë. Megjithatë, ky sektor ka nevojë për investime të reja, posaçërisht në mirëmbajtjen dhe në modernizimin e rrjetit ekzistues. Transporti i mallrave është rritur gjatë viteve të fundit dhe pritjet të rritet edhe më shumë.

Kosova ka Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës që operon me shërbime të kombinuara civile dhe ushtarake. Në prill të vitit 2010 ka hyrë në fuqi kontrata e PPP-së në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konsorciumit Turko – Francez Limak- Aeroport de Lyon për dhënien me Koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, dhe ky është një nga shembujt e suksesshëm të projekteve të Koncesionimit në Evropën Juglindore. Terminali i ri, i cili është përruar më 23 tetor të vitit 2013 është një investim prej rreth 100 milionë euro dhe ofron më shumë komoditet për udhëtarët, shërbime të nivelit të lartë, si dhe hapësirë të mjaftueshme dhe një mjedis social e relaksues për pasagjerët. Terminali i ri ka 44,000 m² dhe kapacitet që mundëson pritjen e rreth 4 milionë pasagjerëve në vit, me çka e bën Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës lider absolut në rajon, si për nga hapësirat e terminalit po ashtu edhe nga kulla e kontrollit, përderisa e shndërron Prishtinën dhe Kosovën në pikën lidhëse dhe qendër të aviacionit rajonale - qëllim ky strategjik i Qeverisë së Kosovës.

Objektivat

1. Integrimi në korridoret pan evropiane, përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së transportit dhe infrastrukturës në përputhje me standardet evropiane;
2. Krijimi i ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativ për maksimizimin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve në fushën e transportit;

3. Përmirësimi i sigurisë në komunikacion, dhe mbrojtja e ambientit.

Këto objektiva strategjike realizohen nëpërmjet përmbushjes së objektivave specifike, ku secila objektive ka planin e veprimeve dhe masave të cilat duhet ekzekutuar. Më poshtë, secila prej këtyre tri objektivave është e zëbërthyer në aktivitete specifike.

Objektivi i parë "Integrimi në korridoret pan evropiane, përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së transportit dhe infrastrukturës në përputhje me standardet evropiane", synon që të kemi qasje më të shpejtë dhe më të lehtë në koridoret evropiane (koridori VIII dhe X) që do të mundësonte qarkullimin e njerëzve dhe mallrave me një kosto më të ulët financiare.

Programet të cilat janë në funksion të realizimit të këtij objektivi janë programi i Infrastrukturës Rrugore dhe Departamenti i Transportit Hekurudhor. Aktivitetet e këtyre programeve për realizimin e këtij objektivi janë:

- Vazhdimi i Mirëmbajtjes të segmenteve (1 – 9) të Autostradës Morinë – Merdar (R7);
- Ndërtimi i segmenteve prioritare të Autostradës Prishtinë – Han i Elezit (R6) për t'u lidhur me Koridorin e VIII-të të Evropës Juglindore;
- Mirëmbajtja kualitative verore dhe dimërore e të gjitha rrugëve nacionale dhe rajonale;
- Vazhdimi i projektit të zgjerimit të rrugëve nacionale Prishtinë – Pejë (M9) dhe Prishtinë – Mitrovicë (M2);
- Ndërtimi dhe rikonstruktimi i rrugëve nacionale dhe regjionale;
- Rehabilitimi i linjës 10 Hekurudhore (Leshak –Hani i Elezit).

Objektivi i dytë "Krijimi i ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativ për maksimizimin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve në fushën e transportit" synon ngritjen e nivelit të shërbimeve të transportit (rrugor, hekurudhor) si për udhëtar ashtu edhe për mallra. Programet të cilat janë në funksion të realizimit të këtij objektivi janë: Departamenti i Transportit Rrugor dhe Departamenti i Automjeteve. Aktivitetet e këtyre programeve për realizimin e këtij objektivi janë:

- Subvencionimi i transportit tokësor të udhëtarëve;
- Trajnime të inspektorëve të transportit të infrastrukturës rrugore, kontrolleve teknike dhe auto shkollave;
- Instalimi i kamerave, krijimi i bazës së dhënave për patentë shofer (lidhja e shtatë qendrave në bazën e të dhënave);
- Anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sektorin e transportit.

Objektivi i tretë "Përmirësimi i sigurisë në komunikacion, dhe mbrojtja e ambientit" synon ngritjen e nivelit të sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.

Programet të cilat janë në funksion të realizimit të këtij objektivi janë: Infrastruktura Rrugore, Drejtorati i Këshillit të Sigurisë në Komunikacion Rrugor, Departamenti i Automjeteve, Departamenti i Inspektoratit. Aktivitetet e këtyre programeve për realizimin e këtij objektivi janë:

- Sigurimi i vendkalimeve në hekurudhë përmes instalimit të sinjalizimit horizontal dhe vertikal;
- Përmirësimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal dhe eliminimi i pikave të zeza në

- rrugët nacionale dhe rajonale të Kosovës;
- Hartimi i broshurave, zhvillimi i fushatës së kampanjës;
 - Kontrolle teknike mobile;
 - Implementimi i ligjit për siguri në komunikacion.

Tabela 1. Historiku dhe Shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Ministria e Infrastrukturës s Rrugore	280,049,596	265,158,775	200,860,500	179,990,862	177,860,862	170,435,690
Totali i Programeve						
Programi I Infrastrukturës s Rrugore	276,381,655	261,549,452	186,758,703	166,039,065	163,909,065	156,483,893
Programi i Automjeteve	606,495	659,167	788,070	638,070	638,070	638,070
Programi i Transportit HAD	29,264	32,011	36,768	36,768	36,768	36,768
Programi i Inspektoriatit	153,241	147,818	212,317	212,317	212,317	212,317
Programi i Transportit Rrugor	1,932,052	1,729,491	11,931,226	11,931,226	11,931,226	11,931,226
Programi i Administratës Qendrore	946,889	1,040,836	1,133,416	1,133,416	1,133,416	1,133,416
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	280,049,596	265,158,775	200,860,500	179,990,862	177,860,862	170,435,690
Nr. i punëtorëve	266	266	266	266	266	266
Paga dhe mëditje	1,238,082	1,239,499	1,283,930	1,283,930	1,283,930	1,283,930
Mallra dhe shërbime	7,356,934	6,775,635	7,792,394	6,592,756	6,592,756	6,592,756
Shpenzime komunale	180,959	146,920	205,190	205,190	205,190	205,190
Subvencione dhe transfere	1,865,828	1,655,570	1,853,814	1,853,814	1,853,814	1,853,814
Shpenzime kapitale	269,407,793	255,341,151	189,725,172	170,055,172	167,925,172	160,500,000
Burimet e Financimit	280,049,596	265,158,775	200,860,500	179,990,862	177,860,862	170,435,690
Grantet qeveritare	280,049,596	265,158,775	179,260,500	149,890,862	153,160,862	160,435,690
Të hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet	-	-	21,600,000	30,100,000	24,700,000	10,000,000
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

Tabela 2. Indikatorët Kyç të Performancës

Indikatorët Kyç të Performancës	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	aktuale	aktuale	buxheti	plani	plani	plani
Infrastruktura Rrugore						
Produktet						
Kilometër rrugë të mirëmbajtura dhe sinjalizuara	1,925	1,925	1,925	1,925	1,925	1,925
Kilometër rrugë të asfaltuara të rrugëve regjionale dhe magjistrale	23	34	25	64	65	48
Kilometër - ndërtim i Autostradës	38	22	8	10	10	10
Programi i inspektoratit						
Produktet Inspektimet	2,400	2,500	2,700	2,800	3,000	3,000
Programi i Transporti Rrugor						
Produktet Licencimi i transportit të udhëtarëve dhe të mallrave	400	410	400	450	500	500
Rezultatet						
Ngritja e sigurisë në rrugë	10%	11%	13%	14%	15%	15%
Zgjatja e jetëgjatësisë së rrugëve	4 vite	4 vite	5 vite	5 vite	6 vite	6 vite
Zvogëlimi i kohës së udhëtimit	30'	45'	1 h	1h	1h	1h
Zvogëlimi i shpenzimeve të derivateve	10%	12%	14%	14%	14%	14
Zvogëlimi i numrit të aksidenteve	5 %	6 %	8%	9 %	9%	10%

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Misioni

Misioni i Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) është përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës nëpërmjet: promovimit të mënyrave të shëndetshme të jetesës; ngritjes së përgjegjësisë së qytetarëve, profesionistëve shëndetësorë dhe shoqërisë në përgjithësi për shëndet; përmirësimin të menaxhimit të resurseve profesionale në dispozicion; dhe ofrimit të shërbimeve cilësore me qasje të lehtë, kosto-efektive dhe të barabarta.

Situata aktuale

Situata aktuale në sektorin e shëndetësisë cilësohet me arritje të konsiderueshme në fusha të ndryshme por edhe me vështirësi të theksuara për sigurimin e vëllimit dhe cilësisë së duhur të shërbimeve shëndetësore.

Sektori shëndetësor ka hyrë në fazën fillestare të ndryshimeve reformuese në bazë të infrastrukturës ligjore që rrjedhin nga ligji i shëndetësisë. Është themeluar dhe ka filluar funksionimin Oda e Mjekëve e Kosovës, ndërkaq është në proces konstituimi i odave të farmacistëve, stomatologëve dhe infermierëve. Me Ligjin për Shëndetësi është themeluar edhe Agjencia e Financimit Shëndetësor (AFSH) si para-ardhës i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore i cili është duke ndërtuar kapacitetet e tij operacionale me ndihmën e projektit mbështetës të Bankës Botërore që pritet se do të fuqizohet me projektin e ardhshëm pesë-vjeçar të Bankës Botërore për mbështetjen e reformës së sektorit të shëndetësisë. Me ligjin për kontrollin e duhanit është dhënë kontribut tejet i rëndësishëm për shëndetin publik.

Me Ligjin për sigurime shëndetësore në vitet në vijim parashihet themelimi i skemës së obliguar publike të sigurimit shëndetësor nga punëmarrësi dhe punëdhënësi.

Në shërbimet shëndetësore produktiviteti është i ulët, efikasiteti duhet të përmirësohet, sidomos sa i përket futjes së metodave moderne të trajtimit siç është kujdesi ditor jashtë-spitalor dhe shtëpiak, sidomos sa u përket infeksioneve spitalore, përdorimit të udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike si dhe mënyrës së trajtimit ku pacienti duhet të jetë në qendër të vëmendjes duke siguruar marrëdhënie më të ngrohtë terapeutike dhe kohë të mjaftueshme për ekzaminimet klinike.

Ekzistojnë, veçori pozitive në stilet e shëndosha të jetesës me faktorë të ultë të rrezikut sa i përket përdorimit të alkoolit, faktorëve të rrezikut për HIV/AIDS dhe Tuberkulozë, si dhe me shkallë të lartë të imunizimit. Në përgjithësi, popullata është e kënaqur me shërbimet të cilat ju ofrohen në rrjetin e institucioneve publike dhe private shëndetësore.

Shëndetësia kosovare disponon, me kapacitete relativisht të mjaftueshme infrastrukturore për ofrim të shërbimeve për popullatën me përjashtim të kapaciteteve për shërbime emergjente në QKUK të cilat janë nën minimumin e duhur.

Faktorët jo të favorshëm socio-ekonomik (varfëria dhe papunësia); faktorët ambientat (prevalenca e lartë e sëmundjeve të frymëmarrjes); si dhe shkalla e lartë e fatkeqësive dhe aksidenteve në komunikacion kushtëzojnë vështirësi specifike në aspektin e jetëgjatësisë. Shkalla ende e lartë e sëmundjeve që kanë të bëjnë me gjendjet perinatale është shqetësuese, kjo duke pasur parasysh faktin se shumica e femrave janë të moshës riprodhuese.

Objektivat

Bazuar në Strategjinë për Sektorin e Shëndetësisë 2014-2020, janë përcaktuar tri objektiva strategjike për periudhën e KASH 2015-2017 të definuara më tutje në dokument.

1. Parandalimi i sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve;
2. Qasja universale në shërbime cilësore shëndetësore dhe barazia gjatë shfrytëzimit të tyre;
3. Shërbimi i integruar efikas dhe efektiv shëndetësor.

Objektiva e parë: Parandalimi i sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve nëpërmjet promovimit të mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe ngritjes së përgjegjësisë së qytetarëve, profesionistëve shëndetësorë, dhe shoqërisë në përgjithësi për shëndetin.

Aktivitetet kryesore për realizimin e kësaj objektive janë:

- Fushatat e zbulimit të hershëm të kancerit të: gjirit, kancerit të qafës së mitrës dhe kancerit kolo-rektal; si dhe malformacioneve gjenetike fetale;
- Koordinimi ndër-sektoral dhe ndër-disciplinar;
- Zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore.

Objektiva e dytë: “Qasja universale në shërbime cilësore shëndetësore dhe barazia gjatë shfrytëzimit të tyre”. Për realizimin e këtij objektivi ndërmerren këto aktivitete:

- Funkcionalizimi i plotë i Agjencionit të financimit shëndetësor (AFSH) dhe themelimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore (FSSH) në vitin 2016, me ngritjen graduale të kapaciteteve të tij deri në vitin 2020;
- Funkcionalizimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH) me mbështetjen e partnerëve kryesor zhvillimor (p.sh. Qeveria e Luksemburgut);
- Përpilimi i Listës së shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor në pajtim me nevojat shëndetësore të popullatës dhe mundësive buxhetore në dispozicion;
- Vendosja e sistemit të pagesave që do të promovojë risitë dhe do të shpërblejë performancën, cilësinë dhe efektivitetin, si dhe që do të sigurojë blerjen e shërbimeve shëndetësore në pajtim me nevojat e popullatës, duke mbështetur ofruesit e shërbimeve shëndetësore në të gjitha format e pronësisë;

Objektiva e tretë: “Shërbimi i integruar efikas dhe efektiv shëndetësor”. Për realizimin e këtij objektivi ndërmerren këto aktivitete:

- Fuqizimi i shërbimeve të linjave profesionale me autorizime të reja;
- Realizimi i projekteve të partneritetit publiko privat në SHSKUK.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Ministria e Shëndetësisë	87,276,484	99,059,787	114,707,482	104,663,996	104,663,996	106,543,996
Kujdesi dytësor dhe tretësor shëndetësor (SHSKUK)	56,196,192	57,481,937	88,040,043	80,806,343	79,006,343	79,006,343
Shërbimi i kujdesit parësor	60,000	145,062	553,044	486,482	686,482	686,482
Programi Qendror Farmaceutik	18,213,118	21,153,118	4,318,232	3,670,798	3,670,798	3,670,798
Programet e Shëndetit Publik	2,158,749	3,418,987	2,398,240	2,294,218	2,294,218	2,294,218
Kontraktimi dhe monitorimi i cilësisë së shërbimit shëndetësor	2,061,498	7,639,560	6,279,386	2,798,411	2,798,411	2,798,411
Mbështetja Qendrorë për Programin e Kujdesit Shëndetës	6,931,838	6,541,539	8,693,722	7,122,004	8,322,004	8,322,004
Rregullimi i tregut Financiar	666,526	1,398,967	1,328,574	1,207,002	1,207,002	1,207,002
Shërbimet e Administratës Qen	988,563	1,280,617	3,096,241	6,278,738	6,678,738	8,558,738
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	87,276,484	99,059,787	114,707,482	104,663,996	104,663,996	106,543,996
Nr. i punëtorëve	7,265	7,587	7,758	7,758	7,758	7,758
Paga dhe mëditje	42,519,529	44,374,244	45,033,969	45,033,969	45,033,969	45,033,969
Mallra dhe shërbime	29,157,115	38,073,042	42,463,572	36,094,338	36,094,338	36,094,338
Shpenzime komunale	3,871,062	3,388,643	4,506,216	3,831,964	3,831,964	3,831,964
Subvencione dhe transfere	2,841,184	4,763,603	4,703,725	1,703,725	1,703,725	1,703,725
Shpenzime kapitale	8,887,594	8,460,255	18,000,000	18,000,000	18,000,000	19,880,000
Burimet e Financimit	87,276,486	99,059,787	114,707,482	104,663,996	104,663,996	106,543,996
Garantet qeveritare	82,583,113	95,373,804	107,757,383	96,713,897	96,213,897	97,193,897
Të hyrat vetanake	4,693,373	3,685,983	3,950,099	3,950,099	3,950,099	3,950,099
Financimet nga huamarrjet	-	-	3,000,000	4,000,000	4,500,000	5,400,000
Garantët donatorët	-	-	-	-	-	-

Tabela 2. Përmbledhje e Informatave Kyçe të Performancës

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	aktuale	aktuale	buxheti	Vlersimi	Vlersimi	Vlersimi
Shërbimet e kujdesit shëndetësor dytësor dhe terciar (kodi programor 206085)						
Numri i stafit						
Mesatarja e qëndrimit në spital (MQS)	18	19	19	19	19	20
Numri total i shtretërve	1,097	3,089	3,208	3,258	3,248	3,248
Numri total i ditëve me shtretër	981,603	956,996	1,012,975	1,038,437	1,038,844	1,038,844
Shkalla e shfrytëzimit të shtretërve (%)	62	63	68	74	76	207
Numri i pacientëve të lëshuar	136,471	141,784	147,938	159,033	170,127	170,127
Raporti pacient / staf	95	100	99	102	105	71
Kosto totale për pacient të lëshuar (EUR)						
Shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor (kodi programor 206086)						
Numri i stafit						
Numri i trajnimeve të ofruara lidhur me KSHP			30	33	12	7
Numri i materialeve të hartuara metodologjike						
Numri i akteve rregullative/ legjislativë të hartuara			30	25	3	3
Numri i aktiviteteve për monitorimin dhe raportimin e sistemit të kujdesit shëndetësor						
Numri i monitorimeve analitike dhe raporteve të hartuara për MSH në vit						
<i>Indikatori 6</i>						
Mbështetja Qendrore për programet e kujdesit shëndetësor (kodi programor 206087)						
Numri i stafit			5361	5390	5412	5470
Progresi në vendosjen e Sistemit Informativ të Shëndetësisë (në% për çdo vit, 100% = SISH i themeluar dhe funksionimi)						
Numri i aktiviteteve të inspektimit shëndetësor në vit						
Kostoja mesatare e një inspektimi shëndetësor (në EUR)						
Numri i përgjithshëm i të burgosurve të trajtuar në burgje						
Kostoja mesatare e një pacienti në burg (në EUR)	38278	44,056	45,000	46,000	47,000	50,000
Numri i programeve të ofruara të zhvillimit profesional / % e kuadrit mjekësor të mbuluar nga stafi mjekësor i përgjithshëm në sektor	0.5 E/d	0.5 E/d	0.5 E/d	0.5 E/d	0.5 E/d	0.5 E/d
<i>Indikatori 5</i>						
Kontraktimi dhe monitorimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor (kodi programor 206088)						
Numri i stafit	7	7	7	24	50	75
Numri i pacientëve të financuar në kuadër të programit për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike	583	627	650	650	650	650
Numri i pacientëve të financuar në kuadër të programit për trajtim	100	100	100			

jashtë institucioneve shëndetësore publike						
Kostoja mesatare e një pacient në kuadër të programit për trajtim jashtë vendit (në EUR)	4758.58	6708.67	Varet nga mjete ne dispozicion (Programi i vecante per trajtimin e femijeve me leukemi dhe kancer)			
Numri i kontratave spitalore të nënshkuara dhe të menaxhuara		9	9	9	9	9
Numri i aktiviteteve spitalore të monitorimit të kryera në vit		9	18	18	32	32
Numri i rregulloreve dhe akteve normative të hartuara	6	5	5	5	5	5
Programi i Centralizuar Farmaceutik (kodi programor 206089)						
Furnizim me barna për Institucionet e nivelit Parësor Shëndetësor			2,100,000	2,100,000	2,100,000	2,100,000
Furnizim me material shpenzues për Institucionet e nivelit Parësor Shëndetësor			620,232	620,232	620,232	620,232
Trajtimi i etheve hemoragjike			200,000	200,000	200,000	200,000
Vaksinat sipas indikacioneve			500,000	500,000	500,000	500,000
Vaksinat Unicef			100,000	100,000	100,000	100,000
Skleroza Multiple			500,000	500,000	500,000	500,000
Trajtimi i Sindromit Gaucher			290,000	290,000	290,000	290,000
Terapia ARV			8,000	8,000	8,000	8,000
Programet e shëndetit publik (kodi programor 206090)						
Numri i stafit	292	292	302	306	308	310
Numri i inspeksioneve sanitare të kryera	13,618	13,640	14,600	14,900	15,000	15,550
Kostoja mesatare e një kontrolli sanitar	16	16	16	16	16	16
Numri i rregulloreve dhe akteve normative të hartuara	5	5	5	5	5	5
Numri i popullatës së synuar të vaksinuar	65,654	69,800	70,000	70,000	70,000	70,000
Numri i fushatave/ngritjes së vetëdijes publike të kujdesit shëndetësor profilaktik të organizuar	7	7	7	7	7	7
Rregullimi i Tregut Farmaceutik (kodi programor 206091)						
Numri i stafit						
Numri i licencave të lëshuara në vit	1,440	1,440	1,440	1,440	1,440	1,440
Numri i rasteve të inspeksionit në vit	200	200	200	200	200	200
Shkalla (efikasiteti) i inspeksioneve/punonjës	4,056	4,056	4,056	4,056	4,056	4,056
Lejet farmaceutike të dhëna në vit	75	75	75	75	75	75
Shpenzimi mesatar për inspeksion (Eur)						
Mbështetja e Administratës Qendrore (kodi programor 206092)						
Numri i stafit në MSH / Numri i stafit në Kabinetin e Ministrit			122	155	155	155
Numri i akteve rregullative/ ligjore të hartuara			37	37	37	37
Numri i projekteve të PIP-it të menaxhuara gjatë vitit		1	2	2	2	2

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Misioni

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka për mision krijimin dhe zhvillimin e politikave, ambientit dhe mekanizmave të përshtatshëm për promovimin e aktiviteteve të kulturës, promovimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë në qeverisje dhe krijimtari, zhvillimin dhe afirmimin e sportit kosovar në vend dhe në arenën ndërkombëtare si dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

Situata aktuale

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka qenë dhe është e angazhuar maksimalisht në arritjen e objektivave të saja. Në kuadër të secilës politikë të departamenteve gjegjëse brenda për brenda MKRS-së, janë regjistruar këto të arritura:

- Në fushën e kulturës është arritur të avancohet infrastruktura ligjore, promovimi i skenës sonë kulturore në ngjarjet e mëdha të kulturës në botë: si në Bienalen e Venedikut, në Ekspozitën e Artit Bashkëkohor, në Festivalin e Filmit në Cannes, në Festivalin e Filmit Berlinale si dhe është arritur nënshkrimi i marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit.
- Në fushën e trashëgimisë kulturore, është vazhduar me ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, duke investuar në ndërhyrjet preventive të 32 aseteve, realizimin e 21 projekteve për gërmime arkeologjike, përfshirë ato me karakter shpëtimi, hartimin e studimit të fizibilitetit për turizmin kulturor dhe natyror, valorizimin dhe inventarizimin e Listës së Përkohshme të Trashëgimisë Kulturore prej 1,181 aseteve.
- Në sport është vazhduar me ndërtimin e palestrave sportive në Drenas, Istog, Rahovec, Obiliq, Shtime, Deçan, Skenderaj, Dardanë, Kline dhe Kaçanik. Vazhdimi i projektit multifunksional për sport në bashkëfinancim me IPA të Mitrovicës, rinovimi i disa objekteve ekzistuese të palestrave dhe stadiumeve, ndërtimi i poligoneve sportive në shumë shkolla të Kosovës dhe përfundimi i punimeve në Stadiumin „Adem Jashari” në Mitrovicë. Nga FIFA Kosovës i janë lejuar ndeshjet miqësore ndërkombëtare në futboll dhe në basketboll.
- Me qëllim të fuqizimit të rinisë dhe forcimit të mekanizmave institucional është arritur konsolidimi i Këshillit Qendror të Veprimit për Rini, vazhdimësia e themelimit të Këshillave Lokale për Veprim Rinor, përkrahja e rrjetëzimit dhe bashkëpunimit të rinjve në aktivitete rinore rajonale dhe evropiane dhe ka filluar mbështetja e ndërmarrësve të rinj, përmes ndarjes së grantëve.
- Në kontekst të zhvillimit të së drejtës së autorit e arritur është kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe miratimi i rregulloreve nga kjo fushë dhe fillimi i zbatimit të tyre, krijimi i Task Forcës për luftimin e piraterisë dhe falsifikimit etj.

Objektivat

1. Përkrahja e institucioneve publike të kulturës, përkrahja e kulturës së pavarur, si dhe avancimi i diplomacisë kulturore;
2. Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore;
3. Zhvillimi dhe avancimi i sportit cilësor, masivizimi dhe ndërkombëtarizimi i sportit si dhe modernizimi i infrastrukturës sportive;
4. Fuqizimi dhe integrimi i të rinjve në proceset vendim-marrës dhe në politikë-bërje;
5. Fuqizimi i sistemit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta.

Për të realizuar **objektivin e parë** - përkrahja e institucioneve publike të kulturës, përkrahja e kulturës së pavarur si dhe avancimi i diplomacisë kulturore përmes përmirësimit të infrastrukturës kulturore, ndërmeren këto veprime:

- Mbështeta e institucioneve të kulturës në krijimtarinë e tyre kulturore si në: teatër, muzikë, film, art-pamor, vallëzim, libër.
- Nxitjen dhe përkrahjen e krijimtarisë dhe kreativitetit kulturor, mbështetjen e aktiviteteve kulturore të institucioneve publike të kulturës, të organizatave të pavarura kulturore dhe avancimin e diplomacisë kulturore.

Për të realizuar **objektivin e dytë** ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, MKRS ndërmeren këto veprime:

- Ruajtjen, mbrojtjen, hulumtimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore, rinovimin, restaurimin dhe konservimin e monumenteve të Trashëgimisë Kulturore, si dhe krijimin dhe funksionalizimin e Inspektoratit për Trashëgimi Kulturore.
- Subvencionimin e kërkimeve shkencore dhe prezantimeve nga fusha e trashëgimisë kulturore.

Për të realizuar **objektivin e tretë** zhvillimi dhe avancimi i sportit cilësor, masivizimi dhe ndërkombëtarizimi i sportit, si dhe modernizimi i infrastrukturës sportive, ndërmeren këto veprime:

- Përmirësimi i infrastrukturës sportive, përfshirë ndërtimin dhe rinovimin e palestrave sportive, stadioneve të futbollit, poligoneve shkollore, si dhe ndërtimin e stadiumit kombëtar të futbollit.
- Përkrahja e aktiviteteve të Komitetit Olimpik të Kosovës, të Federatave sportive, si dhe masivizimin dhe ndërkombëtarizimin e sportit.

Për të realizuar **objektivin e katërt**, fuqizimi dhe integrimi i të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe në politikë-bërje, ndërmeren këto veprime:

- Zhvillimin e programit të edukimit joformal, programit të ndërmarrësisë, implementimin e aktiviteteve tradicionale, subvencionimin e organizatave rinore, vazhdimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, fuqizimin e rolit të rinisë në jetën publike dhe në vendimmarrje.
- Përmirësimi i infrastrukturës, për zhvillimin e aktiviteteve rinore.

Për të realizuar **objektivin e pestë**, fuqizimi i sistemit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, ndërmerren këto veprime:

- Zbatimi i Strategjisë kundër piraterisë dhe falsifikimit;
- Promovimi i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta;
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në bazë të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të pronësisë intelektuale dhe shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave;
- Anëtarësimi në Organizatën Botërore të Pronësisë intelektuale dhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.

Tabela1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë dhe politikave të reja 2015 – 2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 plani	2016 plani	2017 plani
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	16,319,669	14,369,183	20,115,174	21,597,075	22,547,075	22,547,075
Programi i Administratës Qe	993,637	1,164,103	1,305,517	1,179,007	1,179,007	1,179,007
Programi i Sportit	8,411,160	6,020,761	8,584,174	10,328,295	11,278,295	11,278,295
Programi i Kulturës	3,762,291	4,028,944	6,333,570	6,271,563	6,271,563	6,271,563
Programi i Rinisë	697,301	790,998	2,607,124	2,451,774	2,451,774	2,451,774
Programi i Trashëgimisë Kulturore	2,455,280	2,364,376	1,284,789	1,366,436	1,366,436	1,366,436
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	16,319,669	14,369,183	20,115,174	21,597,075	22,547,075	22,547,075
Nr. i punëtorëve	554	569	654	654	654	654
Paga dhe mëditje	2,270,495	2,359,967	2,800,112	2,800,112	2,800,112	2,800,112
Mallra dhe shërbime	730,623	848,420	1,074,272	917,406	917,406	917,406
Shpenzime komunale	186,854	177,662	381,557	324,323	324,323	324,323
Subvencione dhe transfere	4,716,739	5,207,632	5,356,550	5,356,550	5,356,550	5,356,550
Shpenzime kapitale	8,414,958	5,775,502	10,502,683	12,198,684	13,148,684	13,148,684
Burimet e Financimit	16,319,669	14,369,183	20,115,174	21,597,075	22,547,075	22,547,075
Garantët qeveritare	16,297,684	14,356,009	20,072,274	21,554,175	22,504,175	22,504,175
Të hyrat vetanake	21,985	14,036	42,900	42,900	42,900	42,900
Garantët donatorët	566,766	1,145,248				

Tabela 2. Indikatorët kyç të performancës

Indikatorët Kyç të Performancës	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	aktuale	aktuale	buxheti	plani	plani	plani
Përkrahja dhe diplomacia e kulturës						
Numri i festivaleve brenda vendit drama-teatër	3	4	5	6	6	7
Pjesëmarrja në arenën ndërkombëtare – kulturore	8	8	9	10	12	13
Realizimi i shfaqjeve të filharmoni, operë, balet	3	3	4	5	5	5
Mbështetja e filmave në kinematografisë	2	2	2	3	2	2
Numri i ekspozitave-galeria e arteve	14	17	22	22	25	25
Bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit	10	10	12	15	20	20
Përmirësimi i infrastrukturës fizike, nr. i projete.	3	4	4	5	5	6
Përkrahja e projekteve për libër/revistave letrare	30	78	82	88	100	100
Ruajtja, mbrojtja e trashëgimisë kulturore						
Hartimi i planeve zhvillimore dhe planeve të menaxhimit	4	4	5	5	6	6
Realizimi i projekteve nga programi Masa preventive-intervenime emergjente	19	20	21	24	25	25
% e realizimit të projekteve	100%	98%	-	-	-	-
Gërmimet arkeologjike me karakter hulumtimi dhe shpëtimi-sipas nevojës	3	4	4	3	5	5
Vizitat e monumenteve historike	10,500	11,500	15,200	16,000	16,600	20,000
Lista e përkohshme e objekteve nën mbrojtje	1,170	1,182	1,182	-	-	-
Zhvillimi dhe avancimi i sportit dhe ndërkombëtarizimi i tij						
Ndërtimi i palestrave sportive nga 2004-2014, gjithsej 10 palestra	6	8	10	12	13	14
Federatat sportive (gjithsej)	24	27	31	33	34	36
Federatat e pranuar ndërkombëtarisht	4	5	6	8	10	12
Ndeshjet ndërkombëtare, futboll, basketboll, gjudo, boks, karate, mundje, taekwondo, tenis, skijim, hemboll, ndeshjet brenda viti voleboll	60	67	78	88	95	100
Numri i ekipeve sportive (klube)	267	312	226	231	233	240
Stadiumet ekzistuese	3	5	6	7		
Poligonet sportive, shkollave fil, mesme	6	7	8	10	11	12
Numri i projekteve për mbështetjen e sportit	512	515	520	530	540	540
Fuqizimi dhe integrimi i rinise-edukimjo formal						
Numri i projekteve për mbështetjen e rinise	230	210	250	250	260	300
Numri i përfitueseve për trajnim për ndërmarr.		200	200	200	250	300
Subvencionimi i start-up biznes (fillestare)		17	20	20	25	30

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Misioni

Misioni i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është zhvillimi, zbatimi dhe mirëmbajtja e një sistemi efektiv arsimor që kontribuon në mirëqenien sociale të popullatës dhe është në të mirën e zhvillimit ekonomik të shtetit, duke siguruar arsimim cilësor dhe të barabartë për të gjithë qytetarët si dhe përkrahje në hulumtimet shkencore të nivelit të lartë dhe inovacionin në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Situata aktuale

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke zbatuar Planin strategjik të arsimit në Kosovë 2011-2016, ka vazhduar procesin e reformimit në të gjitha nivelet e arsimit. Ndër arritjet kryesore që e karakterizojnë vitin 2013 janë:

Programi Arsimi parauniversitar mbulon nivelin parashkollor dhe parafillor, nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9), nivelin e mesëm të lartë (klasat 10-12) si dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Gjatë vitit 2013 janë kryer këto aktivitete: Pilotimi i Kurrikulave Bërthamë në 10 shkollat pilot, në tri nivelet e arsimit parauniversitar, janë hartuar dhe botuar tekstet shkollore për nivelin e tretë të nxënësve shqiptarë në diasporë, Botimi i teksteve shkollore në gjuhën e komuniteteve, si: Historia për klasën 9-të, Edukata qytetare dhe ndërkulturore për klasën e 6-të, janë në përgatitje tekstet e muzikës për klasat 5 dhe 6, ndërsa në proces të vlerësimit janë tekstet e muzikës për klasat 7,8 në gjuhën boshnjake. Gjithashtu është ribotuar teksti Gjuha shqipe 1 për nxënësit e komuniteteve joshqiptare për kl. 3-të të arsimit të obliguar, si dhe janë ndarë bursa për nxënës dhe studentë të komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptas (30 bursa për nxënësit e shkollave të mesme dhe 16 bursa për studentë). MASHT gjatë vitit 2013 ka licencuar 20530 mësimdhënës; në bashkëpunim me UP janë përfshirë 1900 mësimdhënës në programet e ndryshme trajnuese, ndërsa në bashkëpunim me organizatat e ndryshme/partnerët zhvillimorë (Komisioni Evropian përmes projekteve të IPA 2009, GIZ, USAID/BEP) janë përfshirë mbi 11000 mësimdhënës; janë akredituar nga Këshilli i lartë i Ministrisë 13 programe trajnimi dhe 5 OJQ vendore.

Gjatë vitit 2013 janë ndërtuar 8 objekte shkollore, nga këto 4 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe 4 shkolla të mesme me gjithsej 42,560 m² në vlerë investuese €12,890,929. Të gjitha këto objekte shkollore janë pajisur me inventar të nevojshëm. Gjithashtu, vazhdojnë së ndërtuari edhe 23 objekte shkollore, ndërsa nga EU-ja janë duke u ndërtuar edhe 7 anekse.

Është finalizuar Strategjia për ngritjen e praktikës profesionale gjithëpërfshirëse dhe Strategjia për orientim në karrierë, janë zhvilluar planprogramet për 21 profile të reja, bazuar në kërkesa të tregut të punës dhe janë rishikuar të gjitha planprogramet ekzistuese, janë hartuar standardet e profesionit për profilet bujqësore. Gjatë këtij viti MASHT-i ka përgatitur për miratim në Qeveri tri projektligje si dhe ka miratuar 31 udhëzime administrative.

Në programin Arsimi i lartë dhe shkenca janë themeluar tri universitete: Universiteti i Gjakovës, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Mitrovicës, është nënshkruar marrëveshja e përbashkët në mes të Ministrisë dhe Universitetit të Sheffield- it për vitin akademik 2013-

2014, për ndarjen e 55 bursave për studentët kosovarë në nivelet bachelor, master dhe doktoratë (phd).

Është pasuruar literatura e Fakultetit të Mjekësisë me 22 tituj të librave shkencorë, është bërë amandamenti i Ligji të Arsimit të Lartë me udhëzime administrative.

- Janë hapur 11 programe të reja në PHD në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- Është organizuar Universiteti Veror i Prishtinës (kryesisht në gjuhën angleze) me karakter ndërkombëtar (me gjithsej 24 kurse).
- Është instaluar baza e të dhënave për Qendrën Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik, financuar nga projekti austriak “Higher Kos” në bashkëpunim me MASHT.
- Janë ndarë 3 milionë euro për investime në blerjen e librave shkencorë për tre vite.
- Janë ndarë mjete për 18 projekte të vogla dhe të mëdha, 42 mobilitete afatshkurtra për hulumtime dhe kërkime, 38 bursa doktorature 18 publikime dhe botime.
- Këtë vit është paguar pakoja komplete e EBSCOS (116000 tituj librash me qasje të plotë).
- Është finalizuar Strategjia për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë.
- Eshtë mbajtur konferenca "Java e Shkencës 2013", me pjesëmarrje të 500 autorëve dhe bashkautorëve nga gjashtë vende të ndryshme, si dhe është botuar libri i kumtesave të prezentuara në këtë konferencë.

Objektivat

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për periudhën 2015-2017 ka përcaktuar këto objektiva:

1. Gjithëpërfshirja dhe përmirësimi i cilësisë në arsimin parauniversitar;
2. Rritja e pjesëmarrjes dhe sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë dhe nxitja e veprimtarisë kërkimore shkencore;
3. Menaxhimi cilësor dhe zhvillimi i sektorit të arsimit.

Objektivi i parë ka të bëjë me sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe të barabartë për nxënësit e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm të lartë, ngritje të cilësisë për të gjithë nxënësit gjatë fazës së arsimit të detyrueshëm, sigurimin që nxënësit që përfundojnë arsimin e mesëm të lartë të kenë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të hyrë me sukses në arsimin e lartë si dhe të jenë të suksesshëm të inkuadrohen në tregun e punës. Realizimi i këtij objektivi në programin Arsimit parauniversitar planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Zhvillimit të kurrikulave për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- Zhvillimit të mëtejshëm profesional të mësimitdhënësve, duke zhvilluar programe adekuate të akredituara për trajnimin e mësimitdhënësve;
- Zbatimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave si dhe përdorimi për zhvillimin e politikave në arsim;
- Përmirësimin e ambientit mësimor në shkolla përmes investimeve në infrastrukturën eliminimi i tri ndërrimeve si dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasat e stërngarkuara);
- Përfshirjes më të madhe dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për mësim për fëmijët me nevoja të veçanta;
- Pajisjen e vazhdueshme të shkollave profesionale me mjete dhe materiale adekuate për mësim.

Objektivi i dytë ka të bëjë me sigurimin e cilësisë dhe qasjen e barabartë si dhe përfshirjen e plotë të të gjithë të interesuarve në arsimin e lartë, duke siguruar që studentët që e përfundojnë

arsimin e lartë të arrijnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme konform standardeve evropiane për të hyrë me sukses në tregun e punës. Gjithashtu, ky objektivi përfshinë edhe zhvillimin e kërkimeve shkencore sipas standardeve ndërkombëtare. Realizimi i këtij objektivi në programin Arsimi i Lartë dhe Shkenca planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Përkrahje e vazhdueshme e arsimit të lartë dhe zhvillimin e kapaciteteve në universitetet e reja;
- Ngritja e cilësisë në arsimin e lartë;
- Përmirësimi i ambientit të përgjithshëm arsimor në institucionet e arsimit të lartë përmes investimeve në infrastrukturën fizike të institucioneve;
- Përkrahja e zhvillimit shkencor dhe inovacionit si mbështetje për zhvillimin ekonomik,
- Përkrahja e instituteve shkencore, Bibliotekës Universitare, Agjencisë të Akreditimit si dhe institucioneve tjera të arsimit të lartë;
- Të vazhdohet me programet e bashkëpunimit bilateral për përfitimin e bursave ndërkombëtare në nivelin bachelor, master dhe të doktoratës (PhD).

Objektivi i tretë ka të bëjë me menaxhimin e sektorit të arsimit përmes zhvillimit dhe implementimit të kornizës legjislative për monitorimin dhe vlerësimin e programeve të ndryshme të arsimit. Realizimi i këtij objektivi në programin Administrim dhe Zhvillim planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit aktual arsimor, zhvillimit dhe azhurnimit të politikave arsimore, të planeve, programeve dhe projekteve si dhe zhvillimit të sistemeve ligjore dhe informative;
- Zhvillimit të kapaciteteve për të monitoruar cilësinë në arsim;
- Zhvillimit të kapaciteteve të stafit dhe përdorimit të sistemit të ICT-së.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet si pas skenarit bazë dhe politikave të reja 2015-2017

	2012 Aktual	2013 Aktual	2014 Buxhetit	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Shpenzimet sipas programit MASHT						
Totali	45,999,309	43,388,754	50,296,252	46,618,750	40,027,228	41,329,921
Arsimi Para-Universitar	3,903,591	3,824,645	4,542,976	3,516,517	3,958,472	4,730,164
Arsimi i Lartë dhe Shkenca	7,696,662	11,101,516	15,475,463	16,556,690	18,357,853	16,988,854
Shërbimet e Administratë	34,399,056	28,462,593	30,278,813	26,545,543	17,710,903	19,610,903
Shpenzime sipas kategorive Ekonomike						
Totali	45,999,309	43,388,754	50,297,252	46,618,750	40,027,228	41,329,921
Pagat dhe mëditjet	5,359,362	6,615,583	10,089,035	10,260,333	10,478,333	10,502,333
Mallrat dhe shërbimet	6,811,899	8,466,437	9,956,656	9,435,232	9,511,810	10,343,503
Shërbimet komunale	954,124	858,116	1,274,157	943,259	950,159	962,159

Subvencionet dhe Transfere	2,180,504	4,635,860	3,977,404	4,189,926	3,736,926	3,771,926
Shpenzimet kapitale	30,693,420	22,812,758	25,000,000	21,790,000	15,350,000	15,750,000
Shpenzime sipas Burimeve te Financimit						
Totali	45,999,309	43,388,754	50,297,000	46,618,750	40,027,228	41,329,921
Grante Qeveritare	43,729,309	40,852,753	45,681,025	40,544,349	36,852,827	37,455,520
Të Hyra Vetanake	2,270,000	2,536,001	2,616,227	1,674,401	1,674,401	1,674,401
Grante Donatoret	0	0	0	0	0	0
Huamarrje	0	0	2,000,000	4,400,000	1,500,000	2,200,000
Numri I Stafit						
Nr. Stafit	1,090	1,248	1,384	1,384	1,384	1,384
Propozimi i politikës së re : Qendra e Studentëve – Kërkesa për financim shtesë është paraparë për aktivitete të vazhdueshme						
Totali				941,250	941,250	941,250
Numri i punëtorëve				-	-	-
Paga dhe medijtje				-	-	-
Mallra dhe sherbime				829,826	829,826	829,826
Shpenzime komunale				106,424	106,424	106,424
Subvencione dhe transfere				5,000	5,000	5,000
Shpenzime kapitale						
Burimet e Financimit				941,250	941,250	941,250
Grantet qeveritare				941,250	941,250	941,250
Te hyrat vetanake						
Totali i skenarit bazë dhe politikave te reja				47,560,000	40,968,478	42,271,171
Numri i punëtorëve				1,384	1,384	1,384
Paga dhe medijtje				10,260,333	10,478,333	10,502,333
Mallra dhe sherbime				10,265,058	10,341,636	11,173,329
Shpenzime komunale				1,049,683	1,056,583	1,068,583
Subvencione dhe transfere				4,194,926	3,741,926	3,776,926
Shpenzime kapitale				21,790,000	15,350,000	15,750,000

Burimet e Financimit				47,560,000	40,968,478	42,271,171
Grantet qeveritare				41,485,599	37,794,077	38,396,770
Te hyrat vetanake				1,674,401	1,674,401	1,674,401
Huamarrje				4,400,000	1,500,000	2,200,000

Arsyetim: në kërkesat për financim shtesë është paraparë për aktivitete të vazhdueshme pasi që në vitin 2014 dhe viteve në vijim buxheti është i pamjaftueshëm për t'i kryer obligimet ndaj furnitorëve, kursimet sipas vendimit të Qeverisë është zvogëluar buxheti në Qendrën e Studentëve për 15%, gjithashtu vendimi për uljen e taksave për studenta prej 50% në të gjitha shërbimet që i ofron UP në MASHT do të ketë problem në funksionet e mëtutjeshme pasi që kjo ulje ndikon direkt në zbritjen e të hyrave, të institucioneve të cekura me lartë. Ka nevojë urgjente për rritjen e fondeve pasi që është rritur hapësira për strehim të studentëve. Ndërtimi i 2 konvikteve, rriten shpenzimet në strehim dhe ushqim mbi 800 shtretër, kjo reflekton në implikime financiare në shumë prej €941,250.

Tabela 2. Indikatorët kyç të performancës

(në 000' Euro)	2012 Aktual	2013 Aktual	2014 Buxhetit	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Shpenzimet e MASHT në përqindje të BPV	0.9%	0.9%	0.9%	0.8%	0.6%	0.6%
Arsimi parauniversitar						
Arsimi parafilor dhe fillor						
Nr. i fëmijëve me nevoja të veçanta	515	515	515	515	515	515
Nr. i mësimitdhënësve me nevoja të veçanta	130	130	130	130	130	130
Mesatarja e RNM në arsimin me nevoja të veçanta	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0
Mesatarja e shpenzimeve vjetore për fëmijë me nevoja të veçanta (EUR)	3,050	3,165	3,196	3,126	3,192	3,192
Mesatarja e shpenzimeve vjetore operative për student e shprehur në përqindje të BPV-së për kokë banori	113.6%	114.9%	110.8%	103.7%	101.3%	96.9%
Programe tjera në arsimin parauniversitar						
Përqindja e mësimitdhënësve të licencuar	60%	80%	90%	95%	100%	100%
Përqindja e mësimitdhënësve që marrin pjesë në trajnim	30%	20%	10%	20%	10%	10%
Shpalosja e planprogrameve (niveleve)		3 nivele për vit				
Nr. i stafit (EOP) në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve	0	0	24	24	24	24
Përqindja e shkollave me më shumë se një ndërrim ose klasa të stërngarkuara	6.7%	5.5%	4.3%	3.1%	2.5%	2.5%
Përqindja e shkollave që kanë nevojë për renovim	7.6%	6.6%	6.5%	5.7%	4.7%	4.7%
Arsimi i lartë dhe shkenca						
Universiteti						
Mesatarja e shpenzimeve vjetore për student (EUR)	520	342	561	473	437	418

Mesatarja e shpenzimeve vjetore operative për student e shprehur në përqindje të BPV-së për kokë banori	19.4%	12.4%	19.5%	15.7%	13.9%	12.7%
Nr. i studentëve në universitet	2,330	11,216	15,150	17,856	20,175	21,188
Nr. stafit	101	311	563	584	597	601
Raporti student - personel akademik	29.1	51.3	38.5	43.8	48.3	50.7
Shkenca						
Shpenzimet e shkencës dhe teknologjisë në përqindje të BPV	0.027%	0.025%	0.034%	0.029%	0.027%	0.026%
Nr. stafit të shkencës	115	115	115	115	115	115
Nr. i botimeve shkencore	0	23	20	20	20	20
Nr. i projekteve hulumtuese	0	100	100	100	100	100
Nr. i mobiliteteve afatshkurtër	0	42	45	45	45	45
Nr. i granteve vjetore të doktoraturës	0	38	40	40	40	40
Programe tjera në arsimin e lartë						
Nr. i studentëve në Qendrën e Studentëve në strehim mujor	3,550	3,550	3,550	3,550	3,550	3,550
Nr. i studentëve në Qendrën e Studentëve në ushqim ditor	3,963	3,963	3,963	3,963	3,963	3,963
Nr. i bursave- Marrëveshjet bilaterale dhe programet e USAID-it	54	69	75	110	110	110
Nr. i stafit Agjencia e Akreditimit	4	9	9	9	9	9
Shërbimet e administratës						
Nr. Stafit Totali	244	234	232	232	232	232

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Misioni

Misioni i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), është fuqizimi, zbatimi dhe koordinimi i politikave, ligjeve dhe instrumenteve tjera për të siguruar mbrojtje dhe përfshirje sociale, krijimi i infrastrukturës për punësim dhe aftësim profesional, shkathtësi dhe mundësinë e ofrimit të shërbimeve për të gjithë qytetarët në gjendje të nevojës sociale.

MPMS ka obligime ligjore për të ofruar shërbime, përmes programeve të cilat janë të disenjuara që të ndihmojnë pjesët më nevojtare të popullatës: të moshuarit, të varfërit, personat me aftësi të kufizuara, të papunësuarit dhe të tjerët që kanë më shumë nevojë për ndihmë nga qeveria.

Situata aktuale

Mirëqenia sociale është ndër fushat prioritet të përkushtimit në kuadër të prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilat janë proklamuar në programin qeveritar të vitit 2014-2016.

Qeveria vazhdon përkrahjen për kategoritë sociale përmes skemave të mbrojtjes sociale dhe atyre pensionale. Në funksion të kësaj, është bërë rishikimi i infrastrukturës ligjore që mundëson përkrahje më të madhe për këto kategori si dhe përmirësim të targetimit të përfituesve të skemave sociale. Vlen të përmendet se nga tetori 2012 ka filluar pagesa e shtesave të fëmijëve për familjet përfituese në Skemën e Ndihmës Sociale, ndërsa nga janari 2013, është bërë rritja e pensioneve bazë dhe atyre të aftësisë së kufizuar për 33.3%.

Në këtë drejtim, ne do të punojmë shumë dhe në të gjitha drejtimet, edhe me reformën ligjore por edhe me mënyrën dhe volumnin e përkrahjes së politikave të punës dhe punësimin.

Ndërlidhur me tregun e punës, për të rritur efektivitetin dhe eficiencën e inputit të politikave të aftësimeve ne jemi duke e rritur fokusin tonë dhe do të punojmë shumë më afër me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në kuadër të strategjisë së mësimin tërë-jetësor si strategji të përgjithshme në kuadër të Planit 5-vjeçar strategjik të arsimit. Për më shumë, përmirësimi i rezultateve të aftësimeve dhe koordinimit ndër-institucional është pjesë e programit të zhvillimit të kapitalit njerëzor si pjesë e agjendës Evropa 2020.

Njëkohësisht, është punuar dhe do të punohet shumë në Këshillin Ekonomiko-Social (KES), në skemat dhe shërbimet e mbrojtjes sociale dhe pensionet nga shtylla e parë. Qeveria dhe MPMS është zotuar të adresoj edhe çështjen e kategorive të luftës duke u dhënë atyre përkrahjen e nevojshme dhe meritore në kuadër të mundësive të shoqërisë sonë.

Zyrat e punësimin (ZP) kanë përgjegjësi të regjistrojnë të papunët, të hulumtojnë tregun e punës, dhe t'u ofrojnë punëkërkesve informata për tregun e punës (përfshirë mundësitë për migrim për punë), këshillime për karrierë dhe trajnim dhe të ndërmjetësojnë në punësimin e tyre. Aftësimi profesional ofrohet përmes 8 Qendrave për Aftësim Profesional (QAP) dhe 6

njësive të tyre mobile, por edhe përmes angazhimit të ofruesve të tjerë jopublikë në raste të veçanta.

MPMS nëpërmjet QAP ofron trajnime falas (bazuar në klasë dhe punëtori) mbi 30 profesione të ndryshme. Përpos trajnimeve të ofruar nga QAP, shkollat për aftësim profesional ofrojnë aftësim për të rriturit në profilet e ndryshme të ofruara edhe për studentët e rregullt. Kohëzgjatja maksimale e programit është 3 muaj. Shkollat për aftësim profesional janë të lejuara që të ngarkojnë pjesëmarrësit për këto programe në pajtim me kushtet që rregullohen nga MASHT-i.

Objektivat

1. Sistemi pensional tre shtyllës, i drejtë, funksional, me burime të qëndrueshme financiare, i cili i plotëson kërkesat nga e drejta e sigurimeve sociale për femra dhe meshkuj, për të gjitha kategoritë e pensioneve;
2. Ngritja e mirëqenies dhe mbështetja e familjeve, përmes ofrimit të ndihmave sociale dhe shërbimeve sociale për kategoritë e rrezikuara dhe barazisë gjinore;
3. Rritja e shkallës së punësimit të grave dhe burrave dhe forcimi i trajnimeve profesionale sipas kërkesës së tregut të punës;
4. Fuqizimi i rolit të partnerëve social në zhvillimin e politikave socio-ekonomike të vendit, përmirësimi i kushteve të punës të punëtorëve dhe zvogëlimi i punësimit informal në mes të grave dhe burrave.

Për realizimin e **objektives së parë** “Sistemi pensional tre shtyllës, i drejtë, funksional, me burime të qëndrueshme financiare, i cili i plotëson kërkesat nga e drejta e sigurimeve sociale për të gjitha kategoritë e pensioneve”, MPMS-ja planifikon të realizoj këto veprime:

- Ngritja e cilësisë së shërbimeve përmes riorganizimit të subjekteve pensionale në nivel të Agjencisë për zbatimin e skemave pensionale;
- Harmonizimi i skemave pensionale dhe beneficioneve për realizimin e kërkesave dhe përfitimeve sipas legjislacionit dhe të drejtave të fituara;
- Avancimi dhe koordinimi i sigurimeve sociale përmes arritjes së marrëveshjeve bilaterale për realizimin e të drejtave të grave dhe burrave pensionistë dhe krijimit të mundësive për lëvizje të fuqisë punëtore;
- Reformimi i shtyllës së parë të Sistemit Pensional në Kosovë, me qëllim të konsolidimit, harmonizimit, unifikimit dhe plotësimit të skemave pensionale të cilat financohen nga Buxheti i Kosovës, përmes Projektligjit për Skemat Pensionale të financuara nga shteti;
- Krijimi i sistemit të integruar informativ për të gjitha skemat pensional.

Për të realizuar **objektivin e dytë** “Ngritja e mirëqenies dhe mbështetja e familjeve, përmes ofrimit të ndihmave sociale dhe shërbimeve sociale për kategoritë e rrezikuara”, MPMS-ja planifikon të realizoj këto veprime:

- Financimi i skemës sociale dhe përkrahja e familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar 1-18 vjeç;
- Pagesa e strehimit familjar për fëmijët pa kujdes prindëror dhe fëmijë të braktisur;
- Zbutja e varfërisë duke ofruar shërbime të avancuara për gra e burra dhe vajza e djem në nevojë sociale dhe posaçërisht grupet e cënueshme;

- Financimi i strehimoreve për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, përmes blerjes së shërbimeve nga OJQ-të me bashkëfinancim me donatorë;
- Funkcionalizimi i plotë dhe forcimi i kapaciteteve të disa shtëpive të komunitetit për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuar me shtrirje regjionale nëpër Kosovë;
- Decentralizimi i shërbimeve sociale dhe shërbimeve familjare dhe vendosja e mekanizmave për financim të qëndrueshëm;
- Ngritja dhe avancimi i kapaciteteve njerëzore të ofruesve publik dhe ofruesve të licencuar jo-qeveritar të shërbimeve sociale dhe familjare.

Për të realizuar **objektivin e tretë** “Rritja e shkallës së punësimit dhe forcimi i trajnimeve profesionale sipas kërkesës së tregut të punës”, MPMS-ja planifikon të realizoj këto veprime:

- Reformimi dhe modernizimi i shërbimeve publike të punësimit (SHPP) që i përgjigjet nevojave të tregut të punës;
- Zgjerimi i masave aktive të tregut të punës duke u fokusuar në gra dhe burra që kanë vështirësi në tregun e punës;
- Ofrimi i shërbimeve cilësore të aftësisimit profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- Sigurimi i cilësisë së trajnimeve në Qendrat për aftësim profesional dhe plotësimin e kushteve për akreditim deri në vitin 2015 në disa komuna të Kosovës.

Për realizimin e **objektivës së katërt** “Fuqizimi i rolit të partnerëve social në zhvillimin e politikave socio-ekonomike të vendit, përmirësimi i kushteve të punës të punëtorëve dhe zvogëlimi i punësimit informal”, MPMS-ja planifikon të realizoj këto veprime:

- Zhvillimi dhe përforcimi i dialogut me partnerët social, në veçanti, dialogu me organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të strukturave si dhe sistemit të punës të KES-it;
- Përmirësimi i të drejtave të punëtorëve dhe garantimi i minimumit të standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas standardeve ndërkombëtare nëpërmjet avancimit të kornizës ligjore, ngritjes së vetëdijes dhe monitorimit më të mirë të zbatimit të kësaj kornize ligjore;
- Përforcimi i mekanizmave dhe bashkërendimi ndërinstitucional në zvogëlimin e punësimit informal të grave dhe burrave .

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë dhe politikave të reja 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlërsimi	2016 Vlërsimi	2017 Vlërsimi
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale						
Totali i programeve	204,478,112	228,729,619	230,262,929	229,632,051	229,319,551	229,344,551
Pensionet	160,389,305	187,857,559	188,080,211	187,830,211	187,830,211	187,933,711
Mirëqenia Sociale	35,355,600	35,125,306	34,559,069	34,742,069	34,367,069	34,343,569
Puna dhe Çështjet e Punësimit	7,738,634	4,901,795	6,670,124	6,136,785	6,199,285	6,144,285
Zyra për Çështjet e Trashëgimisë TMK-së	86,445	87,434	92,741	71,741	71,741	71,741
Shërbimet e Administratës	908,128	757,526	860,784	851,244	851,244	851,244
Totali i program. sipas kategorive ekonomike	204,478,112	228,729,619	230,262,929	229,632,051	229,319,551	229,344,551
Nr i punëtorëve	930	945	944	944	944	944
Pagat dhe mëditjet	4,076,301	4,096,241	4,134,642	4,134,642	4,134,642	4,134,642
Mallra dhe shërbimet	2,922,866	2,633,961	2,886,932	2,468,892	2,478,892	2,498,892
Shpenzime komunale	389,637	399,829	478,924	407,085	407,085	407,085
Subvencione dhe transfere	194,828,592	219,486,687	220,262,431	220,262,431	220,262,431	220,262,431
Shpenzimet kapitale	2,260,716	2,112,901	2,500,000	2,359,000	2,036,500	2,041,500
Shpenzimet sipas burimeve të financimit	204,478,112	228,729,619	230,262,929	229,632,051	229,319,551	229,344,551
Grantet qeveritare	204,478,112	228,729,619	230,262,929	229,632,051	229,319,551	229,344,551
Të hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet						
Grantet nga Donatoret	135,119		158,153			
Propozimi i politikës së re: Zbatimi i vendimit të Qeverisë për rritje të pensioneve për 25%.						
Nr i punëtorëve	-	-	-	-	-	-
Pagat dhe mëditjet	-	-	-	-	-	-
Mallra dhe shërbimet	-	-	-	-	-	-
Shpenzime	-	-	-	-	-	-

komunale						
Subvencione dhe transfere	-	-	-	68,500,000	73,500,000	78,500,000
Shpenzimet kapitale	-	-	-	-	-	-
Totali i politikës se re				68,500,000	73,500,000	78,500,000
Grantet qeveritare				68,500,000	73,500,000	78,500,000
Të hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet						
Grantet nga Donatoret	-		-			
Totali i skenarit bazë dhe politikave të reja				298,132,051	302,819,551	307,844,551
Nr i punëtorëve				944	944	944
Pagat dhe mëditjet				4,134,642	4,134,642	4,134,642
Mallra dhe shërbimet				2,468,892	2,478,892	2,498,892
Shpenzime komunale				407,085	407,085	407,085
Subvencione dhe transfere				288,762,431	293,762,431	298,762,431
Shpenzimet kapitale				2,359,000	2,036,500	2,041,500
Shpenzimet sipas burimeve të financimit				298,132,051	302,819,551	307,844,551
Totali				298,132,051	302,819,551	307,844,551
Grantet qeveritare				298,132,051	302,819,552	305,844,552
Të hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet						
Grantet nga Donatoret						

Mjetet në tabelën e sipërme përfshijnë: Vazhdimin e politikave ekzistuese, zbatimin e vendimit të Qeverisë për rritje të pensioneve dhe rritjen natyrore.

Përmbledhje e informatave Kyçe të Përfomancës

Sistemi i mbrojtjes sociale në Kosovë, skemat, numri i përfituesve dhe shpenzimet në vitin 2012

#	Mbrojtja Sociale që ndërlidhet me skemat	Numri i përfituesve ne vitin 2012	Shuma e përfitimeve ne 2012 (EUR milion)
1	Pensionet bazë kontributeve	147,765	111.25
2	Pensionet dhe beneficionet e aftësisë se kufizuar	21,965	15.72
3	Pensionet e parakohshme te TMK-se dhe TREPÇES	4,641	4.67
4	Beneficiomet e Invalidëve te luftës	13,232	6.61
5	Asistenca Sociale	31,111	27.39
6	Tregu i Punës dhe lehonja	8,818	3.95

Treguesit kryesorë në tregun e punës

Treguesit	2009	2011
Pjesëmarrja në tregun e punës (%)	48.1	36.9
Meshkuj	67.5	55.4
Femra	28.8	17.8
Shkalla e papunësisë (%)	45.4	30.9
Meshkuj	40.7	28.1
Femra	56.4	40
Shkalla e punësimit (%)	26.4	25.6
Meshkuj	40.2	39.9
Femra	12.6	10.7
Shkalla e papunësisë së të rinjve (%)	73	55.3
Meshkuj	68.5	52
Femra	81.7	63.8
Të rinjtë që nuk janë të punësuar	na	35.1
Meshkuj	na	30.7
Femra	na	40.1

Programet e përfitimeve në Kosovë (pensionet dhe skemat e mbrojtjes sociale) sipas vlerësimeve të MPMS mbulojnë mbi 300,000 persona, që d.m.th. rreth 15% e popullsisë kanë qasje në njërin nga skemat e pagesave sociale të menaxhuara nga MPMS-ja.

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Misioni

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka për mision mbrojtjen e mjedisit, ujërave, rregullimin dhe zhvillimin e planifikimit hapësinor, banimin e ndërtimin, kadastrën dhe shpronësimin në nivel nacional. Realizimi i misionit do të arrihet përmes hartimit dhe zbatimit të politikave, strategjive, programeve dhe projekteve, si dhe realizimit të aktiviteteve tjera në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Mbështetja e misionit në zhvillimin e qëndrueshëm ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Kosovës, dhe brezave që do të vijnë. Realizimi i kësaj politike zhvillimore do të bëhet përmes integritit të strategjisë mjedisore me strategjitë sektoriale dhe përmes monitorimit, informimit dhe raportimit mjedisor. E gjithë kjo do të mundësojë administrimin e integruar dhe të qëndrueshëm të mjedisit; planifikimin hapësinor, kadastrin, si mekanizëm për koordinimin dhe harmonizimin e aktiviteteve të sektorëve të ndryshëm në rrafshin hapësinor; Zhvillimi i ndërtimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm; Përmirësimi i standardeve të banimit dhe cilësisë së jetesës;

Situata aktuale

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor gjatë vitit 2013 ka vazhduar me plotësimin e kornizës ligjore me të cilën ishte planifikuar hartimi i 4 projektligjeve të reja dhe 6 të bartura nga viti 2012. Në këtë drejtim gjatë vitit 2013 janë miratuar 6 projekt ligje.

Gjatë vitit 2013 MMPH ka miratuar edhe 31 Udhëzime Administrative që dalin nga Ligjet në fuqi.

Në funksion të përmirësimit të gjendjes në mjedis dhe parandalimit të degradimit të mëtejshëm, MMPH ka hartuar dhe miratuar në Kuvend Strategjinë për Cilësinë e Ajrit 2013-2022, ka hartuar dhe miratuar në Qeveri strategjinë për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022, planin për menaxhimin e mbeturinave 2013-2017, Strategjinë e Mjedisit 2013-2022 dhe Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis 2013-2017. Gjatë vitit 2013 MMPH ka hartuar dokumentin Strategjik Plan Hapësinor i Parkut Kombëtar “Mali Sharr”i cili është miratuar në Qeveri, dhe i zgjeruar edhe për 20 mijë Hektarë.

Gjatë vitit 2013 është shpallur edhe Parku i dytë Kombëtar i Kosovës Parku i Bjeshkëve të Nemuna.

Me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe sigurimit të ujit të pijshëm në bazë të ligjit për Ujërat e Kosovës, gjatë viti 2013 janë nxjerre vendime për 16 burime të ujit të pijshëm me të cilat këto burime shpallen Zona të Mbrojtura.

Lidhur me fuqizimin e fushës së Planifikimit Hapësinor, Banimit dhe Ndërtimit, pas miratimit të Ligjit nr 04/L-061 për shitjen e banesave janë pranuar 1528 kërkesa, janë themeluar 31 komisione për shqyrtimin e kërkesave.

Gjatë viti 2013, 6 komuna janë pajisur me pëlqim për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) nga MMPH me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Nga aktivitetet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës gjatë vitit 2013 ka vazhduar projekti Zhvillimi i sistemit të unifikuar të adresave në Republikën e Kosovës, i regjistrit të adresave. Me këtë projekt janë digjitalizuar në ARIS rreth 20,000 rrugë dhe 430,000 hyrje të objekteve.

Procesi i shpronësimit ka vazhduar dhe në vitin 2013 janë pranuar 37 kërkesa për shpronësim të pronave të paluajtshme me interes nacional si dhe janë realizuar kompensimi për 1251 prona në vlerë prej €32,277,521.

Gjatë vitit 2013 gjithashtu janë dhënë edhe një numër i konsiderueshëm i lejeve nga fushëveprimtaria e mjedisit, ujrave planifikimit, dhe ndërtimit.

Inspektorati gjatë inspektimeve dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit të bëra ka lëshuar 718 procesverbale, 59 inicime kundërvajtëse dhe penale, 62 vendime 21 konfiskime si dhe zbatimin e vendimit të Ministrit për Prevallë për rrënimin e objekteve pa leje.

Objektivat

Për ta realizuar misionin e saj, MMPH-ja në periudhën afatmesme planifikon t'i realizojë këto objektiva:

1. Kompletimi i infrastrukturës Ligjore në fushëveprimtarinë e MMPH-së dhe zbatimi i saj;
2. Përmirësimi i gjendjes së mjedisit;
3. Administrimi, menaxhimi i resurseve ujore dhe funksionalizimi i Autoriteteve Rajonale të Pellgjeve Lumore;
4. Krijimi i sistemit administrativ efikas për planifikim hapësinor, banim, ndërtim dhe kadastër për të siguruar zbatimin e tyre;
5. Shpronësimi.

Për të realizuar **objektivin e parë** “Kompletimi i infrastrukturës ligjore të fushëveprimit të MMPH”, planifikohen këto aktivitete:

- Hartimin e ligjeve;
- Hartimin e udhëzimeve administrative.

Për të realizuar **objektivin e dytë** “Përmirësimi i gjendjes së mjedisit”, MMPH-ja planifikon këto aktivitete:

- Parandalimi, zvogëlimi i ndotjes së mjedisit dhe qasja e integruar për kontrollin e ndotjes;
- Mbrojtja e llojllojshmërisë biologjike, trashëgimisë natyrore dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore.

Për të realizuar **objektivin e tretë** “Administrimi, menaxhimi i resurseve ujore dhe funksionalizimi i Autoriteteve Rajonale të Pellgjeve Lumore”, planifikohen këto aktivitete:

- Ndërprerja dhe largimi i të gjithë operatorëve nga shtretërit e lumenjve;

- Ndërprerja e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe vajrave nga operatorët komercial,
- Trajtimi i ujërave të zeza.

Për të realizuar **objektivin e katërt** “Krijimi i sistemit administrativ efikas për planifikim hapësinor, banim, ndërtim dhe kadastrë për të siguruar zbatimin e tyre”, MMPH-ja planifikon këto aktivitete:

- Hartimi i planeve hapësinore dhe dokumenteve përkatëse;
- Përmirësimi i shërbimeve kadastrale për qytetarët;
- Themelimi i sistemit transparent të banimit me qira jo profitabile në fondin e ndërtuar të banesave me qira që janë pronë e shtetit apo komunave dhe në ato që do të ndërtohen;
- Hartimi i rregullave teknike ndërtimore në harmoni me standardet e BE-së.

Për të realizuar **objektivin e pestë** “Shpronësimi”, MMPH-ja që të bëjë:

- Shpronësimin e pronave për nevoja nacionale.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015 - 2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	50,338,480	45,487,230	47,785,027	27,951,847	41,652,290	41,652,290
Totali i Programeve	2,656,620	3,453,186	47,785,027	27,951,847	41,652,290	41,652,290
Njësia për të Drejtat e Njeriut	21,619	23,672	26,101	24,300	24,300	24,300
Departamenti i Mjedisit	977,181	1,090,436	2,466,197	2,443,847	2,165,847	2,443,847
Departamenti i Planifikimit Hapësinor	1,657,820	2,339,078	2,654,627	1,239,877	764,877	2,644,877
Departamenti i Burimeve Ujore	2,674,399	4,809,702	4,096,384	5,528,472	2,778,623	980,473
Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit	481,761	382,763	1,145,243	1,135,343	1,135,343	1,135,343
Departamenti për Shpronësim	41,995,023	33,249,251	32,742,130	13,249,849	32,073,891	31,406,541
Fshati Hade	361,101	135,058	300,000	300,000	300,000	300,000
Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit	566,778	534,550	875,758	1,011,358	1,011,358	831,358
Agjencia Kadastrale e Kosovës	822,057	2,131,943	2,478,585	2,096,714	475,964	963,464
Departamenti i MNUNP			161,561	149,560	149,560	149,560
Zyra e Ministrit	154,193	155,754	160,752	150,252	150,252	150,202
Departamenti i Administratës Qendrore	1,657,820	2,339,078	677,689	622,275	622,275	622,275

Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	50,338,480	45,487,230	47,785,026	27,951,847	41,652,289	41,652,290
Nr. i punëtorëve	303	293	293	293	293	293
Paga dhe mëditje	1,442,159	1,401,057	1,442,857	1,442,857	1,442,858	1,442,858
Mallra dhe shërbime	1,227,113	1,260,690	1,287,008	1,093,957	1,093,957	1,093,957
Shpenzime komunale	56,149	76,562	97,906	83,220	83,220	83,220
Subvencione dhe transfere	-	-		0	0	0
Shpenzime kapitale	47,613,059	42,748,921	44,957,255	25,331,813	39,032,255	39,032,255
Burimet e Financimit	50,338,480	45,487,230	48,375,678	27,951,847	41,652,290	41,652,290
Grantet qeveritare	50,007,529	44,236,542	44,870,026	26,453,974	41,652,289	41,652,290
Të hyrat vetanake	-	-		0	0	0
Financimet nga huamarrjet	330,951	1,250,688	2,915,000	1,497,873	0	0
Grantet donatoret	793,633	592,024	590,652	456,750	0	0

Përmbledhja e Indikatorëve kyç të performancës

1. Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë posedon:

- Rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit me matje automatike;
- Laboratorin e analizave kimike të ajrit për përcaktimin e ndotësve inorganik dhe organik në ajër;
- Laboratorin për përgatitjen e mostrave të ajrit për analizë laboratorike;
- Laboratorin për kalibrimin e analizërëve të ajrit.

Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë bëhet përmes 12 stacioneve automatike përmes të cilave bëhet monitorimi 24h/7 ditë pa ndërprerë, dhe një stacion mobil (lëvizës), përmes së cilit bëhet monitorimi sipas nevojave dhe kërkesave.

2. Ndikimi Mjedisor

Në periudhën 03 janar 2013 - 31 dhjetor 2013, në Sektorin për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor janë pranuar 116 kërkesa për pëlqim mjedisor.

Numri i përgjithshëm i lëndëve të VNM-së të pranuar në këtë periudhë janë 116 prej tyre :

- 110 janë shqyrtuar,
- 06 janë në procedurë për shqyrtim.

Numri i përgjithshëm i lëndëve të VNM-së të shqyrtuara janë 103, prej tyre:

- 86 - jepet pëlqimi mjedisor,
- 12 - refuzohen,
- 12- informata shtesë.

3. Mbrojtja e mjedisit dhe shpronësimi

Në vitin 2013 janë kryer 583 inspektime në mjedis dhe janë rrënuar 233 objekte pa leje. Gjatë vitit 2013 janë shpronësuar 2,449,124 m².

MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM

Misioni

Ministria për Komunitet dhe Kthim (MKK) zhvillon dhe udhëheqë me programe dhe mekanizma për zbatim dhe integrim të barabartë më të gjitha komunitetet dhe anëtarët e përkatësive të ndryshme, të cilët momentalisht jetojnë në Kosovë si dhe siguron kthimin e qëndrueshëm të personave të shpërngulur.

MKK-së mundëson ofrimin e shërbimeve sa më të mira qytetarëve për çështje të realizimit të të drejtave dhe kthimit, të jetë partner aktiv dhe i besueshëm i komunitetit ndërkombëtar si dhe i kushton rëndësi të veçantë dialogut ndëretnik dhe aktiviteteve të bashkësive për kthim të qëndrueshëm nga vendet e rajonit.

Situata aktuale

Duke pasur parasysh faktin se mijëra qytetar të Kosovës janë të zhvendosur dhe shpesh jetojnë në kushte të rënda dhe shumica e tyre janë të strehuar nëpër qendra kolektive, MKK-ja është duke bërë sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale për të kthyerit. MKK-ja të gjithë të kthyerve në Kosovë u garanton siguri dhe lëvizje të lirë, qasje në shërbimet publike, qasje në strehim dhe realizueshmëri ekonomike përmes qasjes së drejtë dhe të barabartë të edukimit, mbrojtjes shëndetësore dhe mundësive për punësim.

Objektivat

Për të realizuar misionin e saj, MKK-ja në periudhën afatmesme planifikon të realizoj këto objektiva:

1. Krijimi i bazës ligjore për një shoqëri demokratike, rritja e besueshmërisë dhe bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
2. Stabilizimi i komuniteteve përmes implementimit të projekteve të MKK-së dhe rritja e numrit të kthimit të qëndrueshëm;
3. Procesi i kthimit, integrimin dhe stabilizimit të komuniteteve.

Objektivi i parë, "Krijimi i bazës ligjore për një shoqëri demokratike, rritja e besueshmërisë dhe bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare", arrihet për mes këtyre aktiviteteve:

- Fuqizimi i të drejtave të komuniteteve dhe sigurimi i zbatimit të ligjit aktual për mbrojtjen dhe promovimin e ligjeve për komunitete;
- Të sigurohet pjesëmarrja shoqërore dhe qasja e komuniteteve në të gjitha shërbimet publike si: arsimin, shërbimet shëndetësore, sociale;
- Sigurimi i përfaqësimit të barabartë të të gjitha komuniteteve në pajtim me vlerat e një shoqërie multietnike.

Objektivi e dytë “Stabilizimi i komuniteteve përmes implementimit të projekteve të MKK-së dhe rritja e numrit të kthimit të qëndrueshëm”, arrihet përmes këtyre aktiviteteve:

- Ofrimin e mundësive të barabarta për zhvillimin e të gjithë komuniteteve;
- Zbatimin e projekteve të cilat plotësojnë kushtet për stabilizim dhe integrim të komuniteteve, ndërtimin e shtëpive për të kthyerit, ndërtimi i ndërtesave banesore për banim kolektiv, kopshteve për fëmijë dhe qendrave shëndetësore;
- Përmirësimi i kushteve ekonomike dhe integrimi i komuniteteve, duke përfshirë personat e kthyer në mënyrë që të promovohet një shoqëri stabile, prosperuese dhe multi-etnike;
- Sigurimi i makinave bujqesore për të kthyerit, sigurimi i mjeteve materiale për nisjen e veprimtarisë vetanake për të kthyerit.

Objektivi e tretë “Procesin e kthimit, integrimin dhe stabilizimit të komuniteteve”, arrihet për mes këtyre aktiviteteve:

- Vëmendje e posaçme i kushtohet implementimit të projekteve të cilat kanë për qëllim komoditetin e komuniteteve si nga MKK-ja dhe donatorët e ndryshëm, ndërtimin e rrugëve, ujësjellësit dhe kanalizimit, objekteve sportive dhe aktivitetet tjera, mbyllja e qendrave kolektive;
- Të sigurohet se personat e zhvendosur dhe të kthyerit potencial të kenë informacione adekuate rreth kushteve të kthimit dhe të drejtave të tyre.

Tabela 1. Historiku dhe Shpenzimet sipas skenarit bazë për 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Ministria për Komunitete dhe Kthim	6,282,826	6,567,575	7,186,000	7,252,312	7,252,312	7,252,312
Totali i Programeve	6,282,826	6,567,575	7,186,000	7,252,312	7,252,312	7,252,312
Programi i Administratës qendrore	1,129,211	1,337,887	1,556,000	1,252,312	1,252,312	1,252,312
Projekti i Konsoliduar për të kthyerit	5,153,615	5,229,688	5,630,000	6,000,000	6,000,000	6,000,000
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	6,282,826	6,367,575	7,186,000	7,252,312	7,252,312	7,252,312
Nr. i punëtoreve	104	99	99	99	99	99
Paga dhe mëditje	490,503	506,521	526,158	526,158	526,158	526,158
Mallra dhe shërbime	305,224	302,921	675,544	380,000	380,000	380,000
Shpenzime komunale	33,488	28,445	54,298	46,154	46,154	46,154
Subvencione dhe transfere	299,996	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000
Shpenzime kapitale	5,153,615	5,229,688	5,630,000	6,000,000	6,000,000	6,000,000
Burimet e Financimit:	6,282,826	6,567,575	7,186,000	7,252,312	7,252,312	7,252,312
Grantet qeveritare	6,282,826	6,567,575	7,186,000	7,252,312	7,252,312	7,252,312
Të hyrat vetanake						
Garantët donatorët	662,000	205,342	-	-	-	-

Përmbledhje e Informatave Kyçe të Përformancës

Gjatë vitit 2012 janë kthyer 422 persona, janë ndërtuar 148 banesa, 76 shtëpi të financuara nga MKK-ja, është bërë mbyllja e kampit në Çesmin Llug dhe kampi Osterode. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe MKK-ja ka furnizuar me material ndërtimor 301 familje në shumën financiare prej €1,959,042, që kanë për bazë stabilizimin, riintegrimin e komuniteteve dhe zhvillimin e qëndrueshmërisë ekonomike të komuniteteve pakicë.

Gjatë vitit 2013, me strehim janë mbështetur 102 familje të kthyera, nga këto, 58 janë ndihmuar me ndërtimin e shtëpive nëpër regjione të ndryshme dhe 44 familje të zhvendosura brenda vendit janë ndihmuar me ndarjen e apartamenteve për strehim në komunën e Graqanicës.

Ndihma me pako ushqimore dhe dru për ngrohje është edhe njëra nga format e ndihmave dedikuar për komunitetet, është bërë shpërndarja e 250 m³ të lëndëve djegëse për 50 familjet e kthyera dhe familjeve me kushte të vështira sociale si dhe shpërndarja e mobileve shtëpiake dhe teknik të bardhë për 49 familje. Gjithashtu është bërë shpërndarja e 198 pakove ushqimore-higjienike për familjet e kthyera dhe familjeve me kushte të vështira sociale në të gjitha.

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

Misioni

Misioni i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është avancimi cilësor i qeverisjes së pushtetit lokal, në bashkëpunim me strukturat e zgjedhura dhe zyrtarët komunal për të siguruar shërbime të përgjegjshme dhe efektive në shërbim të qytetarëve.

Situata aktuale

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), është angazhuar në zhvillimin e legjislacionit primar dhe sekondar për funksionimin efektiv dhe efikas të vetëqeverisjes lokale. MAPL zhvillon dokumente strategjike, profesionale dhe administrative për funksionalizimin e sistemit, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të të drejtave të njeriut si dhe përkushtimin me sukses të plotë të kompetencave vetanake dhe të deleguara në komuna. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është duke i zhvilluar mekanizmat administrativ për monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga komunat. Po ashtu vazhdon në përkrahjen e komunave për ndërtimin e kapaciteteve dhe përmbushjen e obligimeve të komunave që kanë të bëjnë me procesin e integriteteve evropiane.

Objektivat

Për të realizuar misionin e saj, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në periudhën afatmesme planifikon të realizoj këto objektiva:

1. Strategjia e vetëqeverisjes lokale 2015-2025;
2. Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në komunat e veriut;
3. Promovimi i diversitetit lokal në funksion të zhvillimit socio-ekonomik të vendit.

Objektivi i parë ka për qëllim zhvillimin e Strategjisë së vetëqeverisjes lokale 2015-2025. Kjo do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Krijimi i qendrueshmërisë ekonomike, sociale dhe strukturave lokale, për të siguruar që parametrat e politikave lokale dhe modalitetet financiare të sjellin risi në zhvillimin e komunave;
- Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë dhe rregullimin efektiv për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase e profesionale të komunave;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale të vetëqeverisjes lokale për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët;
- Forcimi i partneritetit ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

Për të realizuar **objektivin e dytë** organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në komunat e veriut, MAPL planifikon të realizojë këto aktivitete:

- Inaugurimi i organeve të komunave në përputhje me rezultatet e zgjedhjeve dhe me ligjet e Kosovës;
- Ndërtimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore për ushtrimin e kompetencave të pushtetit lokal;
- Përkrahja e komunave në zbatimin e ligjshmërisë gjatë punës së tyre.

Objektivi i tretë synon promovimin e diversitetit natyror dhe kulturor në funksion të zhvillimit socio-ekonomik të vendit. Kjo do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Shfrytëzimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore për zhvillimin ekonomik lokal;
- Përfshirja e komuniteteve dhe shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik lokal nëpërmjet shfrytëzimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	5,752,498	4,877,197	5,050,000	4,996,599	4,996,599	4,996,599
Totali i Programeve	5,752,498	4,877,197	5,050,000	4,996,599	4,996,599	4,996,599
Shërbimet e Administratës Qendrore	5,168,957	4,877,197	5,050,000	4,996,599	4,996,599	4,996,599
Shpenzimet Kontigjente për komunat e reja	583,541					
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	5,752,498	4,877,197	5,050,000	4,996,599	4,996,599	4,996,599
Nr. i punëtorëve	118	125	141	141	141	141
Paga dhe mëditje	696,535	666,931	756,746	756,746	756,746	756,746
Mallra dhe shërbime	609,059	348,159	326,005	277,104	277,104	277,104
Shpenzime komunale	23,401	25,724	30,000	25,500	25,500	25,500
Subvencione dhe transfere	390,063	468,125	437,249	437,249	437,249	437,249
Shpenzime kapitale	4,033,440	3,368,258	3,500,000	3,500,000	3,500,000	3,500,000
Burimet e Financimit	5,752,498	4,877,197	5,050,000	4,996,599	4,996,599	4,996,599
Grantet qeveritare	5,752,498	4,877,197	5,050,000	4,996,599	4,996,599	4,996,599
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatorët	-	-	-	-	-	-

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Misioni

Misioni i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), është t'i kontribuoj zhvillimit ekonomik, standardit të jetesës dhe mirëqenies së qytetarëve, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë me theks të veçantë EE, BRE dhe bashkëprodhimin, sektorit minerar dhe të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës. MZHE-ja do të siguroj shfrytëzim të qëndrueshëm, efikas dhe efektiv të resurseve energjetike dhe minerale dhe frekuencore në pajtueshmëri me praktikën më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Po ashtu ngritja e konkurrencës së ekonomisë përmes krijimit të një klime të favorshme për investime në vend, ristrukturimi i ekonomisë përmes transformimit të pronësisë, modernizimit dhe ngritjes së efikasitetit të ndërmarrjeve publike, me qëllim të krijimit të një ekonomie funksionale të tregut.

Situata aktuale

Përkundër progresit në rritjen e kapaciteteve të transmisionit dhe distribucionit, furnizimit me energji elektrike, rritjes së efikasitetit në shfrytëzimin e resurseve minerale, rritjes së penetrimit të internetit e cila është mbi 52% dhe penetrimit të telefonisë mobile që aktualisht është 98.4%, fillimit të ofrimit të teknologjisë 3G të telefonisë, mbetet që edhe më tutje të këtë angazhim për përmirësimin e gjendjes aktuale.

Sa i përket sektorit të energjisë dhe kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë nga linjiti, ka vazhduar aktiviteti për identifikimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e investitorëve potencial për implementimin e projektit TC Kosova e Re – 600 MW. Është përmbyllur procesi i privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit të KEK (KEDS) dhe bartja e aseteve nga KEK të operatori Calik-Limak ndërsa monitorimin e implementimit të kontratës së transaksionit e bën Njësia e Post Privatizimit në kuadër të MZHE-së. Në drejtim të përmirësimit të komponentës mjedisore, gjithashtu janë bërë investime të konsiderueshme në blloqet e njësisë të TC Kosova A, ku së fundi janë implementuar edhe sistemi i filtrave, bartja hidraulike e hirit dhe komisionimit të stacionit të kompresorëve në TC Kosova A.

Procesi i dekomisionimit të TC Kosova A, Qeveria e Kosovës përmes vendimit Nr. 04/156 ka qartësuar qasjen lidhur me këtë proces, me ç' rast vazhdon procesi i dekomisionimit dhe çmontimit të azotikut, gazifikimit, ngrohtores dhe objekteve tjera përcjellëse të cilat nuk e pengojnë operimin normal të njësisë aktive të TC Kosova A. Aktiviteti për procesin e dekomisionimit do të mbështetet financiarisht me fondet e Bashkimit Evropian përmes mbështetjes IPA 2014.

Gjithashtu në funksion të zhvillimit të sektorit minerar, tashme ka filluar puna rreth ndryshimit të statusit të Trepçës në mënyrë që të krijohen të gjitha parakushtet për implementimin e programeve zhvillimore përkatëse.

Është themeluar Agjencia Gjeologjike e Kosovës në kuadër të MZHE-së për të siguruar informacione të dobishme gjeo-shkencore në formë të shërbimeve, hulumtimeve dhe këshillimeve lidhur me nevojat kombëtare dhe lokale për zhvillimin e sektorit minerar.

Në fushën e BRE dhe EE tashmë janë miratuar planet zhvillimore përkatëse. Ndërkohë, ka një interesim të shtuar të investitorëve privat për të investuar në projektet e BRE-ve, kryesisht në hidrocentrale të vogla dhe energji të erës, për të cilat projekte Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka lëshuar apo është në proces të lëshimit të autorizimeve përkatëse. Gjithashtu në funksion të implementimit të planit të EE, tashmë janë ndërtuar apo janë në funksion të ndërtimit linjat kreditore përkatëse të mbështetura edhe nga komuniteti i donatorëve.

Gjatë vitit 2013 ka filluar realizimi i fazës së parë të Projektit Sistemi i Integruar Informativ për Zhvillim Ekonomik, qëllimi i së cilit është mbledhja, mirëmbajtja dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet institucioneve. Këto të dhëna do të shërbejnë për planifikim, analizim, vendimmarrje dhe krijim të raporteve më cilësore brenda institucioneve të Republikës së Kosovës. Në fillim të vitit 2014 dhe fazës së dytë të projektit, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë vendim për plotësimin e GP me 7 institucione tjera.

Industria e telekomunikacionit përbën njërin nga sektorët më dobiprurës për treguesit makroekonomik, si dhe shërben si katalizator i të ashtuquajturës “ekonomi e dijes”. Kjo industri shërben dhe u mundëson bizneseve dhe individëve qasje të shpejtë dhe globale. Zhvillimi i telekomunikacionit i shërben kohezionit ekonomik dhe social të shtetit tonë, si dhe përparimit të shoqërisë informative. Baza ligjore për rregullimin e sektorit është e vendosur me Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, Ligjin Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike si dhe Dokumentin Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike – Axhenda Digjitale për Kosovën 2013-2020.

Për sa i takon Ndërmarrjeve publike, fokusi është në monitorimin e punës së bordeve të drejtorëve dhe punës së Ndërmarrjeve Publike Qendrore (NP) në drejtim të rritjes së nivelit të shërbimeve publike për qytetarë të Kosovës, përmirësimit të qeverisjes korporative dhe ngritjes së vlerës së aseteve të NP si pronë e Republikës së Kosovës dhe mundësisë së përfshirjes së kapitalit privat. MZHE i mbështet edhe financiarisht NP për subvencione dhe projekte kapitale sipas prioriteteve të dhëna.

Objektivat

Ministria planifikon të realizojë misionin e saj përmes arritjes së objektivave të dhënë më poshtë:

1. Krijimi i politikave të përshtatshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
2. Krijimi i mjedisit të favorshëm ligjor dhe rregullator për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve në sektorët e energjisë, minierave dhe telekomunikimeve (TIK-ut);
3. Nxitja e hulumtimit, shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve minerale dhe resurseve frekuencore;
4. Furnizimi i sigurtë me energji, duke ndërmarr masa në sistemin e rrjetit, në rivitalizimin e njësive gjeneruese aktuale në harmoni me kërkesat e legjislacionit përkatës dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja, shërbime të telekomunikimeve, përmes tregut konkurrues të integruar në sistemet rajonale dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare;
5. Reformimi dhe ristrukturimi i NP-ve dhe ngritja e nivelit të shërbimeve publike për qytetarët.

Objektivi i parë synon të krijojë parakushte për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik duke marrë në konsideratë shfrytëzimin racional të resurseve sektoriale me qëllim të adresimit të sfidave me të cilat ballafaqohet MZHE-ja.

Objektivi i dytë synon të krijon infrastrukturën e domosdoshme ligjore për funksionimin e qëndrueshëm dhe shërbimeve të tyre në fushat që mbulohe nga MZHE-ja.

Objektivi i tretë synon të nxisë investimet në fushën e hulumtimit dhe shfrytëzimit të resurseve minerale që janë të lidhura ngushtë me harmonizimin e legjislacionit primar dhe sekondar në këtë sektor. Kurse, resurset frekuencore do të arrihen me penetrim më të madh të këtyre shërbimeve për të njëjtat frekuenca në dispozicion, si dhe shfrytëzimin e teknologjive të reja inovative.

Objektivi i katërt synon të krijojë parakushtet e domosdoshme në funksion të ngritjes dhe zhvillimit të sektorëve që janë në kompetencën e MZHE-së me theks të veçantë në fushën e energjisë, minierave dhe telekomunikacionit.

Objektivi i pestë synon reformimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve publike (NP), si dhe involvimin e kapitalit privat në shërbimet publike. Ngritja e nivelit të shërbimeve do të bëhet përmes ngritjes së performancës operative të NP-ve dhe rritjes së shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbimeve tjera publike.

Tabela1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	41,956,042	36,780,567	30,079,640	28,075,226	29,645,373	29,645,673
Totali i Programeve	41,956,042	36,780,567	30,079,640	28,075,226	29,645,373	29,645,673
Administrata Qendrore	4,333,082	4,728,161	4,743,420	4,315,843	4,315,843	4,315,843
Zyra e Ministrit	162,849	182,075	198,536	198,536	198,536	198,536
Departamenti i Energjisë	596,251	489,089	509,289	375,289	325,289	325,289
Departamenti i Minierave	453,257	-	70,000	80,000	150,000	150,000
Inspektorati	34,614	30,395	34,611	34,611	34,611	34,611
Programit Energjia - KEK-u	13,550,000	11,644,245	-	-	-	-
Importi i Energjisë - Rastet Sociale	4,500,000	4,500,000	4,500,000	4,500,000	4,500,000	4,500,000
Programi i KOSTT	3,491,100	1,677,755	-	-	-	-
Programi i Hekurudhat e Kosovës	3,261,087	-	-	-	-	-
Programi-Ngrohja Qendrore	3,500,000	3,500,000	3,500,000	3,500,000	3,500,000	3,500,000
Programi-Uji dhe Hedhurinat	2,538,562	3,981,959	4,657,959	1,900,000	1,650,000	1,650,000
Njësia per Politikat dhe Monitorim	889,325	521,266	523,307	223,307	223,307	223,307
Trainkos	-	1,500,000	1,738,842	1,738,842	1,738,842	1,738,842
Infrakos	-	2,461,087	2,400,000	2,400,000	2,400,000	2,400,000
Telekomunikacioni	83,272	66,709	66,709	66,709	66,709	66,709
Minierat e Trepçës	5,412,870	4,817,870	4,817,870	4,817,870	4,817,870	4,817,870
Departamenti i Politikave te ZHE	-	330,665	336,785	76,785	326,785	326,785
Departamenti Ligjor	-	24,012	28,092	28,092	28,092	28,092

Instituti gjeologjik i Kosovës	-	556,209	861,695	1,533,207	1,388,354	1,388,654
Agjencia e Kosovës për Efiqencë të Energjisë	-	51,789	1,053,448	2,253,448	3,948,448	3,948,448
Muzeu Shtetëror i Kristaleve	-	37,302	39,077	39,077	39,077	39,077
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	41,956,042	36,780,567	30,079,640	28,075,226	29,645,373	29,645,673
Nr. i punëtorëve	153	153	153	153	153	153
Paga dhe mëditje	762,146	781,377	845,175	845,175	845,175	845,175
Mallra dhe shërbime	5,006,574	4,229,474	5,141,246	4,363,669	4,363,669	4,363,669
Shpenzime komunale	42,196	39,735	42,600	36,210	36,210	36,210
Subvencione dhe transfere	26,202,371	24,602,809	12,833,870	12,833,870	12,833,870	12,833,870
Shpenzime kapitale	9,942,755	7,127,173	11,216,749	9,996,302	11,566,449	11,566,749
Burimet e Financimit:	41,956,042	36,780,567	30,079,640	28,075,226	29,645,373	29,645,673
Grantet qeveritare	41,956,042	36,780,567	29,079,640	25,875,226	25,750,373	25,750,673
Të hyrat vetanake	-	-	1,000,000	2,200,000	3,895,000	3,895,000
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatorët	-	-	-	-	-	-

Tabela 2. Përmbledhje e Informatave Kyçe të Performancës

Indikatorët Kyç të Performancës	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 plani	2016 plani	2017 plani
Sektori i energjisë						
Identifikimi i potencialeve të kursimit të energjisë në ndërtesat e nivelit qendror dhe lokal në Kosovë.	144,000	144,000	144,000	100,000	100,000	100,000
Identifikimi dhe promovimi i mundësive për shfrytëzim të EE-se dhe BRE-se.	110,000	90,000	1,123,000	2,470,000	320,000	320,000
Hulumtimet - Studimet për ngritjen e kapaciteteve të reja energjetike në Kosovë						
Sektori i minierave						
Ngritja e kapaciteteve për hulumtim dhe analiza për identifikim të zonave perspektive në fushën e hulumtimit të resurseve minerare - Ngritja e laboratorit për analiza	-	477,000	771,000	1,442,000	1,200,000	-
Zhvillimi i minierave të Trepçës	1,335,000	1,335,000	1,735,000	1,735,000	1,735,000	1,735,000
Studimet për identifikimin e zonave të mundshme për hapjen e minierave të reja.	173,000	50,000	70,000		50,000	200,000
Ndërmarrjet Publike						

<p>Ngritja e nivelit të shërbimeve publike për qytetarët e Kosovës nga sektori i Hekurudhave nga Investimet qeveritare vërehet në rritjen e nr. të udhëtarëve që për qarkullim përdorin transportin hekurudhor sikurse që është rritur niveli i shfrytëzimit të transportit të mallrave përmes hekurudhës.</p>	2,761,000	2,861,000	3,039,000	3,039,000	3,039,000	3,039,000
<p>Edhe në Sektorin e Ujit është ngritur performanca me shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm duke reduktuar humbjet e ujit nga 61% në 59% , duke rritur % e inkasimit për 3% si dhe duke ngrit nr. e konsumatorëve për 5% si qasje e popullatës në furnizim me uji.</p> <p>Spektori i mbeturinave ka ngritje në performance nga investimet në pajisje e mjete të transportit të mbeturinave me një përfshirje me të madhe gjeografike të territorit të Kosovës për grumbullimin e mbeturinave.</p>	1,301,000	2,882,000	2,689,000	2,689,000	2,689,000	2,689,000
<p>Spektori i mbeturinave ka ngritje në performance nga investimet në pajisje e mjete të transportit të mbeturinave me një përfshirje me të madhe gjeografike të territorit të Kosovës për grumbullimin e mbeturinave.</p>	638,000	500,000	1,369,000	1,369,000	1,369,000	1,369,000

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Misioni

Misioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) është ndërtimi, ruajtja dhe ngritja e sigurisë për të gjithë qytetarët, mbikëqyrja dhe sigurimi i sundimit të ligjit, mbrojtja e jetës, pasurisë dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët. MPB-ja, mbështetur në vlerat profesionale dhe humane, ofron qasje moderne, profesionalizëm, transparencë, respektim të drejtave të njeriut, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Situata Aktuale

Ministria e Punëve të Brendshme ka ngritur kapacitetet e saj për fuqizim dhe sundim të ligjit duke ngritur kapacitetet e teknologjisë informative, funksionalizimin e drejtorisë për mbrojtje të dëshmitarëve, themelimin e qendrës kombëtare për menaxhimin e kufirit dhe funksionalizimin e sistemit të të dhënave CODIS në laboratorin e ADN-së.

Është avancuar procesi i integritimit evropian me fillimin e negociatave të marrëveshjes së stabilizim-asocimit dhe përparimit në dialogun për liberalizimin e vizave. Janë zbatuar marrëveshjet e arritura në Bruksel ku është bërë kthimi i regjistrave themeltar të gjendjes civile nga Serbia, inkuadrimi i rreth 100 ish-pjesëtarëve të MUP-it në policinë e Kosovës, themelimi dhe funksionalizimi i drejtorisë rajonale të policisë për rajonin e veriut të Mitrovicës, dhe implementimi i menaxhimit të integruar të kufirit.

Është plotësuar baza ligjore dhe strategjike sipas legjislacionit të BE-së. Përmes sistemit elektronik të regjistrimit qendror të gjendjes civile është ngritur siguria e dokumenteve dhe regjistrave civil dhe janë lëshuar pasaportat dhe letërnjoftimet biometrike.

Janë nënshkruar marrëveshje në fushën e ripranimit të personave të riatdhesuar, bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e migrimit, si dhe luftimin e krimit të organizuar.

Punohet vazhdimisht në ngritjen e efikasitetit për të menaxhuar me sukses në situata emergjente. Për të zbatuar legjislacionin në fuqi, MPB-ja është angazhuar intensivisht në sistemin e të gjitha njësive rajonale dhe komunale të emergjencave në strukturën e MPB.

Objektivat

1. Parandalimi dhe luftimi i krimit dhe ofrimi i sigurisë publike;
2. Zbatimi i rekomandimeve nga rishikimi i sektorit të sigurisë;
3. Reformat në Agjencitë e Sigurisë Publike;
4. Zgjerimi i ofrimit të shërbimeve të dokumenteve civile.

Objektivi i parë synon parandalimin dhe luftimin e krimit dhe ofrimin e sigurisë publike. Realizimin e këtij objektivi departamentet përkatëse të Policisë së Kosovës do ta arrijnë përmes këtyre aktiviteteve:

- Krijimi i sistemit digjital të radio-komunikimit – TETRA;

- Operacionalizimi i Drejtorisë për Mbrojtje të Dëshmitarëve;
- Zgjerimi i fushave të ekspertizës në Agjencinë e Forenzikës;
- Luftimi i krimit kibernetik;
- Zbatimi i strategjisë së policimit të udhëhequr nga inteligjenca.

Objektivi i dytë ka për qëllim zbatimin e rekomandimeve që dalin nga rishikimi strategjik i sektorit të sigurisë. Aktivitetet me të cilat do të arrihet ky objektivi janë:

- Ngritja e kapaciteteve të Policisë së Kosovës në menaxhimin e turmave dhe protestave të dhunshme;
- Themelimi i Qendrës Operative për Menaxhimin e Situatave Emergjente, ngritja e aftësisë vepruese dhe kompletimi i sistemit të emergjencave më infrastrukturë dhe pajisje të nevojshme, për parandalimin dhe menaxhimin e krizave si dhe ngritja e kapaciteteve të AME-së për marrjen e përgjegjësisë nga FSK-ja;
- Menaxhimi i materieve të rrezikshme;
- Operacionalizimi i Njesisë së Helikopterëve.

Objektivi i tretë është i lidhur ngushtë me reformat, ngritjen e kapaciteteve si dhe në zbatimin e veprimeve dhe aktiviteteve të ndryshme në agjencitë e sigurisë publike”. Realizimi i këtij objektivi synohet të arrihet përmes këtyre aktiviteteve:

- Draftligji për pensionim të parakohshëm të zyrtarëve policor;
- Uniformat sipas disenjit të ri për Policinë e Kosovës;
- Agjencia e Kosovës për Siguri Publike – studimet bachelor;
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore profesionale në Inspektoratin Policor të Kosovës;
- Vazhdimi i negocimit dhe hartimit të marrëveshjeve bilaterale për ripranim;
- Decentralizimi i kompetencave në procesin e ri integritimit;
- Implementimin e veprimeve që dalin nga udhërrëfyesi për liberalizim.

Objektiva e katërt ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve të dokumenteve civile, kurse realizimi i këtij objektivi synohet të arrihet përmes këtyre aktiviteteve:

- Digjitalizimi i regjistrave civile;
- Pajisja e qytetarëve me dokumente personale të cilësisë së lartë të sigurisë (biometrike), sipas standardeve të BE-së.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Ministria e Punëve të Brendshme	89,204,437	92,173,665	107,062,880	102,922,413	101,262,413	102,195,207
Totali i Programeve	89,204,437	92,173,665	107,062,880	102,922,413	101,262,413	102,195,207
Programi i Shërbimeve të Administratës Qendrore	1,824,164	1,997,573	2,641,134	2,213,594	2,363,594	2,163,594

Programi i Agjencisë të Regjistrimit Civil	6,760,839	10,527,733	11,490,345	10,628,614	10,978,614	10,828,614
Programi i Ri-integrimit të Personave të Riatdhesuar	2,120,042	2,091,682	2,372,450	2,094,928	2,094,928	2,094,928
Programi i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë		761,329	1,128,741	1,124,741	1,537,860	1,274,741
Programi i Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave	929,788	994,164	4,022,843	4,244,373	1,234,373	1,734,373
Programi i Inspektorati Policor	795,845	908,804	1,140,677	1,056,597	1,060,844	1,107,357
Programi i Policisë së Kosovës	74,414,702	72,256,820	80,936,928	78,605,849	79,068,483	80,677,883
Programi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike	2,359,057	2,635,561	3,329,762	2,953,717	2,923,717	2,313,717
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	89,204,437	92,173,665	107,062,880	102,922,413	101,262,413	102,195,207
Nr. i punëtorëve	9,601	9,635	10,275	10,275	10,275	10,275
Paga dhe mëditje	54,316,965	5,462,157	59,304,289	59,304,289	59,304,289	59,304,289
Mallra dhe shërbime	9,124,496	21,974,568	25,365,588	21,524,469	21,524,469	21,524,469
Shpenzime komunale	1,418,377	1,539,043	2,167,528	1,878,180	1,878,180	1,878,180
Subvencione dhe transfere	957,792	997,362	1,318,870	1,318,870	1,318,870	1,318,870
Shpenzime kapitale	13,386,807	12,200,535	18,906,605	18,896,605	17,236,605	18,169,399
Burimet e Financimit	89,204,437	92,173,665	107,062,880	102,922,413	101,262,413	102,195,207
Grantet qeveritare	88,450,552	91,966,784	106,171,751	102,031,284	100,371,284	101,304,078
Të hyrat vetanake	482,357	54,127	891,129	891,129	891,129	891,129
Financimet nga huamarrjet	271,528	152,753	-	-	-	-
Grantet donatorët	-	-	-	-	-	-

Tabela 2. Përmbledhja e informatave kyçe të performancës

Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve

Indikatorët kyç të performancës	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Numri i pasaportave të lëshuara	153,7 16	159,725	300,000	300,000	300,000	200,000
Numri i Letërnfajtimeve të lëshuar	193,4 15	162,123	400,000	500,000	400,000	400,000
Numri i patentshoferëve të lëshuar	79,81 2	63,165	70,000	80,000	70,000	70,000

Forenzika

	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Gjithsej punëtor		42	53	62	72	72
Zyra e Kryeshefit (Nr Punetorëve)		2	5	5	6	6
<u>Departamenti për Traesologji Forenzike</u> (Nr Punetor)		25	30	34	37	37
Laboratori i Balistikës <i>Raste të pranuar/Raste të ekzaminuara</i>	1613/1365	1558/1515	1620/1620	1750/1750	1850/1850	2100/2100
Laboratori i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë <i>Raste të pranuar/Raste të ekzaminuara</i>	1001/1011	1291/1279	1400/1400	1530/1530	1650/1650	1800/1800
Laboratori i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve <i>Raste të pranuar/Raste të ekzaminuara</i>	720/715	775/773	800/800	880/880	950/950	1150/1150
<u>Departamenti për Kimi dhe Biologji Forenzike</u> (Nr Punetor)		9	9	13	17	17
Laboratori për Analiza Kimike të Narkotikëve <i>Raste të pranuar/Raste të ekzaminuara</i>	282/285	340/327	600/600	850/850	950/950	1180/1180
Laboratori i Serologjisë dhe ADN-së <i>Raste të pranuar/Raste të ekzaminuara</i>	69/80	112/117	250/250	380/380	450/450	600/600
Laboratori për Analizë të Zjarrenjeve dhe Eksploziveve <i>Raste të pranuar/Raste të ekzaminuara</i>	00/00	00/00	100/100	150/150	200/200	280/280
<u>Departamenti për Teknologji Invormative Forenzike</u> (Nr Punetor)		6	9	10	12	12

Laboratori për ekzaminim të kompjuterëve <i>Raste të pranuar/Raste të ekzaminuara</i>	45/39	82/46	150/150	250/250	320/320	470/470
Laboratori për ekzaminim të zërit dhe audiove <i>Raste të pranuar/Raste të ekzaminuara</i>	00/00	00/00	50/50	100/100	180/180	320/320
Laboratori për ekzaminim të fotografisë <i>Raste të pranuar/Raste të ekzaminuara</i>	00/00	00/00	50/50	100/100	150/150	270/270
TOTALI	3730/3495	4158/4057	5020/5020	5890/5890	6700/6700	8170/8170

Departamentin e Ri integrimit

Nr	Indikatorët kyç të performancës	Shërbime të ofruara	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Asistenca emergjente								
1	Transport deri në komunën e origjinës	Persona	361	316	320	320	320	320
2	Akomodimi i përkohshëm 7 ditor	Persona	166	138	140	140	140	140
3	Ushqimi i përgaditur (sevuar)	Persona	166	138	140	140	140	140
Asistenca afatshkurter								
4	Banesa me qera	Banesa	232	322	200	200	200	200
5	Pako ushqimore dhe higjienike	Persona	2783	2536	2500	2500	2500	2500
6	Barna dhe trajtim mjeksor	Persona	38	29	30	30	30	30
7	Pako dimërore (dru zjarri)	Familje/individ	509	297	200	200	200	200
Asistenca afatgjate								
8	Renovim shtëpie	Vendime	28	9	20	20	20	20
9	Rindertim/Ndertim shtëpie	Vendime	47	44	50	50	50	50
10	Orendi shtëpiake	Familje/individ	58	22	70	70	70	70
11	Plan bizneset	Persona	153	268	200	200	200	200
Finacimete e propozuar								
12	Sistemi i Menaxhimit të Rasteve i finacuar nga Programi për Riintegrim për menaxhimin e procesit të riintegrit	Kosto në €	-	26,030	40,000	5,000	5,000	5,000
14	Projektit i UNICEF-it i finacuar nga Programi për Riintegrim për asistencën e riintegrit	Kosto në €	-	23,908	23,908	23,908	23,908	23,908
13	Projektit i UNDP-is i finacuar nga Programi për Riintegrim për	Persona	134	120	120	120 €	120 €	120 €

	trajnimin për punësim dhe punsim për personat e riatdhesuar							
15	Projektit i MASHT-it i financuar nga Programi për Riintegrim për ofrimin e mësimin plotësues - kurseve të gjuhës për nxënësit e riatdhesuar	Nxënës të riatdhesuar	-	92	330	330	330	330
15	Si dhe projekte tjera	Kostot në €	-	92	50,000	50,000	50,000	50,000

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Indikatorët kyç të performancës	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Trajnimet e realizuara në AKSP						
Numri i pjesëmarrësve nga Agjencionet e Sigurisë Publike	4660	4263	8583	8583	8583	8583
Numri i trajnimeve të realizuara	281	277	140	250	250	250
Numri i instruktorëve të AKSP-së	7	7	17	53	53	53
Numri i instruktorëve të Agjencioneve në AKSP.	46	46	46	0	0	0
Arsimi i lartë (Fakulteti i Sigurisë Publike)						
Numri i Studentëve	-	-	65	130	195	270
Numri i Profesorëve	-	-	12	20	20	20
Shërbimet e administratës						
Numri i stafit të AKSP-së	168	163	177	177	177	177

Policia e Kosovës

Indikatorët kyç të performancës	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Numri i përgjithshëm i rasteve	45,379	54,180	53,096	52,055	51,014	49,994
Numri i veprave penale	35,585	36,642	35,909	35,205	34,501	33,811
Numri i aksidenteve në trafik	19,754	19,998	19,398	18,834	18,269	17,721
Aksidente me fatalitet	116	104	99	94	89	85
Persona të vdekur në aksidente me fatalitet	121	119	113	108	102	97

Kalimi i paautorizuar i kufirit	114	125	121	118	114	111
Kontrabandim me migrant	28	42	40	39	37	36
Kontrabandim me mallra	206	154	146	139	132	125
Krimi i organizuar	3	7	7	6	6	6
Krime kibernetike	11	19	18	17	16	15
Kultivim i narkotikeve	59	31	29	28	27	25
Posedim i narkotikeve	348	428	407	386	367	349
Trafikim me narkotik	142	119	113	107	102	97
Trafikim me njerez	34	38	36	34	32	30
Veprat penale kunder ekonomise	140	133	129	125	121	118
Veprat penale kunder detyres zyrtare	159	170	165	160	155	150
Veprat penale - vrasjet	55	39	36	33	30	28
Veprat penale - vjedhje	8,607	8,689	8,255	7,841	7,449	7,076
Arrestime	19,491	18,189	18,371	18,555	18,740	18,928
Armë te konfiskuara	1,601	1,758	1,828	1,902	1,978	2,057
Municion i konfiskuar i te gjitha kalibrave	34,270	37,812	39,324	40,900	42,536	44,237
Grupe kriminale te goditura	83	61	63	66	69	71
Trajnime te organizuara nga Divizioni i Trajnimeve	180	210	212	214	216	219
Numri i pjesmarresve ne trajnime	2,993	3,235	3,267	3,300	3,333	3,367
Trajnime, konferenca jashte vendit	73	72	73	73	74	75
Numri i pjesmarresve ne keto trajnime	309	357	361	364	368	372
Te gjitha llojet e tranimeve (duke perfshire edhe ri-certifikimin)	685	741	748	756	764	771
Numri total i pjesmarresve ne trajnime	8,249	8,667	8,840	9,021	9,201	9,385
Dollar te konfiskuar	1,172,513	73,505	74,975	76,505	78,035	79,595
Euro te konfiskuara	232,876	285,514	305,500	328,382	351,369	375,964
Euro te falsifikuara	0	86,022				

MINISTRIA E DREJTËSISË

Misioni

Misioni i Ministrisë së Drejtësisë (MD) është të zhvillojë dhe hartojë legjislacionin dhe politikat në fushën e drejtësisë, të vendos një sistem të avancuar ligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane. Për më tepër, misioni i Ministrisë është edhe krijimi i një gjyqësie dhe prokurorie të pavarur e unike për të siguruar sundimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe pronës së qytetarëve të Kosovës.

Situata aktuale

Ministria e Drejtësisë është zotuar të udhëheq dhe zbatojë reforma në lëminë e sundimit të ligjit. Ministria ka zbatuar një varg masash në mënyrë që të bëhet më efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në përgjigje të nevojave dhe prioritetëve të qytetarëve në lëminë e sundimit të ligjit. Ministria është e përkushtuar të përmbush obligimet që rrjedhin nga disa dokumente strategjike dhe të planifikimit, përfshirë: Planin e Zhvillimit Strategjik për vitin 2012-2016 të Ministrisë së Drejtësisë; Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit; Planin e Veprimit për Udhërrëfyesin për Liberalizim të Vizave; dhe Programin Legjislativ për Vitin 2013.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, të cilat lidhen dhe burojnë nga agjenda evropiane e kësaj Ministrie, me koordinimin e drejtpërdrejtë të saj dhe në bashkëpunim me Komisionin Evropian në maj të vitit të kaluar është mbajtur takimi i dytë për “Dialogun e Strukturuar për Sundim të Ligjit”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Të arriturat kyçe të Ministrisë së Drejtësisë janë si në vijim:

- Ministria ka përgatitur nëntëmbëdhjetë projekt ligje, katërmëdhjetë akte nënligjore, si dhe Rregulloren mbi organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Për të luftuar krimin trans-nacional, është nënshkruar marrëveshje për bashkëpunimin ligjor ndërkombëtar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë në çështje penale;
- Në dhjetor të vitit 2013, është përruar burgu i ri i sigurisë së lartë. Objekti do të pranojë rreth 390 të burgosur dhe pritet të vihet në funksion gjatë vitit 2014. Janë hapur dy qendra të reja rajonale të Shërbimit Sprovues të Kosovës (Ferizaj dhe Gjakovë);
- Departamenti për mjekësi ligjore ka kryer 300 autopsi mjekoligjore dhe 100 ekzaminime klinike fizike lidhur me dhunën familjare. 100 ekzaminime janë kryer në terren; baza e re e të dhënave për personat e zhdukur është bërë tërësisht funksionale;
- Instituti për hulumtimin e krimeve të luftës vazhdoi me identifikimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës. Instituti ka grumbulluar dhe fotokopjuar materialet e pranuar si prove të krimeve të luftës në regjionin e Gjilanit, Klinës, Istogut, Kaçanikut dhe Kamenicës. Shumë vizita janë kryer dhe janë marrë deklarata nga të mbijetuarit e masakrës së Qyshkut, Zahaqit, dhe Pavlanit në Pejë. Instituti ka hapur një ekspozitë në Vjenë me titullin "Shkatërrimi i Trashëgimisë Kulturore në Kosovë 1998-1999" dhe ka botuar përmbledhjen

e punimeve nga Konferenca Ndërkombëtare "Sfidat e Huluntimit të Krimeve të Luftës në Kosovë 1998-1999" (shqip anglisht dhe shqip-serbisht).

- MD ka përfaqësuar Qeverinë e Republikës së Kosovës në gjithsej 1656 seanca gjyqësore, ndërsa ka pranuar 2579 raste të Procedurës kontestimore, jokontestimore, përmbartimore dhe administrative dhe nga këto raste janë: 303 aktgjykime të fituara dhe 159 aktgjykime të humbura, 17 aktgjykime ku është shpallur gjykata jokompetente, 91 padi, 8 revizione etj.

Objektivat

Për ta përmbushur misionin e vet, Ministria e Drejtësisë planifikon të arrijë këto objektiva vijuese strategjike në përputhje me Planin e zhvillimit strategjik 2012-2016:

1. Themelimin dhe promovimin e kornizës ligjore dhe institucionale, në përputhje me prioritetet e nxjerrura nga procesi i integritimit evropian;
2. Fuqizimi i mëtejshëm i sistemit të ndihmës ligjore ndërkombëtare dhe bashkëpunimit;
3. Sigurimi i parakushteve dhe menaxhim më efikas i përmbartimit të dënimeve penale;
4. Zhvillimi dhe ngritja e kapacitetit të forenzikës, gjetja dhe identifikimi i personave të zhdukur gjatë luftës si dhe hetimi i krimeve të luftës dhe
5. Zhvillimi i kapacitetit profesional për detyra dhe përgjegjësi më efikase operative të Ministrisë.

Objektivi i parë ka të bëjë me nevojën e hartimit apo të amendamentimit të disa ligjeve të Kosovës në mënyrë që ato të jenë më shumë të orientuara kah zbatimin dhe/ose të harmonizuara me ligjet e tjera në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së. Realizimi i këtij objekti arrihet përmes dy programeve: Njësia e Politikës Ligjore dhe Departamenti për Integritim Evropian.

Aktivitetet me të cilat parashihet realizimi i kësaj objektive janë:

- Ndryshimi dhe plotësimi i kornizës ekzistuese ligjore, përfshirë përafrimin e legjislacionit me standardet e BE-së;
- Fuqizimi i aftësisë së Ministrisë për hartimin e ligjeve dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore.

Objektivi i dytë ka të bëjë me avancimin e ndihmës ndërkombëtare juridike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar juridik. Realizimi i këtij objekti bëhet përmes programit Departamenti për Bashkëpunim Juridik.

Aktivitetet me të cilat parashihet realizimi i kësaj objektive janë:

- Propozimi i legjislacionit relevant në lidhje me lëminë e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar;
- Sigurimi dhe procedimi i të gjitha kërkesave që kanë të bëjnë me ndihmën juridike ndërkombëtare.

Objektivi i tretë ka për qëllim sigurimin e parakushteve dhe menaxhim më efikas të përmbartimit të dënimeve penale. Realizimi i këtij objekti bëhet përmes programeve

Shërbimet Korrektuese-Burgjet, Shërbimi i Lirimit me Kusht dhe Inspektoriati për Shërbimin Korrektues.

Për të arritur këtë objektiv, MD përfshin aktivitete vijuese:

- Ndërtimi i kapaciteteve të reja të burgut dhe rehabilitimi i objekteve ekzistuese të SHKK-së;
- Zbatimi i masave për ri-socializim të të burgosurve;
- Themelimi i institucioneve të veçanta për të mitur që vuajnë masa institucionale edukative për të mitur, ashtu siç parashihet me Kodin e drejtësisë për të mitur, dhe trajnimin e stafit adekuat;
- Mbikëqyrja e personave të dënuar me masa alternative dhe ata të liruar me kusht;
- Ngritja e vetëdijes të opinionit profesional dhe publik lidhur me zbatimin e masave alternative dhe rolin e SHKK-së;
- Kryerja e inspektimeve të rregullta të pavarura nga Inspektoriati për Shërbimin Korrektues dhe ofrimi i këshillave për menaxhmentin e Ministrisë së Drejtësisë.

Objektivi i katërt ka të bëjë me ekzaminimet mjekoligjore, grumbullimin e provave mbi krimet e luftës dhe kryerjen e hulumtimeve. Realizimi i këtij pikësnyimi bëhet përmes programeve nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi si dhe Institutit për Hulumtime të Krimeve të Luftës.

Për të arritur këtë objektiv përfshihen këto aktivitete:

- Ofrimi i ekzaminimeve mjekoligjore bazuar në standardet ndërkombëtarisht të pranuar;
- Sigurimi i funksionimit të plotë të Institutit për hulumtimin e krimeve të luftës.

Objektivi i pestë ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve profesionale të Ministrisë me qëllim të krijimit të kushteve të domosdoshme për avancimin e reformave ligjore si dhe të sigurimit dhe funksionimit efikas të Ministrisë së Drejtësisë.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Ministria e Drejtësisë	16,230,248	16,514,390	18,115,335	17,029,545	17,029,545	16,767,045
Totali i Programeve	16,230,248	16,514,390	18,115,335	17,029,545	17,029,545	16,767,045
Programi i Shërbimeve të Administratës Qendrore	1,199,074	869,790	874,361	818,626	818,626	818,626
Programi i Njësisë së Politikës Ligjore	149,117	156,277	105,992	99,617	99,617	99,617
Programi i Shërbimit të Lirimit me Kusht	346,948	366,175	539,421	516,873	516,873	516,873

Programi i Shërbimeve Korrektuese - Burgjet	13,275,540	13,877,786	14,581,313	13,832,117	13,832,117	13,569,617
Programi i Agjencisë për Menaxhimin e pasurisë së sekuestruar	188,138	253,205	409,195	371,920	371,920	371,920
Programi i Njësisë Kundër Krimeve Ekonomike	-	-	62,146	59,836	59,836	59,836
Programi i Zyrës për Personat e Zdukur dhe Mjekësi Ligjore	698,564	625,897	894,538	736,750	736,750	736,750
Programi i Departmentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar	106,151	141,049	149,505	139,973	139,973	139,973
Programi i Departamentit për Integritet Evropian	-	40,889	54,634	50,266	50,266	50,266
Programi i Inspektoratit për Hulumtime të Krimeve të Luftës	233,421	131,159	240,724	213,502	213,502	213,502
Programi i Inspektoratit për Shërbimin Korrektues	33,295	52,163	67,085	61,699	61,699	61,699
Programi i Avokatisë Shtetërore	-	-	77,625	74,280	74,280	74,280
Programi i Departamentit për Profesione të Lira	-	-	58,796	54,086	54,086	54,086
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	16,230,248	16,514,390	18,115,335	17,029,545	17,029,545	16,767,045
Nr. i punetoreve	1,869	1,864	1,926	1,926	1,926	1,926
Paga dhe mëditje	9,494,958	9,510,257	9,870,908	9,870,908	9,870,908	9,870,908
Mallra dhe shërbime	4,701,155	5,163,793	5,744,669	4,882,968	4,882,968	4,882,968
Shpenzime komunale	858,186	889,912	827,258	703,169	703,169	703,169
Subvencione dhe transfere	31,698	31,940	50,000	50,000	50,000	50,000
Shpenzime kapitale	1,144,252	918,488	1,622,500	1,522,500	1,522,500	1,260,000
Burimet e Financimit	16,230,248	16,514,390	18,115,335	17,029,545	17,029,545	17,029,545
Grantet qeveritare	16,227,098	16,478,391	18,067,135	16,981,345	16,981,345	16,718,845
Te hyrat vetanake	3,150	35,998	48,200	48,200	48,200	48,200

Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

Tabela2. Përmbledhje e Informatave Kyçe të Performancës

	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Programi Shërbimi për Denime Alternative –Shërbimi Sprovues						
Numri i stafit	65	65	73	73	73	73
Numri total i masave dhe sanksionimeve alternative që janë ekzekutuar		1216	1000-1200	1000-1200	1000-1200	1000-1200
Numri i personave të liruara me kusht ngaburgjet nën kujdestarinë e SHSK		123	100-150	100-150	100-150	100-150
Programi Shërbimet Korrektuse Burgjet						
Numri i stafit	1605	1626	1626	1626	1626	1626
Numri i të burgosurve		3733	3000-4000	3000-4000	3000-4000	3000-4000
Numri i të burgosurve të liruara		3588	3000-4000	3000-4000	3000-4000	3000-4000
Numri i të burgosurve të transferuar		787	600-800	600-800	600-800	600-800
Programi Agjensioni për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar						
Numri i stafit	17	17	24	24	24	24
Vlera totale e të ardhurave të përgjithshme të konfiskuar dhe të depozitave të sekuestruara në €		Të ardhurat nga asetet e kapura me një shume prej €992.30 dhe depozitave të konfiskimeve e janë më shumë se €86,004.84				
Program Departamenti për Mjekesi Ligjore						
Numri i stafit	65	59	63	63	63	63
Numri i autopsive mjekoligjore të kryera		300	200-300	200-300	200-300	200-300
Numri i ekzamineve të kryera		100	100	100	100	100
Program Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar						
Numri i stafit	16	14	24	24	24	24
Numri i kërkesave të procesuara në lidhje me asistencën ligjore	7009	8778	7000-8750	7000-8750	7000-8750	7000-8750
Program 369 Avokatia Shtetërore						
Numri i stafit			10	10	10	10
Përfaqësimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës – totali i seanceve		1656	1250-1650	1250-1650	1250-1650	1250-1650
Program 370 Departamenti për Profesionet e Lira						

	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Numri i stafit			5	5	5	5
Numri i provimeve të jurisprudencës të mbajtura		2	2	2	2	2
Numri i provimeve të përmbartuesit privat të mbajtur		2	2	2	2	2
Numri i provimeve të administratorit të falimentit të mbajtura		3	3	3	3	3
Numri i rastëve të ndërmjetësimit(<i>shërbim sipas kërkesës; të jipet një numër i përafërt</i>)		769	500-750	500-750	500-750	500-750
<p>Shënim: Është hera e parë që informatat jo-financiare paraqiten në këtë format. Politikat bazë për indikatorët/matjet duhet ende të zhvillohen, gjë e cila nuk është e lehtë të bëhet në fushën e drejtësisë. Përmirësimet e mëtejme priten të bëhen në vitet e ardhshme. Disa iniciativa janë duke u hartuar. Për shembull, Agjencia për Menaxhimin e Aseteve të Konfiskuara dhe të Konfiskuara është duke e përmirësuar databazën e saj. Poashtu, databaza e personave të zhdukur është funksionale, dhe të dhënat janë duke u futur në të. Për disa fusha, informacionet jo-financiare përbëhen nga përshkrime kualitative në vend të matjeve kuantitative.</p>						

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Misioni

Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) ka për mision formulimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, mbrojtjen e interesave të Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, përfaqësimin e Kosovës në vendet e jashtme, ruajtjen dhe mbrojtjen e imuniteteve dhe privilegjeve të misioneve diplomatike dhe personave të cilëve u takojnë ato sipas konventave dhe zakoneve ndërkombëtare, zhvillimin dhe bashkërendimin e politikave në raport me vendet e tjera. Ministria e Punëve të Jashtme promovon dhe mbron politikat nacionale, kulturore e ekonomike të Republikës së Kosovës në botë.

Situata aktuale

MPJ është në proces të konsolidimit të infrastrukturës së saj institucionale. MPJ është duke marrë masat dhe duke krijuar infrastrukturën e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve për shërbimin brenda saj dhe në misionet diplomatike e konsullore jashtë vendit. MPJ aktualisht ka një staf prej 115 personave që punojnë në Ministri dhe 101 të tjerë në misione diplomatike e konsullore. Ministria aktualisht ka nën varësi njëzetë e pesë misione diplomatike, që janë themeluar nga viti 2008 si dhe tetëmbëdhjetë përfaqësi konsullore, duke siguruar kështu një mbulim diplomatik/konsullor me shtrirje në të gjitha kontinente.

Në kuadër të MPJ-së funksionon edhe Akademia Diplomatike, që për mision ka përgatitjen dhe formimin profesional të anëtarëve të personelit në Shërbimin e Jashtëm për nevojat e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Objektivat

Objektivat kryesore të Ministrisë së Punëve të Jashtme se në planin afat-mesëm janë:

1. Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Organizatat Ndërkombëtare;
2. Fuqizimi institucional i MPJ-së dhe shërbimit diplomatik të RKS;
3. Integrimi i Republikës së Kosovës në BE dhe NATO;
4. Konsolidimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës;
5. Avancimi i bashkëpunimit rajonal bilateral dhe ndërtimi i partneritetit strategjik me vende të veçanta.

Objektivi i parë ka për qëllim mbarëvajtjen e procesit të integritit të Republikës së Kosovës në sistemin ndërkombëtar, përfshirë organizatat politiko-ekonomike dhe socio-kulturore ndërkombëtare. Ky prioritet i lartë politik synon avancimin gradual të pozitës së Kosovës në rrafshin multilateral deri në përmbylljen e plotë të procesit. Kjo objektivë është e lidhur ngushtë edhe me prioritetet e dikastereve qeveritare që kanë për synim anëtarësimet/integrimet në mekanizma ndërkombëtar. Për realizimin e këtij objektivi janë të nevojshme të zbatohen këto aktivitete:

- Koordinimi ndërinstitutional;

- Koordinimi dhe lobimi politik me partnerët ndërkombëtarë;
- Pjesëmarrja në takimet shumëpalëshe dhe
- Pagesa e anëtarësimit e cila ndryshon nga lloji dhe rëndësia e organizatës, kuotat participuese të së cilës përcaktohet nga politikat statusore të vet organizatës.

Objektivi i dytë synon fuqizimin e MPJ-së dhe shërbimit diplomatik të RKS-së. Në këtë drejtim është e rëndësishme që aparati i shërbimit diplomatik dhe MPJ-së të jetë në nivelin e duhur për të arritur qëllimet e përcaktuara.

Rrjedhimisht synohet zhvillimi i mëtutjeshëm i Akademisë Diplomatike, e cila parashihet të mbuloj pjesën e ngritjes së kapaciteteve për shërbim të jashtëm. Në kuadër të politikës një shërbim një ministri, përmes politikës së propozuar synohet përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe imazhit ndërkombëtar si dhe avancimit gradual të pozitës së Kosovës në rrafshin e bashkëpunimit diplomatik me shtetet dhe mekanizmat tjerë të politikës ndërkombëtare, ku parashihet hapja e misioneve të reja diplomatike dhe konsullore. Për realizimin e këtij objektivi janë të nevojshme të zbatohen këto aktivitete:

- Hapja e misioneve të reja diplomatike dhe konsullore (Poloni, Malajzi, Kanada, Senegal, Zyrat ndërlidhëse në Rumani dhe Greqi);
- Ngritja e kapaciteteve të shërbimit të jashtëm (Rritja e numrit të diplomatëve në Bruksel, Nju Jork, Uashington, Gjenevë);
- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në kuadër të MPJ-së (Rekrutimi i stafit të ri për departamentet politike dhe administrative) dhe
- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në kuadër të Akademisë Diplomatike.

Objektivi i tretë ka të bëjë me avancimin i Republikës së Kosovës drejt strukturave Euro-Atlantike përmes nënshkrimit dhe implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit si dhe avancimit përmes partneritetit me paqen me NATON është prioritet i lartë i Qeverisë së Kosovës, MPJ-ja ka përgjegjësinë e bashkërendimit të aktiviteteve që sigurojnë drejt zbatimit të kësaj objektive.

Objektivi i katërt ndërlidhet me forcimin e shtetësisë së Kosovës në planin ndërkombëtar. Kjo politikë është prioritet i ri konsoliduar në qasje, qëllim dhe përmbajtje gjithmonë duke marr për bazë aktualitetin politik ndërkombëtar.

Ky prioritet është i lidhur ngushtë me Strategjinë për Njohjen e Plotë Ndërkombëtare të Kosovës, Strategjinë për Diplomaci Publike/Digjitale/Ekonomike, Platformën për Politikë të Jashtme të MPJ-së. Për realizimin e këtij objektivi janë të nevojshme të zbatohen këto aktivitete:

- Sigurimi i njohjeve të reja ndërkombëtare;
- Koordinimi institucional në përfaqësim ndërkombëtar;
- Inicimi i koordinuar i marrëveshjeve bilaterale me interes shtetëror;
- Shtrirja e mëtutjeshme e rrjetit diplomatik në shtetet me fuqi rajonale dhe globale;
- Realizimi i vizitave zyrtare te shtetet jo-njohëse dhe
- Nxitja e aktiviteteve që kanë për synim reflektimin e imazhit real të Republikës së Kosovës.

Objektivi i pestë paraqet avancimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimin e partneritetit strategjik me vende të veçanta, kurse për realizimin e këtij objektivi janë të nevojshme të zbatohen këto aktivitete:

- Promovimi i Republikës së Kosovës në rajon;
- Zbatimi i partneritetit strategjik me Republikën e Shqipërisë, dhe
- Forcimi i bashkëpunimit të gjithanshëm me shtetet e rajonit.

Tabela 1. Historiku dhe Shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Ministria e Punëve të Jashtme	14,589,691	16,331,077	21,426,629	19,511,133	19,511,132	19,510,968
Totali i Programeve	14,589,691	16,331,077	21,426,629	19,511,133	19,511,132	19,510,968
Programi - Administrata Qendrore	1,598,878	1,471,645	2,169,735	1,974,810	1,537,810	1,957,646
Programi - Zyra e Ministrit	521,555	891,574	713,313	620,837	620,837	620,837
Programi - Drejtorati i Drejtorive të Përgjithshme	392,025	399,973	453,897	416,202	416,202	416,202
Programi - Ambasdat	12,077,233	13,288,438	17,670,015	16,175,615	16,612,614	16,175,614
Programi - Akademia Diplomatike	-	279,447	419,669	323,669	323,669	340,669
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	14,589,691	16,331,077	21,426,629	19,511,133	19,511,132	19,510,968
Numri i punëtorëve	191	219	272	272	272	272
Paga dhe mëditje	3,632,948	4,151,610	6,815,491	6,815,490	6,815,490	6,815,490
Mallra dhe shërbime	10,009,750	11,449,597	11,833,444	10,058,428	10,058,427	10,058,427
Shpenzime komunale	360,894	350,560	936,530	796,051	796,051	796,051
Subvencione dhe transfere	46,988	128,487	100,000	100,000	100,000	100,000
Shpenzime kapitale	539,111	250,823	1,741,164	1,741,164	1,741,164	1,741,000
Burimet e Financimit	14,589,691	16,331,077	21,426,629	19,511,133	19,511,132	19,510,968
Grantet qeveritare	14,589,691	16,331,077	21,426,629	19,511,133	19,511,132	19,510,968
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatore	-	483,425	834,468	-	-	-

Përmbledhje e informatave kyçe të performancës

Brenda një harku kohor më pak se gjashtë vjet prej themelimit dhe funksionalizimit të MPJ-së (2008), Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës e kanë shoqëruar dy synime themelore:

- Konsolidimin e shtetësisë së Kosovës në rrafshin ndërkombëtar dhe
 - Konsolidimin e brendshëm të MPJ-së dhe të rrjetit të saj diplomatik e konsullor.
- a) Rezultate të rëndësishme janë shënuar në drejtim të konsolidimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës. Duke qenë se njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Kosovës ka qenë ndër prioritetet më të rëndësishme për vendin, tashmë mbi 106 shtete anëtare të OKB nga të gjitha anët e globit e kanë njohur Republikën e Kosovës.
 - b) Po ashtu, Republika e Kosovës ka forcuar subjektivitetin ndërkombëtar duke nënshkruar një numër të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare (mbi 150 marrëveshje ndërkombëtare të nënshkuara dhe ratifikuara dhe rreth 100 të tjera të iniciuara e të cilat janë në fazën e negociimit dhe në pritje të nënshkrimit).
 - c) Avancimi i mëtejshëm i lidhjeve speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilën përveç bashkërendimit të veprimeve për çështje madhore dhe strategjike, ka vazhduar edhe zbatimi i nismave konkrete të bashkëpunimit dypalësh në aspektin ekonomik, arsimor, kulturor etj.
 - d) Kosova tashmë ndodhet në përmbyllje të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe pritet që në pjesën e parë të 2014 edhe nënshkrimi i saj.
 - e) Për sa i përket anëtarësisë së Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare Republika e Kosovës ka arritur të anëtarësohet në dy institucionet kryesore financiare botërore, FMN dhe Bankën Botërore. Një e arritur shumë e madhe është edhe anëtarësimi i RKS në BERZH dhe Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës. RKS është anëtarësuar edhe në më shumë se 16 organizata dhe nisma rajonale.

MPJ në mënyrë aktive ka qenë nikoqire e organizimit të shumë konferencave dhe aktiviteteve të tjera diplomatike, të cilat kanë pasur për qëllim pasqyrimin e imazhit të vendit, promovimit të vlerave kulturore dhe potencialit ekonomik të Kosovës.

MINISTRIA PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Misioni

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në nivelin strategjik të mbrojtjes së vendit si dhe të ushtrisë funksionet dhe kompetencat në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

MFSK është përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit civil demokratik mbi Forcat e Sigurisë së Kosovës, përfshirë planifikimin, menaxhimin dhe administrimin.

Misioni i MFSK-së është që të formulojë, të zbatojë, të vlerësojë dhe të zhvillojë politikat dhe aktivitetet e Forcave të Sigurisë të Kosovës brenda kornizës së qeverisjes demokratike dhe në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Situata aktuale

Pas deklarimit të kapaciteteve nga ana e Këshillit Veri Atlantik të NATO-s në vitin 2013, Ministria e FSK-së ka vazhduar me zhvillimin e kapaciteteve të plota operationale me qëllim të shfrytëzimit maksimal të kapaciteteve ekzistuese për të garantuar siguri për pronën dhe jetën e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim mbështetja e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës dhe e komunitetit në përgjithësi ka qenë dhe mbetet një prej objektivave strategjike dhe prioriteteve të MFSK-së.

Ministria e FSK-së progresin e zhvillimit të FSK-së e ka vazhduar në: avancimin e personelit (shkollimi brenda dhe jashtë vendit, rekrutimin, gradimet, avancimet, dekoratat); ngritjen e kapaciteteve për operatione reale; krijimin e kompanive model; krijimin e Qendrës së Ekselencës për Kërkim-Shpëtim; thellimin e partneritetit dypalësh dhe nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit me shtete me të cilat ende nuk kemi memorandume të tilla (fuqizimi i partneritetit dypalësh me SHBA-të, vendet e BE-së, vendet e rajonit dhe KFOR-in).

MFSK-ja si institucion i përfshirë në procesin e RSSS-së ka përfunduar analizën në kuadër të RSSS-së dhe ka dalë me rekomandimet për zhvillimin e mëtejshëm të forcave të ardhshme. Rekomandimet kanë nxjerrë konkluzionin që MFSK-ja të shndërrohet në Ministri të Mbrojtjes kurse FSK-ja, në Forca të Armatosura të Kosovës.

Objektivat

Objektivat strategjike u referohen të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të Republikës së Kosovës, prioriteteve të Qeverisë, programit të Qeverisë - pika 2.2 Mbrojtja dhe siguria si dhe dokumenteve strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes.

Analiza e RSSS-së, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia e Mbrojtjes, Libri i Bardhë i Mbrojtjes, Plani i Veprimit për realizimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Plani Afatgjatë i Zhvillimit, Plani i Integruar Afatmesëm - PIAM përcaktojnë rrugën dhe mënyrën se si Forcat e Armatosura të Kosovës do të zhvillohen, modernizohet dhe stërviten për të arritur kapacitetet reale për realizimin e misionit kushtetues.

Për periudhën afatmesme 2015 – 2017 objektivat strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes janë:

1. Zbatimi i rekomandimeve nga procesi i RSSS-së;
2. Bërja e FA të Kosovës forcë profesionale;
3. Bërja e FA të Kosovës forcë e besueshme;
4. Bërja e FA të Kosovës forcë për të mirë në rajon.

Objektivi i parë ka të bëjë me zbatimin e rekomandimeve që dalin nga procesi i RSSS-së. Në këtë drejtim Ministria e Mbrojtjes do të hartojë Strategjinë e Mbrojtjes, Librin e Bardhë të Mbrojtjes, Planin Afatgjatë të Zhvillimit, Planin e Integruar Afatmesëm. Përmes këtyre dokumenteve paraqitet zhvillimi i Forcave të Armatosura të Kosovës me rol, mision dhe madhësi, e cila do të jetë e qëndrueshme, e përballeshme dhe e aftë për të kryer detyrat e reja. Ministria e Mbrojtjes planifikon përtej Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve duke hartuar dokumentet e saj strategjike që parashikojnë zhvillimin e Forcave të Armatosura të Kosovës në 10 vitet në vijim deri në vitin 2024. Forcat e Armatosura të Kosovës do të përbëhen nga më së shumti pesë mijë (5,000) pjesëtarë të personelit ushtarak aktiv dhe më së shumti tre mijë (3,000) pjesëtarë të personelit ushtarak rezervë. Zhvillimi i kësaj force do të bëhet përmes një procesi transparent dhe të hollësishëm të ndarë në tri faza:

- Faza I-rë (2014-2016) - Zhvillimi i kornizës së nevojshme kushtetuese ligjore, institucionale dhe doktrinare për forcë të re. Fokusimi do të jetë në plotësimin me personel, doktrina, trajnime dhe infrastrukturë.
- Faza II-të (2017- 2019) - Theksi i veçantë vendoset në zhvillimin e kapaciteteve të komandës, kontrollit dhe komunikimit; prokurimi i armatimit dhe pajisjeve esenciale; arritja e shkathtësive shtesë dhe e kapaciteteve operacionale.
- Faza III-të (2010-2024) - Kompletimi i rekrutimit të personelit, të trajnimeve dhe pajisjeve për forcën në përmbushje të misionit të saj të ri të mbrojtjes së vendit.

Për objektivin e dytë që është bërja e Forcave të Armatosura të Kosovës, forcë profesionale, Ministria e Mbrojtjes ka planifikuar këto veprime:

- Ngritja e nivelit operacional të Forcave të Armatosura, veçanërisht e strukturave të përcaktuara për angazhim në mbështetje të operacioneve brenda dhe jashtë vendit;
- Profesionalizimi, modernizimi dhe standardizimi i vazhdueshëm i FA të Kosovës;
- Zhvillimi i një force me gatishmëri të lartë e mbështetur nga një logjistikë e integruar, e pajisur plotësisht, e kompletuar me personel, e trajnuar në mënyrë efektive, e vetëqëndrueshme dhe e ndërveprueshme me strukturat e NATO-s;
- Zbatimi i ndryshimeve në politikat dhe strukturën e FA të Kosovës të miratuara nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilat rezultojnë nga rekomandimet e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Për të realizuar **objektivin e tretë** bërja e Forcave të Armatosura të Kosovës, forcë e besueshme, Ministria e Mbrojtjes ka planifikuar këto veprime:

- Forcë me imazh të mirë dhe e gatshme t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve të Republikës së Kosovës;
- Zhvillimi perspektiv i FA të Kosovës në përputhje me misionin, politikat dhe direktivat e qeverisë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes;

- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies ndaj institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj;
- Një forcë me identitet kombëtar dhe partnere e përkushtuar e SHBA-ve, NATO-s dhe BE-së.

Me qëllim të realizimit të **objektivit të katërt** - Bërja e Forcave të Armatosura të Kosovës të Kosovës forcë për të mirë në rajon, Ministria e Mbrojtjes ka planifikuar këto veprime:

- Ngritja e një force për zbarkim jashtë vendit dhe certifikimi i saj nga organizatat përkatëse ndërkombëtare (EU,NATO,OKB etj.);
- Ngritja e bashkëpunimit dhe mirëbesimit në fushën ushtarake dhe të mbrojtjes me shtetet e rajonit dhe më gjerë;
- Angazhimi i FA të Kosovës për anëtarësim në organizmat dhe iniciativat rajonale të sigurisë;
- Pjesëmarrja e FA të Kosovës në angazhimet, trajnimet, stërvitjet e rëndësishme të sigurisë në rajon, NATO dhe më gjerë;
- Funkcionalizimi dhe certifikimi i Qendrës së Ekselencës për Kërkim-Shpëtim Urban.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë dhe politikave të reja 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës	33,008,268	32,351,160	42,038,070	38,045,497	37,985,997	31,752,997
Totali i Programeve	33,008,268	32,351,160	42,038,070	38,045,497	37,985,997	31,752,997
Programi i Shërbimeve të Administratës Qendrore	2,635,959	2,906,804	3,530,332	3,273,837	3,243,837	3,223,837
Programi i Forcës së Sigurisë së Kosovës	30,372,309	29,444,356	38,507,738	34,771,660	34,742,160	28,529,160
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	33,008,268	32,351,160	42,038,070	38,045,497	37,985,997	31,752,997
Nr. i punetoreve	3,008	3,008	3,024	3,024	3,024	3,024
Paga dhe medijtje	14,547,644	14,548,070	16,510,415	16,510,415	16,510,415	16,510,415
Mallra dhe shërbime	7,922,013	8,115,829	9,296,155	7,901,732	7,901,732	7,901,732
Shpenzime komunale	664,124	784,569	851,000	723,350	723,350	723,350
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	9,874,488	8,902,691	15,380,500	12,910,000	12,850,500	6,617,500
Burimet e Financimit	33,008,268	32,351,160	42,038,070	38,045,497	37,985,997	31,752,997
Grantet qeveritare	33,008,268	32,351,160	42,038,070	38,045,497	37,985,997	31,752,997
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-

Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatore	-	-	-	-	-	-
Propozimi i politikës së re : Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë						
Totali				3,000,000	3,000,000	3,000,000
Numri i punëtorëve				300	500	700
Paga dhe medijtje				774,000	1,290,000	1,806,000
Mallra dhe shërbime				520,000	600,000	650,000
Shpenzime komunale				35,000	50,000	50,000
Subvencione dhe transfere						
Shpenzime kapitale				1,671,000	1,060,000	494,000
Burimet e Financimit				3,000,000	3,000,000	3,000,000
Grantet qeveritare				3,000,000	3,000,000	3,000,000
Te hyrat vetanake						
Totali i skenarit bazë dhe politikave të reja				41,045,497	40,985,997	34,752,997
Numri i punëtorëve				3,324	3,524	3,724
Paga dhe medijtje				17,284,415	17,800,415	18,316,415
Mallra dhe shërbime				8,421,732	8,501,732	8,551,732
Shpenzime komunale				758,350	773,350	773,350
Subvencione dhe transfere				-	-	-
Shpenzime kapitale				14,581,000	13,910,500	7,111,500
Burimet e Financimit				41,045,497	40,985,997	34,752,997
Grantet qeveritare				41,045,497	40,985,997	34,752,997
Te hyrat vetanake				-	-	-

Politika e re: Formimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Kosovës (Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë)

Kjo politikë ka të bëjë me ngritjen e nivelit të sigurisë në nivel vendi, ngritjen e kapaciteteve duke u përafëruar me standarde të vendeve të NATO-s e, cila do të hap rrugën e integritimit të Kosovës në strukturat euroatlantike dhe që Kosova të kalojë nga konsumues i sigurisë në kontribuues të sigurisë dhe paqes.

Tabela 2. Indikatorët kyç të performancës

Indikatorët kyç të Performancës		2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Forca e Sigurisë së Kosovës							
Rekrutimi i Personelit		1057 + (1679 nga TMK)	30	182 +(27 transfer nga rezerva)	175 +(341 transfer nga rezerva)	546+ (134 transfer nga rezerva)	590
	Rezerve/540		3	/	/	/	10
	Kadete/45		8	19	20	20	20
	Civ.ne MFSK115		5	2	20	20	20
	Civ.ne FSK/86		8	6	10	10	10
Trajnimet e personelit brenda dhe jashtë vendit		295 trajnime	182 trajnime	200-250	250-300	250-300	250-300
Pajisjet individuale (Veshmbathje, armatimi,thasë fjetjeje,shtretër fushor,rrypa brezi etj.(Milion €)		2,9	2.6	4,4	3.8	4,2	3.1
Pajisjet kolektive (automjete taktike,kamion,minibus,pajisje xhenios) (Milion €)		1.8	0.8	4	10.6	8.9	14
Infrastruktura (Objekte –për komandë,akomodim,kuzhina,sporative,poligone stërvitje,pompa për derivate, garazha, infrastrukturë rrugore etj) (Milion €)		3	5	4.9	5.6	5.7	2.8
Komand Kontroll Komunikim	Radio Taktike Luftarake (CNR)	FSK 52%	FSK 65%	FSK 83%	FAK 29%	FAK 35%	FAK 46%
	Implementimi i projektit në %			FAK 23%			
	Infrastruktura e Rrjetit të TI-së	FSK 56%	FSK 66%	FSK 76%	FAK 70%	FAK 80%	FAK 90%
				FAK 50%			
Shërbimet e rrjetit të TI-së (e-mail, internet, VoIP, VTC, SharePoint, Collaborati on Tool etj.)		10%	30%	50%	65%	78%	85%

	Buxheti total	2.3	1.5	3	4.2	5.4	7
Operacionet e Deminimit (fushata e minuara)		163,567m ²	113,907 m ²	2 fusha te minuara	135 fusha ende te pa pastruara	sipas prioriteteve	sipas prioriteve
Operacionet e EOD		360 intervenime /433 mjete shperthyese	398 intervenime /547 mjete eksplozive	107 intervenime /170 mjete eksplozive	24/7 ne thirrje	24/7 ne thirrje	24/7 ne thirrje
Operacionet Humanitare brenda dhe jashtë vendit		113 operacione	155 operacione	21 operacione	24/7 ne thirrje	24/7 ne thirrje	24/7 ne thirrje
Projekte humanitare të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarake		28	24	5	20 mijë/€	25mijë/€	30mijë /€

Indikatori 1.

Në indikatorin e parë është paraqitur gjendja e personelit civil dhe ushtarak në MFSK dhe FSK për vitet 2012,2013, 2014 dhe planifikimi për vitet vijuese deri në 2017. Në shtojcë gjeni edhe tabelën e personelit të shprehur në përqindje.

Gjendja aktuale e personelit të FSK-së								
Të plotësuara		%	M	%	F	%	Min.	%
Aktiv	2294	91.76%	2080	91.94%	185	8.06%	202	8.97%
Rezervë	449	56%	426	95.00%	23	5.00%	10	2.00%
Civil/MFSK	119	96.00%	82	68.91%	37	31.09%	6	6.50%
Civil/FSK	94	94.00%	79	84.04%	15	15.96%	1	1.06%

Indikatori 2.

Në indikatorin e dytë është paraqitur trajnimi i personelit sipas viteve si në vijim: Në vitin 2012 janë realizuar 208 trajnime jashtë vendit, ndërsa 87 brenda vendit. Në vitin 2013 janë realizuar 87 trajnime brenda vendit, ndërsa 98 trajnime jashtë vendit. Për vitin 2014-2017 parashihen 250 -300 trajnime për çdo vit duke përfshirë trajnimet brenda dhe jashtë vendit.

Indikatori 3.

Në indikatorin e tretë është pasqyruar kompletimi me pajisje personale të personelit ushtarak të FSK-së sipas Top Tabelës Organizative të Pajisjeve, të cilat kanë kontribuar në ngritjen e imazhit si dhe në ngritjen profesionale të pjesëtarëve të FSK-së.

Indikatori 4.

Në indikatorin e katërt është paraqitur realizimi i projekteve në pajisje kolektive, i cili ka rritur efektivitetin dhe operacionalitetin e Forcës, si në ushtrimet fushore ashtu edhe në operacionet e deminimit dhe projektet e ndryshme humanitare, si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit.

Indikatori 5.

Gjatë viteve 2012 - 2014 janë realizuar një mori projektesh në fushën e infrastrukturës si: objekte-akomodimi, kuzhina, pompa të derivateve, fusha sportive, infrastrukturë rrugore, objekte poliklinike, rrethoja sigurie, porta hyrëse, salla sportive, klasë mësimi, servise për automjete, garazhe të cilat kanë përmirësuar standardin dhe kushtet për zhvillimin e FSK-së, bazuar në standardet e NATO-s.

Për vitet 2015-2017 planifikojmë të realizojmë projekte infrastrukturore (objekte akomodimi, Qendra e Ekselencës për Trajnime në Kërkim&Shpëtim, pista të helikopterëve, halla sportive dhe pishina, klasa mësimi, servise për automjete, porta hyrëse, garazhe etj,

Pas rishikimit të RSSS-së dhe vendimit të Qeverisë së Kosovës për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës është e nevojshme që të ndërtohen objekte shtese dhe infrastruktura përcjellëse.

Indikatori 6.

Projektet e realizuara gjatë viteve 2012 -2014 si dhe të planifikuara për vitet 2015-2017 në indikatorin komandë, kontroll, komunikim përfshinë këto fusha: radiolidhje taktike, rrjeti i teknologjisë informative, rrjeti optik lokal, sistemi i telekonferencës (VTC), sistemi i telefonisë IP (VOIP), rrjeti strategjik i komunikimit, softueri dhe licencat për rrjetin e IT, projekti i DRS për rrjetin e IT, projekti i sistemit të kriptombrojtjes (COMSEC&INFOSEC), projekti i furnizimit me nyje mobile të komunikimit.

Indikatori 7.

Operacionet e Deminimit për vitet 2012-2014 janë realizuar në këto lokacione: Harilaq, Ferizaj, Belincë, Hajvali, Koshare, Doberqan, Parku i Lirisë në Ferizaj, Luzhnicë, Gorancë, Nivokaz, Ferizaj, të cilat kanë ndikuar në rritjen e sigurisë së qytetarëve të Kosovës. Gjatë viteve në vazhdim Forcat e Armatosura do të jenë në gjendje gatishmërie për të çminuar të gjitha fushat e minuara të përcaktuara nga ekspertët e FA të Kosovës.

Indikatori 8.

Operacionet e EOD-së FSK-ja i ka zhvilluar në bazë të thirrjeve të qytetarëve të Kosovës numri i të cilave është prezantuar në tabelën më lart.

Indikatori 9.

Operacionet humanitare të FSK-së brenda dhe jashtë vendit janë zhvilluar gjatë viteve 2012-2014 në fushat e kërkim&shpëtimit, shuarjen e zjarreve, mjeteve kimike-atomike- biologjike, mjekësi, operacione të xhenios në zhbllokimin e rrugëve, vlerësimin e rreziqeve si dhe zbarkimi jashtë vendit në Shqipëri në dy operacione të kërkim&shpëtimit në ujëra. Në vitet në vazhdimi FA të Kosovës do të vazhdojnë të realizojnë operacione humanitare.

Indikatori 10.

Gjatë viteve 2012-2014 FSK-ja ka realizuar një sërë projektesh humanitare në këto fusha: asistencë mjekësore për komunitetet në lokacionet ku ata banojnë, mbajtja e ligjëratave në shkollat e ciklit të ulët dhe të mesëm për vetëdijesimin nga minat, mbështetje në rregullimin e infrastrukturës rrugore në pjesë të ndryshme të Kosovës, vendosja e urave lëvizëse, pastrimin e lumenjve, organizimin e kampeve verore për të rinj, mbështetje të OJQ-ve, mbështetje me transport për njerëzit me aftësi të kufizuara, mbështetje të institucioneve qendrore dhe lokale me pajisje dhe transport për realizimin e projekteve të tyre humanitare.

MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN

Misioni

Ministria e Integrimit Evropian (MIE) ka për mision drejtimin, bashkërendimin dhe monitorimin e procesit të integrimit të plotë të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, duke siguruar hartimin e politikave dhe legjislacionit vendor në pajtim me legjislacionin e BE-së, koordinimin e dialogut dhe negociatave për anëtarësimin, koordinimin e ndihmës financiare, informimin e publikut dhe ngritjen e kapaciteteve.

Situata aktuale

Gjatë vitit 2013 është shënuar progres drejt përbushjes së dy objektivave kryesore në kuadër të procesit të integrimit evropian të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe liberalizimit të vizave.

Komisioni Evropian publikoj raportin monitorues për zbatimin e kriterëve afatshkurta dhe konfirmoj që Kosova ka përbushur të gjitha kriteret afatshkurta për nisjen e negociatave për MSA, si dhe Samiti Evropian mori vendim për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Komisioni Evropian dorëzoi raportin e parë të progresit për përbushjen e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Duke u bazuar në rekomandimet e këtij raporti, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Planin e Veprimit për Liberalizimin e Vizave.

Kosova është anëtarësuar në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës, Kosova ka nënshkruar marrëveshjen kornize me Bankën Evropiane për Investime.

Ministria e Integrimit Evropian, gjatë vitit 2013 ka koordinuar 8 takimet e Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit (DPSA) me Komisionin Evropian, respektivisht: DPSA për Drejtësi, Liri dhe Siguri, Bujqësi, Peshkatari, Pylltari dhe Siguri Ushqimore, Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal, Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime, Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e shëndetit të Konsumatorit, Inovacionin, Kohezionin Social dhe Shoqërinë Informativë, Ekonomi, Çështje Financiare dhe Statistika, Bashkëpunim Rajonal.

MIE ka dorëzuar inputin e parë për Raportin e Progresit për periudhën shtator 2012 – maj 2013 dhe po ashtu ka dorëzuar inputin e dytë të përditësuar i cili mbulon periudhën maj – shtator 2013.

Qeveria e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për koordinimin e donacioneve me Luksemburgun dhe Programin Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara si dhe ka miratuar vendimin për fillimin e procedurave të anëtarësimit të Kosovës në Open Government Partnership.

Gjatë vitit 2013 është miratuar legjislacioni i nevojshëm për fillimin e përdorimit të tabelave të pajtueshmërisë të legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e BE-së, ky është hapi i parë drejt krijimit të një fundamenti të qëndrueshëm të përafrimit të legjislacionit tonë me acquis.

Me qëllim të integritit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është mbajtur edhe konferenca e nivelit të lartë për këtë çështje.

Objektivat

1. Menaxhimi i agjendës evropiane;
2. Koordinimi i strukturave qeveritare për integrim evropian;
3. Koordinimi i asistencës financiare;
4. Përafrimi i legjislacionit dhe koordinimi i përkthimit.

Objektivi i parë synon të siguroj menaxhimin e efektshëm të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, i cili përfshin të gjithë sektorët dhe fushat e politikave publike dhe të gjitha institucionet publike të vendit. Më konkretisht, ky objektivi përmban tre komponentë: Dialogun e Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA-në) me BE-në, Koordinimin e përmbushjes së objektivave dhe masave të dakorduara me BE-në në kuadër të DPSA-së dhe Procesin e liberalizimit të vizave. Aktivitetet të cilat do t'i ndërmarrë Ministria e Integritit Evropian për realizimin e këtij objektivi janë si në vijim:

- Organizimi i një mbledhjeje vjetore Plenare (të nivelit politik) të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së;
- Hartimi dhe përditësimi i Planit të Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (PVMSA) si dhe Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e PVMSA-së;
- Raportimi i rregullt në Komisionin Evropian mbi zbatimin e PVMSA-së, konkluzioneve të mbledhjeve të DPSA-së dhe dokumenteve të tjera relevante;
- Organizimi i mbledhjeve të Komitetit Drejtues për Liberalizimin e Vizave (KDLV) si dhe hartimi i konkluzioneve të mbledhjeve të këtij Komiteti dhe të nëngrupeve punuese për liberalizimin e vizave në kuadër të Grupit Punues për Liberalizimin e Vizave (GPLV).

Objektivi i dytë synon të siguroj koordinimin e efektshëm të strukturave ndër-institucionale të Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilat janë përgjegjëse për integrim evropian dhe monitorimin e punës së tyre. Meqë këto struktura përfshijnë të gjitha institucionet publike të vendit, ngjashëm me të parin, ky objektivi përmban vetëm një komponent, atë të strukturave përgjegjëse për integrim evropian, të cilat pasqyrojnë ato që merren me Dialogun e Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA). Aktivitetet të cilat do t'i ndërmarrë Ministria e Integritit Evropian për realizimin e këtij objektivi janë si në vijim:

- Organizimi i mbledhjeve mujore të shtatë Komisioneve Ekzekutive për Integrim Evropian (KEIE): KEIE për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime; KEIE për Infrastrukturë, KEIE për Treg të Brendshëm, KEIE për Inovacion dhe Kohezion Social, KEIE për Qeverisje, KEIE për Ekonomi, Kontroll Financiar dhe Statistika dhe KEIE për Bujqësi dhe Peshkatari;

- Koordinimi i hartimit të konkluzioneve të mbledhjeve të Komisioneve Ekzekutive për Integrim Evropian (KEIE) dhe monitorimi i zbatimit të tyre;
- Hartimi i konkluzioneve të mbledhjeve të Komitetit Punues për Integrim Evropian (KPIE) dhe Këshillit Ministror për Integrim Evropian (KMIE);
- Monitorimi dhe raportimi mbi punën e Komisioneve Ekzekutive për Integrim Evropian, Komitetit Punues për Integrim Evropian (KPIE), dhe Këshillit Ministror për Integrim Evropian (KMIE).

Objektivi i tretë synon të siguroj koordinimin e efektshëm të asistencës financiare të BE-së dhe të donatorëve të tjerë që përfshinë të gjithë sektorët e politikave publike të institucioneve vendore dhe të gjithë donatorët që veprojnë në vend. Ky objektivi përmban dy komponentë: Asistencën e BE-së dhe Asistencën nga donatorët bilateral.

Aktivitetet të cilat do t'i ndërmarrë Ministria e Integrit Evropian për realizimin e këtij objektivi janë si në vijim:

- Koordinimi i hartimit të Dokumentit Strategjik Nacional (DSN) 2014–2020 për Instrumentin e Asistencës së Para-aderimit (IPA) dhe i rishikimit të tij, në baza vjetore;
- Monitorimi i rregullt i implementimit të projekteve IPA Nacionale si dhe organizimi i mbledhjeve të rregullta vjetore të Komitetit të Përbashkët për Monitorim (KPM/JMC) për IPA;
- Identifikimi i nevojave si dhe inicimi dhe zhvillimi në bashkëpunim me institucionet e linjës i aplikacioneve për instrumentin e Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informatave;
- Përfshirja në identifikimin e nevojave, si dhe inicimin dhe zhvillimin e programeve të asistencës nga burime dhe instrumente sektoriale dhe të tjera;
- Koordinimi dhe monitorimi i rregullt i donacioneve të jashtme (përmes përditësimit të të dhënave në Platformën për Menaxhimin e Ndihmës së Jashtme (AMP), hartimit dhe publikimit të raporteve tremujore mbi shpenzimet e donatorëve nga AMP, verifikimit/validimit të të dhënave në AMP dhe organizimit të misioneve për vlerësimin e AMP-së;

Objektivi i katërt synon të siguroj koordinimin e procesit të përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së. Kjo përfshin të gjithë sektorët dhe fushat e politikave publike dhe të gjitha institucionet publike të vendit. Më konkretisht, ky objektivi përmban dy komponentë: Koordinimin e përafrimit të legjislacionit vendor me Acquis-në e BE-së dhe Koordinimin e përkthimit të Acquis-së së BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës.

Aktivitetet të cilat do t'i ndërmarrë Ministria e Integrit Evropian për realizimin e këtij objektivi janë si në vijim:

- Kontrollimi i pajtueshmërisë së të gjitha projektligjeve të hartuara nga institucionet e Kosovës me Acquis-në e BE-së përmes hartimit të Tabelave të Pajtueshmërisë dhe Deklaratave të Pajtueshmërisë për secilin projektligj;
- Koordinimi i përkthimit të Acquis-së së BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës përmes identifikimit të akteve përkatëse, vlerësimit të nevojave dhe vëllimit të punës dhe planifikimit të këtij procesi;
- Ngritja e kapaciteteve të MIE-së dhe institucioneve të linjës për përafrimin e legjislacionit vendor me Acquis-në e BE-së dhe përkthimin e Acquis-së së BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës.

Tabela 1. Historiku dhe Shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Ministria e Integrimiëve Evropiane	1,468,342	1,670,397	1,896,430	1,703,856	1,572,140	1,572,140
Totali i Programeve	1,468,342	1,670,397	1,896,430	1,703,856	1,572,140	1,572,140
Shërbimet e Administratës	1,468,342	1,670,397	1,896,430	1,703,856	1,572,140	1,572,140
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	1,468,342	1,670,397	1,896,430	1,703,856	1,572,140	1,572,140
Nr. i punëtorëve	76	77	85	85	85	85
Paga dhe mëditje	499,459	528,351	562,603	562,603	562,603	562,603
Mallra dhe shërbime	807,192	1,003,427	1,253,827	1,065,753	934,037	934,037
Shpenzime komunale	12,714	6,309	30,000	25,500	25,500	25,500
Subvencione dhe transfere	148,978	132,310	50,000	50,000	50,000	50,000
Shpenzime kapitale						
Burimet e Financimit	1,468,342	1,670,397	1,896,430	1,703,856	1,572,140	1,572,140
Grantet qeveritare	1,468,342	1,670,397	1,896,430	1,703,856	1,572,140	1,572,140
Të hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet						
Grantet donatoret						

MINISTRIA E DIASPORËS

Misioni

Ministria e Diasporës (MD) është përgjegjëse t'i krijojë, t'i zhvillojë dhe t'i mbajë lidhjet e gjithanshme institucionale ndërmjet Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës së saj, si dhe me organizatat dhe shoqatat e tyre. Misioni i MD-së është afrimi i diasporës me Kosovën, mbajtja e lidhjeve sa më të forta me të, mbështetja për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, kulturor e gjuhësor, si dhe rritja e pjesëmarrjes së diasporës dhe mërgatës në zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës.

Situata aktuale

Republika e Kosovës ka një diasporë të madhe ku supozohet se mes 800 mijë deri në 1 milion banorë ose 1/3 e popullsisë së saj jeton jashtë vendit. Bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës në T/4 për vitin 2013 rreth 620.8 milionë euro ishin remitancat vjetore nga diaspora dhe mërgata.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018. Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën është dokumenti i parë strategjik i Qeverisë së Kosovës, nëpërmjet të cilit me veprime konkrete synohet të sigurohen avancimi i të drejtave politike e sociale të diasporës, ruajtja e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës, shmangia e asimilimit, ndihma për integrimin në vendet ku jetojnë dhe lehtësi maksimale ligjore e administrative për ata që duan ta ndihmojnë zhvillimin ekonomik të atdheut të tyre.

Këtë vit janë bërë hapa konkretë për krijimin e urave lidhëse mes pjesëtarëve të diasporës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, por edhe për krijimin dhe forcimin e lidhjeve brenda vetë diasporës, si p.sh. krijimi i Rrjetit të Grave në Biznes, Rrjetëzimi i Bizneseve të Diasporës, Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptarë në Mërgatë, etj.

Në Turqi është bërë hapja e Qendrës së parë Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën (QKKDM), janë themeluar qendra të tilla edhe në Zvicër, Gjermani, Francë, Austri, Suedi dhe SHBA. QKKDM-të në Turqi dhe Zvicër janë funksionale, ndërsa të tjera priten të funksionalizohen së shpejti.

Është aprovuar Rregullorja për hartimin e Regjistrit të mërgimtarëve, shoqatave dhe formave të tjera të organizimit të tyre. MD-ja e ka përgatitur gjithë materialin përkatës dhe ka filluar procesin e hartimit të Regjistrit të Diasporës e Mërgatës dhe i shoqatave e formave të tjera të organizimit të mërgimtarëve.

Ministria e Diasporës i ka pajisur me literaturë të nevojshme shkollat me mësim plotësues dhe bibliotekat në të gjitha vendet ku jeton dhe vepron mërgata jonë. Si çdo vit, edhe këtë vit, Ministria e Diasporës, në bashkëpunim me komunat e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare, i ka organizuar "Ditët e Diasporës", manifestim ky që ka për qëllim t'u ofrojë bashkatdhetarëve tanë (për pushimet verore) mundësi për t'u njohur më shumë me artin, kulturën dhe arsimin shqip.

Ndër prioritetet e Ministrisë së Diasporës është tërheqja e investimeve nga diaspora në Kosovë. Në këtë kuadër janë organizuar një numër i madh i konferencave, të cilat kanë pasur për qëllim t'i sensibilizojnë dhe t'i informojnë bashkatdhetarët tanë për mundësitë që Kosova

u ofron për të investuar, si dhe për benefitet që do t'u sillte ky investim. Në këtë aspekt, ndihmë të madhe kemi pasur edhe nga organizatat ndërkombëtare, konkretisht nga IOM-i dhe UNDP-ja, të cilat me metoda të ndryshme kanë mbështetur çdo aktivitet të Ministrisë që ka pasur për qëllim tërheqjen e investimeve.

Objektivat

Për periudhën afatmesme 2015-2017, MD-ja planifikon t'i realizojë këto objektiva:

1. Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës;
2. Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me diasporën;
3. Mbështetje për integrimin e diasporës në vendet pritëse;
4. Përfshirja e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik.

Objektivi i parë synon ta përmirësojë pozitën e pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës nëpërmjet fuqizimit të pjesëmarrjes së tyre në proceset politike dhe sociale në Kosovë. Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

- Themelimi i komisionit parlamentar për diasporën dhe mërgatën në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Krijimi i Kuvendit të Përgjithshëm të Diasporës dhe Mërgatës si dhe kuvendeve në shtetet përkatëse ku jeton dhe vepron diaspora dhe mërgata;
- Regjistri i Diasporës dhe Mërgatës si dhe formave të tjera të organizimit të mërgimtarëve;
- Krijimi i lehtësive për qasjen në shërbimet administrative të Kosovës për pjesëtarët e diasporës dhe mërgatës.

Objektivi i dytë synon përfshirjen e një numri sa më të madh të nxënësve me origjinë nga Kosova dhe trevat e tjera shqiptare në procesin e mësimin plotësues në vendet ku jetojnë. Të sensibilizohen mërgimtarët për rëndësinë që ka mësimi plotësues për ruajtjen e identitetit gjuhësor e kulturor dhe mundësitë që krijon për integrimin e tyre në shoqëritë ku jetojnë. Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

- Aprovimi dhe realizimi i projekt-programit të përbashkët për zhvillimin e mësimin plotësues në diasporë dhe mërgatë;
- Sigurimi i librave dhe i mjeteve të tjera mësimore, organizimi i shkollave verore dhe dimërore, organizimi i kuizeve të diturisë, organizimi i ekskursioneve mësimore në atdhe, botimi i revistave dhe publikimeve të tjera për fëmijë, organizimi i trajnimeve dhe seminareve për mësuesit e mësimin plotësues;
- Mbështetja për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, letrare, artistike, etj, në funksion të ruajtjes dhe të kultivimit të kulturës dhe traditës së vendit të origjinës, promovimi i vlerave kulturore dhe artistike të pjesëtarëve të diasporës dhe prezantimi para opinionit kulturor të vendit ku jetojnë, duke e bërë kulturën tonë pjesë të multikulturalizmit në vendet ku jetojnë;
- Grumbullimi i ekspoziteve me vlerë muzeore dhe i dokumenteve arkivore të pjesëtarëve të diasporës, të cilat tregojnë historinë dhe kontributin e mërgimtarëve.

Objektivi i tretë synon mbështetjen e MD-së për integrimin e pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës në shtetet ku jetojnë dhe veprojnë. Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

- Themelimi i Qendrave Kulturore të Kosovës për diasporën dhe mërgatën në vendet me interes për diasporën e mërgatën dhe për Republikën e Kosovës;
- Mbështetja në organizimin e pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës nëpër shoqata dhe forma të tjera organizative;
- Bashkëpunimi ndërmjet tyre nëpërmjet rrjetëzimit të shoqatave dhe formave të tjera të organizimit;
- Lehtësi në parashtrimin e nevojave të tyre para autoriteteve shtetërore ku ata jetojnë;
- Promovimi i të drejtave dhe i obligimeve të diasporës dhe mërgatës në vendet ku jetojnë dhe veprojnë, ngritja e vetëdijes nëpërmjet fushatave vetëdijesuese, promovimi i shembujve të suksesit nga radha e personaliteteve të shquara të diasporës dhe mërgatës.

Objektivi i katërt synon krijimin e lehtësive të nevojshme për investimin e kapitalit të diasporës në Kosovë, si dhe motivimin e investimeve të huaja direkte, fuqizimin e pjesëmarrjes së tyre në zhvillimin socio-ekonomik. Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

- Organizimi i konferencave, forumeve, panairove dhe organizimeve të ngjashme për promovimin e investimeve të diasporës në Kosovë;
- Funksionalizimi i rrjeteve të bizneseve të diasporës dhe mërgatës;
- Inkurajimi i diasporës për pjesëmarrje në projektet e partneritetit publiko- privat;
- Përfshirja e bizneseve nga diaspora në zonat ekonomike, parqet e biznesit, parqet teknologjike dhe inkubatorët e biznesit;
- Identifikimi dhe angazhimi i profesionistëve të profileve të ndryshme që të angazhohen në programet e ndryshme zhvillimore.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Ministria e Diasporës	1,263,805	1,463,264	3,986,206	1,796,199	1,637,019	1,637,019
Totali i Programeve	1,263,805	1,463,264	3,986,206	1,796,199	1,637,019	1,637,019
Shërbimet e Administratës	1,263,805	1,463,264	3,986,206	1,796,199	1,637,019	1,637,019
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	1,263,805	1,463,264	3,986,206	1,796,199	1,637,019	1,637,019
Nr. i punëtorëve	55	52	66	66	66	66
Paga dhe mëditje	297,569	307,060	413,460	413,460	413,460	413,460
Mallra dhe shërbime	679,007	988,135	3,412,746	1,227,239	1,068,059	1,068,059
Shpenzime komunale	10,397	8,106	30,000	25,500	25,500	25,500
Subvencione dhe transfere	129,924	147,528	130,000	130,000	130,000	130,000
Shpenzime kapitale	146,908	12,435	-	-	-	-
Burimet e Financimit	1,263,805	1,463,264	3,986,206	1,796,199	1,637,019	1,637,019
Grantet qeveritare	1,263,805	1,463,264	3,986,206	1,796,199	1,637,019	1,637,019
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet e donatoreve	-	-	-	-	-	-

KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Misioni

Misioni i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), është zbatimi i Ligjit për Prokurim Publik (LPP), i cili si qëllim parësor ka që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, dhe organet publike, që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen në aktivitetet e prokurimit.

Situata aktuale

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, vazhdon ta mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të LPP-së, dhe rregullave të nxjerra nga KRPP-ja sipas autorizimit të ligjit. Për këtë qëllim, KRPP-ja përgatit dhe zbaton një metodologji dhe mekanizëm të përshtatshëm raportimi të mbështetur nga sistemi elektronik i menaxhimit të informacionit.

Është bërë avancimi dhe disenjimi i web-faqes së KRPP-së me rubrika të reja dhe futja e informacioneve në të tri gjuhët e parapara sipas LPP-së, po ashtu publikimin e të gjitha njoftimeve dhe informative që kanë të bëjnë me prokurimin publik.

KRPP-ja ka bërë përgatitjen e raportit vjetore që kërkohet nga LPP-ja, në mënyrë që të jepet një vlerësim i përgjithshëm dhe i saktë i gjendjes së sistemit kombëtar të prokurimit si dhe vlerësim të veçantë të shkallës së përputhjes/mospërputhjes nga autoritetet individuale kontraktuese.

KRPP-ja vazhdon ta mbështesë Institutin Kosovar për Administratë Publike, dhe autoritetet tjera të trajnimit dhe arsimimit për të siguruar ngritjen e profesionalizimit në prokurim publik. KRPP-ja është duke u marr me përgatitjet për fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, si dhe implementimin me sukses të këtij projekti në vitin 2015.

Objektivat

Për të realizuar misionin e saj, KRPP-ja në periudhën afatmesme planifikon të realizoj këto objektiva:

1. Rritja e qasjes në informacione lidhur me tenderët publik dhe në përgjithësi me Prokurimin Publik (PP),
2. Avancimin e sistemit ekzistues të prokurimit publik, në pajtueshmëri me kërkesat që dalin nga Direktivat e Prokurimit Publik të Komisionit Evropian,
3. Krijimin e një kornizë institucionale moderne dhe transparente të LPP-së në pajtim me legjislacionin e BE-së,

4. Aftësimi i një numri sa më të madh të zyrtarëve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese si dhe personelit të KRPP-së për trajner në lëmin e prokurimit publik.

Objektivi i parë synon të rrisë qasjen në informacione lidhur me tenderët publik dhe në përgjithësi me prokurimin publik. Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

- Fillimi i zbatimit të prokurimit elektronik, si dhe implementimi me sukses i këtij projekti;
- Avancimi dhe disenjimi i web-faqes së KRPP-së me rubrika të reja dhe futja e informacioneve në të tri gjuhët e parapara sipas LPP-së;
- Publikimin e të gjitha njoftimeve dhe informative që kanë të bëjnë me prokurimin publik;
- Grumbullimi i raporteve vjetore mbi kontratat e nënshkruara publike nga të gjitha autoritetet kontraktuese në Kosovë, si dhe hartimi i raportit të konsoliduar vjetor përmbledhës;
- Pavarësimi i rrjetit dhe hostingut të web-faqes së KRPP-së.

Objektivi i dytë synon avancimin e sistemit ekzistues të prokurimit publik, në pajtueshmëri me kërkesat që dalin nga Direktivat e Prokurimit Publik të Komisionit Evropian. Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

- Avancimi i sistemit të prokurimit publik në Kosovë përmes mbikëqyrjes së zbatimit të LPP-së, përmes aktiviteteve të mbikëqyrjes dhe monitorimit;
- Matja e Pajtueshmërisë dhe Monitorimi i Performancës së Entiteteve dhe Stafit të Prokurimit në pajtim me Sistemin e Prokurimit Publik në Kosovë;
- Identifikimi i përparësive dhe dobësive në zbatimin të LPP-së dhe të rregullave të prokurimit të aprovuara nga KRPP-ja;
- Ngritja e vetëdijes dhe përgjegjësisë së zyrtarëve të prokurimit dhe të atyre që janë të involvuar në procesin e prokurimit përmes takimeve të drejtpërdrejta, këshillave dhe dhënies së rekomandimeve duke u mbështetur në gjetjet e konstatuara nga aktivitetet e mbikëqyrjes dhe të monitorimit;
- Dhënia e rekomandimeve dhe sugjerimeve autoriteteve kontraktuese zbatimin e drejtë të LPP-së dhe legjislacionit dytësor mbi prokurimin;
- Identifikimi i vështirësive me të cilat ballafaqohen autoritetet kontraktuese gjatë implementimit të aktiviteteve të prokurimit.

Objektivi i tretë synon krijimin e një kornizë institucionale moderne dhe transparente të LPP-së në pajtim me legjislacionin e BE-së. Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

- Përpilimi i rregullave dhe komplet legjislacionit dytësor mbi prokurimin publik sipas kërkesave të ligjit;
- Ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit dytësor të aprovuar sipas nevojave, si dhe nxjerrja e Udhëzimeve Administrative për çështjet që nuk janë të precizuara në ligj;
- Përcjellja e zbatimit të ligjit, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e ligjit;
- Dhënia e ndihmës profesionale autoriteteve kontraktuese në nivelin e pushtetit lokal dhe qendror me qëllim të efektivitetit dhe azhuritetit të sistemit të prokurimit në përgjithësi;

- Avancimi i mëtutjeshëm i tavolinës ndihmese në kuadër të Departamentit të Rregullave të KRPP-së.

Objektivi i katërt synon aftësimin e një numri sa më të madh të zyrtarëve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese si dhe personelit të KRPP-së për trajner në lëmin e prokurimit publik. Aktivitetet për realizimin e këtij objektivi janë:

- Mbështetja e Institutit Kosovar për Administratë Publike, dhe autoriteteve tjera të trajnimit dhe arsimimit për të siguruar ngritjen e profesionalizmit në prokurim publik;
- Azhurnimi dhe përsosja e vazhdueshme e moduleve të trajnimit nga fusha e prokurimit publik;
- Aftësimi i një numri sa me të madh të zyrtarëve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese si dhe personelit të KRPP-së për trajner në lëmin e prokurimit publik;
- Përfshirja e një numri sa me të madh të zyrtarëve të prokurimit, auditorëve të brendshëm dhe zyrtarëve të financave në trajnime;
- Ngritja e kompetencës së trajnuesve si dhe përmirësimi i cilësisë së programit trajnues;
- Ngritja e vetëdijes së publikut për prokurimin publik përmes seminareve, komunikimeve, debateve publike, broshurave, etj.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	310,197	287,550	1,426,367	878,021	328,021	328,021
Totali i Programeve	310,197	287,550	1,426,367	878,021	328,021	328,021
Shërbimet e Administratës	310,197	287,550	1,426,367	878,021	328,021	328,021
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	310,197	287,550	1,426,367	878,021	328,021	328,021
Nr. i punëtorëve	27	29	33	33	33	33
Paga dhe mëditje	166,771	168,673	202,611	202,611	202,611	202,611
Mallra dhe shërbime	129,549	109,411	1,203,556	667,210	117,210	117,210
Shpenzime komunale	13,877	9,466	20,200	8,200	8,200	8,200
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Burimet e Financimit	310,197	287,550	1,426,367	878,021	328,021	328,021
Grantet qeveritare	310,197	287,550	350,482	328,021	328,021	328,021
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	1,075,885	550,000	-	-
Grantet donatoret	-	-	68,500	33,262	-	-

Përmbledhje e Informatave Kyçe të Performancës

Informatave Kyçe të Performancës së KRPP -së	2012 Aktual	2013 Aktual	2014 Buxheti	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Numri i prokurimeve të monitorimit të AK.	24	35	42	45	58	64
Numri i monitorimit të menaxhimit të kontatave të AK	11	20	25	35	42	50
Numri i publikimeve dhe interpretimeve me shkrim, si dhe ndihmë teknike dhe këshilla për zbatimin e dispozitave të LPP-së	1,400	1,475	1,500	1,600	1,800	1,880
Numri i Publikimi të aktiviteteve të prokurimit;	13,300	14,200	15,500	16,200	17,800	18,600
Numri i zyrtarve të trajnuar në PP	489	560	620	660	730	750

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE ARTEVE TË KOSOVËS

Misioni

Misioni i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) është organizimi, zhvillimi, nxitja dhe bashkërenditja e veprimtarisë shkencore dhe e krijimtarisë artistike në seksione, në bërthama të studimit, në njësi shkencore dhe artistike dhe në qendra studimore dhe hulumtuese.

Situata aktuale

Akademia e Shkencës dhe Arteve të Kosovës gjatë vitit 2013 ka punuar në këto projekte: Fjalori Enciklopedik i Kosovës (projekt afatmesëm), janë mbajtur takimet e parapara të Këshillit Ndërkademiq për gjuhën shqipe (projekt afatgjatë), është punuar projekti afatgjatë Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX, përgatitja e veprës së plotë e Norbert Joklit ka përfunduar dhe gjatë vitit 2014 pritet botimi i saj. Projektet Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe Shqipërisë dhe Ndikimi i mbitensioneve atmosferike në sistemet elektroenergjetike të Kosovës vazhdojnë me punë, ndërsa te projekti Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre, ka përfunduar faza e parë. Sa i përket projektit Inventarizimi i virozëve dhe shëndetësimi i materialit të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri, ka përfunduar.

Po ashtu janë botuar këto vepra: Monografia Kosova-versioni anglisht, Vepra e Plotë e Ali Podrimjes, ndikimi i Anglishtes në Gjuhën Shqipe, Utopia Letrare, Të menduarit dhe të Shkruarit Juridik, Lugina e Preshevës, Uvertura Solemne, Tahir Emra-Monografi, Revistat Studime 19, Kërkime 20 si dhe Vjetari 2012.

Janë organizuar një varg aktivitetesh të parapara me programin e punës, si: Konferenca Shkencore Energjetika dhe Mjedisi për Zhvillim të Qëndrueshëm, si dhe tryezat shkencore: Letërsia Shqipe në Shkrimet Enciklopedike, Depërtimi dhe Përshtatja e Huazimeve Angleze në Gjuhën Shqipe, Punësimi në kontekstin zhvillimor dhe integruet të Kosovës.

Njëherit gjatë vitit janë mbajtur edhe Ligjërata inauguruese të anëtarëve të rinj të Akademisë. Nga fillimi i vitit 2014 e deri më tani është botuar Fjalësi i Zërave të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës si dhe janë përgatitur për botim veprat: Ndarja Administrativo-Territoriale e Kosovës 1944-2010, Kërkime dhe studime arkeologjike 2000-2012, Vepra Korale si dhe Revista Studime nr.20. Deri në fund të vitit parashihet botimi i veprave që janë pjesë e programit të punës për vitin 2014.

Buxheti i Akademisë ka shënuar rritje, falë kësaj rritje janë realizuar me sukses punët e parapara rreth Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, në kuadër të projektit Enciklopedia e Kosovës.

Objektivat

Në kuadër të misionit të saj Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës në periudhën afatmesme planifikon të realizojë këto objektiva:

1. Realizimi i projektit Fjalori Enciklopedik në kuadër të projektit Enciklopedia e Kosovës, (projekt afatgjatë);
2. Veprimtaria botuese e Akademisë (botimi i rezultateve të studimeve shkencore);
3. Veprimtaria afatgjate e Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe (në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë).

Objektivi i parë synon zhvillimin e projektit Fjalori Enciklopedik në kuadër të projektit Enciklopedia e Kosovës (projekt afatgjatë). Gjatë vitit 2013 ka përfunduar Fjalësi i zërave dhe është finalizuar faza e parë e këtij projekti. Fjalësi përfundimtar i Fjalorit Enciklopedik të Kosovës përfshin rreth 5900 zëra. Realizimi i këtij objektivi në programin e Akademisë planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Hartimi i zërave të Fjalorit Enciklopedik (rreth 5900 zëra);
- Pajisjen në vazhdimësi me mjete pune të Qendrës Leksikografike Enciklopedike (brenda së cilës është duke u realizuar Projekti i Enciklopedisë).

Objektivi i dytë synon realizimin e veprimtarisë botuese të paraparë me programin e Akademisë. Viteve në vijim parashihet rritja e numrit të botimeve shkencore dhe artistike, meqë është shtuar numri i anëtarëve të Akademisë. Realizimi i këtij objektivi do të realizohet përmes botimit të rezultateve të studimeve shkencore.

Objektivi i tretë synon realizimin e Projektit të Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe (veprimtari afatgjate) ky objektivi pritet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Konferencave shkencore;
- Takimeve të vazhdueshme të anëtarëve të Këshillit;
- Simpoziumeve shkencore.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
ASHAK						
Totali	774,174	1,044,677	1,146,500	1052500	1052500	1052500
Numri i stafit	55	55	55	55	55	55
Totali i programit	774,174	1,044,677	1,146,500	1,052,500	1,052,500	1,052,500
Paga dhe mëditje	459,392	613,281	636,000	636,000	636,000	636,000
Mallra dhe shërbime	284,964	423,049	480,000	411,500	411,500	411,500
Shpenzime komunale	6,837	4,369	10,000	5,000	5,000	5,000
Subvencione dhe Transfere	0	0	0	0	0	0
Shpenzime kapitale	22,980	0	0	0	0	0
Donacioni	0	3,978	20,500	0	0	0
Numri i stafit	55	55	55	55	55	55
Burimet e Financimit:						
Totali	774,174	1,044,677	1,146,500	1,052,500	1,052,500	1052500
Grantet qeveritare	774,174	1,040,700	11,126,000	1,052,500	1,052,500	1,052,500
Te hyrat vetanake	0	0	0	0	0	0
Huamarrja	0	0	0	0	0	0
Donacionet	0	3,978	20,500	0	0	0

AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Misioni

Misioni i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) është implementimi dhe nxjerrja e rregulloreve dhe standardeve për liberalizimin e mëtutjeshëm të tregut bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizës rregullator të BE-së për komunikime elektronike duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Objektivat

Objektivat kryesore të ARKEP-së do të arrihen përmes:

Krijimi dhe sigurimi i parakushteve ligjore dhe rregullatore për zhvillimin e mëtutjeshëm të infrastrukturës së teknologjisë informative dhe komunikuese përmes arritjes së sigurisë dhe integritetit të rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;

1. Nxitjen e konkurrencës së ofertave të shërbimeve komunikuese dhe atyre postare;
2. Nxitjen e investimeve përmes adoptimit dhe implementimit të teknologjisë moderne komunikuese që do të kontribuojnë në zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë informative;
3. Liberalizimin e mëtutjeshëm të shërbimeve brezëgjera;
4. Qeverisje të dobishme dhe transparente dhe përdorim optimal të resurseve të kufizuara.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	632,279	683,253	1,209,200	724,183	749,183	649,183
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	632,279	683,253	1,209,200	724,183	749,183	649,183
Nr. i punetoreve	33	37	39	39	39	39
Paga dhe meditje	266,487	289,557	309,088	309,088	309,088	309,088
Mallra dhe sherbime	251,088	259,370	387,412	327,395	327,395	327,395
Shpenzime komunale	11,034	12,930	12,700	12,700	12,700	12,700
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	103,670	121,396	500,000	75,000	100,000	-
Burimet e Financimit	632,279	683,253	1,209,200	724,183	749,183	649,183
Grantet qeveritare	632,279	683,253	1,209,200	724,183	749,183	649,183
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSION

Misioni

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) si organ i pavarur i themeluar me ligj është përgjegjës për zbatimin e politikës shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë. Agjencia ushtron përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Fushëveprimi i Agjencisë është i përqendruar në hetimin dhe zbulimin e rasteve të veprave penale me natyrë të korrupsionit, përpjekjeve për parandalimin e fenomenit të korrupsionit si dhe vetëdijesimin e publikut në hapat progresiv drejtë krijimit të një shoqërie ku sundon rendi dhe ligji.

Situata aktuale

Agjencia Kundër Korrupsionit është duke zhvilluar hetime paraprake për të gjitha rastet e dyshuara për kryerje të veprave penale me natyrë të korrupsionit dhe i përcjell kallëzime penale Prokurorisë së Shtetit ose asaj të EULEX-it.

Po ashtu Agjencia është duke monitoruar zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit, mbikëqyrjen dhe kontrollin e deklarimit, burimit dhe prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Në vazhdimësi Agjencia është duke ndërmarr aktivitete të ndryshme me qëllim të edukimit dhe ngritjes së vetëdijesimit të opinionit publik për pasojat që shkakton korrupsioni, dhe inkurajimin e tyre për domosdoshmërinë e angazhimit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Objektivat

Për periudhën afatmesme 2015-2017, AKK planifikon t'i realizojë këto objektiva:

1. Përbushja e plotë e mandatit ligjor të përcaktuar me ligjet në fuqi në rrafshin e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit;
2. Plotësimi dhe avancimi i kornizës ligjore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
3. Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve të brendshme profesionale në fusha të ndryshme;
4. Forcimi dhe kultivimi i frymës së bashkëpunimit me mekanizmat institucional përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Agjencia Kundër Korrupsionit	370,000	447,939	485,000	456,306	456,306	456,306
Totali i Programeve	370,000	447,939	485,000	456,306	456,306	456,306
	370,000	447,939	485,000	456,306	456,306	456,306
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	370,000	447,939	485,000	456,306	456,306	456,306
Nr. i punëtorëve	35	39	40	40	40	40
Paga dhe mëditje	236,679	286,822	293,709	293,709	293,709	293,709
Mallra dhe shërbime	111,198	150,390	181,291	154,097	154,097	154,097
Shpenzime komunale	6,378	3,777	10,000	8,500	8,500	8,500
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	15,745	6,950	-	-	-	-
Burimet e Financimit	370,000	447,939	485,000	456,306	456,306	456,306
Grantet qeveritare	370,000	447,939	485,000	456,306	456,306	456,306
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	86,317	86,317	-	-

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Misioni

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka për mision krijimin dhe funksionimin efikas, transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë, përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për dhënien e licencave në fushën e energjisë elektrike, ngrohjes qendrore dhe gazit, monitorimin dhe përkujdesjen për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji, vendosjen e tarifave si dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në këtë sektor.

Situata aktuale

Zyra e Rregullatorit të Energjisë i ka kushtuar rëndësi të veçantë bashkëpunimit me ministritë relevante të Qeverisë së Kosovës, komisioneve parlamentare të Kuvendit të Kosovës dhe me institucionet e organizata ndërkombëtare siç janë: Këshilli i Rregullatorëve të Energjisë së Evropës (CEER) dhe Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) për t'i bashkërenditur aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e strategjisë dhe të politikave në sektorin e energjisë.

Është punuar në hartimin e një kornize ligjore adekuate për përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe për bashkëgjenerim. Ndhimesë teknike për realizimin e këtij qëllimi ka dhënë AER, USAID dhe Banka Botërore.

Janë lëshuar, transferuar dhe vazhduar 40 licenca për sektorin e energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore, ndërsa sa i përket energjisë së ripërtërishme, ZRRE ka lëshuar 23 autorizime preliminare, nga të cilat 6 autorizime finale.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar fushës së mbrojtjes së konsumatorëve, ku janë shqyrtuar dhe zgjedhur me vendim gjithsej 1080 ankesa të konsumatorëve.

Objektivat

1. Bashkëpunimi me palët në sektorin e energjisë dhe përmirësimin e kornizës ligjore;
2. Monitorimi i tregut të energjisë si dhe zhvillimi i tij;
3. Mbrojtja e konsumatorëve dhe e kompanive të licencuara në mbështetje me procedurat për zgjidhje të kontesteve.

Për të realizuar **objektivin e parë** - bashkëpunimi me palët dhe përmirësimi i kornizës ligjore për vitet 2015-2017, ZRRE planifikon dhe do të ndërmerr këto veprime:

- Krijimin e kornizës rregullative, e cila siguron funksionim transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë duke u bazuar në parimet e tregut të lirë dhe të jetë në pajtim me 'acquis communautaire';
- Nxjerrjen e akteve nënligjore dhe përcaktimin e tarifave të energjisë.

Për të realizuar **objektivin e dytë** - monitorimi i tregut të energjisë si dhe zhvillimi i tij për vitet 2015-2017, ZRRE dhe do të ndërmerr këto veprime:

- Monitorimi i bizneseve të të gjitha kompanive të licencuara;
- Monitorimin dhe përkujdesjen për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji;
- Krijimi i kushteve të favorshme për investime të reja dhe hapjen e tregut për kompanitë e reja të ngrohjes.

Për të realizuar **objektivin e tretë** - mbrojtja e konsumatorëve dhe e kompanive të licencuara në mbështetje për procedurat për zgjedhje të kontesteve për vitin 2015-2017, ZRRE planifikon të ndërmer këto veprime:

- Konsultime publike për tarifat dhe çmimet;
- Konsultime publike për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Konsultimet publike për licencim.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

Zyra e Rregullatorit të Energjisë	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 plani	2016 plani	2017 plani
Totali programit	643,501	587,620	674,456	635,156	635,156	635,156
Nr. i punëtorëve	33	33	33	33	33	33
Paga dhe mëditje	372,319	351,930	372,456	372,456	372,456	372,456
Mallra dhe shërbime	219,893	194,068	240,000	200,700	200,700	200,700
Shpenzime komunale	10,159	18,626	22,000	22,000	22,000	22,000
Shpenzime kapitale	41,130	22,996	40,000	40,000	40,000	40,000
Burimet e financimit	643,501	587,520	674,456	635,156	635,156	635,156
Grandet qeveritare	643,501	587,520	674,456	635,156	635,156	635,156

Tabela 2. Indikatorët kyç të performancës

Indikatorët Kyç të Performancës	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Zyra e Rregullatorit të Energjisë	aktuale	aktuale	buxheti	plani	plani	plani
Zgjidhja e ankesave të konsumatorëve	182	253	42	-	-	-
Licenca të modifikuara	15	2	-	-	-	-
Licenca të transferuara	-	2	-	-	-	-
Licenca të vazhduara	2	1	-	-	-	-
Licenca të lëshuara	1	-	-	-	-	-
Autorizime preliminare për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese	4	14	-	-	-	-
Autorizime finale për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese	1	3	-	-	-	-

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Misioni

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është themeluar si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur.

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore.

Situata aktuale

Agjencia Kosovare e Privatizimit në portfolion e saj në fund të vitit 2013 numëron 585 ndërmarrje shoqërore. Gjatë vitit 2013, AKP, ka mbajtur tri (3) valë të privatizimit: Vala 57, Vala 58 dhe Vala 59, dhe pesë shitje të asetëve të ndërmarrjeve në likuidim (SHAL): SHAL 19, SHAL 20, SHAL 21, SHAL 22, SHAL 23.

Gjatë periudhës 01 janar – 31 dhjetor 2013, kanë filluar procedurat e likuidimit edhe për 161 Ndërmarrje Shoqërore ku janë emëruar edhe Autoritetet e Likuidimit përkatëse për këto Ndërmarrje nëpër Zyrat Rajonale (ZR) përkatëse të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Gjatë vitit 2013 janë publikuar gjithsej 12 lista fillestare dhe 36 lista përfundimtare dhe është bërë shpërndarja e pjeshme për punëtorët e kualifikueshëm të NSh-ve në shumë të përgjithshme prej €9,924,575.

Fokus si dhe njëherit sfidë e vazhdueshme për AKP-në mbetet riorganizimi dhe gjetja e mundësive për rivitalizimin e Trepçës, duke ditur se AKP-ja ushtron autoritetin administrativ në cilësinë e Administratorit që nga hyrja në fuqi e Ligjit të Riorganizimit, në nëntor 2011. Duke e ditur kompleksitetin dhe vështirësitë e funksionimit të kësaj ndërmarrje, numrin dhe vlerën e përafërt të pretendimeve ndaj saj dhe pasojat për ndërmarrjen në rast të mos aprovimit të planit të riorganizimit nga Dhoma e Posaçme dhe duke pasur parasysh se ne si Administrator nuk kemi kapacitetet e duhura njerëzore e as teknike për hartimin e një plani të tillë, Bordi ka vendosur të angazhoj një Ofrues Profesional të Shërbimeve për të hartuar dhe mbrojtur para Dhomës së Posaçme planin e riorganizimit. Aktualisht, AKP është në proces të angazhimit të këtyre Ofruesve të Shërbimeve dhe është në fazën e vlerësimit të ofertave të dorëzuara nga këta Ofrues.

Objektivat

Për ta realizuar misionin e saj, Agjencia Kosovare e Privatizimit në periudhën afatmesme planifikon të realizojë këto objektiva:

1. Përmbyllja e procesit të privatizimit përmes krijimit të ndërmarrjeve të reja;

2. Përqendrimi dhe kthimi i fokusit në shitjen e aseteve në likuidim si dhe shpërndarja e mjeteve të kreditorët pas përmbylljes së likuidimit të NSH-ve/ Shpërndarja e mjeteve tepriçë e NSH-ve në likuidim;
3. Riorganizimi dhe ngritja e bashkëpunimit me të gjitha palët e interesit për gjetjen e mundësive për rivitalizimin e Trepçës;
4. Shitja e aseteve përmes ankandit publik dhe negociatave të drejtpërdrejta;
5. Shpërndarja e mjeteve të 20% për punëtorët e kualifikueshëm.

Tabela 1. Historiku 2012-2014 dhe shpenzimet bazë 2015-2017

<i>(in 000' Euro)</i>	<i>2012 aktuale</i>	<i>2013 aktuale</i>	<i>2014 buxheti</i>	<i>2015 plani</i>	<i>2016 plani</i>	<i>2017 plani</i>
Agjencia Kosovare e Privatizimit						
Total	8,079,010	7,716,447	11,345,873	9,911,383	5,446,711	4,392,321
<i>Administrata Qendrore</i>	4,952,887	5,105,068	5,224,200	4,809,466	4,136,794	3,385,404
<i>Auditimi</i>	205,736	50,000	180,000	160,000	100,000	50,000
<i>Departamenti Ligjor</i>	80,000	50,000	30,000	30,000	30,000	30,000
<i>Riorganizimi dhe administrimi i NSH-ve</i>	1,214,105	1,169,676	4,300,000	3,690,000	210,000	120,000
<i>Likuidimi</i>	955,026	736,447	976,417	816,917	619,917	506,917
<i>Privatizimi</i>	671,256	605,256	635,256	405,000	350,000	300,000
Totali i programeve sipas kategorive ekonomike						
Total	8,079,010	7,716,447	11,345,873	9,911,383	5,446,711	4,392,321
<i>Nr. I punëtorëve</i>	271	271	271	218	184	127
<i>Pagat dhe Meditjet</i>	3,500,000	3,500,000	3,500,000	3,286,391	2,694,594	2,107,404
<i>Mallra dhe Sherbime</i>	4,201,010	3,976,447	7,507,873	6,366,992	2,564,117	2,116,917
<i>Shpenzime Komunale</i>	98,000	98,000	98,000	98,000	98,000	98,000
<i>Subvencione dhe Transfere</i>	100,000	80,000	80,000	80,000	60,000	40,000
<i>Shpenzime Kapitale</i>	180,000	62,000	160,000	80,000	30,000	30,000
Shpenzimet sipas burimeve të financimit						
Total	8,079,010	7,716,447	11,345,873	9,911,383	5,446,711	4,392,321
<i>Grantet qeveritare</i>	-	-	4,000,000	3,400,000	20,000	20,000
<i>Të hyrat vetanake</i>	8,079,010	7,716,447	7,345,873	6,511,383	5,426,711	4,372,321
<i>Financimet nga huamarrjet</i>	-	-	-			
<i>Grantet nga donatorët</i>	-	-	-			

Përmbledhja e Informatave kyçe të performancës

Privatizimi

Në vitin 2012, 3 Valë të Privatizimit përmes metodës Spin-of 8 Shitje të Aseteve dhe 3 Shitje Individuale.

8 shpallje të tenderëve të shitjes x 5 publikime x 7 gazeta kombëtare, TV dhe radio = 280 dhe 2 publikime në gazeta ndërkombëtare.

Publikime në gazeta kombëtare dhe ndërkombëtare për procesin e Likuidimit. Rezultati i publikimeve është njoftimi sa më i madh i blerësve potencial.

Janë publikuar gjithsej 49 lista fillestare dhe 45 lista finale.

Në vitin 2013, 3 Vale të Privatizimit përmes metodës Spin-of dhe 8 Shitje të Aseteve.

7 shpallje të tenderëve të shitjes x 5 publikime x 7 gazeta kombëtare, TV dhe Radio = 245.

Janë publikuar gjithsej 12 lista fillestare dhe 36 lista finale.

Në vitin 2014, 9 Shitje te Aseteve. 9 shitje x 5 publikime x 7 gazeta kombëtare = 315 dhe 2 publikime në gazeta ndërkombëtare.

Parashikohet të publikohen 45 lista fillestare dhe 45 lista finale.

Gjatë viteve 2015-2017 pritet të privatizohen rreth 1000 asete.

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Misioni

Misioni i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) është kryerja e funksioneve që i janë caktuar sipas Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë (Ligji Nr. 04/L – 042) dhe Ligjit për procedurën për dhënien e koncesioneve (Ligji Nr. 02/L-44) lidhur me ankesat e parashtruara nga operator të ndryshëm ekonomik.

Situata aktuale

Organi Shqyrtues i Prokurimit si një institucion i pavarur, është përpjekur të sigurojë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, si dhe respektimin e procedurave ligjore nga ana e Autoriteteve Kontraktuese, konform LPP-së dhe legjislacionit sekondar, duke u mbështetur në ankesat dhe kërkesat operatorëve ekonomikë, OSHP si synimin ka garantimin të drejtave të tyre.

Synimet për vitin 2014 dhe vitet në vijim, përfshijnë vazhdimin e përpjekjeve për konsolidimin e institucionit, si nga pikëpamja strukturale po ashtu edhe nga organizimi i punës së OSHP-së, konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me operatorët ekonomik, autoritetet kontraktuese si dhe për zbatimin e strategjisë së komunikimit.

Objektivat

Për të realizuar misionin e saj, OSHP-ja në periudhën afatmesme planifikon që me buxhetin e paraparë të realizojë këto objektiva:

1. Shërbim i operatorëve ekonomik dhe mbrojtja e te drejtat e ligjshme nga veprimet apo mos veprimet e Autoriteteve kontraktuese. Rëndësi të veçante për arritjen e kësaj objektive do ti kushtohet profesionalizimit , efikasitetit dhe vendimmarrjes së drejtë;
2. Rritja e transparencës ndaj operatorëve ekonomik dhe në përgjithësi ndaj publikut në mënyrë që prokurimet publike të arrijnë efektivitetin e shpenzimit të parasë publike;
3. Informimin në mënyrë të rregullt dhe transparent për veprimtarinë e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), nëpërmjet krijimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe lehtësisht të monitorueshëm nga komuniteti i biznesit dhe publiku i gjerë për menaxhimin e ankesave dhe dhënien e vendimeve meritore nga ana e OSHP-së.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
OSHP						
Totali	253,842	217,422	314,400	283,320	283,320	283,320
Nr. i punëtorëve	18	16	23	23	23	23
Paga dhe mëditje	134,825	120,905	163,865	163,865	163,865	163,865
Mallra dhe shërbime	115,470	94,425	134,535	114,355	114,355	114,355
Shpenzime komunale	3,547	2,092	6,000	5,100	5,100	5,100
Subvencione dhe transfere			-	-	-	-
Shpenzime kapitale	-	-	10,000	-	-	-
Burimet e Financimit:	253,842	217,422	314,400	283,299	283,299	283,299
Garantët qeveritare	253,842	217,422	314,400	283,299	283,299	283,299
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Garantët donatorët	-		-	-	-	-

Indikatorët kyç të performacës

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Trajnimi stafit në prokurim publik dhe në partneritet publiko o privat		5%	10%	20%	20%	20%
Publikimi i dokumenteve zyrtare (vendimeve)		10%	10%	10%	10%	10%
Shqyrtimi i ankesave të parashtruara		85%	80%	70%	70%	70%

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Misioni

Agjencia për Ndhmë Juridike Falas (ANJF) për mision të saj ka ofrimin e ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore, duke ju mundësuar qasjen e barabartë në drejtësi si dhe respektimin e parimit të mos diskriminimit ndaj askujt, pa marr parasysh përkatësinë etnike, racore, politike, gjinore apo ndonjë dallim tjetër.

Situata aktuale

Aktualisht ofrimi i ndihmës juridike shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës, nëpërmjet zyrave rajonale për ndihmë juridike falas, në 5 (pesë) rajone: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan, dhe 8 zyra për ndihmë juridike të përkrahura nga Projekti “Avancimi i Drejtësisë Gjinore” - UNDP, në: Graçanicë, Ferizaj, Dragash, Gjakovë, Mitrovicë, Kllokot, Skenderaj dhe në Klinë.

Duke u mbështetur në faktin që ndihma juridike falas nuk mund të mbulojë kërkesat e qytetarëve, në komunat në të cilat ANJF ende nuk i ka të hapur zyrat për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas, me Projektin “Avancimi i Drejtësisë Gjinore” i mbështetur nga UNDP, kjo Agjenci ka formuar Klinikën mobile lëvizëse, një aktivitet jashtëzakonisht i rëndësishëm, pikërisht për arsye të cekura më lartë.

Në dhjetë komuna të Republikës së Kosovës, si: Prishtinë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë, Dragash, Skenderaj Kllokot, dhe Klinë, në mbështetje të UNDP, ANJF ka organizuar “Javën e Ndhmës Juridike Falas si fushatë vetëdijesuese, qëllimi i së cilës ka qenë informimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve lidhur me shërbimet e ofruara nga Agjencia për Ndhmë Juridike Falas.

Objektivat

1. Shtrirja territoriale e ofrimit të ndihmës juridike dhe sensibilizimi vetëdijesimi i qytetarëve, e veçmas qytetarëve të cilët i plotësojnë kriteret për të përfituar ndihmën juridike falas;
2. Rritja e numrit të përfitueseve të ndihmës juridike dhe ofrimi i shërbimeve juridike falas në mënyrë sa më profesionale.

Objektivi i parë - Shtrirja territoriale e ndihmës juridike falas, është e paraparë me Ligjin Nr. 04/L -17 për Ndhmë Juridike Falas, prandaj konsiderohet edhe si objektivi shumë i rëndësishëm i ANJF-së.

ANJF ballafaqohet edhe në mungesë të vetëdijesimit të qytetarëve për këtë institucion e sidomos qytetarëve të cilët kanë nevojë për ndihmë juridike falas. Prandaj si objektivi kyç konsiderohet edhe vetëdijesimi dhe sensibilizimi.

Objektivi i dytë i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas është rritja e numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas si dhe ofrimi i shërbimeve më cilësore profesionale, duke e marr parasysh se afër 74 % të qytetarëve i plotësojnë kriteret për ofrimin e shërbimeve juridike falas.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	284,264	282,609	303,211	278,469	278,469	278,469
Totali i Programit	284,264	282,609	303,211	278,469	278,469	278,469
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	284,264	282,609	303,211	278,469	278,469	278,469
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	284,264	282,609	303,211	278,469	278,469	278,469
Nr. i punetoreve	20	21	22	22	22	22
Paga dhe mëditje	122,585	123,782	138,266	138,266	138,266	138,266
Mallra dhe shërbime	148,608	146,869	150,925	128,286	128,286	128,286
Shpenzime komunale	13,071	11,958	14,020	11,917	11,917	11,917
Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Burimet e Financimit	284,264	282,609	303,211	278,469	278,469	278,469
Grantet qeveritare	284,264	282,609	303,211	278,469	278,469	278,469
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

Tabela 2. Përmbledhje e informatave kyçe të performancës

Indikatorët Kyç të Përformancës	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas						
Nurmmi i lëndëve	3,872	5,686	6,000	6,000	6,000	6,000
Numri i lëndëve Administrative	2,103	3,164	3,300	3,300	3,300	3,300
Numri i lëndëve Civile	1,518	2,215	2,400	2,400	2,400	2,400
Numri i lëndëve Penale	242	293	320	320	320	320
Nurmi i lëndëve Kundervajtëse	9	14	20	20	20	20
Gjenerimi i raporteve të brendshme	2	8	10	10	10	10
Hartimi i akteve nën - ligjore	0	6	3	3	3	3
Implementimi i projekteve	2	4	2	2	2	2
Digjitalizimi i shërbimeve	10%	80%	90%	100%	100%	100%
Trajnimet e organizuara për stafin e ANJF-së	4	8	5	5	5	5

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Misioni

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP) është institucion autonom publik për arsimin e lartë, që zhvillon arsimin akademik, kërkimet shkencore, krijimtarinë artistike, këshillimet profesionale dhe fushat e tjera të veprimtarive akademike. UP-ja ka për mision zhvillimin e një sistemi arsimor efektiv, që do t'i kontribuojë ngritjes së mirëqenies së shoqërisë, duke ofruar edukim dhe arsimim të barabartë për të gjithë qytetarët, cilësi të lartë në fushën e kërkimeve shkencore, inovacioneve dhe transferim të teknologjisë në pajtim me vlerat dhe standardet bashkëkohore duke respektuar diversitetin e një shoqërie demokratike dhe të prosperuar.

Situata aktuale

Universiteti i Prishtinës ka 14 njësi akademike të shpërndara në shtatë qendra administrative, me afro 53,363 studentë në aftësimin dhe përgatitjen e kuadrit adekuat për tregun e punës, kuadro të cilët ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë së vendit. UP-ja si universitet publik, është bartës kryesor i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe kontribuuesi kryesor në arritjen e objektivave nacionale për rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e lartë.

Gjatë këtij viti ka rritje në numër të studentëve në krahasim me vitet e tjera. Në vitin 2013 është investuar kryesisht në infrastrukturë dhe atë: në objektin e FSHTA-së në Ferizaj, ndërtimin e Fakultetit të Bujqësisë, përfundimi i Amfiteatrit në Fakultetin Ekonomik, fillimi i procedurave të projektimit në Fakultetin e Mjekësisë, projektimi i fasadës dhe termoizolimi i objektit të Filologjisë, si dhe ndërrimi i dritareve, renovime të ndryshme në të gjitha njësitë e UP-së, furnizimi me pajisje të teknologjisë informative, investimi në disa laboratorë dhe mjete konkretizimi të njësive akademike etj.

Është bërë ristrukturimi i disa planeve mësimore në bazë të nevojave të tregut si dhe në kuadër të ecjes në hap me universitetet rajonale dhe më gjerë. Gjithashtu, Universiteti ka bërë zgjerimin e studimeve me programe të reja në disa njësi akademike sidomos me nivelin e studimeve të doktoratave, po ashtu një numër i programeve kanë aplikuar për akreditim ku një numër prej tyre është akredituar dhe kanë filluar studimet e doktoratës.

UP gjatë vitit 2013 ka përgatitur një numër të rregulloreve për themelimin e instituteve në kuadër të njësive akademike dhe departamenteve të ndryshme. Këto institute janë në fazën e konsolidimit dhe funksionalizimit të cilat do ti shërbejnë avancimit të punës kërkimore studimore si dhe do të bëjnë analiza të veçanta për palët e treta të cilat kontribuojnë në rritjen e të hyrave në UP.

Sistemi i reformave në arsim, si pjesë përbërëse ka për qëllim edhe promovimin e demokracisë qytetare, zhvillimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së arsimit të lartë.

Objektiv madhor për Universitetin mbetet thellimi dhe vazhdimi i bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë rajonal dhe ndërkombëtar si dhe harmonizimi i plan-programeve

me standardet evropiane, nga viti i kaluar ka filluar të realizohet objektivi i UP-së që është futja në zonën evropiane të arsimit.

Pavarësisht këtyre rezultateve UP-ja përballet me këto sfida:

- Mungesën e hapësirave për studim,
- Numrin e madh të studentëve,
- Kërkesën për laboratorë dhe pajisje të TI-së,
- Rinovime në objektet e vjetra,
- Arritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie,
- Avancimi dhe shtimi i stafit akademik

Objektivat

Për të realizuar misionin e vet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën afatmesme 2015-2017, ka këto objektiva:

1. Ngritja e cilësisë në studime dhe mësimdhënie;
2. Avancimi i kërkimeve shkencore në UP - shndërrimi i Universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe hulumtimeve shkencore;
3. Zgjerimi dhe mirëmbajtja e objekteve të arsimit të lartë;
4. Ngritja dhe avancimi i sistemit informativ.

Objektivi i parë synon të bëjë ngritjen e cilësisë në studime, mësimdhënie dhe mësimnxëje si dhe në hulumtime shkencore sipas normave që kërkohen. Realizimi i këtij objektivi planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Organizimin e Universitetit Veror të Prishtinës;
- Sigurimin e përfshirjes më të madhe të gjeneratës së re në arsimin e lartë, në harmoni me kërkesat e tregut të punës;
- Ngritjen e kapaciteteve në të gjitha njësitë akademike sipas planifikimit të Keshillit Drejtues;
- Avancimi dhe kualifikimi i mësimdhënësve, aktivitet ky i UP-së që rrjedh nga marrëveshja me MASHT-in për avancimin dhe kualifikimin e mësimdhënësve, të cilët kryejnë module shtesë në Fakultetin e Edukimit dhe organizohet për mësimdhënësit që e kanë të kryer shkollën e lartë. Për këtë program, në mënyrë që të realizohen objektivat në nivelin e duhur, UP-ja planifikon që për çdo vit të ndahet masa monetare në vlerë prej €750,000;
- Stimulimin e studentëve me bursa.

Objektivi i dytë synon avancimin e kërkimeve shkencore, shndërrimin e Universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe të hulumtimeve shkencore. Realizimi i këtij objektivi planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Integrimi dhe ndërkombëtarizimi i UP-së në proceset zhvillimore evropiane dhe botërore të kërkimeve shkencore për zgjidhjen e problemeve të shoqërisë dhe në shërbim të ekonomisë;

- Rritja e lëvizshmërisë së mësimdhënësve/hulumtuesve dhe studentëve;
- Përkrahja dhe stimulimi i stafit për pjesëmarrje në aktivitetet ndërkombëtare shkencore;
- Rritja e numrit të bibliotekave me literaturë bashkëkohore.

Objektivi i tretë synon eliminimin e mungesës së hapësirave në UP si dhe arritjen e standardeve në nivel me universitetet e rajonit dhe me gjerë. Realizimi i këtij objektivi planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Përfshirjes më të madhe si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve për mësim të studentëve;
- Avancimi i kërkimeve shkencore në UP - shndërrimi i Universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe hulumtimeve shkencore;
- Hartimin e politikave për sigurim të cilësisë, certifikim, vlerësim, standarde dhe kualifikime;
- Krijimin e strukturave për vlerësimin e brendshëm.

Objektivi i katërt synon që të arrijë digjitalizimi e të gjitha shërbimeve dhe eliminimin e pritjeve të gjata në të gjitha njësit akademik. UP-ja gjatë tre vjetëve të ardhshëm do të investojë në digjitalizimin e shërbimeve të universitetit, disa faza të projekt tashmë kanë filluar të aplikohen. Realizimi i këtij objektivi planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Digjitalizimin e shërbimeve administrative në UP;
- Zbatimin e teknologjisë së nivelit rajonal dhe botëror;
- Bashkëpunimin për rrjetëzimin e universiteteve të ndryshme me Universitetin e Prishtinës;
- Trajnimin e stafit të për përdorimin e moduleve të programit SEMS;
- Furnizimin e të gjitha njësive me teknologji të re informative.

Tabela më poshtë paraqet shpenzimet e politikave bazë të UP dhe nuk përfshinë shpenzimet e ndonjë politike të re apo ndonjë investimi që fillon në 2015 dhe më tej.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet si pas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Universiteti I Prishtinës	24,630,347	25,516,720	29,731,253	25,063,339	25,063,339	25,063,339
Totali	24,630,347	25,516,720	28,238,590	25,063,339	25,063,339	25,063,339
Nr. i punëtorëve	2,142	2,142	2,155	2,230	2,230	2,230
Paga dhe mëditje	18,258,818	18,877,488	19,283,075	16,175,632	16,175,632	16,175,632
Mallra dhe shërbime	3,132,575	2,729,461	3,130,862	3,256,233	3,256,233	3,256,233
Shpenzime komunale	930,500	884,842	1,061,191	868,012	868,012	868,012
Subvencione dhe transfere	1,236,970	1,292,455	1,314,000	1,314,000	1,314,000	1,314,000
Shpenzime kapitale	1,071,485	1,732,474	3,449,462	3,449,462	3,449,462	3,449,462

Burimet e Financimit:	24,630,347	25,516,720	29,731,253	25,063,339	25,063,339	25,063,339
Grantet qeveritare	15,225,493	16,138,418	19,644,053	20,019,739	20,019,739	20,019,739
Te hyrat vetanake	9,404,854	9,378,302	10,087,200	5,043,600	5,043,600	5,043,600
Financimet nga huamarrjet	0	0	0	0	0	0
Grantet donatoret	0	0	0	0	0	0
Propozimi i politikës së re në Universitetin e Prishtinës						
Totali				5,043,600	5,043,600	5,043,600
Numri i punëtorëve				-	-	-
Paga dhe medijtje				3,940,107	3,940,107	3,940,107
Mallra dhe shërbime				446,493	446,493	446,493
Shpenzime komunale				-	-	-
Subvencione dhe transfere				657,000	657,000	657,000
Shpenzime kapitale				-	-	-
Burimet e Financimit				5,043,600	5,043,600	5,043,600
Grantet qeveritare				5,043,600	5,043,600	5,043,600
Te hyrat vetanake				-	-	-
Totali i skenarit bazë dhe politikave te reja				30,106,939	30,106,939	30,106,939
Numri i punëtorëve				2,230	2,230	2,230
Paga dhe medijtje				20,115,739	20,115,739	20,115,739
Mallra dhe shërbime				3,702,726	3,702,726	3,702,726
Shpenzime komunale				868,012	868,012	868,012
Subvencione dhe transfere				1,971,000	1,971,000	1,971,000
Shpenzime kapitale				3,449,462	3,449,462	3,449,462
Burimet e Financimit				30,106,939	30,106,939	30,106,939
Grantet qeveritare				25,063,339	25,063,339	25,063,339
Te hyrat vetanake				5,043,600	5,043,600	5,043,600

UP-ja nuk mund të ketë funksionim normal pas marrjes së vendimit për kursim nga Qeveria në masën financiarë 15% në kategoritë mallra, shërbime dhe shpenzime komunale, pasi që vetëm në janar të vitit 2014 janë shtuar 3 objekte të reja, siç janë: FSHTA në Ferizaj, amfiteatri i Fakultetit Ekonomik dhe Biblioteka Universitare. Gjithashtu vendimi i Qeverisë për uljen e taksave për studentë prej 50% në të gjitha shërbimet që i ofron UP-ja. Në UP do të ketë problem në funksionet e mëtutjeshme pasi që kjo ulje ndikon direkt në zbritjen e të hyrave, të institucioneve të cekura më larte. Andaj kërkojmë që UP-së për vitin 2015-2017 t'i rriten kufijtë buxhetorë, pasi që kërkesa për mjete shtesë nuk është politik e re por aktivitete të vazhdueshme pa të cilat UP-ja nuk mund të funksionojë.

Tabela 2. Indikatorët kyç të UP-së

Universiteti i Prishtinës	2012 Aktual	2013 Aktual	2014 Buxheti	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Numri I Profesorëve	1722	1722	1735	1810	1810	1810
Nr. i stafit të administratës	420	420	420	420	420	420
Nr. I stafi total	2142	2142	2155	2230	2230	2230
Buxheti për paga të profesorëve	16,494,818	17,088,288	17,418,275	18,099,738	18,099,738	18,099,738
Buxheti për paga të administratës	1,764,000	1,789,200	1,864,800	2,016,000	2,016,000	2,016,000
Paga mesatare mujore e një mësimdhënësi	798	827	837	833	833	833
Paga mesatare e punëtorëve te administratës	350	355	370	400	400	400
Pjesëmarrja e buxhetit te pagave në buxhetin e përgjithshëm	74.13	73.98	64.86	69.04	64.04	64.04
Numri total i studentëve në UP	46,460	52,896	57,750	59,084	52,597	52,601
Niveli beaqelor	41,000	46,500	49,800	51,500	45,000	45,000
Niveli master	5,350	6,248	7,700	7,000	7,000	7,000
Niveli I doktoratës	110	148	250	584	597	601
Shpenzimet mesatare për një student	530	482	515	493	554	554
Pjesëmarrja e investimeve ne buxhetin e UP-se	4.35	6.79	11.60	11.84	11.84	11.84
Laborator për njësit akademike dhe katedrat	6	4	12	10	14	14
Mjete konkretizimi materiali didaktik dhe kapitale tjera	14	14	14	14	14	14
Numri i stafit qe marrin pjese ne publikime shkencore	65	70	90	120	140	200
Bursa për student në shumë financiare	1,236,970	1,292,455	1,314,000	1,314,000	1,314,000	1,314,000
Pjesëmarrja e bursave ne % ne buxhetin e UP-se	5.02	5.07	4.42	4.51	4.51	4.51
Vlera e bursave për student	900	900	900	900	900	900
Numri i bursistëve fitues	1,374	1,436	1,460	1,460	1,460	1,460
Pjesëmarrja e studentëve në kërkime shkencore	0	0	10	35	70	100
Krijimi i instituteve sipas dinamikës se parapare	0	0	2	4	6	4
Aktivitete për ndërkombëtarizmin e Universitetit	10	25	35	40	30	60
Aktivitete për ngritjen dhe rritja e cilësisë në arsim dhe shkence	1	1	2	3	4	5
organizmi i konferencave shkencore						

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS

Misioni

Gjykata Kushtetuese e Kosovës (GJKK) si institucion profesional, kompetent dhe i pavarur është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Situata aktuale

Gjykata Kushtetuese si datë të fillimit të punës e konsideron 15 majin 2009, përkatësisht ditën e votimit në Kuvendin e Kosovës të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Si e tillë, është në proces të konsolidimit të brendshëm dhe aktualisht ka të punësuar 60 punonjës vendës dhe 6 punonjës ndërkombëtarë, ndërsa pozita e paplotësuar e një gjyqtari vendor do të rekrutohet nga Kuvendi i Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës nga fillimi i punës së saj e deri më sot ka pranuar 796 kërkesa të ndryshme qoftë nga institucionet, qytetarët apo grupe të ndryshme të interesit, nga të cilat të zgjidhura janë 721 kërkesa, ndërsa në procedurë të shqyrtimit janë edhe 75 kërkesa. Ndryshe Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjatë një viti kalendarik pranon 230-250 kërkesa për shqyrtim. Nga fillimi i vitit (3 janar e deri më 18 mars 2014), Gjykata Kushtetuese ka pranuar 49 kërkesa. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese ka zgjidhur 77 kërkesa, prej të cilave 72 kërkesa të bartura nga vitet paraprake, ndërsa 5 kërkesa të pranuar gjatë periudhës tremujore të vitit 2014.

Objektivat

Për ta përmbushur misionin e vet, Gjykata Kushtetuese e Kosovës planifikon të realizoj këto objektiva:

1. Sigurimi dhe zhvillimi i kuadrit cilësor për nevojat e gjykatës;
2. Avancimi i Kornizës ligjore për punë efektive dhe efikase të gjykatës;
3. Infrastruktura funksionale dhe teknologjia e avancuar informative për punë të përshtatshme në gjykatë;
4. Zhvillimi i procesit efikas dhe efektiv të komunikimit dhe i perceptimit të publikut.

Objektivi i parë “Zhvillimi dhe sigurimi i kuadrit cilësor për nevojat e gjykatës” synohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Analiza dhe planifikimi i burimeve njerëzore,
- Hartimi dhe aprovimi i organogramit të ri të gjykatës,
- Rekrutimi i mëtejshëm i personelit sipas nevojave të identifikuara,
- Krijimi i Njesisë për trajnim dhe për zhvillim të karrierës.

Objektivi i dytë: “Korniza e avancuar ligjore për punë efektive dhe efikase të gjykatës” synohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Zbatimi i kornizës ligjore,
- Hartimi i rregulloreve dhe i udhëzimeve të domosdoshme konform nevojave të Gjykatës,
- Hartimi i udhëzuesit për harmonizimin e terminologjisë juridike në gjuhët e punës të Gjykatës.

Objektivi i tretë: “Infrastruktura funksionale dhe teknologjia e avancuar informative për punë të përshtatshme në gjykatë” synohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Pasurimi me literaturë dhe digjitalizimi i bibliotekës,
- Avancimi i sistemit të digjitalizimit dhe standardizimi i pajisjeve ekzistuese,
- Avancimi i sistemit të CDMS-së.

Objektivi i katërt: “Zhvillimi i procesit efikas dhe efektiv të komunikimit dhe i përceptimit të publikut” synohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Themelimi i zyrës për komunikim;
- Informimi i opinionit publik për funksionin e gjykatës;
- Përmirësimi i disponueshmërisë dhe i qasjes në dokumentet zyrtare, si dhe i qasjes së palëve në gjykatë;
- Përmirësimi i komunikimit ndërmjet gjykatës dhe entiteteve të tjera.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	1,394,014	1,527,704	1,552,741	1,387,145	1,413,745	1,413,745
Totali i Programeve	1,394,014	1,527,704	1,552,741	1,387,145	1,413,745	1,413,745
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	1,394,014	1,527,704	1,552,741	1,387,145	1,413,745	1,413,745
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	1,394,014	1,527,704	1,552,741	1,387,145	1,413,745	1,413,745
Nr. i punëtorëve	56	59	61	61	61	61
Paga dhe mëditje	707,409	737,776	859,439	859,439	859,439	859,439
Mallra dhe shërbime	595,500	592,559	582,302	494,956	494,956	494,956
Shpenzime komunale	9,701	9,365	11,000	9,350	9,350	9,350
Subvencione dhe transfere	-	101,042	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	81,404	86,962	100,000	23,400	50,000	50,000
Burimet e Financimit	1,394,014	1,527,704	1,552,741	1,387,145	1,413,745	1,413,745
Grantet qeveritare	1,394,014	1,527,704	1,552,741	1,387,145	1,413,745	1,413,745
Grantet donatorët	-	22,457	-	-	-	-

KOMISIONI KOSOVAR I KONKURENCËS

Misioni

Misioni i Komisionit Kosovar të Konkurrencës (KKK) është krijimi i konkurrencës së lirë, mbrojtja e saj si një segment vital për ekzistimin e ekonomisë së tregut. KKK vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në zbatim të ligjit "Ligji për Konkurrencën 2004/36", duke u mbështetur në shtyllat kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës.

Situata aktuale

Komisioni Kosovar i Konkurrencës gjatë këtyre viteve ka bërë identifikimin e fushave ku mund të cenohet konkurrenca e lirë dhe ka ndër marr masa për pengimin e saj. Po ashtu ka parandaluar pozitat dominuese të disa kompanive duke mos lejuar të veprojnë me marrëveshje të brendshme por të sillen sipas rregullave të tregut.

Objektivat

1. Ndalimi i abuzimit me pozitën dominuese dhe marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve përmes organizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të brendshme;
2. Kompletimi me legjislacion sekondar në fushën e konkurrencës në pajtim me direktivat evropiane;
3. Monitorimi dhe fillimi i procedurave investiguese për shkelësit e konkurrencës.

Krijimi i konkurrencës së lirë dhe mbrojtja e saj janë segmente vitale për ekzistimin e ekonomisë së tregut, konkurrenca zënë vend të rëndësishëm në politikat ekonomike. Ky institucion e koncepton funksionimin e tij si nxitës dhe avokat i konkurrencës dhe interesave të konsumatorit dhe bizneseve, me synim final që tregu të gjeneroj zhvillim të qëndrueshëm.

Tabela 1. Historiku dhe Shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Komisioni Kosovar i Konkurrencës	194,112	187,470	255,043	241,779	241,779	241,779
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	194,112	187,470	255,043	241,779	241,779	241,779
Nr. i punëtorëve	23	23	23	23	23	23
Paga dhe mëditje	100,040	107,037	166,616	166,616	166,616	166,616

Mallra dhe shërbime	91,952	77,985	82,727	70,318	70,318	70,318
Shpenzime komunale	2,120	2,448	5,700	4,845	4,845	4,845
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Burimet e Financimit	194,112	187,470	255,043	241,779	241,779	241,779
Garantët qeveritare	194,112	187,470	255,043	241,779	241,779	241,779
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Garantët donatoret		0	-	-	-	-

AGJENCIA E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË

Misioni

Bazuar në mandatin Kushtetues dhe Ligjit për Inteligjencën në Republikën e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës.

Situata aktuale

Në kuadër të Agjencisë Kosovare për Inteligjencë janë në proces këto aktivitete:

- Që nga themelimi AKI-ja ka funksionalizuar strukturën bazike të saj duke mbuluar të gjitha fushat e përgjegjësive të parapara me kornizën ligjore në fuqi dhe është në fazën e marrjes së përgjegjësive të reja në fushat e përgjegjësive të parapara, pas procesit të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës.
- AKI është duke vazhduar procesin e funksionalizimit dhe plotësimit të strukturës së saj organizative bazuar në përgjegjësitë e saja, por edhe nevojat për shtrirje më të madhe strukturore me qëllim të realizimit të mandatit të saj kërkimor brenda dhe jashtë vendit.
- AKI vazhdon me planet dhe programet e saja për ngritje profesionale dhe operative, duke tentuar që ti gërshetojë kapacitetet e saja humane teknike dhe profesionale, me qëllim të përmbushjes së misionit të saj kushtetues.

Objektivat

Objektivat kryesore në planin afatmesëm janë:

1. Përmbushja e misionit të Institucionit të Inteligjencës bazuar në mandatin Kushtetues dhe Ligjor;
2. Ngritja e nivelit profesional të strukturave kërkimore dhe avancimi në nivelin e metodave, teknikave dhe pajisjeve teknologjike, të cilat do të shfrytëzohen gjatë veprimtarisë operative;
3. Shtrirja e aktiviteteve dhe strukturës organizative në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke synuar identifikimin në kohë reale dhe vërtetimin e informacioneve të cilat paraqesin interes për AKI;
4. Implementimi i rekomandimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës të dala nga procesi i rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlersimi	2016 Vlersimi	2017 Vlersimi
Agjencioni Kosovar i Inteligjencës	4,875,285	5,487,896	5,930,000	5,783,000	5,783,000	5,783,000
Programi AKI	4,875,285	5,487,896	5,930,000	5,783,000	5,783,000	4,283,000
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	4,875,285	5,487,896	5,930,000	5,783,000	5,783,000	5,783,000
Nr. i punëtorëve	90	90	90	90	90	90
Paga dhe mëditje	2,696,206	2,974,187	3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000
Mallra dhe shërbime	842,488	859,194	900,000	765,000	765,000	765,000
Shpenzime komunale	10,752	17,796	80,000	68,000	68,000	68,000
Subvencione dhe transfere	390,000	198,700	450,000	450,000	450,000	450,000
Shpenzime kapitale	935,839	1,438,019	1,500,000	1,500,000	1,500,000	1,500,000
Burimet e Financimit	4,875,285	5,487,896	5,930,000	5,783,000	5,783,000	5,783,000
Grantet qeveritare	4,875,285	5,487,896	5,930,000	5,783,000	5,783,000	5,783,000

KËSHILLI I KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE

Misioni

Misioni i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) është vlerësimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, si pasuri e papërsëritshme me vlerë dhe rëndësi nacionale duke ofruar bazë për ndërtimin e së ardhmes mbi vlera të qëndrueshme shoqërore, ekonomike dhe ekologjike. Realizimi i misionit bëhet përmes vlerësimit të paanshëm të mozaikut të pasur të trashëgimisë arkitekturore, arkeologjike, të luajtshme, shpirtërore dhe peizazheve kulturore në Republikën e Kosovës.

Situata aktuale

Potenciali i trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës përbëhet nga mozaiku i pasur me shprehje materiale dhe jomateriale të krijuara nga praktikrat jetësore të njerëzimit me fill që nga parahistoria dhe në vazhdimësi deri më sot. Ky potencial, me rëndësi për identitetin dhe zhvillime të qëndrueshme bashkëkohore është në situatë të pafavorshme. Sipas legjislacionit të vendit, parimeve, normave dhe praktikave ndërkombëtare, ruajtja, mbrojtja dhe rehabilitimi i potencialit të trashëgimisë kulturore i përket shtetit. Në këtë kuadër, detyrat kryesore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore janë: vlerësimi dhe shpallja e potencialeve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të shtetit; përcaktimi i masave të domosdoshme financiare në sektorin e trashëgimisë kulturore; vlerësimi/monitorimi i projekteve në sektorin e trashëgimisë kulturore, mbështetja dhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare të specializuar, siç janë UNESCO, CoE; etj. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore përmes punës me përkushtim profesional dhe shpenzime racionale, ka arritur rezultate evidente të kënaqshme. Megjithatë, duke konsideruar gjendjen e pafavorshme të trashëgimisë kulturore dhe me përqendrim drejt përmirësimit të situatës, gjatë periudhës 2015-2017, në mënyrë të paevitueshme paraqitet nevoja për zhvillim të veprimtarisë në gamë të gjerë aktiviteteve.

Objektivat

Për të realizuar misionin e vet Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në periudhën afatmesme 2015-2017 planifikon të realizojë këto objektiva:

1. Fuqizimi i mbrojtjes ligjore të trashëgimisë;
2. Konservimi i integruar i trashëgimisë kulturore, koordinimi i veprimeve;
3. Konsolidimi i trashëgimisë kulturore të rrezikuar;
4. Zhvillimi strategjik i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	176,104	147,831	161,200	148,678	148,678	148,678
Totali i Programit	176,104	147,831	161,200	148,678	148,678	148,678
Programi Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	176,104	147,831	161,200	148,678	148,678	148,678
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	176,104	147,831	161,200	148,678	148,678	148,678
Nr. i punetoreve	9	8	16	16	16	16
Paga dhe meditje	77,718	65,339	77,718	77,718	77,718	77,718
Mallra dhe shërbime	80,685	80,267	80,482	68,410	68,410	68,410
Shpenzime komunale	2,418	2,225	3,000	2,550	2,550	2,550
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	15,283	-	-	-	-	-
Burimet e Financimit	176,104	147,831	161,200	148,678	148,678	148,678
Grantet qeveritare	176,104	147,831	161,200	148,678	148,678	148,678
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARSHTRESA

Misioni

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe rregullat zgjedhore.

Misioni i PZAP-it, është mbrojtja e të drejtave zgjedhore, respektivisht Zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike sipas standardeve ndërkombëtare, si për nivelin qendror ashtu edhe për nivelin lokal.

Situata aktuale

Për Zgjedhjet e Rregullta Komunale të mbajtura me 3 nëntor të vitit 2013, PZAP-i ka pranuar shqyrtuar dhe vendosur 17,510 ankesa prej tyre vetëm për votuesit jashtë Kosovës 16,410 ankesa. Nga numri i ankesave të pranuar dhe të shqyrtuara, na jep të kuptojmë që procesi i ankesave lidhur me zgjedhjet komunale të cekura më lartë ka qenë mjaft i vështirë, duke llogaritur afatin shumë të shkurtër për vendosjen e ankesave, dhe kapacitetet njerëzore, respektivisht numri i vogël i personelit të sekretariatit të PZAP-it që kanë administruar këto ankesa.

Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013, për shkak të parregullsive gjatë këtyre zgjedhjeve, PZAP-i, ka caktuar gjopa në shumë prej 190,550 euro prej tyre ka realizuar 183,900 euro të cilat janë derdhur në Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe kanë mbetur të pa realizuara edhe 6,650 euro të cilat në të ardhmen PZAP-i do të inkason sipas procedurave ligjore.

Gjatë kësaj kohe PZAP-i ka pasur dhe ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e parregullsive gjatë procesit zgjedhor, respektivisht në mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.

Objektivat

Synimet kryesore të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në planin afatmesëm janë:

1. Vendosja në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale si dhe rregullat zgjedhore;
2. Të vazhdoj me ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit për funksionimin e plotë të strukturës organizative dhe vendim-marrëse të PZAP-i, me qëllim të implementimit të ligjeve zgjedhore në fuqi;
3. Përballimi i procesit ankimor për Zgjedhjet e Rregullta Parlamentare të Republikës së Kosovës, që sipas ligjit duhet të mbahen në vitin 2014.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia	187,743	210,855	269,000	252,678	252,678	252,678
Totali i Programit	187,743	210,855	269,000	252,678	252,678	252,678
Programi Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia	187,743	210,855	269,000	252,678	252,678	252,678
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	187,743	210,855	269,000	252,678	252,678	252,678
Numri i punëtorëve	20	20	20	20	20	20
Paga dhe mëditje	125,902	132,688	160,184	160,184	160,184	160,184
Mallra dhe shërbime	53,922	70,200	99,616	84,674	84,674	84,674
Shpenzime komunale	7,920	7,968	9,200	7,820	7,820	7,820
Burimet e Financimit	187,743	210,855	269,000	252,678	252,678	252,678
Grantet qeveritare	187,743	210,855	269,000	252,678	252,678	252,678

Përmbledhje e informatave kyçe të performancës:

PZAP-i, në bazë të mandatit të tij të përcaktuar me ligj, ka planifikuar të ndanë masën monetare të nevojshme për të realizuar – përmbushur objektivat e tij, në mënyrë kualitative dhe kuantitative si dhe brenda afatit kohor.

Për vendosjen e ankesave dhe apeleve të lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor për nivelin Komunal, Parlamentar apo Presidencial, PZAP-it i nevojiten një mori veprimesh dhe aktivitete.

Meqenëse në vitin 2014 duhet të mbahen Zgjedhjet e Rregullta Parlamentare të Republikës së Kosovës, në bazë të përvojave nga vitet e kaluara, PZAP-i afërsisht mund të pranoj shqyrtoj dhe vendos deri në 22,000 ankesa për një proces zgjedhor qoftë ai i nivelit komunal apo Parlamentar. Duke i marr parasysh këto aktivitete PZAP-i do të bëjë përpjekje që me këtë buxhet të planifikuar do të arrijë me sukses që ti përmbush objektivat kryesore në planin afatmesëm.

PZAP-i, me numrin aktual të stafit të angazhuar synon që të arrijë një performancë të kënaqshme në shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për periudhën afatmesme 2015-2017.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Misioni

Misioni i Këshillit të Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) është shqyrtimi dhe marrja e vendimeve lidhur me ankesat e ushtruara nga nëpunësit civil kundër vendimeve të organit të punësimit në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Situata aktuale

Konform legjislacionit në fuqi gjatë vitit 2013 Këshilli ka arritur ti realizojë këto aktivitete:

- Gjatë vitit të lartpërmendur, Këshilli ka pranuar 452 ankesa, ndërsa ka shqyrtuar dhe vendosur për 440 ankesa;
- Ka realizuar 26-vizita monitoruese në institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal;
- Ka vëzhguar rekrutimin e 38 pozitave të nivelit drejtues nëpër institucionet qendrore dhe ato lokale;
- Ka realizuar 166 lëndë financiare duke treguar performancë të mirë në shfrytëzim të këtij buxheti.

Objektivat

1. Mbiqyrja e vlerësimit të respektimit dhe zbatimit në praktikë të rregullave dhe parimeve të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës nga ana e institucioneve të vendit, të nivelit qendror, lokal dhe përfaqësive Diplomatike dhe Konsullore të vendit tonë që ndodhen jashtë vendit;
2. Funkcionimi efikas, profesional, i paanshëm dhe i balancuar në aspektin etnik dhe gjinor;
3. Do të shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
4. Do të vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimeve sipas skenarit bazë 2015 – 2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës	211,976	247,668	259,500	249,578	249,578	249,578
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	211,976	247,668	259,500	249,578	249,578	249,578
Numri i punëtorëve	23	25	26	26	26	26
Paga dhe mëditje	151,994	183,687	193,351	193,351	193,351	193,351
Mallra dhe shërbime	55,701	60,159	61,649	52,402	52,402	52,402
Shpenzime komunale	4,282	3,821	4,500	3,825	3,825	3,825
Burimet e Financimit	211,976	247,668	259,500	249,578	249,578	249,578
Grantet qeveritare	211,976	247,668	259,500	249,578	249,578	249,578

Tabela 2. Përmbledhje e informatave kyçe të performancës

	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Programi KPMSHCK						
Indikatori 1- Shqyrtimi i Ankesave	Ankesa të arritura	Ankesa të arritura	Ankesa të arritura	Ankesa të pritura	Ankesa të pritura	Ankesa të pritura
	385	452	480	480	480	480
	Të vendosura	Ankesa të vendosura	Do vendosen	100%	100%	100%
	385	440	100%			
	100%	97.35%				
Indikatori 2- Vizita Monitoruese në Institucionet e Republikës së Kosovës	Janë realizuar	Janë realizuar	Do të realizohen	Do të realizohen	Do të realizohen	Do të realizohen
	112 monitorim	26 monitorim	120 monitorim			
				120-monitorim	120-monitorim	120-monitorim
Indikatori 3- Vëzhgimi i regrutimit të pozitive të nivelit drejtues në Institucionet e Republikës së Kosovës	Janë realizuar	Janë realizuar	Do të realizohen	Do të realizohen	Do të realizohen	Do të realizohen
	46-viz. Vëzhguese.	38-viz. Vëzhguese	80-viz. Vëzhguese	80-viz. Vëzhguese	80-viz. Vëzhgime	80 viz. Vëzhgime

PROKURORI I SHTETIT

Misioni

Misioni i Prokurorit të Shtetit është luftimi i suksesshëm i krimit në Republikën e Kosovës dhe kontributi në sigurimin e sundimit të ligjit i cili do të bazohet në respektimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve dhe konventave ndërkombëtare. Gjatë ushtrimit të funksioneve do të respektohen pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi si dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Situata Aktuale

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Prokurori i Shtetit në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligj, janë duke ndërmarr të gjitha veprimet për të ndërtuar dhe zhvilluar një sistem prokurorial të bazuar në parime dhe vlerat më të larta që korrespondojnë me standardet dhe praktikatat me të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

KPK dhe Prokurori i Shtetit punojnë për të siguruar që në Kosovë të sundoj rendi dhe ligji, ku Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit, si institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave që bien ndesh me ligjin. Prokurori i shtetit gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të tij siguron se të drejtat dhe liritë e qytetarit të garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare respektohen.

Nga 1 janar 2013 Prokuroria e Shtetit ka filluar me implementimin e tërësishëm të Ligjit Nr.03/L-225 për Prokurorinë e Shtetit me të cilin ka ndryshuar edhe sistemi organizativ i prokurorive, prej nga prokuroritë të qarkut dhe komunale janë shndërruar në prokurori themelore si dhe është themeluar prokuroria e apelit.

Me qëllim të zbatimit të planit strategjik të bashkëpunimit ndër institucional në luftimin e krimit të organizuar në luftimin e krimit të organizuar, KPK ka nxjerrë planin e veprimit për rritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit.

Objektivat

Prokurori i Shtetit synon që gjatë ushtrimit të funksioneve të fuqizojnë rolin e tij duke realizuar objektivat strategjike të renditura si më poshtë:

1. Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit, veprave penale dhe veprave tjera të ndaluara me ligj;
2. Miratimi i rregulloreve dhe akteve të brendshme në KPK lidhur me përcaktimin e procedurave, kriterëve të qarta dhe objektive lidhur me emërimin, ri-emërimin, shkarkimin, disiplinimin dhe vlerësimin e performancës së prokurorëve në pajtim me praktikatat dhe standardet e BE-së;
3. Mbrojtjen efektive të sistemit prokurorial nga ndërhyrjet e jashtme. Ngritja e bashkëpunimit në mes të KPK-së dhe Policisë së Kosovës për sigurimin e mbrojtjes për prokurorë në raste të kërcënimeve apo ndërhyrjeve nga jashtë;

4. Instalimi i infrastrukturës së re të teknologjisë informative duke përfshirë një rrjet të avancuar (WAN/LAN), Dhomë të Serverëve sipas standardeve dhe Sistem të menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL);
5. Plotësimin e infrastrukturës ligjore të sistemit prokurorial të Kosovës.

Tabela 1. Historiku dhe Shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Prokurori i Shtetit	4,399,815	5,411,094	6,872,000	6,587,131	6,527,131	6,587,131
Totali i Programeve	4,399,815	5,411,094	6,872,000	6,587,131	6,527,131	6,587,131
Programi i Prokurorëve dhe Administratës	3,727,176	4,611,047	6,059,054	5,814,034	5,754,034	5,814,034
Programi i Prokurorëve Special	672,639	594,968	593,650	563,821	563,821	563,821
Programi i Njësisë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	-	205,079	219,296	209,276	209,276	209,276
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	4,399,815	5,411,094	6,872,000	6,587,131	6,587,131	6,587,131
Nr. i punëtoreve	479	510	641	641	641	641
Paga dhe mëditje	3,252,410	3,880,034	4,842,877	4,842,877	4,842,877	4,842,877
Mallra dhe shërbime	882,720	1,310,512	1,664,264	1,414,624	1,414,624	1,414,624
Shpenzime komunale	164,623	138,482	234,859	199,630	199,630	199,630
Shpenzime kapitale	100,062	82,066	130,000	130,000	70,000	130,000
Burimet e Financimit	4,399,815	5,411,094	6,872,000	6,587,131	6,587,131	6,587,131
Grantet qeveritare	4,359,863	5,411,094	6,631,970	6,347,101	6,28,101	6,347,101
Te hyrat vetanake	39,953	-	240,030	240,030	240,030	240,030

Përmbledhje e Informatave Kyçe të Performancës

Gjatë vitit 2013 prokuroritë e Republikës së Kosovës kanë pasur në punë gjithsej 160,371 lëndë kallëzime-lëndë penale nga të cilat 91,614 janë kallëzime - lëndë penale të mbetura nga viti paraprak, ndërsa 68,757 janë pranuar gjatë vitit 2013. Prej tyre:

- Kallëzime penale të kryesve madhorë të veprave penale gjithsej 39,452 prej tyre të bartura nga viti 2012 janë 13,055, ndërsa të pranuar në vitin 2013 janë 26397. Në fund të vitit 2013 janë zgjedhur 21,446 lëndë.
- Kallëzime penale të kryesve të mitur të veprave penale gjithsej 3,295 prej tyre të bartura nga viti 2012 1,565, ndërsa të pranuar në vitin 2013 janë 1,730. Në fund të vitit 2013 janë zgjedhur 1,426 lëndë.
- Kallëzime penale të kryesve të panjohur të veprave penale gjithsej 83,766 prej tyre të bartura nga viti 2012 janë 69,461 ndërsa të pranuar në vitin 2013 janë 14,305. Në fund të vitit 2013 janë zgjedhur 17,843 lëndë.
- Lëndë të ndryshme penale gjithsej 27,820 prej tyre të bartura nga viti 2012 janë 7,424 ndërsa të pranuar në vitin 2013 janë 20,396. Në fund të vitit 2013 janë zgjedhur 11,358.

- Lëndë e ndihmës juridike ndërkombëtare gjithsej 496, prej tyre të bartura nga viti 2012 89, ndërsa të pranuar në vitin 2013 janë 407. Në fund të vitit 2013 janë zgjedhur 213 lëndë.
- Lëndë e Prokurorisë së Apelit gjithsej 4,674 prej tyre të gjitha janë të pranuar në vitin 2013 pra 4,674. Në fund të vitit 2013 janë zgjedhur 4,674 lëndë.
- Lëndë e Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës gjithsej 868, prej tyre të bartura nga viti 2012 janë 20 ndërsa të pranuar në vitin 2013 janë 848. Në fund të vitit 2013 janë zgjedhur 855 lëndë.
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave gjatë vitit 2013 ka pasur gjithsej 1,128 raste ku përfshihen: dhuna në familje, trafikim me qenie njerëzore, vepra penale kundër integritetit seksual, vrasje.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Misioni

Misioni i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është që të kontribuoj për një menaxhim të shëndoshë financiar në administratën publike, kryerjen e auditimeve sa ma cilësore në pajtim me standardet e auditimit të njohur ndërkombëtarisht dhe krijimin e mirëbesimit në shpenzimin e fondeve publike për të siguruar interesin e taksapaguesve në rritjen e llogaridhënies publike.

Situata aktuale

Aktualisht Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është duke adresuar strategjinë dalëse të Auditorit të Përgjithshëm që synon sigurimin e pavarësisë, qëndrueshmërinë dhe përpjekjet për përgjegjshmëri dhe ndryshim të vazhdueshëm.

ZAP vazhdon me publikimin e raporteve në kohë dhe cilësore të Auditimeve të Rregullsisë duke u bazuar në një qasje të re auditimi. Numri i planifikuar i raporteve të auditimit për këtë sezon është 115, d.m.th. një mbulim i dukshëm më i madh krahasuar me vitet e kaluara.

Vënia në përdorim e Auditimit jo statusor, siç është edhe Auditimi menaxherial, auditimi i performancës dhe auditimi i sistemit ndihmojnë në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe mbikëqyrjes së financave publike. Krijimin e mekanizmave për të vënë para përgjegjësisë entitetet e audituara dhe përcjelljen e tyre dhe modernizimin e qeverisjes së përbashkët.

Objektivat

Për të realizuar misionin e vet, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në periudhën afatmesme planifikon të realizoj këto objektiva:

1. Sigurimi i pronësisë vendore dhe qëndrueshmërisë institucionale;
2. Kontributi në forcimin e qeverisjes së mirë;
3. Zhvillimi dhe ruajtja e cilësisë së auditimit dhe zhvillimit të përbashkët.

Për të realizuar **objektivin e parë** sigurimin e pronësisë vendore dhe qëndrueshmërisë institucionale, ZAP planifikon të realizojë këto aktivitete:

- Të fillohet me zbatimin e ligjit të ri mbi AP dhe ZAP;
- Miratimi i Strategjisë së re të Zhvillimit të Përbashkët;
- Sigurimi i zbatimit të një kulture që orientohet kah rezultatet.

Për të realizuar **objektivin e dytë** kontributi në forcimin e qeverisjes së mirë, ZAP planifikon të realizojë këto aktivitete:

- Konsolidimin e cilësisë së Auditimit të Rregullsisë dhe forcimi i Auditimit të Performancës dhe të Menaxhimit;
- Adresimin e fushave të reja të auditimit dhe futjen në përdorim të një qasje më të fokusuar në sistemin e prokurimit dhe mbi mënyrën se si kryhen shërbimet publike në forma të tjera (PPP, NP, Privatizimi);
- Vazhdimin e hartimit të RVA-së në kohë, me cilësi të rritur, bazuar në përfshirjen më të madhe të auditimit si dhe raporteve të lexueshme;
- Futjen në përdorim të qasjeve të reja, forma dhe masa që synojnë të zhvillojnë dhe përmirësojnë qeverisjen e mirë;
- Zhvillimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me shoqërinë civile në fushën e Reformave në Administratën Publike,

Për të realizuar **objektivin e tretë** zhvillimin dhe ruajtjen e cilësisë së auditimit dhe zhvillimit të përbashkët, ZAP planifikon të realizoj këto aktivitete:

- Forcimi i funksionit të cilësisë;
- Zbatimi i një skeme të re për certifikim të pajtueshme me SNISA;
- Shtimin e numrit të auditorëve të licencuar dhe certifikuar krahas auditorëve të rinj.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	1,929,879	1,984,405	2,130,753	1,988,028	1,988,028	1,988,028
Totali i Programit	1,929,879	1,984,405	2,130,753	1,988,028	1,988,028	1,988,028
Programi Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	1,929,879	1,984,405	2,130,753	1,988,028	1,988,028	1,988,028
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	1,929,879	1,984,405	2,130,753	1,988,028	1,988,028	1,988,028
Nr. i punetoreve	142	144	146	146	146	146
Paga dhe medijtje	1,214,853	1,268,385	1,349,253	1,349,253	1,349,253	1,349,253
Mallra dhe shërbime	615,026	592,293	711,500	604,775	604,775	604,775
Shpenzime komunale	40,000	28,846	40,000	34,000	34,000	34,000
Subvencione dhe transfere		74,500	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	60,000	20,381	30,000	-	-	-
Burimet e Financimit	1,929,879	1,984,405	2,130,753	1,988,028	1,988,028	1,988,028
Grantet qeveritare	1,929,879	1,984,405	2,130,753	1,988,028	1,988,028	1,988,028
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet			-			
Grantet donatore					-	-

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA

Misioni

Ofrimin dhe rregullimin e standardeve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe ujërave të zeza në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme, të besueshme dhe me çmime të përballueshme për konsumatorin, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Situata aktuale

Në Kosovë operojnë shtatë kompani rajonale për ofrimin e ujësjellësit dhe kanalizimit të licencuara nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) si dhe një kompani e cila merret me shitjen e ujit me shumicë.

Gjendja e këtyre kompanive në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit nuk është e kënaqshme dhe përcillet me:

- Nivelin e dobët të faturimit dhe inkasimit nga ofruesit e shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit,
- Nivelin e lartë të shpenzimeve fikse dhe operative nga ofruesit e shërbimeve, dhe
- Humbjet e ujit në shkallë të lartë.

Objektivat

1. Furnizim me ujë 24 orë për konsumatorë sipas standardeve ndërkombëtare;
2. Ngritja e standardeve të shërbimit si dhe ngritja e shkallës së inkasimit dhe faturimit;
3. Mbrojtja e interesave të konsumatorëve ;
4. Faturimi në bazë të leximit të ujëmatësve;
5. Monitorimi dhe raportimi i performancës së ofruesve të shërbimeve.

Tabela 1: Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Zyra Rregullatore për Ujë dhe mbeturina	318,024	313,222	359,000	334,318	334,318	334,318
Totali i Programeve		313,214	359,000	334,318	334,318	334,318
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	318,024	313,214	359,000	334,318	334,318	334,318
Nr. i punëtorëve	19	18	21	21	21	21
Paga dhe mëditje	161,376	163,818	194,450	194,450	194,450	194,450
Mallra dhe shërbime	150,902	143,958	156,900	133,365	133,365	133,365
Shpenzime komunale	5,746	5,438	7,650	6,503	6,503	6,503
Subvencione dhe transfere						
Shpenzime kapitale						
Burimet e Financimit	318,024	313,214	359,000	334,318	334,318	334,318
Grantet qeveritare	318,024	313,214	359,000	334,318	334,318	334,318
Te hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

Tabela 2. Përmbledhje e Informatave Kyçe të Performancës

Indikatorët Kyç te Performancës	2012 aktuale	2012 aktuale	2014 buxheti	2015 plani	2016 plani	2017 plani
Zyra Rregullatorë për Ujësjellës dhe Kanalizim						
Tarifa te përballueshme dhe reale	318,024	313,213	359,000	386,732	386,732	386,732
Standarde te shërbimeve të ujësjellësit						
Monitorimi dhe Mbrojtja e konsumatorëve						

AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE

Misioni

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARRH) rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave rregullon dhe mbikëqyr këto fusha: licensimin, sigurinë, interoperabilitetin, rregullimin e tregut dhe lëshimin, përtëritjen, amendamentimin dhe revokimin e certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë.

Situata aktuale

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është i angazhuar në implementimin e legjislacionit në fuqi për hekurudhat, politikave dhe përkrahjes së zhvillimit të këtij sektori.

Krijimi i kushteve për licencimin e kompanive, Certifikatës së Sigurisë dhe Lejet Speciale për të përafuar standardet e pjesëmarrjes në transportin hekurudhor me vendet në regjion.

Monitorimi–Inspektimi i respektimit të rregullave dhe ligjeve që lidhen me sektorin e hekurudhave (kushtet e licencës, certifikata e sigurisë, krijimi i kushteve për transport të sigurt të mallrave dhe udhëtarëve). Hapja e tregut dhe krijimi i infrastrukturës ligjore jo diskriminuese dhe konkurrenca.

Objektivat

Për ta realizuar misionin e saj, ARRH-ja në periudhën afatmesme planifikon të realizoj këto objektiva:

- Lëshimin e licencave dhe leje speciale për ndërmarrjet hekurudhore konform ligjeve dhe direktivave të BE;
- Të zhvilloj infrastrukturën ligjore në sektorin hekurudhor;
- Të bëjë funksionimin transparent dhe jo-diskriminues të tregut në sektorin hekurudhor në pajtim me “acquis” rregullat e BE dhe
- Afrimi i aranzhimeve të kalimit të kufijve me standardet e BE-së.

Tabela1. Historiku dhe Shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	225,420	305,893	354,200	310,265	310,265	310,265
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	225,420	305,893	354,200	310,265	310,265	310,265
Nr. i punëtorëve	12	20	20	20	20	20
Paga dhe mëditje	106,205	136,104	174,633	174,633	174,633	174,633
Mallra dhe shërbime	95,500	145,383	145,567	123,732	123,732	123,732
Shpenzime komunale	5,860	4,926	14,000	11,900	11,900	11,900
Subvencione dhe transfere						
Shpenzime kapitale	17,855	19,480	20,000			
Burimet e Financimit	225,420	305,893	354,200	310,265	310,265	310,265
Grantet qeveritare	225,420	305,893	354,200	310,265	310,265	310,265
Te hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet						
Grantet donatoret						

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Misioni

Misioni i Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) është të krijojë një ambient të aviacionit civil në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, partneritetit me industrinë dhe nivel të lartë të kompetencës profesionale të personelit.

Situata aktuale

Në përputhje me ligjin dhe me rregullore të nxjerra, AAC-ja ka certifikuar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” për ofrim të shërbimeve aeroportuale dhe për shërbime në tokë. AAC-ja ka licencuar edhe ofruesin e shërbimeve të furnizimit me karburant në Aeroportin e Prishtinës. Po ashtu, janë licencuar edhe kontrollorët e trafikut ajror të Ofruesit të Shërbimeve të Navigimit Ajror dhe kanë dhënë certifikata tjera për shërbime aeronautike për kompani dhe stafin e aviacionit, ashtu siç përcaktohet me ligj dhe rregullore relevante.

Në kuadër të përgjegjësisë për mbikëqyrje të vazhdueshme të sigurisë së aviacionit civil, AAC-ja kryen një numër të madh inspektimesh dhe auditimesh, ku në këtë kuadër, vetëm gjatë vitit 2013 janë kryer 43 inspektime të aeroplanëve të huaj që operojnë në Kosovë. Është kryer edhe auditimi i organizatës së mirëmbajtjes së aeroplanëve që operon në ANP “Adem Jashari”. AAC po ashtu është në shqyrtim e sipër të kërkesës për certifikatë të operatorit ajror nga një kompani aplikuese dhe po vlerëson interesimin për operime me helikopterë në Republikën e Kosovës të disa kompanive tjera. AAC-ja vetëm gjatë vitit të kaluar ka dhënë 45 certifikata për kompani ajrore për bartje të mallrave të rrezikshme.

Republika e Kosovës, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme edhe të AAC-së, për arsye që janë jashtë fushëveprimit dhe përgjegjësisë të AAC-së, nuk është ende anëtare e Organizatës Ndërkombëtare për Aviacionin Civil (ICAO), e Konferencës Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC) dhe as e Organizatës Evropiane për Siguri të Navigacionit Ajror (EUROCONTROL). Pamundësia për të qenë anëtare në organizata të tilla është duke e dëmtuar zhvillimin e industrisë së aviacionit në Kosovë dhe e vështirëson tej mase punën e AAC-së.

Objektivat

Objektivat e AAC për periudhën 2015-2017 janë:

1. Normalizimi i plotë i hapësirës ajrore të Kosovës,
2. Anëtarësimi i Kosovës në Organizata Ndërkombëtare të Aviacionit,
3. Lidhja e marrëveshjeve teknike ndërkombëtare dhe rajonale,
4. Zbatimi me sukses i përgjegjësisë rregullatore,
5. Hartimi dhe Zbatimi i Planit Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit.

Objektivi i parë synon normalizimin e plotë të hapësirës ajrore të Kosovës e cila do të mundësojë që kjo hapësirë të menaxhohet në mënyrë më efikase dhe pritet të ulë shpenzimet e operimeve me fluturake në territorin e Republikës së Kosovës. Përderisa, përgjegjësia për

operim dhe mbikëqyrje për hapësirën e lartë ajrore (mbi 7000 metra) i është dhënë Shtetit të Hungarisë nga NATO-ja, normalizimi i plotë i hapësirë së ulët ajrore dhe hapja e korridoreve të reja për fluturime kërkon një angazhim shumë të madh të stafit të AAC-së.

Objektivi i dytë synon anëtarësimin e Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), në Konferencën Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC) dhe Organizatën Evropiane për Siguri të Navigacionit Ajror (EUROCONTROL).

Objektivi i tretë synon lidhjen e marrëveshjeve teknike me shtete tjera e cila ka rëndësi të veçantë për vendin tonë, duke ditur se Republika e Kosovës ende nuk është anëtare e barabartë e familjes ndërkombëtare të kombeve në fushën e aviacionit civil.

Objektivi i katërt - AAC-ja punon me përkushtim që përmes veprimeve të caktuara, çdo vit, të realizojë plotësisht përgjegjësitë e veta rregullatore. Për shkak se aviacioni është një fushë me ndryshime të vazhdueshme teknologjike dhe rregullatore, zbatimimi i këtij objekti strategjik çdo vit kërkon përkushtim të veçantë.

Objektivi i pestë synon hartimin dhe zbatimin e Programit Shtetëror të Sigurisë, që është kërkesë nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO).

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Autoriteti I Aviacionit Civil të Kosovës	731,568	729,460	783,000	739,426	739,426	739,426
Totali i Programeve	731,568	729,460	783,000	739,426	739,426	739,426
AAC	731,568	729,460	783,000	739,426	739,426	739,426
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	789,558	729,460	783,000	739,426	739,426	739,426
Nr. i punëtorëve	27	27	27	27	27	27
Paga dhe mëditje	379,386	459,035	492,508	492,508	492,508	492,508
Mallra dhe shërbime	339,108	258,700	274,330	233,181	233,181	233,181
Shpenzime komunale	16,043	11,725	16,162	13,738	13,738	13,738
Subvencione dhe transfere						
Shpenzime kapitale						
Burimet e Financimit	731,568	729,460	783,000	739,426	739,426	739,426
Grantet qeveritare	731,568	729,460	783,000	739,426	739,426	739,426
Te hyrat vetanake						
Financimet nga huamarrjet	-	-			-	-

Tabela 3. Përmbledhje e Informatave Kyçe të Performancës

Indikatorët Kyç të Performancës	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 plani	2015 plani	2016 plani	2017 plani
Autoriteti I Aviacionit Civil të Kosovës						
Rregulloret për implementim e Ligjit për Aviacionin Civil dhe Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane Ajrore të nxjerra nga AAC.	7	9	22	15	17	19
Trajtimi dhe hetimi i ndodhive në aviacionin civil në Kosovë, numri i ndodhive.	89	129	140	150	160	170
Inspektimet e aeroplanëve të huaj që operojnë në Kosovë.	40	43	50	60	66	67
Inspektime të planifikuara dhe ad-hoc të Aeroportit dhe të ofruesve të shërbimeve në tokë	10	6	7	9	10	11
Auditimi i organizatës së mirëmbajtjes së aeroplanëve që operon në ANP “Adem Jashari”.		1	2	3	3	3
Auditimi i ofruesit të shërbimeve të kontrollit ajror në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës – Kontrolli Ajror “Adem Jashari”	2	2	3	4	5	5
Shqyrtimi i kërkesave për të marrë certifikatë të operatorit ajror të një kompanie dhe vlerësimi i interesimit për operime me helikopterë në Republikën e Kosovës.	2	4	5	5	5	5
Auditimi i KA “Adem Jashari” si organizatë trajnuese			1	3	4	3
Miratimet e ndryshimeve në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajrore në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës – Kontrolli Ajror “Adem Jashari”.	1	1	4	4	3	3
Dhënja e certifikatave për transport të mallrave të rrezikshme.	34	48	50	52	55	57

KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE

Misioni

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ka për mision lëshimin dhe administrimin e të gjitha lejeve dhe licencave për shfrytëzimin mineral, të kryej mbikëqyrjen teknike të instalimeve minerare dhe të impianteve si dhe të përpilojë rregulloret ligjore, të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës. Me qëllim që të këshillojë investitorët, KPMM bën vlerësimet e burimeve gjeologjike, këshillon investitorët për zonat potenciale të interesit dhe ofron informata për shërbime të orientuara për ndonjë çështje që ka lidhje me interes në botën e shfrytëzimit mineral.

Situata aktuale

Pesha dhe rëndësia e resurseve minerare për vendin tonë është fushë e pa zëvendësuar, kur dihet rezervat potenciale që ka Kosova, traditën dhe përvojën në fushën e xehetarisë. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM-ja është e përkushtuar që të krijojë një ekip të shëndoshë dhe të fuqishëm me staf profesional, bazuar në ngritjen - e kapaciteteve si dhe pajisjeve profesionale. Bashkëpunim të mirë me institucionet e Republikës së Kosovës, ambient të sigurt në aktivitetet minerare, politikë transparente të informatave, bazuar në qasjen publike përmes internetit, lidhje të forta me komunitetin e investuesve ndërkombëtarë dhe atyre vendor, që ti jepet Kosovës një epërsi në fushën e xehetarisë globale.

Objektivat

Objektivat që planifikohen të realizohen janë:

1. Licencimi i kompanive minerare në harmoni me planin për menaxhimin e resurseve minerale dhe Strategjinë minerare;
2. Monitorimi – Inspektimi si dhe zbatimi i të gjitha ligjeve që ndërlidhen me sektorin mineral (respektimi i kushteve të licencës, siguria dhe shëndeti në punë, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e ujërave etj.) nga ana e kompanive të licencuara;
3. Joshja e Investitorëve përmes promovimeve të potencialit mineral që ka dhe ofron Kosova;
4. Aktivitetet hulumtuese (në veçanti të mineralet Metalore dhe ato Energjetike);
5. Shfrytëzimi i Qëndrueshëm i resurseve minerale;
6. Ngritja e nivelit të transparencës dhe komunikimit.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015 - 2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1,505,564	1,683,064	1,758,600	1,149,100	1,239,100	1,099,100
Totali	1,505,564	1,683,064	1,758,600	1,149,100	1,239,100	1,099,100
Nr. i punëtorëve	79	79	79	79	79	79
Paga dhe mëditje	615,801	615,801	645,801	645,801	645,801	645,801
Mallra dhe shërbime	473,763	473,763	402,699	402,699	402,699	402,699
Shpenzime komunale	36,000	36,000	30,600	30,600	30,600	30,600
Subvencione dhe transfere	-	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000
Shpenzime kapitale	380,000	537,500	659,500	50,000	140,000	-
Burimet e Financimit:	1,505,564	1,683,064	1,758,600	1,149,100	1,239,100	1,099,100
Grantet qeveritare	1,505,564	1,683,064	1,758,600	1,149,100	1,239,100	1,099,100

Tabela 3. Përmbledhje e Informatave kyçe te Performancës

Indikatorët Kyç të Performances	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Inspektime te rregullta te kompanitë e licencuara për hulumtim	79	96	108	100	100	100
Inspektime te rregullta te kompanitë e licencuara për shfrytëzim	232	265	251	250	250	250
Inspektime periodike shfrytëzim	58	65	62	60	60	60
Inspektime në objektet kapitale		4				

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Misioni

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik, të cilët ofrojnë shërbime mediave audio dhe audiovizuale.

Situata aktuale

Komisioni i Pavarur për Media menaxhon dhe monitoron brezin frekuencor të transmetimit, monitorimin e çështjeve programore dhe monitorimin e pajtueshmërisë të të licencuarve të KPM-së sipas Ligjit për KPM-në. Komisioni i Pavarur për Media është në përgatitje të strategjisë për kalim në transmetimin Digjital në Republikën e Kosovës si dhe dokumenteve tjera përcjellëse për shërbime mediale audiovizuale.

Objektivat

Për të realizuar misionin e saj, KPM-ja në periudhën afatmesme planifikon të realizojë këto objektiva:

1. Përcjellja e procesit të digjitalizimit në tërë kompleksitetin e vet;
2. Zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben gjithë qytetarëve të Kosovës;
3. Krijimi i kushteve për arkivimin afatgjatë të programeve të monitoruara.

Për të realizuar objektivin e **parë** përcjellja e procesit të digjitalizimit në tërë kompleksitetin, KPM-ja planifikon të realizojë këto veprime:

- Krijimi e politikave për procesin e digjitalizimit;
- Koordinimin me shtetet fqinje për planin frekuencor digjital.

Për të realizuar objektivin e **dytë** zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës, KPM-ja planifikon të realizojë këto veprime:

- Lëshimin e licencave të reja bazuar në vendimin e KPM-së për frekuencat lokale.

Për të realizuar objektivin e **tretë** krijimi i kushteve për arkivim afatgjatë të programeve të monitoruara, KPM-ja planifikon të realizojë këto veprime:

- Monitorimi dhe arkivimi i programeve të licencuara për të siguruar ata që punojnë në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së dhe aktet nënligjore.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Komsioni i Pavarur për Media	668,403	752,987	1,483,539	1,127,174	727,174	727,174
Totali i Programit	668,403	752,987	1,483,539	1,127,174	727,174	727,174
Programi Komisioni i Pavarur per Media	668,403	752,987	1,483,539	1,127,174	727,174	727,174
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	668,403	752,987	1,483,539	1,127,174	727,174	727,174
Nr. i punetoreve	29	39	31	31	31	31
Paga dhe meditje	232,619	296,475	373,769	373,769	373,769	373,769
Mallra dhe sherbime	418,804	430,097	395,770	336,405	336,405	336,405
Shpenzime komunale	16,980	17,086	20,000	17,000	17,000	17,000
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	-	9,329	694,000	400,000	-	-
Burimet e Financimit	668,403	752,987	1,483,539	1,127,174	727,174	727,174
Grantet qeveritare	428,015	752,987	1,483,539	1,127,174	727,174	727,174
Të hyrat vetanake	240,388	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donoret	-	-	-	-	-	-

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Misioni

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, referendumet dhe shpalljen e rezultateve.

Situata aktuale

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vitin 2013 ka organizuar zgjedhjet lokale për asamble komunale në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Pasi që në 25 komuna, asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar me shumë se 50% plus një votë të numrit të përgjithshëm të votave, KQZ-ja organizoi raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave. Gjithashtu në vitin 2014 janë mbajtur zgjedhjet komunale edhe në tri komuna në pjesën veriore të Kosovës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore dhe në përputhje me vendimin e Presidentes ka organizuar dhe administruar këto zgjedhje. Ndërsa, zgjedhjet parlamentare janë planifikuar të organizohen në këtë vit.

Objektivat

Objektivat kryesore në planin afatmesëm 2015-2017 të KQZ-s janë:

1. Rishikimi i rregullave zgjedhore në pajtim me reformën zgjedhore;
2. Mirëmbaja dhe azhurnimi i listëve votuese, trajnimet dhe gatishmëria e stafit për organizim të zgjedhjeve;
3. Organizimi dhe mbajtja e Zgjedhjeve Lokale në vitin 2017.

Për të realizuar **objektivin e parë** “Rishikimi i rregullave zgjedhore në pajtim me reformën zgjedhore” KQZ-ja ka paraparë këto aktivitete:

- Organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve;
- Përpilimi dhe miratimi i fletëvotimeve dhe materialet tjera zgjedhore;
- Mbajtja e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin e Partive Politike në mënyrën e paraparë me këtë ligj.

Për të realizuar **objektivin e dytë** “Mirëmbaja dhe azhurnimi i listave votuese, trajnimet dhe gatishmëria e stafit për organizim të zgjedhjeve” parashihet ky aktivitet:

- Krijimi dhe mbajtja e listës së personave që kanë të drejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta.

Për të realizuar **objektivin e tretë** “Organizimi dhe mbajtja e Zgjedhjeve Lokale në vitin 2017” parashihen këto aktivitete:

- Përgatitja, publikimi dhe paraqitja e të gjitha rezultateve;
- Certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	5,450,939	10,386,190	11,534,930	5,204,632	5,204,632	11,488,041
Totali i Programeve	5,450,939	10,386,190	11,534,930	5,204,632	5,204,632	11,488,041
Sekretariati	741,462	961,197	1,017,517	888,325	888,325	888,325
Zgjedhjet	562,931	5,309,514	6,317,413	116,307	116,307	6,399,716
Fondi per demokratizim	4,146,546	4,115,479	4,200,000	4,200,000	4,200,000	4,200,000
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	5,450,939	10,386,190	11,534,930	5,204,632	5,204,632	11,488,041
Nr. i punetoreve	85	88	88	88	88	88
Paga dhe meditje	567,492	625,591	582,937	582,937	582,937	582,937
Mallra dhe sherbime	615,741	5,584,936	6,480,513	374,904	374,904	6,658,313
Shpenzime komunale	17,023	32,924	61,980	46,791	46,791	46,791
Subvencione dhe transfere	4,146,546	4,115,479	4,200,000	4,200,000	4,200,000	4,200,000
Shpenzime kapitale	104,137	27,260	209,500	-	-	-
Burimet e Financimit	5,450,939	10,386,190	11,534,930	5,204,632	5,204,632	11,488,041
Grantet qeveritare	5,450,939	10,386,190	11,534,930	5,204,632	5,204,632	11,488,041
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	14,870	-	-	-	-	-

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

Misioni

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka për mision mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të organeve të tjera dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.

Situata aktuale

Aktualisht, IAP veprimtarinë dhe funksionimin e vet e zhvillon në Zyrën Qendrore në Prishtinë dhe në zyrat rajonale: Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë, Graçanicë dhe në Mitrovicë, në jug e në veri.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Avokatin e Popullit, si dhe në ligjet e tjera të aplikuara në Republikën e Kosovës, IAP-së i janë bartur shumë përgjegjësi të reja dhe të veçanta. Me bartjen e përgjegjësive të reja për IAP-në përmes ligjeve të reja që priten të miratohen që në vitin 2014 (Ligji kundër Diskriminimit, Ligji për barazi gjinore, etj.) pritet edhe shtimi i mëtejme i vëllimit të punëve, aktiviteteve dhe intensitetit të punës. Sa për ilustrim, vetëm gjatë vitit 2013 është shënuar rritje e rasteve të paraqitura (ankesave) prej rreth 25 % në raport me vitin 2012.

IAP, për vitin 2014, ka të aprovuar 63 pozita/vende të punës, prej tyre 6 zyrtarë të zgjedhur (emëruar) dhe 57 zyrtarë janë shërbyes civilë. Rritja e numrit të personelit për IAP-në, për vitin 2014 në raport me vitin paraprak, ka ngritë mundësitë për zgjerimin dhe zhvillimin e veprimtarisë lidhur me realizimin-përmbushjen e misionit kushtetues në nivel më të mirë dhe më të lartë se në vitin 2013.

Kufizimet themelore të IAP-së, për ushtrimin e kompetencave dhe funksionimin efikas, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, në mënyrë direkte janë të varura nga mungesa e zyrave për punë si në Zyrën Qendrore në Prishtinë gjithashtu edhe në zyrat regjionale/komunale.

Objektivat

Në bazë të mandatit dhe misionit të IAP-it, synimi dhe objektivi themelor i punës së IAP-it është që të ndër marrë veprimet dhe të realizojë hetimin e rasteve, sipas parashtresave të qytetarëve, me qëllim që mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të realizohet me përgjegjësi dhe profesionalizëm.

Objektivat themelore të IAP-së, të cilat synohen të arrihen, janë si në vijim:

1. Rritja e numrit të shqyrtimit dhe hetimit të rasteve të zgjidhura pozitivisht, sipas parashtresave të ligjshme të *ankuesve nga 60 % sa ishte gjatë vitit 2013 deri në 90 %* në vitet 2015 – 2017;
2. Rritja e efikasitetit dhe numrit të trajtimit të rasteve *ex officio* (me vetiniciativë) dhe dhe e analizave të ndryshme ligjore për 100%, si përgjegjësi themelore e punës dhe funksionimit të IAP-së;

3. Ngritja e kapaciteteve profesionale të bashkëpunëtorëve në IAP-it, në fusha të caktuara, që do të përcillet me rritjen kualitative të trajtimit të rasteve , që vazhdimisht përcillet me një rritje kuantitative midis 15-25% për çdo vit;
4. Anëtarësia e rregullt në rrjetet universale dhe regionale të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës”, përkatësisht anëtarësimi i IAP-it në Institucionin Ndërkombëtar të Ombudsmenëve (IOI), në Institutin Evropian të Ombudsmenëve (EOI) dhe anëtarësimi në Rrjetin Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI) dhe pritja për anëtarësim në Komitetin Koordinues Ndërkombëtar të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ICC).

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015 – 2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Institucioni i Avokatit të Popullit	623,318	738,988	1,095,610	1,012,224	1,012,224	1,012,224
Totali i Programeve	623,318	738,988	1,095,610	1,012,224	1,012,224	1,012,224
Institucioni i Avokatit të Popullit	623,318	738,988	1,095,610	1,012,224	1,012,224	1,012,224
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	623,318	738,988	1,095,610	1,012,224	1,012,224	1,012,224
Nr. i punëtorëve	46	51	63	63	63	63
Paga dhe mëditje	369,772	450,248	596,371	596,371	596,371	596,371
Mallra dhe shërbime	234,832	256,900	459,239	390,353	390,353	390,353
Shpenzime komunale	18,714	17,410	30,000	25,500	25,500	25,500
Shpenzime kapitale	-	14,430	10,000	-	-	-
Burimet e Financimit	623,318	738,988	1,095,610	1,012,224	1,012,224	1,012,224
Grantet qeveritare	623,318	738,988	1,095,610	1,012,224	1,012,224	1,012,224

Përmbledhje e informatave kyçe të performancës

Performanca e IAP-së është e varur dhe synohet të arrihet nga:

- Rritja kualitative e punës me shtimin e numrit të trajtimit të rasteve ex officio dhe analizave ligjore të posaçme prej së paku 30% në vitin 2015 në raport me vitin 2014.
- Pas reformave dhe riorganizimit të kryer gjatë vitit 2013 në IAP, ky shtim i efikasitetit, efektivitetit dhe i kualitetit të punës është dëshmuar me rritje prej mbi 23% e numrit të rasteve të pranuar në krahasim me vitin 2012;
- Shkurtim i kohës së trajtimit dhe ngritje e cilësisë së trajtimit të rasteve individuale për 80% në krahasim me vitin 2012;
- Shtim mbi 40% i numrit të raporteve speciale, ex-officio dhe raporteve për raste të veçanta në raport me vitin 2012.

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

Misioni

Misioni i Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) është të promovojë ngritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ngrit kualitetin e kompetencave profesionale dhe interdisiplinare të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë; ngrit kapacitetet profesionale të stafit të gjykatave dhe prokurorive; zhvillojë plane aftësimi dhe veprimtari profesionale kërkimore me qëllim të ngritjes së kualitetit të trajnimeve në mbështetje të gjyqësisë dhe prokurorisë bazuar në standardet më të larta ndërkombëtare.

Situata e Aktuale

Në bazë të ligjit, mandati kryesor i IGJK-së është trajnimi i gjyqtarëve, prokurorëve, kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, trajnimi i profesionistëve të tjerë nga lëmi i gjyqësisë të identifikuar nga IGJK-ja dhe zbatimi i hulumtimeve dhe publikimeve. Mandatin e vet IGJK-ja e realizon përmes programeve trajnuese konkrete të cilat përfshijnë periudha kohore të ndryshme.

Gjatë vitit 2013 IGJK-ja ka hartuar Programin Kornizë të Trajnimeve për 2014-2015. Programi Kornizë i Trajnimeve, për periudhën dy vjeçare, është një përmbledhje e fushave kryesore të punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë të identifikuar nga IGJK e cila do të orientoj hartimin e kurrikulave dhe organizimin e trajnimeve përmes Planit për Zbatimin e Programit Kornizë të trajnimeve. Përmes Programit Kornizë përcaktohet struktura e trajnimeve dhe komponentët e këtij programi.

Sfidat e veçanta të Institutit Gjyqësor të Kosovës për 2014 janë:

- Transformimi eventual i IGJK-së në një Akademi të Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë ka filluar iniciativën për reformim të arsimit ligjor, pjesë e të cilit thuhet të jetë ky transformim;
- Vazhdimi i trajnimeve për gjeneratën e pestë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë (për 29 kandidatë);
- Fillimi i zbatimit të platformës së mësimin në distancë (e-learning);
- Organizimi i trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
- Koordinimi me institucionet e pavarura të sistemit gjyqësor e prokurorial;
- Koordinimi i projekteve të ndryshme të donatorëve të cilët përkrahin IGJK-në;
- Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me institucionet trajnuese ndërkombëtare.

Objektivat

Me qëllim të realizimit të misionit, IGJK-ja në periudhën afatmesme planifikon të realizoj këto objektiva:

1. Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese me cilësi të lartë;
2. Zbatimi i Programit për Hulumtime dhe Publikime;

3. Struktura organizative dhe planet zhvillimore.

Objektivi i parë synon zhvillimin dhe zbatimin e programeve trajnuese të cilësisë së lartë, kurse realizimi i këtij objekti është planifikuar të arrihet përmes këtyre aktiviteteve:

- Hartimi dhe zbatimi i Programit të trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë,
- Organizimi i provimit përgatitor për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë me qëllim të zbatimit të programit fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, përfshirë procesin e vlerësimit të tyre para dhe gjatë trajnimit,
- Hartimi dhe zbatimi i Programit të trajnimit fillestar për kandidatët potencial për gjyqtarë dhe prokurorë,
- Hartimi dhe Zbatimi i Programi Trajnues për Avancim, për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar dhe për ata që kalojnë nga një nivel në tjetrin,
- Hartimi dhe zbatimi i Programit të Trajnimeve për profesionistë të tjerë në lëmin e gjyqësisë të identifikuar nga IGJK-ja..

Objektivi i dytë ka të bëjë me zbatimin e Programit për Hulumtime dhe Publikime. Realizimi i këtij objekti do të bëhet përmes këtyre dy njësive:

- Njësia për hulumtime dhe publikimin e punimeve nga sfera e gjyqësisë dhe prokurorisë dhe
- Njësia për qasje në burime ligjore (bibliotekë) ku përfshihet funksionalizimi i bibliotekës, përfshirë bibliotekën elektronike.

Përmes **objektivit të tretë** synohet avancimi i strukturës organizative dhe planeve zhvillimore. Me qëllim të realizimit të këtij objekti IGJK-ja ka planifikuar të realizojë këto aktivitete:

- Krijimi i programeve dhe metodologjive të reja trajnuese,
- Hartimi i planeve zhvillimore dhe akteve ligjore e nënligjore të IGJK-së,
- Zhvillimi i kapaciteteve të stafit të IGJK-së.

Tabela 1. Historiku dhe Shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Instituti Gjyqësor i Kosovës	441,475	437,164	652,922	560,545	560,545	560,545
Totali	441,475	437,164	652,922	560,545	560,545	560,545
Numri i punëtorëve	21	25	25	25	25	25
Paga dhe mëditje	143,293	151,568	161,745	161,745	161,745	161,745
Mallra dhe shërbime	281,704	272,098	459,177	390,300	390,300	390,300
Shpenzime komunale	16,478	13,498	10,000	8,500	8,500	8,500
Shpenzime kapitale	-	-	22,000	-	-	-
Burimet e Financimit:	441,475	437,164	652,922	560,545	560,545	560,545
Grantet qeveritare	441,475	437,164	652,922	560,545	560,545	560,545
Totali i programit Instituti Gjyqësor i Kosovës	441,475	437,164	652,922	560,545	560,545	560,545
Numri i punëtorëve	21	25	25	25	25	25

Paga dhe mëditje	143,293	151,568	161,745	161,745	161,745	161,745
Mallra dhe shërbime	281,704	272,098	459,177	390,300	390,300	390,300
Shpenzime komunale	16,478	13,498	10,000	8,500	8,500	8,500
Shpenzime kapitale			22,000			
Burimet e Financimit:	441,475	437,164	652,922	560,545	560,545	560,545
Grantet qeveritare	441,475	437,164	652,922	560,545	560,545	560,545

Tabela 2. Permbledhja e informatave kyçe të performancës

	2012	2013	2014	2015 Plani	2016 Plani	2017 Plani
Instituti Gjyqësor i Kosovës						
Indikatori 1 Trajnimi i vazhdueshëm	Janë organizuar 142 aktivitete trajnuese dhe janë trajnuar 1926 gjyqtare, prokurore dhe profesionist e tjerë	Janë organizuar 112 aktivitete trajnuese dhe janë trajnuar 1651 gjyqtarë, prokurorë dhe profesioniste tjerë	IGJK ka hartuar Programin Kornizë 2014-2015. Bazuar në këtë program për këtë vit janë planifikuar 80 aktivitete trajnuese	Bazuar në Programin Kornizë për këtë vit janë planifikuar 120 aktivitete trajnuese	Për këtë vit janë planifikuar 120 aktivitete trajnuese nga të gjitha fushat e së drejtës	Për këtë vit janë planifikuar 120 aktivitete trajnuese nga të gjitha fushat e së drejtës
Indikatori 2 Trajnimi Fillestar	Gjate viti 2012 janë përgatitur 56 kandidat për gjyqtarë/prokurorë nga gjenerata e katërtë e PTF-së	Ka filluar trajnimin gjenerata e pestë prej 29 kandidatëve	Profesionalisht do të përgatiten 29 kandidat për gjyqtarë dhe prokurorë	Do të filloj trajnimin gjenerata e gjashtë e kandidatëve (sipas numrit të caktuar nga KGJK dhe KPK)	Do të diplomoj gjenerata e gjashtë dhe do të filloj trajnimin gjenerata e shtatë (sipas numrit të caktuar nga KGJK dhe KPK)	Do të diplomoj gjenerata e shtatë dhe do të filloj trajnimin gjenerata e re, varësisht nga nevojat e përcaktuara nga KGJK dhe KPK.
Indikatori 3 Trajnimi i avancuar	Janë organizuar 35 aktivitete trajnuese dhe janë trajnuar 438 gjyqtarë dhe prokurorë të avancuar	Janë organizuar 31 aktivitete trajnuese dhe janë trajnuar 864 gjyqtarë dhe prokurorë të avancuar	IGJK ka hartuar Programin Kornizë 2014-2015 përmes të cilit mundësohet numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të avancuara përfshi edhe trajnimin e trajnueseve	Bazuar në Programin Kornizë për këtë vit janë planifikuar 10 aktivitete trajnuese të mbështetura në programet orientuese	Trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të avancuar planifikohen varësisht nga nevojat e paraqitura	Trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të avancuar planifikohen varësisht nga nevojat e paraqitura

<p>Indikator 4</p> <p>Trajnimi për stafin e gjykatave dhe prokurorive</p>	<p>Janë organizuar 9 trajnime për stafin mbështetës ku kane marr pjese 196 zyrtar përmbarues dhe bashkëpunët or profesional</p>	<p>Janë organizuar 5 aktivitete trajnuese për stafin mbështetës për 147 pjesëmarrës, bashkëpunët or profesional dhe zyrtar përmbarues</p>	<p>IGJK ka hartuar Planin e zbatimit për Programin Kornize 2014-2015. Bazuar në këtë program për këtë vit janë planifikuar 10 trajnime për grupin përfitues</p>	<p>Bazuar ne Programin Kornize për këtë vit janë planifikuar 15 trajnime për stafin e gjykatave dhe prokurorive</p>	<p>Për stafin e gjykatave/prokurorive janë planifikuar 15 aktivitete trajnuese</p>	<p>Për stafin e gjykatave dhe prokuroriv e janë planifikuar 15 aktivitete trajnuese</p>
--	---	---	---	---	--	---

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

Misioni

Misioni i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) është zhvillimi dhe mbarëvajtja e një sistemi të pavarur gjyqësor i cili do tu ofrojë shërbime të paanshme të gjithë qytetarëve dhe i cili do të jetë funksional në të gjitha aspektet e organizimit dhe funksionimit të tij.

Sistemi Gjyqësor i Kosovës do të jetë i pavarur, me qasje për të gjithë, i drejtë, efikas dhe i përgjegjshëm në punën e tij dhe i cili do të funksionoi sipas standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës.

Situata aktuale

Sistemi Gjyqësor i Kosovës, përballet me sfida që dalin nga nevoja e rritjes së performancës së gjyqësorit dhe zbatimit të ligjeve në fuqi që janë: Ligji për Gjykatat, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka përfunduar dhe është në proces të realizimit të:

- Ristrukturimit të gjykatave në pajtim me ligjin për gjykata;
- Janë hartuar aktet kryesore nënligjore nga grupi punues i formuar nga KGjK për zbatimin e plotë të Ligjit për Gjykata;
- Ka përfunduar caktimi i gjyqtareve për Gjykatën Supreme, Dhomën e Posaçme, Gjykatën e Apelit, Gjykatat Themelore dhe degët e tyre në bazë të strukturës së re të gjykatave;
- KGjK-ja ka rishqyrtuar zbatimin e Strategjisë Shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetra (2011-2012) si dhe është aprovuar Strategjia e re;
- Është miratuar dhe ka filluar zbatimin e Strategjisë për Teknologji Informative dhe Komunikim (TIK) 2012-2017;
- Është bërë revidimi i strukturës së brendshme të gjykatave për të gjithë nëpunësit civil të administratës gjyqësore konform Ligjit për Gjykata;
- Është vazhduar me investime në infrastrukturën gjyqësore ku ka filluar ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Ferizaj si dhe i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega në Vushtrri si dhe është marrë pëlqimi nga Komuna e Gjakovës për ndërtimin e gjykatës në Gjakovë;
- Ka filluar procesin e ndarjes së buxhetit të KGjK-së në programe të veçanta për gjykatat.

Objektivat

Gjatë periudhës 2015 -2017 Këshilli Gjyqësor i Kosovës planifikon të realizoj misionin e tij përmes arritjes së këtyre objektivave:

1. Zbatimi i dispozitave kushtetuese për një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm si dhe emërimi i gjyqtarëve në bazë të kriterëve objektive;

2. Delegimi i përgjegjësive (decentralizimi) nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përkatësisht Sekretariati i KGJK-së në Gjykata;
3. Krijimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së gjykatave me qëllim të plotësimit të nevojave që dalin nga reforma gjyqësore;
4. Zbatimi i Strategjisë shtetërore për lëndët e vjetra dhe zgjidhja me kohë e të gjitha lëndëve të evidentuara nëpër gjykata.

Objektivi i parë ka për qëllim zbatimin e dispozitave kushtetuese për një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm si dhe emërimi i gjyqtarëve në bazë të kritereve objektive. Këtë objektivi KGJK-ja planifikon ta realizojë përmes këtyre aktiviteteve:

- Emërimi i gjyqtarëve në pozitat vakante;
- Nxjerrja e akteve nënligjore;
- Procedimi me kohë i lëndëve gjyqësore;
- Publikimi i raporteve dhe vendimeve gjyqësore.

Objektivi i dytë ka për qëllim delegimin e përgjegjësive (decentralizimi) nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përkatësisht Sekretariati i KGJK-së në Gjykata”. Me qëllim të realizimit të këtij objektivi janë paraparë të zhvillohen këto aktivitete:

- Ndarja e buxhetit në programe të veçanta për gjykata;
- Sigurimi i pozitave, regrutimi dhe ngritja e kapaciteteve;
- Kontrolli dhe monitorimi i gjykatave.

Objektivi i tretë synon krijimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave me qëllim të plotësimit të nevojave që dalin nga reforma gjyqësore. Këtë objektivi Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka paraparë që ta zhvillojë përmes këtyre aktiviteteve:

- Ndërtimi i objekteve të reja për Gjykatat Themelore në Ferizaj, Gjakovë, Pejë, Prizren dhe degët e tjera të gjykatave;
- Themelimi i degës së re të gjykatës në Fushë Kosovë;
- Funksionalizimi i sistemit informativ për menaxhimin e lëndëve (SIML) në zbatim të strategjisë për TIK;
- Sigurimi i pajisjeve për audio dhe video incizim të seancave në procedurë penale siç parashihet në kodin e procedurës penale.

Objektivi i katërt ka të bëjë me zbatimin e strategjisë shtetërore për lëndët e vjetra dhe zgjidhja me kohë e të gjitha lëndëve të evidentuara nëpër gjykata. Çështja e zgjidhjes së lëndëve të vjetra mbetet synim i përhershëm i KGJK-së, andaj për këtë qëllim janë paraparë këto aktivitete:

- Nxjerrja e planeve të veprimit nga gjykatat;
- Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit nga KGJK;
- Raportimi për realizimin e planit të veprimit.

Tabela1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	16,281,092	16,760,413	20,833,483	19,987,449	19,987,449	18,557,449
Totali i Programeve	16,281,092	16,760,413	20,833,483	19,987,449	19,987,449	18,557,449
Programi i Dhomës ë Posaçme e Gjykatës Supreme	344,517	458,633	550,930	517,929	517,929	517,929
Programi i Gjykatës dhe Sekretariatit	15,701,244	16,080,500	19,947,619	19,151,416	19,151,416	17,721,416
Programi i Njësisë e Shqyrtimit të Performancës Gjyqësore	75,867	63,979	99,755	94,955	94,955	94,955
Programi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor	159,465	157,300	235,179	223,149	223,149	223,149
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	16,281,092	16,760,413	20,833,483	19,987,449	19,987,449	18,557,449
Numri i punëtorëve	1,831	1,844	2,118	2,118	2,118	2,118
Paga dhe mëditje	10,843,325	11,449,464	13,509,921	13,509,921	13,509,921	13,509,921
Mallra dhe shërbime	3,582,897	3,472,471	4,366,587	3,711,599	3,711,599	3,711,599
Shpenzime komunale	484,224	436,544	606,975	515,929	515,929	515,929
Subvencione dhe transfere	158,324	266,374	250,000	250,000	250,000	250,000
Shpenzime kapitale	1,212,322	1,135,560	2,100,000	2,000,000	2,000,000	570,000
Burimet e Financimit	16,281,092	16,760,413	20,833,483	19,987,449	19,987,449	18,557,449
Grantet qeveritare	15,412,867	15,821,818	19,619,583	18,773,549	18,773,549	17,343,549
Te hyrat vetanake	868,225	938,595	1,213,900	1,213,900	1,213,900	1,213,900
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

Tabela 2. Përmbledhje e Informatave Kyçe të Performancës

Indikatorët Kyç të Performancës	2012	2013	2014	2015 Plani	2015 Plani	2015 Plani
Programi Gjykatat dhe Sekretariati						
Numri i lëndëve të zgjidhura në gjykata		419,422	456,980	528,334	528,334	528,334
Numri i gjyqtareve të angazhuar		335	365	422	422	422
Numri mesatar i lëndëve për gjyqtar		1252	1252	1252	1252	1252
Numri i stafit administrativ në gjykata		905	986	1139	1139	1139
Numri mesatar i stafit administrativ për një gjyqtar		2.7	2.7	2.7	2.7	2.7
Shërbimi administrativ / teknik		505	505	505	505	505
Programi Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD)						
Numri i rasteve në ZPD	511	455	455	650	650	650
Numri i inspektorëve/prokurorëve disiplinor të angazhuar	7	7	7	10	10	10
Numri i rasteve për inspektor	73	65	65	65	65	65
Numri i stafit profesional/administrativ në ZPD	13	13	13	18	18	18
Numri mesatar i stafit administrativ për një inspektor	1.8	1.8	1.8	1.8	1.8	1.8
Programi Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore						
Numri i zyrtareve shqyrtues të performances	7	7	7	7	7	7
Numri i performancave për një vit	6	6	6	6	6	6
Numri i subjekteve të performuara për një performancë	6	6	6	6	6	6
Totali i subjekteve të performuar brenda një viti	36	36	36	36	36	36
Programi Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme						
Numri i lëndëve të zgjidhura në DhPGjS		3819	3819	3819	3819	3819
Numri i gjyqtarëve të angazhuar		10+8 staf nderk.	12+8 staf nderk.	12+8 staf nderk.	12+8 staf nderk.	12+8 staf nderk.
Numri mesatar i lëndëve për gjyqtar		381	381	381	381	381
Numri i stafit administrativ ne DhPGjS		25	25	32	32	32
Numri mesatar i stafit administrativ për një gjyqtar		2.7	2.7	2.7	2.7	2.7
Shërbimi administrativ / teknik		4	4	4	4	4

AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS

Misioni

Mandati i Agjencisë Kosovare për Prona (AKP) është të zgjidhë me të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës, kërkesat e pronësisë dhe kërkesat për të drejtë e shfrytëzimit që lidhen me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, që janë pasojë e konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 si dhe një pjesë e mandatit e trashëguar nga ish Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB) siç është zbatimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB) të cilat ishin në pritje të zbatimit, menaxhimin e pronave nën administrimin e DÇPB-së, zbatimi i skemës së qirasë dhe zbatimi i rasteve në kompensim.

Situata aktuale

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranura është 42,696. Është përfunduar publikimi i 42,684 pronave dhe notifikimi i 42,514 pronave. Është përfunduar verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga palët në procedurë për 42,541 lëndë, janë vendosë 40,348 kërkesave nga Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKKP). Është kryer shpërndarja e 38,049 vendimeve për paraqitësit e kërkesave dhe janë zbatuar 23,700 vendime.

Aktualisht janë nën administrim 12,365 prona, prej të cilave janë dhënë me qira 1,074 prona. Janë ushtruar 791 ankese kundër vendimeve të KKKP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës prej të cilave 435 janë vendosur.

Shumica e punës që ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave duhet të përfundojë deri në fund të qershorit 2014 me mundësi që një numër i vogël i kërkesave të mbesin për vendosje në gusht 2014. Procesi i implementimit do të vazhdojë në të njëjtën kohë me procesin e vendimmarrjes dhe planifikohet që procesi i implementimit në përgjithësi të përfundojë në dhjetor 2015.

Gjithashtu AKP-ja do të operojë edhe pas vitit 2015 në mënyrë që të administrojë pronat që janë nën administrimin e saj, të udhëheqë skemën vullnetare të qirasë dhe aktivitete tjera.

Objektivat

Për të realizuar misionin e saj AKP-ja në periudhën afatmesme planifikon të realizojë këto objektiva:

1. Zgjidhja e kërkesave në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe zbatimin e vendimeve;
2. Administrimi i rreth 12,400 pronave dhe në rast të pajtimit të bartësit të së drejtës pronësore/paraqitësit të suksesshëm të kërkesës, marrëveshjet për përfshirjen e tyre në skemën vullnetare të qiradhënies të drejtuar nga AKP-ja. Numri i pronave nën administrim pas vendosjes së të gjitha kërkesave nga KKKP-ë pritet të rritet dukshëm pasi procesi i vendosjes së kërkesave dhe shpërndarjes dhe zbatimit të vendimeve vazhdon si dhe zbatimin e skemës së qirasë;

3. Verifikimi i dokumenteve kadastrale të para vitit 1999 të cilat janë marrë në Kosovë nga Serbia nëse aprovohet projektligji i cili është në procedurë në Kuvendin e Kosovës.

Objektivi i parë – synon zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe zbatimin e vendimeve. Aktivitetet për realizimin e këtij objekti janë:

- Përfundimi i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të kërkesave nga paraqitësit e kërkesave dhe ndonjë palë përgjegjëse;
- Përgatitja e lëndëve për t'ia prezantuar Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) për vendimmarrje;
- Shpërndarja e vendimeve të Komisionit palëve;
- Zbatimin e vendimeve të KKPB-së apo i Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të marra sipas ankesave, përmes dëbimeve për riposedim dhe për mos pagesën e qirasë.

Objektivi i dytë synon administrimin e pronave dhe në rast të pajtimit të bartësit të së drejtës pronësore/paraqitësit të suksesshëm të kërkesës, marrëveshjet për përfshirjen e tyre në skemën vullnetare të qiradhënies të drejtuar nga AKP-ja. Numri i pronave nën administrim pas vendimeve të KKPK-së pritet të rritet dukshëm pasi procesi i vendosjes së kërkesave dhe shpërndarjes dhe zbatimit të vendimeve vazhdon. Aktivitetet për realizimin e këtij objekti janë:

- Administrimi i pronës së paraqitësve të suksesshëm të kërkesës, me kërkesën e tyre,
- Përfshirja e pronës (nëse është e përshtatshme) në skemën vullnetare të qiradhënies me pajtimin e bartësit të së drejtës pronësore;
- Rregullisht do të ndërmerren aktivitete për publikimin e skemës së qiradhënies së pronave për të rritur numrin e qiramarrësve;
- Heqja e këtyre pronave nën administrim ex-officio duke ia kthyer pronën bartësit të së drejtës pronësore.

Objektivi i tretë synon pranimin e dokumenteve kadastrale të para vitit 1999 të cilat janë marrë në Kosovë nga Serbia. Aktivitetet për realizimin e këtij objekti janë:

- Krahasimi i dokumenteve kadastrale dhe identifikimi i dallimeve;
- Vendosja-gjykimi i dallimeve të evidentuara në mes të dokumenteve kadastrale;
- Azhurnimi i evidencave kadastrale sipas vendimeve të plotfuqishme të Komisioni për Verifikim dhe Vendosje për Prona gjegjësisht Gjykatës Supreme. Në rast të ankesës kundër vendimit të Komisionit.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

AKP	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 plani	2016 plani	2017 plani
Totali i Programit sipas kategorive ekonomike	1,757,204	1,733,854	1,782,000	1,672,569	1,672,569	1,672,569
Nr. i punëtorëve	242	242	242	242	242	242
Paga dhe mëditje	898,925	905,258	956,462	956,462	956,462	956,462
Mallra dhe shërbime	657,130	629,276	635,028	539,774	539,774	539,774
Shpenzime komunale	131,794	119,969	96,510	82,333	82,333	82,333

Subvencione dhe transfere		6,000				
Shpenzime kapitale	69,355	73,351	94,000	94,000	94,000	94,000
Burimet e Financimit	1,757,204	1,733,854	1,782,000	1,672,569	1,672,569	1,672,569
Garantët qeveritare	1,746,045	1,733,854	1,782,000	1,672,569	1,672,569	1,672,569
Të hyrat vetanake	11,160					
Garantët donatoret	1,630,729	1,598,188	1,493,808	1,493,808	1,493,808	1,493,808

Tabela 2. Indikatorët kyç të performancës

Indikatorët Kyç të Performancës	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	aktuale	aktuale	buxheti	plani	plani	plani
Pranimi i kërkesave dhe njoftimi i palëve						
Numri i kërkesave të pranuar	42,347	42,696	42,900	-	-	-
Numri i kërkesave të publikuara	41,096	41,146	42,900	-	-	-
Numri i Gazetës së AKP-së (nr. i buletinit të shpërndarë)	-	2	2	-	-	-
Numri i buletinit të shpërndarë	-	10,000	10,000	-	-	-
Numri I fletëpalosjeve dhe materialeve informuese të shpërndara	22,100	400	500	500	17,000	17,000
Numri i pronave të identifikuar (notifikuara)	41,660	42,509	42,900	-	-	-
Numri i dokumenteve të verifikuara	10,319	5,475	2,850	9,000	8,000	12,000
Përpunimi i kërkesave						
Numri i kërkesave të vendosura - gjykuara	11,220	4,733	1,049	-	-	-
Numri i kërkesave të reja të vendosura	5,057	3,684	940	-	-	-
Numri i kërkesave të rivendosura	6,163	1,049	109	-	-	-
Përqindja e kërkesave që i përkasin kategorisë- Tokë bujqësore (%)	88%	72%	64%	-	-	-
Përqindja e kërkesave që i përkasin kategorisë- Pronë komerciale (%)	2%	8%	12%	-	-	-
Përqindja e kërkesave që i përkasin kategorisë- Pronë banesore(%)	10%	20%	24%	-	-	-
Numri i vendimeve të shpërndara	14,822	7,964	8,123	4,874	-	-
Numri i vendimeve të zbatuara	7,357	7,838	7,995	6,556	5,330	-
Numri i ankesave kundër vendimeve të shpërndara	167	516	791	892	-	-
Administrimi i pronës						
Numri i pronave nën administrim	8,186	12,138	16,000	20,000	21,000	21,500
Numri i pronave bujqësore nën administrim	5,386	9,207	12,400	16,000	16,880	17,500
Numri i pronave komerciale nën administrim	8	31	100	200	220	200
Numri i pronave banesore nën administrim	2,792	2,900	3,500	3,800	3,900	3,800
Përqindja e pronave të lëshuara me qira (%)	17%	18%	18%	20%	17%	17%
Numri i pronave të reja të përfshira në skemën e qirasë	200	253	250	250	200	200
Të hyrat e grumbulluara nga pronat me qira	612,579	592,259	572,626	572,626	572,626	572,626
Të hyrat e transferuara te pronarët e identifikuar	531,773	494,770	478,372	478,372	478,372	478,372

Të hyrat që mbahen depozitë për pronarët e paidentifikuar (EUR)	48,829	48,579	46,955	46,955	46,955	46,955
Të hyrat të cilat mbahen depozita të sigurisë	30,416	15,857	15,289	15,289	15,289	15,289
Shpenzimet administrative të zbatimit të skemës vullnetare të qirasë	20,504	27,616	23,919	23,919	23,919	23,919
Aktivitetet e dëbimit						
Numri i dëbimeve	832	789	-	-	-	-
Numri i dëbimeve për uzurpim të paligjshëm	416	301	-	-	-	-
Numri i dëbimeve për ri-posedim	161	226	-	-	-	-
Numri i dëbimeve për mos pagesë të qirasë	120	93	-	-	-	-
Numri i dëbimeve për refuzim për të hyrë në marrëveshje të qirasë	135	169	-	-	-	-

AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Misioni

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP) duke pasur status të pavarur, ka përgjegjësinë ligjore për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale. Këshill dhënia organeve publike dhe private, marrja e vendimeve për ankesat e paraqitura, inspektimet dhe kontrollet, informimi i publikut si dhe promovimi e përkrahja e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale janë pjesë e fushë veprimtarisë kryesore në kuadër të misionit të Agjencisë.

Situata aktuale

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është në proces të hartimit të legjislacionit të nevojshëm me akte nënligjore të Agjencisë. Në këtë mënyrë Agjencia dëshiron të sigurohet që të drejtat e çdo individi për privatësi të mbrohen gjatë përpunimit të të dhënave personale. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është themeluar në qershor të 2011 dhe për këtë kohë ka arritur të konsolidojë personel profesional, duke qenë në përkushtim të vazhdueshëm për krijimin e një strukture me staf kompetent, dhe profesionalisht të përgatitur me tendencën e vetme krijimin e një administrate efikase dhe profesionalisht të qëndrueshme.

Objektivat

Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj në periudhë afatmesme, ASHMDHP planifikon të realizojë këto objektiva:

1. Edukimin e kontrollerëve;
2. Thellimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve me organet dhe institucionet tjera, si dhe me mekanizmat dhe institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë;
3. Trajtimi i ankesave;
4. Ngritja e kapaciteteve dhe funksionalizimi i plotë;

Për të realizuar **objektivin e parë** edukimin e kontrollerëve, ASHMDHP-ja planifikon të realizoj këto aktivitete:

- Organizimin e punëtorive, seminareve;
- Dhënia e këshillave të përpunimit të të dhënave.

Për të realizuar **objektivin e dytë** thellimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve me organet dhe institucionet tjera si dhe me mekanizmat dhe institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, ASHMDHP-ja planifikon të realizoj këto aktivitete:

- Inspektimet në bazë të planit vjetor të të gjithë kontrolleret publike dhe private të cilët përpunojnë një numër të madh të të dhënave personale.

Për të realizuar **objektivin e tretë** trajtimi i ankesave, ASHMDHP-ja planifikon të realizoj këto aktivitete:

- Trajtimi dhe shqyrtimi i ankesave me prioritet të lartë brenda institucionit.

Për të realizuar **objektivin e katërt** ngritja e kapaciteteve dhe funksionalizimi i plotë, ASHMDHP-ja planifikon të realizoj këto aktivitete:

- Krijimi i kurikulës për trajnimin e zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave.

Tabela 1: Historiku dhe shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
ASHMDHP						
Totali	281,001	361,811	396,000	321,700	321,700	321,700
Nr. i punëtorëve	17	19	23	23	23	23
Paga dhe mëditje	141,724	159,772	184,000	184,000	184,000	184,000
Mallra dhe shërbime	105,619	147,111	150,000	127,500	127,500	127,500
Shpenzime komunale	7,960	11,569	12,000	10,200	10,200	10,200
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	25,698	43,359	50,000	-	-	-
Burimet e Financimit:	281,001	361,811	396,000	321,700	321,700	321,700
Garantët qeveritare	281,001	361,811	396,000	321,700	321,700	321,700
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Garantët nga donatorët	-	9,290	-	-	-	-

RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS

Misioni

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është shërbim publik transmetues, që ofron shërbimet e veta në fushën e transmetimit radioteleviziv dhe kryen veprimtari të tjera, sipas Ligjit për RTK-në.

Misioni i RTK-së është që t'i ofroj audiencës informim objektiv dhe të balancuar, program cilësor edukativ, kulturor dhe argëtues si dhe të inkurajoj zhvillim harmonik të demokracisë dhe të tolerancës.

Situata aktuale

RTK-ja është duke investuar në digjitalizimin kalimtar të produksionit, derisa ekspertët e teknologjisë dhe transmetimit kanë bërë studime konkrete në terren për shtrirjen e rrjetit të digjitalizimit të RTK-së.

RTK-ja është duke bërë investime në hapësirat e reja, investime në studio të reja për të bërë të mundshëm një efikasitet më të madh në punë.

Në vitin 2013 ka filluar transmetimi i kanalit të dytë televiziv në gjuhën serbe me seli në Prishtinë, ku ka filluar me disa orë program dhe pas tre muajve është zgjeruar me 24 orë program të transmetuar dhe prej tyre rreth 10 orë program të prodhuar me kapacitetet e veta.

Informacionit si shtyllë më të fortë RTK-ja vazhdon t'i jap rëndësi të madhe, ku dy kanalet televizive transmetojnë 20 edicione të lajmeve në ditë.

Emisionet më të shikuara në mbarë globin shfaqen edhe në RTK.

Rëndësi e veçantë ju është dhënë emisioneve argëtuese dhe sportit. RTK-ja edhe gjatë vitit 2013 ka transmetuar ligen e kampionëve, ligen e Evropës, në qershor kampionatin evropian të basketbollit për femra, gjatë verës kampionatin botëror të atletikës, në shtator kampionatin botëror të basketbollit për meshkuj, në dhjetor kupën e federatave në futboll.

Gjithashtu RTK-ja i jep rëndësi edhe promovimit të sportit vendor. RTK-ja ka nënshkruar marrëveshje me klubin basketbollistik Sigal Prishtina dhe është duke transmetuar ligën Ballkanike në basketboll. Po ashtu është realizuar marrëveshja për transmetimin e klubit hendbollistik Prishtina si në kampionatin vendor ashtu edhe në atë evropian.

Objektivat

1. Transmetimi i Kampionatit Botëror të Futbollit që mbahet në Brazil dhe kampionatit botëror të basketbollit për femra dhe meshkuj;
2. Digjitalizimi i arkivës;
3. Transmetimi digjital;

4. Në kanalin RTK3 dhe RTK4 do të krijohen hapësira të reja për më shumë programe atraktive informative por edhe argëtuese, edukative dhe kulturore.

Tabela 1. Historiku dhe shpenzimet e politikave bazë 2015-2017

	2012 aktuale	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vleresimi	2016 Vleresimi	2017 Vleresimi
Radio Televizioni i Kosoves	8,909,999	9,761,000	8,848,000	9,768,500	9,739,800	9,906,400
Totali i Programeve	8,909,999	9,761,000	8,848,000	9,768,500	9,739,800	9,906,400
Radio Televizioni I Kosoves	8,909,999	9,761,000	8,848,000	9,768,500	9,739,800	9,906,400
Totali i Programeve sipas kategorive ekonomike	8,909,999	9,761,000	8,848,000	9,768,500	9,739,800	9,906,400
Nr. i punetoreve	-	-	-	-	-	-
Paga dhe meditje	-	-	-	-	-	-
Mallra dhe sherbime	-	-	-	-	-	-
Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-
Subvencione dhe transfere	8,909,999	9,761,000	8,848,000	9,768,500	9,739,800	9,906,400
Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Burimet e Financimit	8,909,999	9,761,000	8,848,000	9,768,500	9,739,800	9,906,400
Grantet qeveritare	8,909,999	9,761,000	8,848,000	9,768,500	9,739,800	9,906,400
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-	-

AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS

Misioni

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK), ka për mision krijimin e mundësive për funksionimin e Agjencisë në pajtim me Ligjin në fuqi, duke u bazuar në planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, dhe është kompetent për të gjitha Komplekset dhe Memorialet e Kosovës dhe që plani i menaxhimit të jetë në harmoni me standardet vendore dhe ndërkombëtare.

Situata aktuale

Deri më tani jemi në hartim e sipër të Strukturës organizative të Agjencisë e cila përcaktohet sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së AMKMK-së dhe organogramit përkatës e cila aprovohet nga Drejtori i AMKMK-së.

Agjencia do të funksionoj me stafin e brendshëm që do të jenë të punësuar në Agjenci dhe me stafin që do të jenë të punësuar në Komplekse dhe Memoriale.

Objektivat:

1. Krijimi i një sistemi kompakt për komplekset dhe memorialet e Kosovës;
2. Planifikimi dhe zbatimi i projekteve; Ndërtimi i Kompleksit Memorial “Adem Jashari”;
3. Menaxhimi i Komplekseve dhe memorialeve;
4. Qasja dhe vizitat në Komplekse dhe Memoriale.

Tabela1. Historiku dhe Shpenzimet sipas skenarit bazë 2015-2017

	2013 aktuale	2014 buxheti	2015 Vlerësimi	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale te Kosovës					
Totali	769,344	1,167,068	2,086,818	86,818	86,818
Nr. i punëtorëve	4	9	9	9	9
Paga dhe mëditje	13,413	57,068	57,068	57,068	57,068
Mallra dhe shërbime	10,000	30,000	25,500	25,500	25,500
Shpenzime komunale	-	5,000	4,250	4,250	4,250
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-
Shpenzime kapitale	745,931	1,075,000	2,000,000	0	0
Burimet e Financimit:	769,334	1,167,068	2,086,818	86,818	86,818
Grantet qeveritare	769,334	1,167,068	2,086,818	86,818	86,818
Te hyrat vetanake	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Grantet donatoret	-	-	-	-	-

KASH Komunal 2015-2017

Financimi komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake komunale për vitin 2015 si dhe vlerësimet për vitin 2016-2017, si pjesë integrale e KASH-it 2015-2017

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Komunale parimisht ofron deklarin e prioriteteve strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare dhe prezanton shumat agregate të granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin fiskal 2015 si dhe parashikimin afatmesëm 2016-2017 në Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale si pjesë integrale e KASH-it 2015-2017.

Nga aspekti i kornizës së re ligjore për vitet 2009-2015, sistemi i financimit komunal ka pësuar reforma progresive përkatësisht ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të financimit. Parimet, kriteret dhe formulat bazë të zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2015, si dhe pjesëmarrja e buxhetit komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës, janë strukturuar në linjë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) duke respektuar kalendarin buxhetor të përcaktuar me LMFPP.

Komisioni i Granteve me datë 22 prill 2014 ka aprovuar grantet qeveritare dhe projeksionet e të hyrave vetanake sipas komunave në periudhën afatmesme, të bazuar në propozim-grantet specifike nga ministritë e linjës MASHT dhe MSH, duke marrë për bazë aspektet në vijim:

- **Respektimi dhe zbatimi i parimeve të përgjithshme të përcaktuara në LFPL;**
- **Analizat e standardeve sektoriale të ofruara nga ministritë përgjegjëse për arsim dhe shëndetësi;**
- **Formulat shtetërore për arsimin parauniversitar dhe shëndetësinë primare, për alokimin e granteve specifike në arsim dhe shëndetësi sipas komunave;**
- **Korniza makro-fiskale si bazë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, në kuadër të prioriteteve qeveritare.**

Komunat, nga viti në vit kanë pasur një shkallë të rritur të decentralizimit fiskal dhe transparencës së buxhetit komunal në formulimin, regjistrimin/ekzekutimin dhe raportimin e buxhetit.

Në nivelin e aranzhimit institucional ndërministror, Sekretaria e Komisionit të Granteve me datë 29 janar 2014, ka dërguar shkresat zyrtare tek ministritë e linjës MASHT, MSH, MAPL, dhe MPMS, për përgatitjen e propozim-granteve specifike për arsim parauniversitar dhe shëndetësi primare për vitin 2015 dhe vlerësimet për vitin 2016-2017, përfshirë edhe financimin për shëndetësinë sekondare si kompetencë e shtuar. Sekretaria e Komisionit të Granteve në Ministrinë e Financave, në pajtim me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe kalendarin buxhetor të përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), me datë 31 mars 2014 ka zhvilluar takimin e parë informues me anëtarët e rinj të Komisionit të Granteve, përkatësisht me katër kryetarët e komunave: Fushë Kosovë, Podujevë, Hani i Elezit dhe Leposaviq, ku janë shpalosur dy prezantime: a) roli dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit të Granteve me mandat njëvjeçar si dhe b) zhvillimi i procesit buxhetor mbi planifikimin e buxhetit për vitin vijues fiskal, përfshirë konceptin e

planifikimit shumëvjeçar. Gjithashtu, Sekretaria e Komisionit të Granteve ka zhvilluar takime konsultative edhe me autoritetet komunale për vlerësimet e hershme buxhetore, si dhe me Departamentin e Makroekonomisë, Departamentin e Buxhetit Qendror, Partneritetin Publiko Privat (PPP), Departamentin e Tatimit në Pronë, Integrimet Evropiane në MF, Zyrën e Kryeministrit dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar si FMN, BB, KE, USAID, OSBE etj.

Sistemi aktual i financimit komunal përbën decentralizimin fiskal të avancuar, komunat kanë kompetenca të konsiderueshme për shpenzimet, kompetenca për ofrim të shërbimeve publike, autorizime për mbledhjen e të hyrave, dhe autoritet të gjerë në menaxhimin e financave publike.

Përkushtimi i përgjithshëm për të përmirësuar elementet kyçe të procesit të zhvillimit të buxhetit komunal, ka kërkuar edhe disa ndryshime në formatin e prezantimit të buxhetit komunal. Prandaj, jemi mbështetur në aspektet kryesore të mëposhtme të procesit buxhetor, si vijon:

- **Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,**
- **Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,**
- **Zbatimi i konceptit mbi planifikimin shumëvjeçar të buxhetit/kapitaleve dhe prezantimi i të gjitha zërave të buxhetit për vitin paraprak, vitin e tanishëm buxhetor dhe për dy vitet pasuese.**

Futja në përdorim e buxhetimit kapital shumëvjeçar, përfshirë këtu integrimin e informatave për rezultatet e planifikuara në sistemin e PIP-it, dhe buxhetimin në bazë të performancës. Gjatë këtij viti komunat do të hartojnë për secilin program strategjinë me synimet dhe objektivat përkatëse, për arritjen e rezultateve dhe performancës gjatë procesit buxhetor.

Propozimi i buxhetit komunal për vitin 2015-2017

Duke u nisur nga përvojat e deritanishme dhe me qëllim të vazhdimit të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2015 do të ndërtohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nën-programeve. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

1 Burimet e Financimit Komunal për vitin 2015-2017

Financimi komunal përfshinë: Grantin e përgjithshëm, Grantin specifik për Arsim dhe Grantin specifik për Shëndetësi, përfshirë financimin për shëndetësi sekondare, grantet për kompetencat e shtuara, projeksionet e të hyrave vetanake të komunave, transferet për kompetencat e shtuara dhe deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Grantet bazohen në kritere të drejta, transparente dhe objektive, duke ju dhënë kështu komunave pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin e tyre.

Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opcion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFPP të dakorduar me Misionin e FMN-së.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.

Financimi komunal agregat për komuna për vitin 2015-2017 (mil. Euro)

Përshkrimi	2011 Aktuale	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Aktuale	2015 Buxheti	2016 Parashikimi	2017 Parashikimi
1. Grantet qeveritare	295.90	298.83	309.92	319.52	332.07	335.17	338.80
Granti i përgjithshëm	114.20	118.70	128.30	137.57	145.76	145.59	147.94
Granti i përgjithshëm bazë				127.80			
Ndikimi nga regjistrimi i popullsisë 2011, sipas nenit 35 të LFPL				9.77			
Granti specifik për shëndetësi	38.20	39.83	40.43	39.39	42.08	43.92	44.92
Granti specifik për arsim	143.50	140.30	141.19	142.56	144.23	145.66	145.94
Financimi bazë	142.85	139.09	140.32	142.22	143.89	145.32	145.60
Politikat e reja dhe ne vazhdim:	0.65	1.21	0.87	0.34	0.34	0.34	0.34
Qendrat e ekselencës	0.04	0.43	0.87	0.34	0.34	0.34	0.34
Gjuha angleze	0.46	0.78					
Orët e kujdestarisë							
Pedagogët	0.15						
Arsimi joformal							
Kostoja e licencimit							
2. Grantet për kompetencat e	2.85	2.60	2.60	1.85	2.60	2.60	2.60
Kujdesi shëndetësor dytësor	2.85	2.60	2.60	1.85	2.60	2.60	2.60
3. Transferi i Shërbimeve rezidenciale nga MPMS në Skenderaj dhe Graçanicë	-	0.00	0.00	0.24	0.24	0.24	0.24
Shërbimet rezidenciale				0.24	0.24	0.24	0.24
4. Të hyrat vetanake komunale	51.88	60.00	63.00	67.23	74.24	75.63	76.80
5. Financimi kontingjent për decent.	1.50	-	-	-	-	-	-
MAPL (komunat e reja)	1.50						
6. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL	352.13	361.43	375.52	388.84	409.16	413.64	418.44
7. Kontigjenca nga Buxheti Qendror për financimin e rritjes së pagave 25%					10		
8. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL, përfshirë kontigjencën e pagave	352.13	361.43	375.52	388.84	419.16	413.64	418.44

Koment: kostoja e rritjes së pagave 25% për komunat sipas Vendimit të Qeverisë, bazuar në kalkulimin e Payroll/MAP është 42,597,672 euro. Kontigjenca nga Buxheti Qendror për financimin e rritjes së pagave të nivelit komunal është 10,000,000 euro.

Total Financimi Komunal për vitin 2015

Nr	Komuna	Granti i përgjithshëm	Granti specifik për Arsim parauniversitar	Granti specifik për Shëndetësi primare	Shëndetësia sekondare	Financimi i Shërbimeve rezidenciale	Të hyrat vetanake komunale	Total financimi komunal për vitin 2015
1	Deçan	3,197,970	2,335,075	946,169			636,892	7,116,106
2	Dragash	3,394,042	2,302,135	803,791			487,030	6,986,998
3	Ferizaj	8,184,958	10,151,546	2,567,866			4,204,689	25,109,059
4	Fushë Kosovë	2,823,176	2,377,659	823,415			1,822,756	7,847,006
5	Gjakovë	7,487,928	7,004,055	2,235,588			3,026,311	19,753,880
6	Gjilan	6,854,173	8,434,193	2,132,078			3,859,953	21,280,398
7	Glogoc	4,458,511	4,776,086	1,383,848			1,200,874	11,819,319
8	Hani i Elezit	865,478	657,149	222,315			256,258	2,001,199
9	Istog	3,369,804	3,046,842	928,910			1,014,149	8,359,705
10	Junik	624,322	390,710	143,844			91,567	1,250,443
11	Kaçanik	2,647,217	2,543,525	789,889			695,757	6,676,387
12	Kamenicë	3,073,614	2,552,349	853,158			986,433	7,465,553
13	Klinë	3,127,917	3,235,182	910,161			857,767	8,131,028
14	Leposaviq	2,170,664	756,462	325,635			42,888	3,295,649
15	Lipjan	4,563,123	4,788,278	1,361,955			1,342,336	12,055,693
16	Malishevë	4,207,847	5,734,881	1,291,215			755,908	11,989,850
17	Mamusha	818,191	359,283	130,202			64,869	1,372,544
18	Mitrovicë	5,523,924	5,942,343	1,700,144			2,117,292	15,283,703
19	Novo Bërdë	897,591	673,459	159,094			204,672	1,934,815
20	Obiliq	1,797,298	1,786,246	509,483			811,716	4,904,743
21	Pejë	7,698,527	7,244,248	2,280,367			3,394,551	20,617,693
22	Podujevë	6,869,251	7,296,487	2,092,382			1,597,592	17,855,711
23	Prishtinë	14,699,843	15,042,433	4,702,522			27,162,609	61,607,406
24	Prizren	14,356,806	12,962,591	4,203,276			8,275,080	39,797,754
25	Rahovec	4,332,840	4,413,520	1,328,926			1,099,014	11,174,300
26	Shtërpcë	946,649	924,102	164,295	522,371		336,282	2,893,700
27	Shtime	2,193,109	2,438,510	646,021			445,503	5,723,143
28	Skenderaj	4,000,159	4,977,597	1,202,436		133,000	748,155	11,061,347
29	Suharekë	4,629,414	5,104,092	1,412,007			2,117,200	13,262,714
30	Viti	3,653,448	3,898,703	1,110,914			1,008,847	9,671,911
31	Vushtri	5,343,079	5,596,231	1,651,936			1,675,327	14,266,573
32	Zubin Potok	1,206,609	379,176	156,422			42,888	1,785,096
33	Zveçan	1,118,441	323,938	176,873			42,888	1,662,140
34	Gracanicë	1,614,815	1,385,453	252,389	1,090,771	110,000	1,501,093	5,954,520
35	Klllokot	384,206	235,022	60,432			86,849	766,508
36	Mitrovica e Veriut	1,606,553	1,450,219	291,424	989,935		90,066	4,428,196
37	Partesh	369,860	318,281	42,250			46,384	776,775
38	Ranillug	648,646	392,269	91,404			92,768	1,225,086
TOTAL		145,760,000	144,230,328	42,085,037	2,603,077	243,000	74,243,213	409,164,654

Kontigjenca nga Buxheti Qendror për rritjen e pagave 25% për Nivelin Komunal

10,000,000

Total Financimi Komunal

419,164,654

KOMUNAT- Struktura agregate e shpenzimeve për vitin 2015

Komuna	Paga dhe mëditje (fondi 10 dhe 21)	Shpezimet operative nga fondi 10 dhe 21 (mallrat, komunalitë, subvencionet)	Shpezimet Kapitale (fondi 10 dhe 21)	Total
TOTAL	241,314,535	57,850,119	120,000,000	419,164,654

Koment: Rezervat e pashpërndara në shumë prej 3,991,027 euro në kuadër të shpenzimeve operative do të ndahen në procesin buxhetor për të mbuluar financimin e pagave apo shpenzime tjera operative varësisht si do të zhvillohet procesi buxhetor.

1.1 Granti i Përgjithshëm

Komunat do të pranojnë Grantin e përgjithshëm, të përcaktuar si grant me sistem të mbyllur dhe do ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të caktuara komunale në përputhje me kuadrin ligjor.

Granti i Përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë në të hyrat komunale, gjithashtu është mjet adekuat për vendosjen e barazive ndërmjet komunave, dhe mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitet pakicë në komunat përkatëse.

Bazuar në LFPL, shuma e Grantit të përgjithshëm është e përcaktuar me dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja.

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushalle) prej 140,000 € minus 1 € për kokë banori, ose 0 € për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Kriteret bazë të formulës për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna janë:

Numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%).

Granti i përgjithshëm në shumë prej 145,760,000 euro për vitin 2015 është aprovuar nga Komisioni i Granteve me datë 22 prill 2014, sipas parimeve, kriterëve dhe formulës bazë të përcaktuar në LFPL.

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS-ja në komuna përmes memorandumeve të mirëkuptimit, është përfshirë në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës.

Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim parauniversitar, në pajtim me parimet dhe kriteret e përcaktuara në LFPL, duhet të financohen nga Granti i Përgjithshëm në komuna.

Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Shëndetësi primare dhe Shëndetësi sekondare (Graçanicë, Shtërpçë dhe Mitrovicë veriore), në pajtim me parimet dhe kriteret e përcaktuara në LFPL, duhet të financohen nga Granti i Përgjithshëm në komuna.

Për zbatimin e nenit 35 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 dhe të publikuara zyrtarisht nga ASK në muajin dhjetor 2012, përfshirë vlerësimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për katër komunitet minoritare të cilat nuk kanë marrë pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë, si: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë veriore. Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim Nr.09/121 të datës 27.03.2013 ka aprovuar ndryshimin e Shtojcës 1 të LFPL për numrin e ri të popullsisë, si dhe paragrafi 2 i këtij vendimi për zbatimin e nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, viti 2014 do të jetë vit tranzitor. Ndërsa, me Vendimin e Qeverisë Nr. 07/170 datë 14.02.2014 është aprovuar plotësim/ndryshimi i Shtojcës I të LFPL për numrin e popullsisë për katër komunitet veriore Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë veriore, dhe sipas pikës 1 të këtij vendimi do të vlejë vetëm për vitin 2014, ndërsa nuk do të ketë efekte për vitet pasuese, dhe marrja e vendimit nga Komisioni i Granteve është bazuar në statistikat e Shtojcës I të aprovuar në Qeveri me Vendim Nr.09/121 të datës 27.03.2013.

Struktura e Grantit të Përgjithshëm për periudhën 2011-2017 (mil. Euro)

Kriteret	Faktorët	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
		Buxheti	Buxheti	Buxheti	Aktual	Buxheti	Vlerësimi	Vlerësimi
Shuma agregate	Të hyrat buxhetore (mil euro)	1,056.0	1,187.0	1,283.0	1,278.0	1,457.6	1,455.9	1,479.4
	10% e të hyrave buxhetore (mil euro)	105.5	118.7	128.30	127.80	145.76	145.59	147.94
Kosto shtesë nga Niveli Qendror	<i>Ndikimi nga regjistrimi i popullsisë 2011, sipas nenit 35 të LFPL</i>				9.77			
Elementet	Shuma Fikëse	3.40	3.40	3.40	3.63	3.63	3.63	3.63
	Popullsia	2,236,963	2,236,963	2,236,963	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021
	Parametri: 89% e shumës agregate	90.91	102.6	111.2	110.5	118.06	121.4	122.5
	Zona komunale (km2)	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901
	Parametri: 6% e shumës agregate	6.13	6.9	7.5	7.45	7.9	8.2	8.3
	Komunitetet pakicë në komunë	116,599	116,599	116,599	107,926	107,926	107,926	107,926
	Parametri: 3% e shumës agregate	3.06	3.5	3.7	3.7	3.9	4.3	4.1
	Popullsia e komunave pakicë	130,255	130,255	130,255	62,031	62,031	62,031	62,031
	Parametri: 2% e shumës agregate	2.04	2.3	2.5	2.4	2.6	2.7	2.7
Total granti i përgjithshëm		105.5	118.7	128.3	137.57	145.76	145.59	147.94

Formulat e ndarjes së Grantit të Përgjithshëm

Kriteret	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Të hyrat e buxhetuar në buxhetin e Kosovës (m€)	1,457.6	1,455.9	1,479.4
Granti I Përgjithshëm (10%)	10%	145,760,000	147,940,000
Shuma e keqes	140,000	3,636,657	3,636,657
Popullsia	142,123,343	141,953,343	144,303,343
Madhësia gjeografike	89%	126,489,775	126,338,475
Popullsia gjeografike	6%	8,527,401	8,658,201
Popullsia Paketë	3%	4,263,700	4,329,100
Komuna me Popullsi Paketë	2%	2,842,467	2,880,067
Gjithësej		142,123,343	144,303,343

(në mill. €)			
Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	
1,571.8	1,572.5	1,598.2	Të hyrat e përgjithshme (sipas Madkos)
(114.2)	(116.6)	(118.8)	Të hyrat vetanake (niveli Komunal dhe Qendror)
1,457.6	1,455.9	1,479.4	

Komuna	Kriteret për ndarjen e Grantit të Përgjithshëm					Granti I Përgjithshëm për vitin 2015					Granti I Përgjithshëm për vitin 2016		Granti I Përgjithshëm për vitin 2017	
	Popullsia 89%	Madhësia gjeografike 6%	Popullsia Paketë në Komunë 5%	Komuna me popullsi paketë 3%	Komuna me popullsi paketë 2%	Shuma Fitese Popullsia (140,000-€)	Shuma për Popullsi (89%)	Shuma për madhësi gjeografike (6%)	Shuma për popullsi paketë në komunë (3%)	Shuma për Komuna me popullsi paketë (2%)	Total Granti i Përgjithshëm 2015 Viti	Total Granti i Përgjithshëm 2016	Total Granti i Përgjithshëm 2017	
1 Degan	40,019	2,25%	297	2,73%	551	0,51%	99,981	2,643,783	232,437	21,768	-	3,197,970	3,194,264	3,245,489
2 Dragash	33,997	1,91%	430	3,95%	13,559	12,56%	106,003	2,415,855	336,526	535,659	-	3,394,042	3,390,110	3,444,477
3 Ferizaj	108,610	6,10%	346	3,17%	4,193	3,89%	31,390	7,717,917	270,003	165,648	-	8,184,958	8,175,205	8,310,024
4 Fushë Kosovë	34,827	1,96%	83	0,76%	4,511	4,18%	105,173	2,474,836	64,957	178,211	-	2,823,176	2,819,925	2,864,867
5 Gjakovë	94,556	5,31%	587	5,39%	6,679	6,19%	45,444	6,719,228	459,396	263,859	-	7,487,928	7,479,025	7,602,086
6 Gjiçan	90,178	5,07%	392	3,60%	2,264	2,10%	49,822	6,406,124	306,786	89,441	-	6,854,173	6,846,034	6,958,543
7 Gjatoc	58,531	3,29%	276	2,53%	45	0,04%	81,669	4,159,262	216,602	1,778	-	4,458,511	4,453,275	4,525,649
8 Hani i Elezit	9,403	0,53%	83	0,76%	44	0,04%	130,597	666,195	64,957	1,738	-	865,478	864,598	876,750
9 Istog	39,289	2,21%	454	4,17%	3,085	2,86%	100,711	2,791,908	365,308	121,875	-	3,369,804	3,365,893	3,419,948
10 Junik	6,084	0,34%	74	0,68%	4	0,00%	133,916	432,334	57,914	158	-	624,322	623,735	631,844
11 Kacanik	33,409	1,89%	211	1,94%	36	0,03%	106,591	2,374,071	165,132	1,422	-	2,642,217	2,644,178	2,686,187
12 Kamennicë	36,085	2,03%	424	3,89%	1,684	1,73%	103,915	2,654,230	331,830	73,639	-	3,073,614	3,070,062	3,119,165
13 Klinë	38,496	2,16%	308	2,84%	1,241	1,15%	101,504	2,735,558	241,829	49,027	-	3,127,917	3,124,297	3,174,339
14 Leposaviq	13,773	0,77%	538	4,96%	323	0,30%	126,227	976,221	421,831	12,760	631,125	2,170,664	2,168,218	2,202,023
15 Lipjan	57,605	3,24%	338	3,10%	3,107	2,89%	82,395	4,093,459	284,525	122,744	-	4,563,123	4,557,764	4,631,852
16 Malishevë	54,613	3,07%	306	2,81%	54	0,05%	86,357	3,880,845	239,481	2,133	-	4,207,847	4,202,915	4,271,080
17 Mamusha	5,507	0,31%	32	0,28%	379	0,35%	134,493	391,332	25,044	14,973	282,348	818,191	817,373	828,678
18 Mitrovicë	71,909	4,04%	331	3,04%	2,199	2,04%	5,106,913	5,109,913	259,046	86,873	-	5,523,924	5,517,398	5,607,610
19 Novo Bredë	6,729	0,36%	204	1,87%	3,202	2,97%	133,271	478,188	159,654	126,487	-	897,591	896,677	908,315
20 Obiliq	21,549	1,21%	105	0,96%	1,655	1,53%	118,451	1,531,290	82,175	65,382	-	1,797,298	1,795,290	1,823,049
21 Pejë	96,450	5,42%	603	5,53%	8,334	7,72%	43,550	6,853,817	471,918	329,241	-	7,689,527	7,689,370	7,815,945
22 Podujevë	88,499	4,87%	633	5,81%	849	0,79%	51,501	6,288,813	485,397	33,540	-	6,861,096	6,861,096	6,973,827
23 Prishtinë	198,897	11,17%	514	4,72%	4,146	3,84%	14,133,787	402,265	163,791	1,637,91	-	14,689,843	14,682,260	14,925,321
24 Prizren	177,781	9,89%	603	5,53%	31,682	29,36%	12,633,266	471,918	1,251,622	1,251,622	-	14,356,806	14,339,634	14,577,022
25 Rahovec	56,208	3,16%	278	2,55%	944	0,87%	83,792	3,994,187	217,568	37,293	-	4,332,840	4,327,758	4,398,016
26 Shitërcë	6,949	0,39%	248	2,25%	3,182	2,95%	133,051	493,802	194,089	125,707	-	946,649	945,676	959,129
27 Shitërcë	27,324	1,54%	134	1,23%	858	0,79%	112,676	1,941,666	104,871	33,896	-	2,193,109	2,190,620	2,228,020
28 Skenderaj	50,858	2,86%	374	3,43%	1,09	0,10%	89,142	3,614,012	292,699	4,306	-	4,000,159	3,995,481	4,060,149
29 Suharekë	59,722	3,36%	361	3,31%	575	0,53%	80,278	4,243,895	282,525	22,716	-	4,629,414	4,623,972	4,699,192
30 Vushtri	46,987	2,64%	270	2,48%	258	0,24%	3,338,935	211,307	10,192	-	-	3,653,448	3,649,189	3,708,060
31 Vuçitri	69,870	3,83%	346	3,17%	960	0,89%	70,130	4,965,020	271,003	37,926	-	5,343,079	5,336,722	5,423,960
32 Zhdin Pochk	6,616	0,37%	333	3,06%	995	0,92%	133,334	471,138	260,612	39,308	303,167	1,205,609	1,205,376	1,223,071
33 Zveçan	7,481	0,42%	123	1,13%	386	0,36%	132,519	531,606	96,262	15,249	342,804	1,116,441	1,117,261	1,133,563
34 Grahovac	10,675	0,60%	131	1,20%	3,423	3,17%	129,325	755,574	102,523	135,228	489,164	1,614,815	1,613,038	1,637,600
35 Sllkoc	2,556	0,14%	23	0,21%	1,193	1,11%	137,444	181,631	18,000	47,130	-	384,206	383,914	387,991
36 Mitrovica e verit	12,326	0,69%	5	0,05%	867	0,80%	127,674	87,896	3,913	34,252	564,818	1,605,533	1,604,784	1,629,237
37 Prishtinë	1,787	0,10%	29	0,27%	2	0,00%	138,213	126,998	22,996	79	81,886	369,860	369,593	373,413
38 Prillëviz	3,866	0,22%	69	0,63%	168	0,16%	136,134	277,421	54,001	6,637	177,153	648,646	648,033	656,507
TOTAL	1,780,021	100%	10,896	100%	107,926	100%	62,031	3,636,657	126,489,775	8,527,401	4,263,700	2,842,467	145,760,000	147,940,000

1.2 Granti specifik për Arsim

Granti Specifik për Arsim sipas LFPL bazohet në qasjen me sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret dhe parametra në formulën shtetërore të arsimit nga MASHT përfshirë politikat e arsimit parauniversitar për vitin 2015.

Komisioni i Granteve ka aprovuar Grantin specifik të Arsimit parauniversitar për vitin 2015 në shumë prej 144,230,328 euro, nga të cilat: 143,894,328 euro paraqet grantin bazë të arsimit parauniversitar për vitin 2015, ndërsa shuma prej 0.34 milion euro përfshinë politikat e arsimit në vazhdim nga MASHT-i.

Financimi i grantit specifik të arsimit parauniversitar për vitin 2015, i aprovuar nga Komisioni i Granteve për periudhën e KASH-it, synon të mbështesë objektivat e MASHT-it për arsimin parauniversitar.

Formula shtetërore e arsimit parauniversitar trajton në veçanti nivelin e shkollave parafillore, fillore dhe të mesme. Pra, fokusi i shkollave profesionale, shkollat në viset malore, ngritjen e mësimdhënësve në karrierë, zhvillimin profesional të mësimdhënësve apo trajnimet pa shkëputje nga puna, personelin bazë për shkollat e reja, reformën e financimit në nivel të shkollës dhe pedagogët për secilën shkollë.

Formula shtetërore e arsimit nuk trajton: shkollat speciale dhe investimet e mëdha kapitale.

Formula e financimit për grantin specifik të arsimit, është si në vijim:

Alokimi komunal = Pagat për mësimdhënës + Pagat për personel administrativ dhe ndihmës + Mallrat dhe Shërbimet + Kapitalet e vogla + Politikat arsimore.

Implikimet bazë për kalkulimin e grantit të arsimit parauniversitar nga MASHT, janë si vijon:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2013/2014;
- b) Pagat e mësimdhënësve sipas listës së pagave dhe mesatarja e pagës që duhet përfshirë rritjet nga licencimi dhe kostoja për rritjen e pagave prej 25% sipas Vendimit të Qeverisë Nr.01/176 datë 10.03.2014 (të rishikohet propozimi nga MASHT);
- c) Mallrat dhe shërbimet sipas nxënësve, me parametrat e njëjtë;
- d) Përpjesëtimi nxënës-mësimdhënës i njëjtë për nivelin fillor dhe të mesëm, përjashtuar shkollat profesionale (raporti për komunitetin shumicë 1:21.3 dhe për komunitetin pakicë 1:14.2).

Tabela: Granti specifik i Arsimit parauniversitar për vitin 2015

Granti specifik për Arsim për vitin 2015-2017										
Nr	Komuna	Numri i nxënësve parafillor dhe fillor	Numri i nxënësve të sh. Mesme	TOTAL NUMRI I NXËNËSVE	Granti specifik për Arsim për vitin 2015 - bazë	Politikat në vazhdim nga MASHT		Total Granti specifik për Arsim për vitin 2015	Vlerësimi për vitin 2016	Vlerësimi për vitin 2017
						Numri i mësimdhënësve në Qendrat e Kompetencës	Financimi për Qendrat e Kompetencës			
TOTAL		320,113	94,783	414,896	143,894,328	70	336,000	144,230,328	145,669,274	146,369,899
1	Deçan	5,231	1,916	7,147	2,335,075		-	2,335,075	2,358,371	2,369,714
2	Dragash	4,642	644	5,286	2,302,135		-	2,302,135	2,325,103	2,336,286
3	Ferizaj	20,848	6,700	27,548	9,983,546	35	168,000	10,151,546	10,252,825	10,302,138
4	Fushë Kosovë	6,122	1,431	7,553	2,377,659		-	2,377,659	2,401,380	2,412,930
5	Gjakovë	16,342	4,662	21,004	7,004,055		-	7,004,055	7,073,932	7,107,956
6	Gjilan	16,508	6,004	22,512	8,434,193		-	8,434,193	8,518,339	8,559,309
7	Gillogoc	10,945	2,964	13,909	4,776,086		-	4,776,086	4,823,735	4,846,936
8	Hani i Elezit	1,602	402	2,004	657,149		-	657,149	663,705	666,897
9	Istog	6,920	1,893	8,813	3,046,842		-	3,046,842	3,077,240	3,092,040
10	Junik	696	238	934	390,710		-	390,710	394,608	396,506
11	Kaçanik	5,833	1,597	7,430	2,543,525		-	2,543,525	2,568,901	2,581,256
12	Kamenicë	4,861	1,749	6,610	2,552,349		-	2,552,349	2,577,813	2,590,212
13	Klinë	7,405	1,872	9,277	3,235,182		-	3,235,182	3,267,459	3,283,174
14	Leposaviq	1,788	451	2,239	756,462		-	756,462	764,009	767,684
15	Lipjan	11,473	2,768	14,241	4,788,278		-	4,788,278	4,836,050	4,859,309
16	Malishevë	12,640	3,171	15,811	5,734,881		-	5,734,881	5,792,096	5,819,954
17	Mamusha	804	42	846	359,283		-	359,283	362,867	364,613
18	Mitrovicë	13,301	4,243	17,544	5,942,343		-	5,942,343	6,001,628	6,030,494
19	Novobërdë	1,158	210	1,368	673,459		-	673,459	680,178	683,449
20	Obiliq	4,466	740	5,206	1,786,246		-	1,786,246	1,804,067	1,812,744
21	Pejë	16,241	5,166	21,407	7,244,248		-	7,244,248	7,316,522	7,351,712
22	Podujevë	17,859	4,373	22,232	7,296,487		-	7,296,487	7,369,282	7,404,726
23	Prishtinë	35,809	11,385	47,194	15,042,433		-	15,042,433	15,192,507	15,265,578
24	Prizren	27,336	7,634	34,970	12,794,591	35	168,000	12,962,591	13,091,916	13,154,884
25	Rahovec	10,282	2,589	12,871	4,413,520		-	4,413,520	4,457,552	4,478,992
26	Shtërpcë	1,826	695	2,521	924,102		-	924,102	933,322	937,811
27	Shtime	5,466	1,543	7,009	2,438,510		-	2,438,510	2,462,838	2,474,684
28	Skenderaj	9,932	2,936	12,868	4,977,597		-	4,977,597	5,027,257	5,051,436
29	Suharekë	11,019	3,091	14,110	5,104,092		-	5,104,092	5,155,014	5,179,809
30	Viti	8,902	2,655	11,557	3,898,703		-	3,898,703	3,937,599	3,956,538
31	Vushtrri	12,847	3,644	16,491	5,596,231		-	5,596,231	5,652,063	5,679,247
32	Zubin Potok	1,019	270	1,289	379,176		-	379,176	382,959	384,801
33	Zveçan	871	254	1,125	323,938		-	323,938	327,170	328,744
34	Klllokot	520	151	671	1,385,453		-	1,385,453	1,399,275	1,406,005
35	Mitrovica e veriut	2,563	2,311	4,874	235,022		-	235,022	237,366	238,508
36	Partesh	467	331	798	1,450,219		-	1,450,219	1,464,688	1,471,732
37	Ranillug	890	380	1,270	318,281		-	318,281	321,457	323,003
38	Graçanicë	2,679	1,678	4,357	392,269		-	392,269	396,182	398,088

Tabela: Granti specifik i Arsimit parauniversitar për vitin 2015 dhe historiku 2012-2014

ANALIZA:	Viti	Viti	Viti	Viti
Granti specifik për Arsim parauniversitar	2012	2013	2014	2015
Shuma totale (€) Kalkulimet	140,315,623	141,185,995	142,559,329	144,230,328
Total numri i nxënësve	458,878	454,964	435,965	414,896
Nxënës në shkollat fillorë, parafillorë dhe nevoja të veçanta	344,132	339,318	325,350	320,113
Shumicë	334,101	328,027	315,775	309,482
Pakicë	10,031	11,291	9,575	10,631
Nxënës në shkollat të mesme	114,746	115,646	110,615	94,783
Shumicë	111,811	112,326	108,110	92,131
Pakicë	2,935	3,320	2,505	2,652
Numri i Shkollave	1,303	1,300	1,303	1,326
Shkolla fillore	1,170	1,137	1,131	1,166
Shkolla të mesme	133	163	172	160
Total i Mësimdhënësve (fillor dhe të mesëm)	24,835	24,929	24,972	24,083
Numri i mësimdhënësve për nivelin fillor	17,922	17,790	17,137	16,926
Numri i mësimdhënësve për nivelin e mesëm	6,412	6,472	6,192	5,327
Mësimdhënësit shtesë për zonat malore	501	667	1,338	1,525
Numri i mësimdhënësve të gjuhës angleze			305	305
Arsimi special (transfer nga niveli qendror/MASHT në komuna)				
Stafi			76	76
Kalkulimi bazë	139,102,177	140,315,623	142,223,329	143,894,328
Politikat në vazhdim dhe të reja nga MASHT	1,213,446	870,372	336,000	336,000
Kosto e Licencimit	778,260			
Pedagogë (222 pedagogë shtesë)				
Qendra e ekselencës	435,186	870,372	336,000	336,000

1.3 Granti specifik për Shëndetësi primare

Granti specifik për Shëndetësi dhe përcaktimi i shumës së këtij granti bazohet në një qasje me sistem të hapur të financimit në përputhje me LFPL.

Komisioni i Granteve ka aprovuar grantin specifik për shëndetësi primare për vitin 2015 në shumë prej 42,085,037 euro.

Propozim-granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2015 nga MSH, është bazuar në formulën për kokë banori- numrit të vizitave shëndetësore X kostoja mesatare për vizitë, dhe numrit të shërbimeve X kostoja mesatare për shërbime.

Kriteret e aprovuara nga Komisioni i Granteve janë, si vijon:

- 2.5 vizita për kokë banori me një kosto prej 4 € për një vizitë, dhe
- 3.5 shërbime për kokë banori me një kosto prej 3.9 € për një shërbim.

Tabela: Granti specifik për Shëndetësi për periudhën 2015-2017

Granti Specifik për Shëndetësi për vitin 2015-2017									
Nr.	Komuna	Popullsia	Viti 2015				Totali 2016	Total 2017	
			Numri i vizitave		Numri i shërbimeve				Total 2015
			2.5 vizita për kokë banori	4 euro për vizitë	3.5 mesatarja për kokë banori	3.9 euro për shërbime			
1	Deçan	40,019	100,048	400,190	140,067	545,979	946,169	987,423	1,009,906
2	Dragash	33,997	84,993	339,970	118,990	463,821	803,791	838,837	857,937
3	Ferizaj	108,610	271,525	1,086,100	380,135	1,481,766	2,567,866	2,679,829	2,740,845
4	Fushë Kosovë	34,827	87,068	348,270	121,895	475,145	823,415	859,317	878,882
5	Gjakovë	94,556	236,390	945,560	330,946	1,290,028	2,235,588	2,333,062	2,386,183
6	Gjilan	90,178	225,445	901,780	315,623	1,230,298	2,132,078	2,225,040	2,275,701
7	Gllgovc	58,531	146,328	585,310	204,859	798,538	1,383,848	1,444,186	1,477,068
8	Hani i Elezit	9,403	23,508	94,030	32,911	128,285	222,315	232,008	237,291
9	Istog	39,289	98,223	392,890	137,512	536,020	928,910	969,412	991,484
10	Junik	6,084	15,210	60,840	21,294	83,004	143,844	150,116	153,534
11	Kaçanik	33,409	83,523	334,090	116,932	455,799	789,889	824,329	843,098
12	Kamenicë	36,085	90,213	360,850	126,298	492,308	853,158	890,356	910,629
13	Klinë	38,496	96,240	384,960	134,736	525,201	910,161	949,845	971,472
14	Leposavic	13,773	34,433	137,730	48,206	187,905	325,635	339,833	347,571
15	Lipjan	57,605	144,013	576,050	201,618	785,905	1,361,955	1,421,338	1,453,700
16	Malishevë	54,613	136,533	546,130	191,146	745,085	1,291,215	1,347,514	1,378,195
17	Mamushë	5,507	13,768	55,070	19,275	75,132	130,202	135,879	138,973
18	Mitrovicë	71,909	179,773	719,090	251,682	981,054	1,700,144	1,774,273	1,814,671
19	Novobërdë	6,729	16,823	67,290	23,552	91,804	159,094	166,030	169,811
20	Obiliq	21,549	53,873	215,490	75,422	293,993	509,483	531,697	543,803
21	Pejë	96,450	241,125	964,500	337,575	1,315,867	2,280,367	2,379,794	2,433,979
22	Podujevë	88,499	221,248	884,990	309,747	1,207,392	2,092,382	2,183,612	2,233,330
23	Prishtinë	198,897	497,243	1,988,970	696,140	2,713,552	4,702,522	4,907,558	5,019,297
24	Prizren	177,781	444,453	1,777,810	622,234	2,425,466	4,203,276	4,386,545	4,486,420
25	Rahovec	56,208	140,520	562,080	196,728	766,846	1,328,926	1,386,869	1,418,446
26	Shtërpcë	6,949	17,373	69,490	24,322	94,805	164,295	171,459	175,363
27	Shtime	27,324	68,310	273,240	95,634	372,781	646,021	674,189	689,539
28	Skenderaj	50,858	127,145	508,580	178,003	693,856	1,202,436	1,254,863	1,283,435
29	Suharekë	59,722	149,305	597,220	209,027	814,787	1,412,007	1,473,573	1,507,124
30	Viti	46,987	117,468	469,870	164,455	641,044	1,110,914	1,159,351	1,185,748
31	Vushtrri	69,870	174,675	698,700	244,545	953,236	1,651,936	1,723,963	1,763,215
32	Zubin Potok	6,616	16,540	66,160	23,156	90,262	156,422	163,242	166,959
33	Zveçan	7,481	18,703	74,810	26,184	102,063	176,873	184,585	188,788
34	Graçanicë	10,675	26,688	106,750	37,363	145,639	252,389	263,394	269,391
35	Klllokot	2,556	6,390	25,560	8,946	34,872	60,432	63,066	64,502
36	Mitrovica Veriore	12,326	30,815	123,260	43,141	168,164	291,424	304,130	311,055
37	Partesh	1,787	4,468	17,870	6,255	24,380	42,250	44,092	45,096
38	Ranillug	3,866	9,665	38,660	13,531	52,744	91,404	95,389	97,561
	Gjithsej	1,780,021	4,450,053	17,800,210	6,230,074	24,284,827	42,085,037	43,920,000	44,920,000

1.4 Shëndetësia sekondare: spitalet në komunat me kompetenca të zgjeruara:

Implementimi i Strategjisë sektoriale të Ministrisë së Shëndetësisë synon arritjen e objektivave strategjike të definuar.

Komunat minoritare që kanë përfituar nga kompetencat e zgjeruara për vitin 2011 janë:

- Komuna e Graçanicës, financimi prej 1,120, 771 euro
- Komuna e Shtërpcës, financimi prej 522,371 euro dhe
- Komuna e Mitrovicës së veriut, financimi prej 989,935 euro.

Komunat minoritare që kanë përfituar nga kompetencat e zgjeruara për vitin 2012 janë:

- Komuna e Shtërpcës, financimi prej 522,371 euro dhe
- Komuna e Mitrovicës së veriut, financimi prej 989,935 euro
- Komuna e Graçanicës, financimi prej 1,090,771 euro.

Komunat minoritare që kanë përfituar nga kompetencat e zgjeruara për vitin 2013 janë:

- Komuna e Shtërpcës, financimi prej 522,371 euro dhe
- Komuna e Mitrovicës së veriut, financimi prej 989,935 euro
- Komuna e Graçanicës, financimi prej 1,090,771 euro.

Komunat minoritare që kanë përfituar nga kompetencat e zgjeruara për vitin 2014 janë:

- Komuna e Shtërpcës, financimi prej 344,544 euro dhe
- Komuna e Mitrovicës së veriut, financimi prej 699,000 euro
- Komuna e Graçanicës, financimi prej 801,801 euro.

Financimi për shëndetësinë sekondare për vitin 2015

Komisioni i Granteve me datë 22 prill 2014 ka aprovuar financimin për kompetencat e zgjeruara/shëndetësinë sekondare për vitin 2015 në shumë prej 2,603,077 euro.

Komunat minoritare që kanë përfituar nga kompetencat e zgjeruara për vitin 2015 janë:

- Komuna e Shtërpcës, financimi prej 522,371 euro dhe
- Komuna e Mitrovicës së veriut, financimi prej 989,935 euro
- Komuna e Graçanicës, financimi prej 1,090,771 euro.

1.5 Financimi i Shërbimeve rezidenciale në komunat Skenderaj dhe Graçanicë

Komisioni i Granteve në takimin e datës 22 prill 2014, ka shqyrtuar dhe aprovuar propozimin e MPMS për financimin e shërbimeve rezidenciale për dy shtëpitë e komunitetit në komunat Skenderaj dhe Graçanicë, si në vijim:

Tabela: Financimi buxhetor për vitin 2015

Komunat	Stafi	Paga dhe Mëditje	Mallëra dhe Shërbime	Komunale	Subvencione	Kapitale	Total
<i>Skenderaj</i>	13	60,000	50,000	10,000	3,000	10,000	133,000
<i>Graçanicë</i>	11	50,000	40,000	8,000	2,000	10,000	110,000

1.6 Të hyrat Vetanake Komunale

Financimi komunal nga të hyrat vetanake komunale për vitin 2015, të parashikuar në KASH Komunal 2015-2017, bazohet në dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Të hyrat vetanake komunale për vitin 2015 përfshijnë të hyrat e planifikuara nga vet komunat, të cilat janë aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 74,243,213 euro.

Tabela – Të hyrat vetanake komunale për vitin 2015

Projektimi (mil €)	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
<i>Të hyrat Vetanake të Komunave</i>	51.88	60.00	63.00	67.23	74.24	75.62	76.80

Të Hyrat Vetanake Komunale për vitin 2015-2017				
Nr.	Komunat	Projeksionet 2015	Parashikimi 2016	Parashikimi 2017
1	Deçan	636,892	649,402	656,402
2	Dragash	487,030	473,800	496,115
3	Ferizaj	4,204,689	4,283,119	4,302,670
4	Fushë Kosovë	1,822,756	1,878,756	1,791,756
5	Gjakovë	3,026,311	2,977,911	3,035,911
6	Gjilan	3,859,953	3,959,953	4,059,953
7	Glllogoc	1,200,874	1,312,774	1,375,274
8	Hani i Elezit	256,258	259,678	263,808
9	Istog	1,014,149	1,020,249	1,023,299
10	Junik	91,567	91,767	92,367
11	Kaçanik	695,757	708,735	710,157
12	Kamenicë	986,433	966,433	966,433
13	Klinë	857,767	869,767	881,767
14	Leposaviq	42,888	42,888	42,888
15	Lipjan	1,342,336	1,345,575	1,359,375
16	Malishevë	755,908	803,908	825,908
17	Mamusha	64,869	64,869	64,869
18	Mitrovicë	2,117,292	2,267,582	2,358,772
19	Novobërdë	204,672	208,488	227,960
20	Obiliq	811,716	826,857	865,467
21	Pejë	3,394,551	3,427,687	3,553,918
22	Podujevë	1,597,592	1,632,592	1,643,592
23	Prishtinë	27,162,609	27,378,053	27,624,299
24	Prizren	8,275,080	8,274,961	8,382,028
25	Rahovec	1,099,014	1,158,014	1,207,014
26	Shtërpcë	336,282	342,555	345,055
27	Shtime	445,503	451,788	459,224
28	Skenderaj	748,155	680,510	721,385
29	Suharekë	2,117,200	2,601,692	2,741,085
30	Viti	1,008,847	1,027,665	1,027,665
31	Vushtrri	1,675,327	1,703,418	1,703,418
32	Zubin Potok	42,888	42,888	42,888
33	Zveçan	42,888	42,888	42,888
34	Gracanicë	1,501,093	1,501,093	1,501,093
35	Klllokot	86,849	87,849	88,849
36	Mitrovica veriore	90,066	120,166	170,716
37	Partesh	46,384	47,249	48,134
38	Ranillug	92,768	94,498	95,598
Total		74,243,213	75,628,077	76,800,000

2 Transferi i kompetencave të bartura dhe të deleguara

Strategjia e financimit komunal në KASH Komunal ofron këto parime:

Kompetencat e deleguara -Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin.

Kompetencat e deleguara duhet, në të gjitha rastet, të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

3 Komunat e reja - decentralizimi

Me zgjedhjet komunale të vitit 2009 dhe 2010 janë themeluar 4 komuna të reja nga gjithsej 5+1 komuna, përfshirë zgjerimin e komunës së Novobërdës, të dalura sipas pakos për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës.

Ky proces do të vazhdoj me zgjedhjet lokale për komunën e Mitrovicës veriore, të përkrahur me përkushtim nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të inkurajuar dhe siguruar pjesëmarrjen aktive në jetën publike dhe për të fuqizuar qeverisjen e mirë dhe efektivitetin e shërbimeve publike në Kosovë.

Komunat e reja në Kosovë kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për atë që ato kanë të bëjnë me interesin lokal sipas kuadrit ligjor, duke respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Po ashtu, për vitin 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015 është bërë ndarja e granteve qeveritare për komunat e reja në pajtim të plotë me parimet, kriteret dhe formulat e përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Si rrjedhojë e procesit të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, ka rezultuar konstituimi i katër komunave veriore si: Mitrovicë veriore, Lepsaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, dhe sipas kërkesës së MAPL dhe komunave përkatëse në fokus do të jetë ndikimi financiar brenda strukturës së buxhetit përkatësisht në kategoritë ekonomike dhe stafit shtesë.